

TRAFIKIMI NJERËZOR  
NË EUROPËN JUGLINDORE DHE LINDORE  
PROBLEME DHE PERSPEKTIVA

© OJF-të/ anëtarë të rrjetit (lista faqe 4) për raportet përkatëse kombëtare

RRJETI ARIADNE  
kundër  
Trafikimit të qënieve njerëzore  
në Europën Juglindore dhe Lindore

PROJEKT I PËRBASHKËT MBI SITUATËN E TRAFIKIMIT  
TË QËNIEVE NJERËZORE NË DYMBËDHJETË SHTETET TË  
PËRFSHIRA NË RRJET

Edituar nga



Human Rights Defence Centre  
(Koordinator i Rrjetit)

Bashkë-financuar nga  
Ministria e Punëve të Jashtme të Greqisë (HELLENIC AID)  
Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë  
dhe Ambasada e Kanadasë në Greqi

NGO/members of ARIADNE Network

Albania

Albanian Rehabilitation Centre  
for Trauma and Torture  
Victims-ARCT

Useful to Albanian Women  
Association

Bosnia & Herzegovina  
Association “Zena B&H”

Mostar

Bulgaria

Assistance Centre for Torture  
Survivors -ACET

Bulgarian Gender Research  
Foundation- BGRF

Croatia

Croatian Law Centre-CLC

The Former Yugoslav  
Republic of Macedonia

Association for support and  
protection of families and  
children at risk

“FOR HAPPY CHILDHOOD”

Helsinki Committee for  
Human Rights of the Republic  
of Macedonia

Greece

Association for the Social  
Support of Youth-ARSIS  
Human Rights Defence Centre-  
KEPAD

Moldova

International Women’s Rights  
Protection and Promotion

Center

“La Strada”

Romania

ARCA-Romanian Forum for  
Refugees and Migrants

Serbia:

Lawyers Committee for  
Human Rights-YUCOM

Kosovo (administered by  
UNMIK)

Centre for Protection of  
Women and Children

Montenegro

Montenegrin Women’s

Lobby

Turkey

Human Resource

Development Foundation-  
HRDF

Ukraine

International Women’s

Rights Center “La Strada  
Ukraine”

	Shqipëri	Montenegro
	<i>ARCT</i>	<i>Montenegrin</i>
	Valmira Skendi	<i>Womens' Lobby</i>
	<i>Useful to Albanian</i>	Mirjana Vlahovic
	<i>Women</i>	
	Sevim Arbana	Romania
		<i>ARCA</i>
	Bosnia &	Stoian Gina Maria
Editimi	Herzegovina	
	<i>Zena BiH</i>	Serbia
<i>Human Rights</i>	Mostar Team	<i>YUCOM</i>
<i>Defence Centre</i>		Zorka Kovacevic
<i>(KEPAD)</i>	Bulgaria	
Maria Vassiliou	<i>ACET, BGRF</i>	Kosovo
Stamatia Kyriazi	Genoveva Tisheva	<i>CPWC</i>
Olga Fylaktaki	Iliana Stoycheva	Naime Sherifi
Theofania Antoniou		Kaltrina Kelmendi
Maria Vogiatzi	Croatia	Valdete Qahili
Danai Azaria	<i>CLC</i>	
Efie Simiakaki	Lovorka Marinović	Turkey
Stavroula Pouloupati		<i>HRDF</i>
	FYROM	Tuba Dundar
	<i>MHC, "Happy</i>	
	<i>childhood"</i>	Ukraine
	Verica Stamenkova	<i>"La Strada"</i>
	Trajkova	<i>Ukraine</i>
	Bobi Badarevski	Kateryna
	Zarko Trajanoski	Levchenko Olga
		Kalashnyk
	Greece	Ludmila
	<i>KEPAD, ARSIS</i>	Kovalchuk
	Stamatia Kyriazi	Tetyana Doroshok
	Sophia Liakou	Mariana
	Olga Fylaktaki	Evsyukova
		Kateryna

Moldova  
“*La Strada*”  
*Moldova*  
Tatiana Fomina  
Ana Revenco

Cherepakha

Kërkuesit

## Përmbajtja

Hyrje....7

Raportet kombëtare të OJF-ve/anëtare të Rrjetit ARIADNE

Shqipëri.....10

Bosnja dhe Herzegovina.....25

Bullgaria.....42

Kroacia.....63

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.....83

Greqi.....103

Moldavi.....123

Mali i Zi.....159

Rumania.....172

Serbi.....191

Kosovë.....211

Turqi.....228

Ukrainë.....248

Aneks.....:277

Hyrje

Me inisiativën e Human Rights Centre (KEPAD) Rrjeti *ARIADNE kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore në Europën Juglindore dhe Lindore* u krijua në Qershor 2005 me vendodhje në Athinë, Greqi. Anëtarët themelues të Rrjetit janë 17 OJF nga 12 vende të rajonit të Europës Juglindore dhe Lindore (Shqipëri, Bosnje & Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Ish republika e Maqedonisë, Greqi, Moldavi, Mali I Zi, Rumani, Serbi, Turqi dhe Ukrainë). KEPAD ka mandatin e Koordinatorit të Rrjetit.

Objektivi kryesor i Rrjetit është të zhvillojë një bashkëpunim koordinues të ngushtë ndërmjet shteteve të origjinës, transitit dhe destinacionit të viktimave, për zhvillimin e aktiviteteve kundër trafikimit në mbështetje të viktimave dhe parandalimit të fenomenit. Publikimi aktual është frut i projektit të parë të përbashkët të Rrjetit, që ka të bëjë me “Paraqitja e Situatës Aktuale të Trafikimit të Qënieve Njerëzore në dymbëdhjetë vendet anëtare të Rrjetit”.

Raportet kombëtare të paraqitura në këtë vëllim u hartuan nga kërkues të drejtuar nga OJF-të partnerë në bashkëpunim me Agjensitë Shtetërore, Organizatat Ndërkombëtare dhe OJF të tjera lokale që janë të përfshira me këtë problem në shtetet përkatëse.

Objektivi i këtij projekti të përbashkët është të vërë në dukje mangësitë, boshllëqet dhe hapësirat boshe në çështjen e trafikimit të qënieve njerëzore dhe të bëjë rekomandime për përmirësimin e situatës në shtetet pjesëmarrëse.

Duke u bazuar në vlerësimin e situatës dhe të nevojave, anëtarët e Rrjetit do të vazhdojnë me miratimin e një plani veprimi për projekte të tjera të përbashkëta që do të adresojnë përparësitë e përcaktuara nga OJF-të partnere për shtetin përkatës në fushën e trafikimit të qënieve njerëzore.

Publikimi në gjuhën angleze është përkthyer në çdo njëërën prej gjuhëve kombëtare të shteteve pjesëmarrëse në këtë projekt. Publikimi do të shpërndahet në agjensitë shtetërore, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të interesuar që janë aktivë në fushën e trafikimit të qënieve njerëzore.

Target grupet e këtij projekti janë:

Viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të qënieve njerëzore (përfitues të drejtpërdrejtë), gra, fëmijë dhe burra, të cilët janë zakonisht viktimat e fenomeneve sociale si: varfëria, papunësia, mungesa e edukimit, etj.



Agjensitë shtetërore dhe institutet aktive në fushën e trafikimit të qënieve njerëzore duke I ndërgjegjësuar për situatën aktuale në shtetet përkatëse, si edhe në shtetet fqinjë (originë, tranzit dhe destinacion). Opinioni publik, I cili do të ndërgjegjësohet më tepër për problemet e përfshira në trafikimin e qënieve njerëzore, duke bërë të mundur përpjekjen e përbashkët për përmirësimin e situatës.

OJF-të (përfitues jo të drjetpërdrejtë), të cilët do të pasurojnë njohuritë e tyre dhe aftësitë për një plan të përbashkët koordinues kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

Raportet kombëtare do të rishikohen çdo vit në mënyrë që të përfshihen ndryshimet në ligjet kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe implementimit të tyre, si edhe në zbatimin e praktikave për përmirësimin e situatës në këtë fushë.

Projekti I përbashkët është bashkëfinancuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Greqisë(HELLENIC AID), Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Ambasada e Kandasë në Greqi.

Bashkëpunimi ka përfshirë edhe Organizatën Ndërkombëtare të Migrimit (IOM), Misioni në Greqi, dhe Koordinatori Special i paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore, Zyra Selanik.

Human Rights Defence Centre, në emër të të gjithë partnerëve të Rrjetit, dëshiron të shprehë vlerësimin dhe falenderimin për të gjitha agjensitë shtetërore, organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të e tjera, për kontributin e çmuar në këtë kërkim dhe në zbatimin e plotë të këtij projekti.

Në përfundim, duam të theksojmë se këndvështrimet e shprehura në secilin prej raporteve kombëtare janë të OJF-ve individuale, të cilët janë autorët, dhe jo domosdoshmërisht të editorëve ose organizatës që koordinon Rrjetin ose të atyre që kanë ndihmuar në publikim e këtij botimi.

Maria Vassiliou  
Presidente  
Human Rights Defence Centre

# SHQIPËRI

## I. Hyrje

Shqipëria, më një popullësi prej 3.2 milionë banorë, është e vendosur në jugperëndim të Gadishullit të Ballkanit, ishte një nga vendet më pak të njohura në Europë. Nga viti 1944 deri 1991, ka qenë një regjim totalitar komunist që izoloji vendin nga bota. Që me rënien e qeverisë komuniste, Shqipëria ka kaluar një tranzicion social, politik dhe ekonomik. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë si urë kalimi për vendet lindore, e ka transformuar atë në një vend transiti për perëndimin për qytetarë të huaj si: Kurdë, Kinezë, Rumunë, Moldavë, etj. Në këtë aspekt, Shqipëria nuk është vetëm një vend origjinë, por gjithashtu edhe një vend transiti për gratë nga Moldavia, Rusia, Rumania, Bullgaria, etj për trafikimin në vendet perëndimore. Për shkak të natyrës komplekse të trafikimit të qënieve njerëzore, fshehtësisë së aktivitetit dhe mungesës së informacionit, është e vështirë të identifikosh zhvillim e tij gjatë kohës dhe të të përcaktosh numrin e grave të trafikuar për qëllime prostitucioni. Sipas Departamentit të Shtetit të SH.B.A-së, Raporti Vjetor për Trafikimin e Qënieve Njerëzore i vitit 2006 Shqipëria vazhdonte të ishte në vendet e Tier 2, mbasi ka kaluar nga Tier 3 në Tier 2 në 2002.

Një çështje delikate e trafikimit të qënieve njerëzore është trafikimi i fëmijëve për qëllime kriminale, si: lypja apo vjedhja. Trafikimi i fëmijëve për shitjen e organeve është një formë tjetër trafikimi. Në këtë raport Shqipëria në radhë të parë përshkruhet si një vend origjine për trafikimin e grave dhe fëmijëve për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe punës së detyruar. Viktimat trafikohen në Greqi dhe Itali dhe shumë prej tyre më tej në Mbretërinë e Bashkuar, Francë, Belgjikë, Norvegji, Gjermani dhe Vendet e Ulëta. Trafikim i brendshëm në Shqipëri dhe ri-trafikimi i viktimave shqiptare vazhdoi të ishte një problem në 2005. Vazhdon raportimi për fëmijë të komunitetit rom të trafikuar për qëllim punën e detyruar apo lypjen.

## II. Korniza Ligjore Kombëtare

### A. Ligji Kombëtar

Legjislacioni Shqiptar Kundër Trafikimit është miratuar që të përballet me fenomenin. Ligji 8733 of 24 Janar 2001 specifikon që “trafikimi i qënieve njerëzore, trafikimi i grave për prostitucion, trafikimi i

fëmijëve me qëllim përfitimin material ose çdo lloj tjetër përfitimi dënohet me *pesë deri në njëzetë vjet burgim ose burgim me jetë*". Neni 110/a i referohet trafikimit të qënieve njerëzore; neni 114/b trafikimit të grave për qëllime prostitucioni dhe neni 128/b me trafikimin e fëmijëve. Sipas ligjit, *dënimi* për trafikimin është rritur dhe një *përkufizimi* i ri i trafikimit, bazuar në përkufizimin e Protokollit të Palermos është realizuar.

“Trafikim i qënieve njerëzore nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë apo abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël ose dhënia apo marrja e pagesave ose të përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin atë për prostitucion ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbime të tjera të detyruara, skllavërinë ose praktikatat e ngjashme me skllavërinë, heqjen e organeve ose servitudet”.

Që nga Qershori 2001, sipas Legjislacionit Shqiptar, të gjithë personat e trafikuar, gra dhe fëmijë, konsiderohen si viktimat të trafikimit dhe nuk dënohen, edhe në rastet kur kanë kryer një veprim kriminal i lidhur me të qënurit i trafikuar si: prostitucioni, kalimi ilegal i kufinjve, etj. Që në këtë periudhë, një numër grash dhe fëmijësh të trafikuar janë ndihmuar të arratisen dhe asnjëri prej tyre nuk është gjykuar në mënyrë kriminale.

Në kuadër të ndryshimeve që i janë bërë legjislacionit, me qëllim parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Këshilli i Ministrave ka aprovuar *amendamentin* e nenit 298 të *Kodit Penal*, që të përballet në mënyrë më efektive me trafikimin e qënieve njerëzore. Gjithashtu është aprovuar edhe *Moratoriumi për Mjetet e Lundërimit, që ka si qëllim organizmin e operacioni*<sup>1</sup> “*Deti i Qetë*”.

## B. Marrëveshje Bilaterale/Rajonale

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshje për ripranimin e personave dhe lejimit të kalimit tranzit, me shtetet e mëposhtme: Republika e *Italisë*, më 11.09.1997; *Këshilli Federal Zvicerian*, më 02.02.2000; Republika e *Hungarisë*, më 20.03.2001, *Mbretëria e Belgjikës*, më 17.04.2002, Republika e *Bullgarisë*, më 07.06.2002,

---

<sup>1</sup> Ky është një Moratorium për Mjetet e Lundërimit për tre vjet me qëllim të parandalojë trafikimin nga deti.

Republika e *Rumanisë*, më 07.06.2002, Mbretëria e Bashkuar e *Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut*, më 15.10.2003 (Hyri në fuqi më 16.08.2005), Republika e *Kroacisë*, më 28.01.2003 (hyri në fuqi më 15.06.2005) dhe *Këshilli I Europës*, më 14.04.2005.

Një marrëveshje është nënshkruar, 27.02.2006, nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimë të trafikimit.

Protokolli i Zbatimit të Marrëveshjes së BE-së me Shtetet e Beneluksit (Belgjika, Luksemburgu, Holanda), është nënshkruar më 09.06.2005. Marrëveshja midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zvicerian, mbi bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit, më 21.09.2005.

### C. Plani Kombëtar i Veprimit

*Kuadri Strategjik dhe Plani Kombëtar i Veprimit për luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore 2005-2007* u hartua, duke u bazuar në përvojën dhe mësimet e dala nga të gjithë institucionet kombëtare përgjegjëse për vënien në zbatim të *Strategjisë Kombëtare Anti-Trafikim 2001-2004* të Shqipërisë dhe nga drafti përfundimtar qeveritar të *Planit Kombëtar të Veprimit* i viteve 2003-2004. Qëllimi i këtij Plani, si edhe Plani Kombëtar I Veprimit i viteve 2003-2004, është që të konsolidojë progresin e bërë gjatë periudhës draft të *Strategjisë Kombëtare Anti-Trafik të Shqipërisë* dhe në të njëjtën kohë të zhvillojë metoda të reja institucionale dhe ligjore, të përshtatur ndaj ndryshimeve të fenomenit të trafikimit dhe gjithashtu të zhvillojë metoda sistematike, të verifikueshme dhe të sakta për të vlerësuar rezultatet.

*Plani i Veprimit 2005-2007* mbulon nevojat e Shqipërisë në *fushat e mëposhtme*:

Hetim dhe ndjekje penale e krimeve të trafikimit;

Mbështetje dhe mbrojtje e viktimave dhe dëshmitarëve;

Parandalim i trafikimit dhe ri-trafikimit;

Kuadri bashkërendues

### III. Kuadër i përgjithshëm:

#### A. Ngritja e Kapaciteteve Njerëzore

Duke njohur rolin çelës të Policisë, *kurrikula të veçanta* në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore janë përfshirë në programin edukativ të Akademisë së Policisë. *Kurse trainimi* janë zhvilluar brenda dhe jashtë

Shqipërisë dhe gjithashtu janë organizuar *takime rajonale* për të diskutuar problemet anti-trafiking, me pjesëmarrjen e policisë, prokurorëve dhe përfaqësuesve të gjykatave.

Kurse trainimi janë organizuar për të gjithë forcat policore në të gjithë vendin, me qëllim dhënien e ndihmës ligjore dhe psikologjike për fëmijët, dëshmitarët dhe viktimat. Trainime të tjera mbi të drejtat e njeriut të viktimave të trafikut janë organizuar edhe për të gjithë nënpunësit e Prokurorive dhe Gjykatave. Kurse trainimi te veçantë janë organizuar për stafin policor fëmëror dhe nënpunëset e Prokurorive dhe Gjykatave, në poste pune të veçanta që lidhen me problemet e trafikimit të qënieve njerëzore.

Në nivelin lokal, Urdhëri 139 i Kryeministrit më 19.06.2006, parashikon ngritjen e *Komiteteve Rajonale kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore*. Këto komitete, të kryesuar nga Prefektët përkatës, përbëhen nga përfaqësues të të drejtorive të policisë nëpër rrethe, drejtorive arsimore, përfaqësues nga pushteti lokal dhe shërbimeve sociale, prokuroria, zyrat rajonale të SHISH, etj. Në kuadër të funksionimit të Komiteteve Antitrafik në nivel lokal, janë zhvilluar një sërë takimesh, “workshop”-esh dhe trajnimesh. të cilët kanë një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftën kundër këtij fenomeni.

Me qëllim shtrirjen e identifikimit, mbrojtjen dhe rolin mbështetës të Ministrisë së Punëve të Jashtme nëpunës në Tiranë dhe jashtë vendit dhe në bashkëpunim me autoritetet përkatëse në shteteve kryesore të destinacionit, Ministria ka ndërmarrë masat, në bashkëpunim me organe të tjera zbatuese, *trainimin dhe udhëzimin e nënpunësve konsullorë* në përfaqësitë jashtë vendit. Trainimi fokusohet në dhënien e ndihmës viktimave të trafikimit. Ministria, për organizimin e këtyre moduleve të trainimit, ndihmohet nga Akademia e Diplomacisë, por gjithashtu asistohet edhe nga institucione të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare.

IOM po punon për rritjen e *kapaciteteve të strukturave shtetërore*, të përfaqësuar nga Zyrat Kombëtare të Punësimit për të siguruar informimin mbi rrugët ligjore të migrimit, aktivitetet kundër trafikimit dhe shërbimet e kthimit dhe ri-integrimit për migrantët e kthyer (përfshirë viktimat e trafikimit). Si dhe po zhvillohen *kurse trainimesh* të personelit të zyrave të punësimit të 6 rretheve të përzgjedhura.

## B. Analiza, Kërkime dhe Mekanizma Monitorues

Një rol të rëndësishëm për monitorimin e zbatimit të strategjisë luajnë strukturat si në nivel politik dhe ato në nivel teknik. Këtu mund të

përmendim ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, i kryesuar nga Ministri i Brendshëm, i cili ka në përbërjen e tij përfaqësues të lartë të nivelit politik të institucioneve qëndrore, përgjegjës edhe për parandalimin dhe luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore në fushat përkatëse. Një *Koordinator Kombëtar*, Zëvendësministria e Brendshme për Antitrafikimin, është emëruar si pika kyçe për mirëkoordinimin e përpjekjeve antitrafik në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 203, datë 19.12.2005, pranë Koordinatorës Kombëtare për Antitrafikun/Zëvendësministres së Brendshme, është ngritur *Njësia Antitrafik*, për të mbështetur strukturat ekzistuese për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, detyrat kryesore të së cilës janë:

*Monitorimi* i aktiviteteve të institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Strategjisë Kombëtare;

*Bashkërendimi i punës* me këto institucione,

Mbledhja e informacioneve dhe të dhënave për çdo çështje që lidhet me këtë fenomen;

Qeveria ka vënë në funksionim Autoritetin Përgjegjës si *Mekanizëm Kombëtar i Referimit* (MKR) për rastet e viktimave të trafikut në shkallë kombëtare si dhe sigurimin e mbrojtjes së tyre. Ky ka nënshkruar marrëveshje me Autoritetet Përgjegjëse për MKR në vendet kufitare si Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosovë dhe Mal i Zi, vende të rajonit si dhe me vendet e destinacionit si Itali, Gjermani, Angli.

Gjithashtu, Ministria e Brendshme, E Punëve të Jashtme dhe ajo e Punës dhe si Qendrat e Mbrojtjes së Viktimave të Trafikut kanë ngritur një bazë të dhënash ku stafi i tyre regjistron rastet e viktimave të kthyera, të referuara, të trajtuara dhe të mbrojtura në Shqipëri.

C. Bashkëpunimi dhe Rrjeti në Nivelet Rajonale dhe Kombëtare  
Bashkëpunim i ngushtë është vendosur midis *Qendrës së Linzës* (Qendra Kombëtare për Pritjen e Viktimave të Trafikimit) me *Ministrinë e Brendshme* dhe *Policinë e Shtetit* (Zyrat Anti-Trafikimit dhe policinë e kufirit), dhe me *Prokurorinë* për referimin e rasteve, hapjen e proceseve penale dhe mbrojtjen e viktimave.

Në këtë kuadër, do të ngrihet një regjistër i veçantë për Viktimat e Trafikimit dhe për asistencën që do t'iu ofrohet. Ministria e Punës,

Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta do të bashkëpunojë me strukturën që do të hartojë regjistrin.

Bashkëpunimi midis Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCCSSHB) dhe shoqërisë civile në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore është përmirësuar në fushat e mbështetjes, mbrojtjes dhe rehabilitimit të viktimave të trafikimit dhe familjeve të tyre. MPCCSSHB është duke bashkëpunuar me OJF që ofrojnë shërbime parandaluese, mbështetëse, rehabilituese, ri-integruese, etj. Marrëveshje bashkëpunimi midis OJF-ve lokale dhe ndërkombëtare, të përfshira në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore do të hartohen dhe do të përfundohen, duke përcaktuar detyrimet dhe përgjegjësitë e këtij partneriteti dhe veçanërisht atë të ndarjes së produktit të informacionit apo raportimit.

#### E. Mobilizimi I burimeve

Fondet për aktivitetet anti-trafikim sigurohen nga Shteti dhe OJF-të.

Organizata kryesore ndërkombëtare aktive është OSBE-ja.

Specifikisht, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (ODIHR) është në pararojë të përpjekjeve ndërkombëtare për të luftuar dhe parandaluar trafikimin e qënieve njerëzore. Misionet e OSBE-së luajnë një rol jetësor në përpjekjet anti-trafikim në vende pritëse.

Këshilli I Europës dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) janë aktive në fushat e parandalimit, asistencës dhe mbrojtjes.

Agjencitë e Kombeve të Bashkuara duke përfshirë United Nations Office of the High Commissioner for Human Rights, United Nations Children's Fund (UNICEF), United Nations Population Fund, United Nations High Commissioner for Refugees, United Nations Development Fund for Women, United Nations Development Program, United Nations Interregional Crime and Justice Research Institute, and United Nations Office on Drugs and Crime. Organizata të tjera janë: the International Labor Organization, International Centre for Migration Policy Development, and Europol.

Gjithashtu USAID, me programet e tij, si dhe qeveritë e huaja si Norvegjia, Greqia, Holanda, Gjermania, Suedia, etj, asistojnë në përpjekjet e përgjithshme për parandalim efektiv, asistencë dhe mbrojtje të viktimave të trafikimit..

#### IV. Vënia në zbatim e ligjeve anti-trafikim

##### A. Parandalimi dhe ndërgjegjësimi

*Masa parandaluese dhe programe edukuese të rëndësishme janë realizuar me mbështetjen financiare të Qeverisë. Media dhe metoda të tjera informative janë përdorur për të mësuar dhe informuar me efikasitet popullësisë, veçanërisht gratë, fëmijët dhe target grupe të tjera vulnerabël. Në këtë kuadër, në vijim të një bashkëpunimi të mirë ndër-institucional, takime pune janë organizuar me pjesëmarrës të OJF-ve dhe CAAHT, ICPMD, USAID, IOM, Komuniteteve Fetare, Koalicioni “Bashkimi Kundrejt Trafikimit të Fëmijëve”. Ata kanë realizuar aktivitetet e mëposhtme:*

Dokumentarë mbi trafikimin në Televizione lokale dhe kombëtare;  
Publikime periodike në gazetën “Mësuesi” dhe shtypin e përditshëm;  
Fushata ndërgjegjësimi dhe parandalimi nëpër zonat rurale të rajoneve të ndryshme.

Qendra e Linzës me mbështetjen e IOM-it ka përgatitur dhe ka shpërndarë *fletëpalosje dygjuhëshe* (shqip dhe anglisht). OJF të tjera kanë bërë të njëjtën gjë, me mbështetjen e donatorëve. Gjithashtu, MPJ ka kontribuar në përgatitjen e fletëpalosjeve anti-trafikim, për shpërndarje në shtetet e destinacionit/tranzitit. Këto fletëpalosje janë publikuar nga OJF-të në dy gjuhë. Në kuadër të parandalimit të trafikimit, veçanërisht ndaj target grupeve në rrezik, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka nxjerrë më datë 29.03.2006 *Udhëzimin nr. 6*, “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindjeje”.

Të gjithë institucionet shtetërore dhe OJF-të që punojnë me fëmijët organizojnë seminare, shpërndajnë materiale informuese familjeve me probleme sociale, nivel të ulët edukimi dhe komunitetit rom. Duhet theksuar që në këtë aspekt afërsisht 600 studentë dhe 200 gra të komuniteteve vulnerable janë informuar mbi fenomenin dhe rreziqet që mbart. Aktivitetet kundër trafikimit janë përfshirë në *planet vjetore shkollore* dhe *planet edukative të çdo klase*. Në plotësim, në bashkëpunim me UNICEF-in, do të organizohet *trainimi i mësuesve*, që punojnë me nxënës të ngjuar. Për të mbështetur këto aktivitete, vizita dhe takime janë organizuar midis zyrtarëve rajonalë të Ministrive të Edukimit dhe Shkencës. Një *mekanizëm vlerësimi* është ngritur për të vlerësuar efektivitetin dhe impaktin e metodologjive të përdorura. Ky mekanizëm do të kontribuojë në konsolidimin e modeleve të sukseshme të parandalimit të trafikimit në shkollat rajonale.

Sipas Urdhërit 34, më 08.12.2004, për *vënien në zbatim të projektit “Shansi i Dytë”*, vazhdon procesi i edukimit për studentët që kanë



braktisur shkollën dhe që janë të ngujuar nga hakmarrja. Në të njëjtën kohë, sipas Urdhërit 394, më 23.02.2004, për *tarifat në sistemin e edukimit profesional*, i nxjerrë nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ofrohen kurse profesionale falas në qendrat e edukimit profesional publik grave të trafikuar të martuara dhe të pamartuara.

*Vizita studimore dhe shkëmbim reciprok eksperiencash* janë organizuar midis përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe misioneve të IOM-it në Shqipëri, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Zyrat Rajonale të Punës ofrojnë *informacion punësimi*, orientim dhe ndërmjetësim për punë për punëkërkesit e papunë të regjistruar. OJF-të që ofrojnë kurse trainimi dhe bizneset sociale bashkëpunojnë me këto zyra. Janë vënë në zbatim tre *Programe të Nxitjes së Punësimit*, gjatë të cilave, 500 gra me probleme sociale janë punësuar, si gra nga familje të varfëra (217), gra rome (86), gra kryefamiljare (54), gra me shumë fëmijë (100), etj. Në këtë kuadër, ka filluar zbatimi i fazës së dytë të projektit rajonal, ILO-Migrant: *Mundësi punësimi, formimi profesional dhe masa politikash migratore për parandalimin dhe reduktimin e trafikimit të grave në Shqipëri, Moldavi dhe Ukrainë*. Ky projekt, ndërmjet të tjerash, ka si qëllim dhënien e mikro-kredive për sipërmarrje private të kontigjentit të grave e vajzave, ish të trafikuar, me qëllim ri-integrimin e tyre, por edhe për parandalimin e viktimave potenciale të trafikimit.

Në mënyrë që të ulë rrezikun e trafikimit, Qeveria synon të rrisë ndërgjegjësimin publik mbi *rrugët e rregullta të migrimit*. Në projektligjin e ri mbi migrimin janë parashikuar dispozita mbi rreziqet e migrimit të parregullt, me qëllim parandalimin e trafikimit.

#### Komente

Aktivitete të ndryshme organizohen nga OJF-të, që punojnë me problemet e trafikimit. Sidoqoftë, një koordinim i këtyre aktiviteteve është mëse i nevojshëm në të ardhmen.

## B. Mbrojtja dhe Asistenca

*Qendra e Ri-Integrimit*, u hap në mes të Janarit 2002 për të dhënë mbrojtje të përkohshme, këshillim psiko-social dhe mjekësor, asistencë për kthim dhe ri-integrim për viktimat shqiptare të trafikimit.

Aktivitetet e saj fokusohen kryesisht në referimin dhe projektimin e

përfituesve, në akomodimin afat shkurtër dhe afat mesëm deri në përgatitjen e bashkimit familjar ose jetesës së pavarur dhe asistencës ri-integruese për viktimat, duke përfshirë edukim dhe trainim, si edhe asistencë për punësim dhe ngritje kapacitetesh të organizatave lokale që punojnë në këtë fushë.

Në korrik 2003 Qeveria mori përsipër administrimin e *Qendrës Kombëtare të Pritjes të Viktimave të Trafikimit* (QKPVT) për viktimat adulte dhe fëmijë, e njohur më përpara si *Qendra e Linzës*. Qendra Kombëtare e Pritjes është krijuar në kuadër të Strategjive Kombëtare kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore dhe Fëmijëve dhe është një institucion që vepron nën okelion e Shërbimit Social Shtetëror (MoLSAEO<sup>2</sup>), në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Brendshme dhe IOM-in.

Gjithashtu, zbatimi i një metode të kuptueshme për mbrojtjen e viktimave është një prioritet i rëndësishëm. Qendra Kombëtare e Viktimave të Trafikimit i kushton një vëmendje të veçantë përmirësimit të cilësisë së rehabilitimit dhe vazhdon të ofrojë shërbime të mira kundrejt tre target grupeve: (NCFVT):

- \* Gra të trafikuar (të martuara apo beqare), ose në rrezik ndaj trafikimit;
- \* Fëmijë të pasocializuar dhe në rrezik për trafikim;
- \* Migrantë të parregullt.

Stafi i QKPVT, bashkëpunon me të gjitha strukturat e referimit të viktimave, si pikat kufitare dhe komisariatet e policisë në mënyrë që të ofrojë akomodim për viktimat. Në të gjitha rastet stafi i qendrës kryen intervista, bazuar në një pyetësor të hartuar me ndihmën e donatorëve ndërkombëtarë dhe vlerësimin e nevojave.

Qendra ka vendosur një bashëpunim midis nënpunësve të policisë dhe prokurorisë dhe viktimat akomodohen dhe mbrohen. Për shembull, në të gjitha pikat e kalimit kufitar ku të deportuarit rikthehen, oficerët e kufirit I intervistojnë në mënyrë që identifikojnë dhe të mbrojnë viktimat potenciale të trafikimit.

Gjithashtu, QKPVT punon në ndërgjegjësimin e viktimave të trafikimit në mënyrë që të arrihet denoncimi I trafikantëve. Informacioni që iu jepet bazohet në të drejtën e tyre për mbrojtje dhe rreziqet që iu kanosen jetës së tyre. Bazuar në ligjin mbi mbrojtjen e

---

<sup>2</sup> Ministria e Punës, Çështjeve Social e dhe Shanseve të Barabarta

dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, qendra vazhdon të asistojë viktimat e trafikuar që kanë denoncuar trafikantët e tyre dhe kanë nevojë për mbrojtje, edhe mbas përfundimit të gjyqit.

Gjatë 2005 në Qendrën e Linzës, janë akomoduar dhe asistuar 127 persona (116 raste të reja dhe 11 nga viti 2004). 15 prej tyre kanë denoncuar trafikantët e tyre. Në gjashtë raste gjyqi ka përfunduar në favor të viktimave dhe tre raste janë akoma në gjykim. Një bazë të dhënash është krijuar në Linzë, Shërbimin Social Shtetëror në MPCCSSHB, që përtërihet vazhdimisht..

Policia referon ad hoc në një strehëz OJF “Vatra” në Vlorë. Në shumicën e rasteve, policia merr në pyetje viktimat në rajonet e policisë përpara se t’i referojë ato në strehëza.

Në kuadër të Autoritetit Përgjegjës (shiko II b) dhe në bashkëpunim me të gjithë aktorët e përfshirë, ka filluar të funksionojë një linjë kombëtare direkte falas help Line. Ajo asiston viktimat në denoncimin e rasteve të trafikimit dhe ofron mbështetje për të gjithë qytetarët që kanë nevojë për ndihmë ose për ata që kanë informacion për të dhënë lidhur me trafikimin.

Bazuar në vendimin 564 të Këshillit të Ministrave më 12.08.2005 mbi licensimin e dhënësve të shërbimeve sociale, autorizimi I OJF-ve në dhënien e shërbimeve sociale është akoma në proces. Deri më sot, janë rreth 30 OJF të licensuara, që ofrojnë shërbime parandaluese dhe mbështetëse, rehabilitim dhe ri-integrim. OJF-të më impaktin më të madh në fushën e parandalimit, mbështetjes, rehabilitimit dhe shërbimeve ri-integruese janë: “Qendra Vatra”, “Tjetër Vizion”, “Të Ndryshëm por të Barabartë”, Shërbimi Social Ndërkombëtar, “Terre des Hommes”, “Ndihmë për Fëmijët”, Qendra Komunitare Ballsh, Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Emigrimin, Save the Children, “Klinika Ligjore për të Miturit”, “Në Dobi të Gruas Shqiptare”, “Strehëza” Organizata Ndërkombëtare për Migrim, Linja e Këshillimit për Gra, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Koalicioni I OJF-ve “Së bashku kundër Trafikimit të Fëmijëve”.

### C. Prokuroria

Një nga objektivat kryesorë anti-trafikim është rritja e ndjekjeve penale të rasteve të trafikimit dhe dënimi i trafikantëve. Kjo është arritur duke shtuar bashkëpunimin midis Autoriteteve Policore dhe Prokurorisë. Një prioritet ka qenë vënia në zbatim e një metode të kuptueshme për mbrojtjen e dëshmitarëve, duke dëshmuar kundër trafikuesve të tyre.

Ligji i ri i Mbrojtjes së Dëshmitarëve, synon sigurimin e mbrojtjes së një identiteti ligjor, fizik dhe personal, për të gjithë viktimat/dëshmitarë në proceset gjyqësore, pa marrë parasysh pjesëmarrjen e tyre në Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim më Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave kanë hartuar efektet anësore të ligjit mbi mbrojtjen e dëshmitarëve. Në këtë kuadër, një sektor i mbrojtjes së dëshmitarëve është krijuar në Drejtorinë e Krimin të Organizuar në Ministrinë e Brendshme.

Në kuadër të forcimit ligjor, një hap i rëndësishëm është fillimi i procesit të pajisjes së Gjykatës së Krimeve të Rënda me mjetet kryesore të nevojshme për mbrojtjen dhe sigurinë e kërkuar të viktimave të trafikuar që dëshmojnë gjatë një gjyqi, nëpërmjet “video konferencës”. Përgjatë këtij procesi, hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për mbrojtjen e identitetit të të gjithë viktimave/dëshmitarë gjatë procerurave ligjore dhe rishikim i skemës së kompesimit të këtyre viktimave nga pasuritë e konfiskuara .

Duke iu referuar statistikave, përsa i përket programit të mbrojtjes së qytetarëve, mund të thuhet që:

\* Gjatë vitit 2005, ka pasur njëmbëdhjetë dëshmitarë që iu janë siguruar masa të veçanta mbrojtjeje, duke përfshirë edhe zhvendosjen. Veç kësaj, masa të përkohshme mbrojtjeje, për një periudhë 1 mujore, janë siguruar për pesëmbëdhjetë dëshmitarë. Përsa i përket specifikisht trafikimit të qënieve njerëzore, ka pasur vetëm një rast të një dëshmitari me masë mbrojtjeje shpërnguljen.

\* Gjatë vitit 2005, nëntë dëshmitarë viktimë të trafikimit kanë bashkëpunuar me Departamentet Policore dhe kanë denoncuar trafikantët e tyre për ndjekje penale.

Miratimi i ligjit mbi të huajt është në proces. Ky ligj përfshin dispozita për leje rezidence të përkohshme për viktimat e trafikimit në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare. Sektori i Emigracionit pranë policisë kufitare lehtëson shpërndarjen e këtyre lejeve.

## V. BEST PRACTICES

Të gjithë organizatat që punojnë me problemet e trafikimit të fëmijëve, së bashku me përfaqësues të qeverisë dhe organizatave ndërkombëtare kanë formuar një koalicion shqiptar ndër –OJF kundër trafikimit të qënieve njerëzore të quajtur Të Gjithë Së Bashku kundër Trafikimit të Fëmijëve. BKTF-Shqipëri drejton Albania runs ONACT—

Operational Network and Advocacy against Child Trafficking në reduktimin e vulnerabilitetit të trafikimit të fëmijëve në Shqipëri duke promovuar shërbime efektive, rrjete dhe kërkime kundër trafikimit.

## VI. MANGËSITË

- \* Ligji i mbrojtjes së dëshmitarëve nuk është vënë plotësisht në zbatim.
- \* Ka shumë vështirësi në procesin e identifikimit të personave të trafikuar.

## VII. VLERËSIMI I NEVOJAVE

Duke marrë parasysh mangësitë dhe komentet e përfshira në këtë raport dhe nevojën për përmirësimin e situatës, një listë rekomandimesh paraqitet më poshtë.

## REKOMANDIME

1. Ndryshime institucionale, strukturore dhe organizative duhet të realizohen në fushën e luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore.
2. Kushtet sociale kanë nevojë për përmirësim, sidomos zbutja e varfërisë, duke synuar zvogëlimin e ekspozimit të grupeve sociale vulnerable ndaj trafikimit të qënieve njerëzore.
3. Asistenca ndaj viktimave të trafikimit duhet të rritet, sidomos duke zhvilluar programe integrimi.
4. Ndërgjegjësimi publik duhet organizuar dhe intensifikuar.
5. Kapacitet anti-trafikim duhet të përmirësohen dhe të rriten.
6. Bashkëpunimi ndërmjet të gjithë aktorëve aktivë në këtë fushë, si brenda dhe jashtë vendit duhet të forcohen. Gjithashtu duhet të forcohet edhe koordinimi midis OJF-ve dhe organizatave ndërkombëtare.

## LISTA E SHKURTIMEVE

CAAHT Coordinated Action Against Human Trafficking  
ILO Organizata Ndërkombëtare e Punës  
IOM Organizata Ndërkombëtare e Migrimit  
ICPMD International Centre for Migration Policy Development

MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPCCSSH Barabarta	Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
NCFVT Trafficking	Accommodation National Centre for Victims of Trafficking
NRCVT	National Reception Centre of Victims of Trafficking
RNM	Referring National Mechanism
USAID	United States Agency for International Development
UNICEF	United Nations Children's Fund

## BOSNJA DHE HERCEGOVINA

### Hyrje

Bosnja dhe Hercegovina (BH) është një shtet i Europës Jug-Lindore, në Ballkanin Perëndimor. Shtetet fqinje janë Kroacia në Veri, Veriperëndim dhe Jug, dhe Serbia dhe Mali i Zi në Lindje. Në Jug të BH, ka një vijë bregdetare të detit Adriatik 32 km të gjatë.

BH ka fituar pavarësinë më 1992. Përveç sfidave për shkak të fitimit së fundmi të pavarësisë, vendi duhet të përballojë edhe pasojat afatgjata të një lufte, e cila zgjati katër vjet, si edhe me tranzicionin politik nga socializmi dhe ekonomia socialiste në demokraci dhe në ekonomi të tregut. Duke patur parasysh biografinë historike dhe vendndodhjen gjeografike të BH-së, trafikimi i qënieve njerëzore ka gjetur kushtet ideale për të lulëzuar.

BH është një vend i varfër, në tranzicion, ku gratë, fëmijët dhe burrat janë objektiva të lehtë për trafikimin e qënieve njerëzore nga rrjetet e krimit të organizuar. Është e pamundur të përcaktosh kur janë regjistruar rastet e para të trafikimit të qënieve njerëzore në BH, sepse agjensitë ligjore e kanë klasifikuar këtë fenomen në kategorinë e prostitucionit. Duke marrë këtë parasysh, mund të arrijmë lehtësisht në përfundimin që, kur u shfaq trafikimi për herë të parë në BH, nuk kishte një ndërgjegjësim për sa i përket këtij lloj krimi dhe viktimave të tij. Rritja e numrit të rasteve çojë në njohjen e kompleksitetit të këtij fenomeni si edhe në nevojën për të ndërmarrë hapat e nevojshme kundrejt parandalimit dhe luftës ndaj trafikimit të qënieve njerëzore. Përfundimet nga kërkimet tregojnë që arsyt kryesore përse njerëzit e gjejnë veten në zinxhirët e trafikimit janë varfëria, statusi i ulët social-ekonomik, dhuna në familje, influencat e bashkëmoshatarëve dhe mungesa e informacionit.<sup>3</sup> njerëzit që preken drejtpërdrejt nga këto rrethana dëshirojnë të emigrojnë në vende të pasura që të kenë mundësi për kushte më të mira jetese. Në këtë mënyrë ata janë pre të lehta për trafikantët. OJF-të ishin të parat që zbuluan problemin e trafikimit dhe ofruan asistencë dhe mbështetje për viktimat. Gjatë 1999, ZENA BiH së bashku me OJF-në “LARA” nga Bijeljina kryen një studim për United Nations Voluntary Trust Fund for Contemporary Forms of

---

<sup>3</sup> Researches carried out by UNICEF and Save the Children Norway in 2003 and Barbara Limanowska ‘Trafficking in human beings in South Eastern Europe’ UNICEF/UNOHCHR/OSCE ODIHR.

Slavery. Përfundimet treguan që problemi i trafikimit të grave është më mbizotërues;<sup>4</sup> prandaj, filluan të adresojnë këtë problem. Megjithatë aktivitetet anti-trafikim në këtë në atë periudhë ishin të rrezikshme, ata që mund të ndihmonin në këtë çështje u bashkuan me përpjekjet. Institucionet shtetërore u bashkuan me përpjekjet e OJF-ve. Në fillim të 2003, shteti filloi të merrej me këtë problem duke përdorur përfundimet e studimeve dhe eksperiencën e OJF-ve. Situata e tanishme përsa i përket trafikimit të qënieve njerëzore në Bh është e kënaqshme dhe ka një bashkëpunim të mirë midis qeverisë dhe organizatave jo qeveritare lokale dhe ndërkombëtare. Instrumentet dhe strukturat anti-trafikim po zhvillohen. OJF-të, që drejtojnë strehëza për viktimat kanë ofruar akomodim të përkohshëm, asistencë dhe mbrojtje për 66 viktima të trafikimit gjatë vitit 2005 (44 nënshtetas të huaj dhe 22 nënshtetas të BH-së). Nënshtetasit e huaj janë nga Serbia, Mali i Zi, Moldavia, Rumania, Ukraina, Federata Ruse, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kina, Bjellorusia dhe Kroacia. Trembëdhjetë viktima (30% e viktimave) ishin minorenë.<sup>5</sup> Duke e krahasuar me vitet e kaluara, sidomos me 2002, kur në strehëza u akomoduan 225 viktima, ka një tendencë në ulje të nënshtetësave të huaj, ndërsa numri i viktimave të trafikimit të brendshëm është në rritje.

## II. KUADRI LIGJOR KOMBËTAR

### A. Ligji Kombëtar

Në vijim të konventave ndërkombëtare të listuara në Aneksin 1, BH ka vënë në zbatim një reformë në legjislacionin e saj duke miratuar:

Kodin Penal të BH-së

Ligjin e Procedurës Penal të BH-së

Ligjin mbi Gjykatat e BH-së

Ligjin e Prokurorisë së BH -së

*Ligjin mbi mbrojtjen e dëshmitarëve nën kërcënim dhe dëshmitarëve të rrezikuar*

*Ligji mbi programin e mbrojtjes së dëshmitarëve*

*Ligjin mbi hetimin shtetëror dhe agjensitë mbrojtëse*

*Ligjin mbi shërbimet shtetërore të kufirit*

*Ligjin mbi kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufinjve shtetëror*

---

<sup>4</sup> Researches carried out by ZENA BIH Mostar and LARA Bjeljina in 1999 supported by United Nations Voluntary Trust Fund for Contemporary Forms of Slavery.

<sup>5</sup> Report on human trafficking and illegal immigration in BH for 2005.



Ligjin mbi lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve dhe azilit

Ligjin mbi barazinë gjinore dhe

Ligji mbi parandalimin e dhunës në familje

Veç kësaj, mekanizma institucionalë janë ngritur për vënien në zbatim të ligjeve të lartpërmendura në BH.

Trafikimi i qënieve njerëzore është një shkelje penale e parashikuar vetëm në Kodin Penal të BH-së. Kodi Penal Federal, Kodi Penal i Republikës së Srpska-s dhe Distrikti Brcko shqyrtojnë vetëm joshjen. Vetëm Gjykata e BH-së ka juridiksionin të dëgjojë dhe të gjykojë çështjet e lidhura me trafikimin.

B. Marrëveshjet Bilaterale

BH-ja ka nënshkruar *Marrëveshje Ripranimi me Suedinë, Norvegjinë, Danimarkën dhe Rumaninë* dhe ka filluar negociatat për të përfunduar marrëveshje të njëjta me shtete të tjera në rajon vecanërisht me Moldavinë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Shqipërinë, Bullgarinë dhe Turqinë.

C. Plani Shtetëror i Veprimit

Në Nëntor 2001, një Grup, *Grupi Shtetëror për luftën ndaj trafikimit të qënieve njerëzore*, u krijua për të përgatitur Planin Shtetëror të Veprimit (PSHV). Grupi përfshinte përfaqësues të Ministrive të të Drejtave të Njeriut, të Drejtësisë, të Sigurisë, të Punëve të Jashtme, Zyra e Prokurorit të Shtetit dhe përfaqësues të Shërbimeve të Kufirit Shtetëror të BH-së. Plani Shtetëror i Veprimit u dekretua nga Këshilli i Misitrave të BH-së më 6 Dhjetor 2001.

Një Plan Shtetëror Veprimi i ri për luftën kundër trafikimi të qënieve njerëzore për 2005-2007 është aprovuar më 2005. Ky Plan Shtetëror Veprimi përfshin kapitujt e mëposhtëm:

Sistem për mbështetje;

Parandalim;

Mbrojtje e viktimave dhe dëshmitarëve;

Ndjekje penale dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Ministria e Sigurisë propozon një person në pozicionin e *Koordinatorit të Shtetit* për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe Këshilli i Ministrave bën emërimin. Koordinatori Shtetëror së bashku me “Grupin Shtetëror” ndjekin dhe koordinojnë vënien në zbatim të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit. Duke marrë parasysh nevojën për tu fokusuar në parandalimin e trafikimit të fëmijëve, një *Nëngrup për Fëmijët* është krijuar më Mars 2004.

Edhe pse përgjegjësitë e Koordinatorit të Shtetit nuk janë formalizuar akoma, ai/ajo punon në bashkëpunim të ngushtë me Oficerët Ndërlidhës dhe me Forcat e Ndërhyrjes për Luftën kundër Dhunës. Qëllimi i fundit është rritja e aktiviteteve anti-trafikim në nivelet më të larta që kanë lidhje me përfaqësuesit e Zyrave të Prokurorisë së BH-së, Shërbimeve të Kufirit Shtetëror, Agjencisë Shtetërore të Hetimit dhe Mbrojtjes (ASHHM) dhe policisë financiare.

#### Komente

Në Planin Shtetëror të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore 2005-2007, të riparë nuk është përfshirë asnjë kapitull mbi riadhesimin e viktimave. Mirëpo, përveç ofrimit të akomodimit dhe asistencës gjatë qëndrimit në Shtëpinë e Sigurtë, viktimat me origjinë nga BH-ja, kanë nevojë për asistencë me procedurat e riadhesimit/socializimit/ri-integrimit në mënyrë që të rifitojnë vetëbesimin dhe të jene anëtarë aktivë të shoqërisë. Asistenca e papërshtatshme dhe jo gjithë përfshirëse për viktimat krijon mundësi për të rënë përsëri në zinxhirët e trafikimit dhe të humbin tërësisht vetëbesimin e tyre. Edhe pse deri më sot ka vetëm pak viktima nga BH-ja që janë riadhesuar, një kapitull i përshtatshëm duhet të përfshihet në Planin Shtetëror të Veprimit duke siguruar masa dhe aktivitete për riadhesimin dhe ri-integrimin, si dhe përcaktimin e personave të detyruar me vënien në zbatim.

### III. Korniza e Përgjithshme

#### Ngritja e Kapaciteteve

Sipas PSHV, institucionet shtetërore dhe OJF-të kryejnë rregullisht kurse trainimi për ngritjen e kapaciteteve dhe edukimin e zyrtarëve shtetërorë. Në bashkëpunim me Qendrën për Edukimin e Gjykatësve dhe Prokurorëve dhe Komisionin e Drjtësisë së Distriktit të Brcko-s, *oficerët e policisë*, anëtarë të Qendrave për sigurinë publike nga Republika e Srpska-s dhe Ministrinë e Brendshme të kantoneve, *gjykatës dhe prokurorë*, nga i gjithë vendi kanë marrë pjesë në seminare mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Gjatë seminareve, është paraqitur korniza ligjore shtetërore dhe ndërkombëtare si dhe puna e policisë, Zyrave të Prokurorisë dhe shërbimet e kufirit Shtetëror.

Gjithashtu, janë organizuar seminare mbi *procedurën e shqyrtimit të viktomave potenciale të trafikimit të qënieve njerëzore*, si edhe

paraqitja e *Manualit mbi mbrojtjen e viktimave të huaja të trafikuarra, administrimi i të dhënave, monitorimi, vlerësimi dhe rishikim* (program i financuar nga regional CARDS EU-funded program). Përveç kësaj, seminare janë organizuar në bashkëpunim me Qendrën për Edukim të Gjykatësve dhe Prokurorëve për ASHHM-në dhe anëtarë të policisë, gjykatës dhe prokurorë, si edhe seminare informative publike. *Udhëtime studimi* të ndryshme janë organizuar për anëtarët e Grupit Shtetëror. Me rates, në këto vizita kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga OJF-të.

Analiza, Kërkime dhe Mekanizmat Monitorues

Në mënyrë që të përkrahë koordinimi midis Zyrës së Koordinatorit Shtetëror, dhe Organizatave JoQeveritare dhe Ndërkombëtare, *takime të regullta referimi* janë organizuar cdo tre muaj. Takimet referuese sigurojnë një platformë për shkëmbimin e informacionit mbi aktivitete e planifikuara dhe të vëna në zbatim, si edhe koordinimin dhe harmonizimin e këtyre aktiviteteve, duke synuar shmangien e dublikimit e veprimve dhe rregullimin e shpenzimeve të fondeve.

Në mënyrë që të luftohet efektivisht trafikimi i qenieve njerëzore, është e nevojshme të analizohet sipas kriterëve bazë, prirjet që kontribuojnë në këtë fenomen. Si pasojë, Koordinatori Shtetëror, në bashkëpunim me UNICEF-in, ka emëruar një *ekspert rajonal* për të përgatitur një *raport*, duke kryer kërkime dhe analiza të situatës në këtë fushë, duke u fokusuar në treguesit e rritjes së numrit të viktimave të trafikimit të brendshëm. Ky raport është i rëndësishëm sepse është përmbledhja e parë analitike e kësaj prirjeje të re dhe paraqet strukturat e gatshme për të asistuar viktimat e trafikimit të brendshëm. Është e rëndësishme të nxirret në paj rëndësia e *Raportit Fillestar mbi Dhunën kundër Fëmijëve*, përgatitur nga Këshilli për Fëmijët, veccanërisht përfundimet lidhur me trafikimi e fëmijëve.

C. Bashkëpunimi dhe Rrjeti në Nivelet Rajonale dhe Kombëtare OJQ-të dhe institucionet shtetërore janë në mënyrë individuale apo kolektive, anëtarë të rrjeteve rajonale të shumta për parandalimin e trafikimit (INTERPOL, EUROPOL, SECI, RING etj). Ata ia kanë dalë mbanë ti japin shtysa bashkëpunimit rajonal për problem të ndryshme. Është e rëndësishme ti referohemi bashkëpunimit të ngushtë midis Ministrisë së Sigurisë dhe INTERPOL-it, EUROPOL-it dhe South-East European Cooperation Initiative Centre (SECI Centre), si edhe, marrëveshjes së Ministrisë në përgatitjen e Konventës mbi Bashkëpunimin e Policisë për Europën Juglindore.

Shoqata “ZENA BiH” ka vendosur një bashkëpunim të mirë me OJQ-të anëtare të rrjetit Kroat kundër trafikimit PETRA. Gjithashtu është edhe anëtarë i rrjetit ARIADNE netëork, akundër trafikimit të qënieve njerëzore në Europën Juglindore dhe Lindore.

D. Mobilizimi i burimeve

Fondet nga Këshilli i Ministrave, UNICEF-i dhe Delegacioni i Përherhëm i Islandës në OSBE, sigurojnë vënien në zbatim të këtyre aktiviteteve. Përveç tyre USAID-i, IOM-i, Star Netëork of Eëorld Learning dhe CRS kanë kontribuar në bashkë financimin e aktiviteteve kundër trafikimit.

#### IV. Vënia në zbatim e ligjeve anti-trafikim

##### A. Parandalimi dhe ndërgjegjësimi

OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare, si edhe Autoritetet e BH-së, kanë organizuar *fushata ndërgjegjësimi* të shumta gjatë viteve të fundit.

Target grupi i tyre ka qenë:

institucionet përgjegjëse për vënien në zbatim të ligjeve në BH (oficerë të policisë, oficerë të migracionit, Shërbimet Shtetërore të Kufirit);

nxënës të shkollave fillore dhe të mesme; dhe

në mëyrë jot ë drejtpërdrejtë gjithë popullësia e BH-së.

Këta stakeholders kanë zhvilluar fushata të ndryshme gjatë 2005. Ata kanë përfshirë target grupet në vijim në këto fushata: prindër dhe mësues; burrat si klientë të mundshëm (kjo fushatë parandaluese, e para në vend që merret me këtë target grup, si edhe puna e lidhur me burrat është një project pilot i shoqatës “ZENA BiH” Mostar).

*Grupi i Parandalimit dhe Fuqizimit Ekonomik* po punon me *Grupin Shtetëror për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe migrimit joligjor*. Ky Grup ka planifikuar aktivitete, të cilat do të zhvillohen në bashkëpunim me grupe të tjera, autoritetet, organizatatata locale dhe ndërkombëtare. Përveç kësaj, aktivitete të tjera të ngjshme po zhvillohen, sicc është krijimi i *kurrikulumi shkollor*, që përfshin identifikimn e rreziqeve të trafikimit të qënieve njerëzore, përkrahjen e barazisë gjinore, luftën kundër dhunës bazuar në përkatësinë gjinore, rreziqet e HIV/AIDS dhe zbulimin e lidhjes së varësisë ndaj drogës dhe rekrutimin për prostitucion të forcuar nga rrjetet kriminale.

Një shembull interesant i fushatave parandaluese është publikimi nga shoqata “ZENA BiH” Mostar, me 20.000 kopje, i një *libri me histori të vërteta* të shkruara nga viktimat të trafikimit. Ky libër është shitur me ccmimin simbolik të 2 KM (1 EURO). Fondet e mbledhura iu dhuruan strehëzës për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore.

*Programet që tregojnë shkaqet kryesore (faktorët social-ekonomik) në shtetet e origjinës dhe destinacionit*

Për një periudhë të gjatë, BH-ja ka qenë një vend transiti dhe destinacioni për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore. Edhe pse OJQ-të kanë paralajmëruar mundësinë që vendi të kthehej në një vend origjine, institucionet Shtetërore nuk kanë treguar gaditshmërinë që të përballen me këtë problem. Kërkimet e kryera nga organizata të ndryshme locale dhe ndërkombëtare në BH kanë treguar se arsyet përse njerëzit përfundojnë në zinxhirët e trafikimit janë:<sup>6</sup>

Varfëria e përgjithshme;

Status i ulët social-ekonomik;

Dhuna në familje;

Mungesa e informacionit;

Influenca e grupit të bashkëmoshatarëve.

Përveç kësaj, kërkimet mbi nivelin e informimit të qytetarëve rreth trafikimit të qënieve njerëzore tregojnë që ndërgjegjësimi është rritur më shumë në qytete krahasuar me zonat rurale.<sup>7</sup> Akoma, viktimat, shumica e rasteve, vijnë nag zonat rurale.

Për kohët në vazhdim, projektet dhe aktivitetet për zhvillimi ekonomik të BH-së, nuk kanë si qëllim përmirësimin e situatës së varfërisë së përgjithshme dhe statusit të ulët social-ekonomik. Numri i personave të regjistruara në zyrat e punësimit dhe fuqia e ulët blerëse mund të shërbejë si një argument në përkrahje të këtij pohimi..

Sidoqoftë, kapitulli i parandalimit i Planit Shtetëror të Veprimt 2005-2007 vendos si objektiv të programit *përmirësimin e kushteve sociale dhe ekonomike të grupeve sociale vulnerable*. Për realizimin e këtij objektiv, është ofruar mbështetje për vënien në zbatim të programeve kombëtare që adresojnë fuqizimin ekonomik të grave. Ngelet për të parë deri në çfarë niveli ky objektiv do të realizohet.

Mbrojtja dhe Asistenca

Që nga 1999, *Organizata Ndërkombëtare për Migrim* (IOM) ka luajtur një rol kryesor në ofrimin e akomodimit për viktimat e trafikimit. Kjo lidhet edhe me faktin që IOM-i është e vetmja organizatë që zbaton aktivitete riatdhesimi.

Akomodimi i viktimave në Qendrat e Pritjes varet nga dhënia e statusit të viktimave të trafikimit dhe riatdhesimit të tyre në shtetin e origjinës.

---

<sup>6</sup> Research carried out by UNICEF and Save The Children Norway in 2002 and 2003

<sup>7</sup> Research carried out by ZENA BiH supported by BHRN in 2006

Duke marrë parasysh që procesi i riatdhesimit i drejtuar nga organizatat ndërkombëtare nuk ishte vetë-mbështetës, Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët (MDNJR), sipas nenit 3 të Planit Shtetëror të Veprimit, ka zhvilluar një project për krijimin e *Qendrave të Pritjes*. Objektivi është të ofrojë një trajtim më të mirë “fokusuar në të drjetat e viktimave”, një periudhë më të gjatë rehabilitimi, dhe të lehtësojë përhapjen e informacionit. Nuk ka asnjë *linjë telefoni SOS* shtetërore. Vetëm OJQ-të e ofrojnë këtë lloj shërbimi.

Gjatë kësaj kohe, disa OJQ tashmë kanë zhilluar struktura për dhënien e asistencës së drejtpërdrejtë ndaj viktimave të trafikimit. Pjesëmarrja e tyre në krijimin e Qendrave të Pritjes ishte e kufizuar për shkak të mungesës së fondeve, edhe pse tre naëtarë të koalicionit RING kanë mundësuar dhënien e asistencës së drejtpërdrejtë për 100 gra gjatë periudhës 1999 -2002. Të gjitha këto OJQ kanë ofruara shërbime të ndohmës mjekësore, këshillim, ndihmë ligjore dhe forma të tjera të mbështetjes. Janë nxjerrë *udhëzime të përkohshme* për përballimin me viktimat e trafikimit. Këto udhëzime kanë vendosur normat dhe rregullat e sjelljes për të gjithë autoritetet shtetërore dhe entitetet që ushtrojnë luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

MDNJR ka nënshkruar një *Protokoll Bashkëpunimi* më një numër OJQ-së, anëtare të Rrjetit RING. Ky Protokoll ofron disa shtesa për udhëzimet e përkohshme në trajtimin e viktimave të trafikimit. Këto udhëzime të përkohshme janë akoma në fuqi, edhe pse tani ka një version draft me të detajuar.

Për shkak të mungesës të strukturave Shtetërore për akomodimin e viktimave të trafikimit, Ministria e Sigurisë, në Mars 2005, ka nënshkruar një *Marrëveshje Bashkëpunimi* me OJQ-të e mëposhtme: Lara Bijeljina, Medica Zenica, Medjenarodni Forum Sildarnosti (Forumi Ndërkombëtar i Solidaritetit), Group EMMAUS International Tuzla, La Strada Mostar dhe ZENA BiH Mostar. Këto Marrëveshje kanë vendosur të drejtat dhe detyrimet e të gjithë firmëtarëve për sa i përket përgatitjes të tipeve të mbylluar të strehëzave për viktimat e huaja të trafikimit të qënieve njerëzore. Sipas tyre, OJQ-të kanë detyrimin të transportojnë viktimat në strehëza dhe t’iu ofrojnë atyre akomodim, ushqim dhe kujdes mjekësor. Fundet e nevojshme jepen nga donatorët dhe mënyra të tjera. Ministria e Sigurisë supervizon OJQ-të që punojnë në këtë fushë.

Në Korrik 2005 në Vlasica, *PROCEDURA për trajtimin e viktimave të trafikimit në BH* u nënshkrua nga institucionet e pavaruara dhe Shtetërore si më poshtë: Koordinatori Shtetëror për luftën kundër

trafikimit të qënieve njerëzore dhe migrimit jo ligjor, Federata e Zyrave të Prokurorisë të BH-së, Zyra e Prokurorit të Distriktit të Brcko-s, Shërbimet Shtetërore të Kufirit, Ministria e Sigurisë – Sektori për Azil dhe për Migrim, Ministria e Brendshme e Republikës të Srpska-s, Zyra e Prokurorit të BH-së, Agjensia Shtetërore e Hetimit dhe Mbrojtjes, Fedearat e Ministrisë së Sigurisë së BH-së dhe Departamenti i Policisë së Distriktit të Brcko-s.

Në Korrik 2004, në përputhje me *Ligjin mbi lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve dhe azilkërkuesve*, i pranuar nën juridiksionin e Ministrisë së Sigurisë, më vonë edhe OJQ-ja *Vasa Prava* (‘Të Drejtat Tuaja’) nënshkruan një Marrëveshje mbi dhënien e *asistencës ligjore falas* për viktimat e trafikimit. Asistenca ligjore falas përfshin, ndër të tjera, dhënien e këshillave ligjore, skicimin e fakteve dhe dokumentave, si dhe, paraqitjen në të gjitha rastet administrative përpara gjykatave dhe institucioneve shtetërore.

Për shkak të mohimit të ekzistencës të viktimave të trafikimit të brendshëm, Plani Shtetëror i Veprimit nuk përfshin dispozitat mbi *riatdhesimin* e viktimave, aktivitete të cilat kryhen nga OJQ-të. Rasti i parë i riatdhesimit në BH është një shembull i mirë. Vajza u kthye nga Italia. The girl *ëas sent back from Italy*. IOM-i Itali i ofrojë “ZENA BiH” Mostar, ku vajza u prit, me një ndihmë financiare të vogël port ë rëndësishme për riatdhesimin dhe ri-integrimit të viktimës.

Gjithashtu është formuar një *Grup Teme* për *mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve* nga dhuna. Fokusohet në identifikimin e kuadrit ligjor ekzistues, duke kryer analiza të lidhura më këtë çështje, duke i krahasuar me standardet ndërkombëtare dhe identifikimin e aspekteve praktike të këtij problem. Në këtë kontekst, një Manual Udhëzimesh për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit të Brendshëm është duke u përgatitur, duke nënvizuar mbrojtjen e viktimave të trafikimit, veccanërisht e atyre që janë edhe dëshmitarë në situatën e përgjithshme në Bosnje Hercegovinë. Kjo është një detyrë shumë komplekse dhe kërkuese. Është e rëndësishme të përmendet që viktimat e huaja dhe dëshmitarët e trafikimit iu ofrohet gjithashtu e drejta për akomodim, ndihmë ligjore, kujdesje mjekësore, qëndrim humanitar dhe riatdhesim.

### C. Prokuroria

Kuadri ligjor është zhvilluar në mënyrë që të japë ndjekje penale efektive ndaj trafikantëve. Sidoqoftë, është e nevojshme zhvillimi i mëtejshëm i burimeve profesionale dhe teknike, si edhe përkrahja e

bashkëpunimit midis agjensive dhe Zyrave të Prokurorisë për një zbatim më efektiv të ligjit.

Zyra e Prokurorit të BH-së është autoriteti i aftë për ndjekjen penale të trafikantëve. Tashmë Gjykata e BH-së ka shqyrtuar suksesshëm raste të lidhura me trafikimi e qënieve njerëzore.

Sipas Ligjit *mbi Agjensinë Shtetërore të Hetimit dhe Mbrojtjes* (ASHHM), është përgjegjëse për parandalimin dhe hetimin e shkeljeve penale nën juridiksionin e Gjykatës së BH-së, përfshirë edhe shkeljet penale që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore. *Skuadra për Shtypjen e Trafikimit dhe Kundërvajtjeve Seksuale* është pjesë e Departamentit të Hetimit dhe Kriminalitetit të ASHHM-së dhe detyra parësore është parandalimi, hetimi dhe shtypja e kundërvajtjeve penale nën juridiksionin e Gjykatës të BH-së (Neni 185 – Anullimi i Skllavërisë dhe Transporti i Skllavëve, Neni 186 – Trafikimi I Qënieve Njerëzor, Neni 187 – Rekrutimi Ndërkombëtar për Qëllime të Prostitucionit, Neni 188 – Ndalimi Pa Dokumente Identifikimi, Neni 189 – Kontrabanda e Personave, sipas Kodit Penal të BH-së). Veç kësaj, Skuadra të tjera janë ngritur në zyrat qendrore të ASHHM-së, në zyrat rajonale ne Sarajevë, në Banja Luka dhe në Mostar. Gjithashtu ka plane për të ngritur zyra rajonale në Distriktin Brcko dhe në Tuzla.

Parlamenti ka miratuar dy ligje në 2004; *Ligji mbi Agjensinë Shtetërore të Kufirit* dhe *Ligjin mbi kontrollin dhe supervizimi e kufinjve shtetërorë*, të cilët kanë përcaktuar juridiksionin e Shërbimeve Shtetërore të Kufirit dhe kontrollin dhe supervizimin e kufinjve shtetërorë. Këto Ligje përbëjnë një kuadër ligjor efektiv për shtypjen e migrimin joligjor dhe trafikimn e qënieve njerëzore.

Parlamenti ka miratuar *Ligjin mbi programin e mbrojtjes së dëshmitarëve*, që ofron kuadrin ligjor për një program dëshmitarësh më efektiv, duke përfshirë rastet e trafikimi të qënieve njerëzore. Ligji ofron mbrojtjen e identitetit të dëshmitarit dhe fshetësinë e deklaratave. Në fund të 2004, një Department për mbrojtjen e dëshmitarëve është krijuar pranë ASHHM-së. Viktimat, që tashmë kanë dëshmuar përpëra Gjykatave të HB-së, iu është ofruar një vend i sigurtë bazuar në statusin e dëshmitarëve nën mbrojtje. Për një vënië në zbatim më të frytshëm, strukturat e ASHHM-së, veccanërisht kapacitetet e këtij departamenti, kanë nevojë të zhvillohen dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë fushë ka nevojë për përkrahje.

Në 2005, Departamentet përkatëse për vënien në zbatim të Ligjeve në BH kanë paraqitur 36 raporte kundrejt 59 personave lidhur me shkeljet penale të trafikimit të qënieve njerëzore pranë Zyrës së Prokurorit.



Zyra e Prokurorit ka hetuar në total 68 raste të trafikimit të qënieve njerëzore dhe shkelje të tjera penale të lidhura me trafikimin. 37 hetime kanë nisur në 2005, ndërsa 312 hetime kanë nisur në 2004 dhe kanë vazhduar në 2005. Zyrat e Prokurorisë kanë ngritur 24 akuza kundër trafikantëve dhe autorëve të veprave kriminale të lidhura me trafikimn, ndërsa gjykatat kanë konfirmuar 26 akuza. Në fund të 2005, ka pasur 39 hetime të pazgjidhura, të cilat kanë vazhduar gjatë 2006. Gjatë 2005, 17 persona janë paditur dhe dënuar nga Gjykatat në BH.<sup>8</sup>

## Komente

Nënpunësit e Institucioneve Shtetërore nuk janë të trainuar plotësisht për vënien në zbatim të ligjeve të dekretuara. Ata kanë mungese ndjeshmërie kur përballen drejtpërdrejt me viktimat, veçanërisht me fëmijët. Përqindja e grave që punojnë kundër trafikimit në Institucionet Shtetërore është shumë e ulët (sidomos në shërbimet shtetërore të kufirit);

Ka një mungesë burimesh njerëzore dhe materiale në Institucionet që përballen me problemin e trafikimit të qënieve njerëzore;

Ka një mungesë bashkëpunimi midis nënpunësve që punojnë në terren;

Nuk ka një bazë të dhënash rreth numrit real të viktimave të trafikimit në BH

Problemi i martesave të rrema: trafikantët marohen me vajzat – viktimat të trafikimit në vendet e origjinës dhe më pas i sjellin ato në mënyrë ligjore në BH. Sapo arrijnë në BH, ata i detyrojnë këto vajza të prostituojnë.

Mungesa e fondeve si në Institucione edhe në OJQ.

## V. BEST PRACTICES

*Bashkëpunim i mirë* midis OJQ-ve locale, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve shtetërore ka ndihmuar në procesin e zgjidhjes të një numri të madh problemesh. Rezultatet e para tregojnë që masat e ndërmarra do të jenë dobiprurëse dhe të zbatueshme në praktikë.

Veprimet e ndërmarra me bashkëpunimin e OJQ-ve dhe sektorit public duke përfshirë edhe Marrëveshjet e lartpërmendura, vënia në zbatim e kuadrit ligjor, organizimi i vizitave të përbashkëta studimore jashtë vendit dhe organizimi i seminareve dhe ëorkshop-ve në vend.

Bashkëpunimi midis OJQ-ve dhe qeverisë është i kënaqshëm dhe

---

<sup>8</sup> The report on trafficking in human beings and illegal immigration in BH for 2005.

institucionet Shtetëore janë gjithomë gati të ndjekin direktivat e ofruara nga OJQ-të.

Përveç UMCOR-it dhe USAID-it, mbështetje të madhe përpjekjeve të OJQ-ve iu është dhënë edhe nga zyra e UN OHCHR - BH, zyra e Prokurorit të Federatës së BH-së, Gjykata Kushtetuese e Federatës së BH-së dhe Zyra e Koordinatorit të Shtetit për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

Një shembull i mirë *good practice*, është *publikimi* i librit “MARGUERITE mund të jetë motra jote, bija jote, një shoqe...”. Kjo është një pjesë e fushatës të shoqatës “ZENA BIH” që u zhvillua në 2004. Është një përmbledhje e historive të vërteta rrëngjethëse të shkruara nga viktimat të trafikimit (theksi i është vënë faktit që historitë janë shkruar nga viktimat të trafikuar nga BH-ja dhe gjithë Europa). Viktimat gra, që kanë pranuar të publikojnë historitë e tyre, kanë ndihmuar në ngritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik. Veccanërisht, OJQ nga e gjithë bota, duke përfshirë veccanërisht: BH-në, Francën, Serbinë dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, publikojnë revistën dy-javore *START BiH*.

## VI. MANGËSITË

Problemi kryesor dhe më i rëndësishëm i trafikimit të viktimave është *procesi i ri-integritimit*. Të gjithë projektet, të zbatuara nga OJQ-të dhe agjensitë Shtetërore, fokusohen në dhënien e asistencës si akomodimi në Shtëpitë e Sigurta. Sidoqoftë, ato nuk përballeshin më ri-integrimin e viktimave, me fjalë të tjera socializimin e tyre. Nuk ka një ndjekje të mëtejshme të rasteve të viktimave pasi ato lënë strehëzën. Ka një mungesë të ndjekjes së rezultateve në përshtimin social të viktimave si edhe në vështirësitë që hasin për të hyrë në tregun e punës. Si pasojë viktimat rrezikojnë të bien përsëri në ciklin e trafikimit.

*Mungesa e bashkëpunimit të mirë dhe koordinimit* midis vendeve të origjinës, tranzitit dhe destinacionit, me qëllim ndjekjen e rasteve të viktimave.

OJQ-të që aktualisht merren me trafikimin përballeshin me problemin e *burimeve të pakta financiare*.

Pavarësisht nga rëndësia e *fushatave ndërgjegjësuese* mbi trafikimin e qënieve njerëzore, është e qartë që nuk janë të mjaftueshme për parandalimin e fenomenit. Përsa i përket këtyre fushatave qendrat urbane janë të përfshira, ndërsa zonat rurale janë lënë pas dore.

Ndonëse Plani Shtetëror i Veprimit ofron fuqizimin ekonomik të grupeve vulnerabël, nuk janë adresuar mjaftueshëm *ccështjet kryesore social ekonomike* të trafikimit të qënieve njerëzore.

## VII. VLERËSIMI I NEVOJAVE

Duke marrë parasysh mangësitë dhe komentet e përfshira në këtë raport dhe nevojën për përmirësimin e situatës, një listë rekomandimesh paraqitet më poshtë.

### REKOMANDIME

Ka nevojë për një trajtim më serioz të *ri-integrimit* të viktimave të trfaikimit të *riatdhesuara*.

*Bashkëpunim dhe koordinim* më i mirë midis *qeverive rajonale dhe OJQ-ve*.

*Strategjitë e reduktimit të rreziqeve* duhet të bazohen në përfundimet e kërkimeve të bëra. Duke marrë parasysh që përfundimet e kërkimeve tregojnë rrënjët e shkaqeve të trafikimit të qënieve njerëzore, duhet të ketë një vëmendje më të madhe në zhvillim dhe vënien në zbatim të strategjive që adresojnë këto shkaqe kryesore social ekonomike I varfëria e përgjithshme, statusi i ulët social ekonomik, dhuna në familje, etj).

*Mbështetje financiare dhe materiale* e mëtejshme duhet t'iu sigurohet *OJQ-ve*, sidomos atyre në vendet e origjinës, me eksperiencë të gjatë, si edhe, burime njerëzore dhe material për parandalim, asistencë dhe ri-integrim. Është shumë e rëndësishme të fokusohemi në mbrojtjen e viktimave me origjinë nga BH-ja dhe t'iu ofrojmë atyre edukim, trainim, kualifikime të mëtejshme, dhe mundësi për të hyrë në tregun e punës, akomodim dhe këshillim sistematik.

Përsa i përket *aktiviteteve ndërgjegjësuese*, është e nevojshme të fokusohemi në qytetet e vogla/zonat rurale, nga të cilat vijnë shumica e rasteve të viktimave. Material të printuara duhet të shpëndahen nëpër fshatra dhe Ëorkshp-e duhet të organizohen me pjesëmarrjen e burrave të interesuar të mësojnë më shumë rreth këtij problem. Këtyre duhet t'iu shtohen, pagesa të vogla për pjesëmarrësit, në ëorkshop-e apo focus grupe, për të motivuar pjesëmarrjen e publikut – duke pretenduar që ata më vonë do të jenë të interesuar në këto diskutime.

## LIST OF ABBREVIATIONS

ARIADNE	NGO Netëork against human trafficking in SE and E. Europe
BiH	Bosnia and Herzegovina
CARDS	EU funded Program: Community Assistance for Reconstruction, Development and Stabilization
CRS	Catholic Relief Services
EMMAUS	International movement against extreme poverty
EU	European Union
EUROPOL	European Police Office
FYROM	Former Yugoslav Republic of Macedonia
LARA	NGO in BiH
INTERPOL	International Police
IOM	International Organization for Migration
MHRR	Ministry for Human Rights and Refugees
NAP	National Action Plan (State Action Plan)
OSCE	Organization for Security and Cooperation in Europe
ODIHR	OSCE's Office for Democratic Institutions and Human Rights
PETRA	Balkan Netëork at the State Level
RING	Regional Netëork for the prevention of trafficking
SECI	South-East European Cooperation Initiative
SIPA	State Investigation and Protection Agency
UMCOR	United Methodist Committee on Relief
UNICEF	United Nations Children's Fund
UNOHCHR	United Nations Office of the High Commissioner for Human Rights
USAID	United States Agency for International Development.
ZENA	NGO in BiH.

## BULLGARIA

### I. Hyrje

Republika e Bullgarisë, gjendet në Europën Juglindore në Gadishullin e Ballkanit Perëndimor, në kufi me Detin e Zi (Lindje), me Rumaninë (Veri), me Serbinë, Malin e Zi dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (Perëndim), Greqinë (Jug) dhe me Turqinë (Juglindje). Trafikimi qënieve njerëzore, veccanërisht i grave, është një problem serioz për Bullgarinë, që është një vend origjine, destinacioni dhe tranziti. Ky problem është pranuar si i tillë në *Raportin Progresiv 2005* të Komisionit Europian për *hyrjen e Bullgarisë* në Bashkimin Europian, në *Raportin e të Drejtave të Njeriut 2005* të Departamentin të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe nga Qeveria Bullgare. Raporti i Departamentit të Shtetit të SH.B.A.së i botuar në Qershor 2006, përmend Bullgarinë si një vend origjine, tranziti dhe destinacioni për gratë dhe vajzat e trafikuar nga Rumania, Moldavia, Rusia, Ukraina, Armenia, Libani dhe Azia Qëndrore drejt Bullgarisë për në Gjermani, Francë, Itali, Hollandë, belgjikë, Republika Ceeke, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe territori i Kosovës, për qëllime të shfrytëzimit seksual. Sipas "*Raportit të Bullgarisë mbi të Drejtat e Njeriut dhe mbi Trafikimin e Qënieve Njerëzore 2005*" të Departamentit të Shtetit të SH.B.A-së, bazuar në burimet qeveritare dhe të OJQ-ve, shumica e viktimave janë gra dhe vajza të trafikuar me qëllim shfrytëzimit seksual. Sipas burimeve qeveritare dhe OJQ-ve, gra të reja të moshës 18-24, me nivel të ulët edukimi, dhe marrëdhënie familjare problematike janë grupet më vulnerable për trafikimin. Gjatë viteve të fundit, pavarësisht uljes së përqindjes të papunësisë, shumica e viktimave të trafikimit gra nuk kanë gjetur mundësi për të gjetur një punë të përshtatshme me edukimin dhe aftësitë e tyre.

*Fëmijët Roma* trafikohen në Bullgari dhe jashtë vendit për qëllimin e lypjes dhe vjedhjeve të vogla. Në 2005, autoritetet austriake kanë identifikuar 700 fëmijë Romatë trafikuar nga Bullgaria drejt Austrisë për lypje dhe shfrytëzim seksual. Ministria e Brendshme ka vënë re një rritje të numrit të burrave dhe djemve të trafikuar me qëllim shfrytëzimit e punës së detyruar..

Një tendencë e re është industria e *trafikimit të foshnjave*; gra shtatëzëna kalojnë kufirin për të lindur dhe shesin foshnjat e tyre. Në raportet më të fundit, Interpol-i shpreh që bullgarët janë bërë drejtuesit e rrjetit të rrethit të tregëtisë së foshnjave që është nën hetim në Greqi,

Itali, Francë dhe Portugali. Është vërtetuar që kanalet kryesore të kësaj tregtie të qënieve njerëzore përfundojnë në Greqi.

Sipa të dhënave të ofruara nga Zyra e Specializuar në Luftën kundër Krimit të Organizuar të Ministrisë së Brendshme, ka një lidhje të fortë midis trafikimit të qënieve njerëzore dhe krimit të organizuar. Në 2002, Zyra ka identifikuar 42 grupe të krimit të organizuar të përfshira në trfaikimin e qënieve njerëzore për shfrytëzim seksual, 14 grupe të krimit të organizuar të përfshira në migrimin e paligjshëm, 5 grupe të krimit të organizuar të përfshira në përpjekjet për punë jashtë vendit dhe 2 të përfshira në pasaporta fallso, karta krediti, etj.

Qeveria e Bullgarisë nuk përmbush plotësisht stantardet ndërkombëtare minimale për eliminimin e trafikimit; sidoqoftë, po bën përpjekje të rëndësishme për përmbushjen e tyre. Në 2004, qeveria ndërmoi një pozitë më aktive në parandalimin e fenomenit dhe në mbrojtjen e viktimave. Ka rritur përpjekjet përforcuese dhe ka ndërmarrë hapa praparkë për zbatimin e legjislacionit anti-trafikim, duke përfshirë edhe miratimin e një strategjie kombëtare dhe një legjislacion të hollësishëm përr mbrojtjen e viktimave dëshmitarë.

## II. Kuadri Kombëtar Ligjor

### A. Ligji Kombëtar

*Ligji mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore,*<sup>9</sup> miratuar në 2003, është dokumenti ligjor themelor anti-trafikim në lëgjislicionin Bullgar, ndërsa Kodi Penal është amenduar në përputhje me nevojat në 2002.<sup>10</sup> Të dy këto dokumente pasuan ratifikimin e Protokollit të Palermos.

*Ligji mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore,* botuar në Gazetën Shtetërore më 20 Maj 2003, hyri në fuqi më 1 Janar 2004 dhe u rishikua më Tetor 2005. Ky ligj sistemon ccështjet e mëposhtme: (a) autoritetin dhe kompetencat e institucioneve shtetërore që merren me trafikimn e qënieve njerëzore dhe ndërveprimin e tyre; (b) statusin dhe objektivat e strehëzave, qendrave dhe komisioneve të ngritura në përputhje me rrethanat; (c) masat parandaluese; (d) masat për mbrojtjen e grave dhe fëmijët në veccanti. Një nga paraimet kryesore të ligjit është dhënia e mbrojtjes special për viktimat që bashkëpunojnë me autoritetet hetimore.

---

<sup>9</sup> SG No. 46/2003.

<sup>10</sup> SG No. 92/ 2002

Në 2004, dy Norma u miratuan, bazuar në ligjin e ri: Norma *mbi organizimin dhe aktivitetet e Komisionit Kombëtar për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore* dhe Norma *për strehëzat dhe qendrat për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të trafikimit*. Qendrat janë ngritur parandë komisioneve locale për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Strehëzat janë krijuar nga Komisioni Kombëtar, me propozim të komisioneve lokale, ose, nga persona fizikë dhe juridikë që janë regjistruar në Regjistrin special të Komisionit Kombëtar. Këto Norma nuk janë dekretuar akoma.

Në Kodin Penal, përveç përkufizimit të amenduar të *grupit të krimit të organizuar* (Art. 93, item 20), janë përfshirë amendime të tjera, në mënyrë që dënojnë penalisht forma të tjera të trafikimit dhe veprimet që e favorizojnë atë. Këto vepra, që dënohen me sanksione më të rrepta, mund të përshijnë përdhunim me qëllim nxitjen në sjellje pasuese prostitucioni, (Art. 152 para. 3 në item 4); nxitje për kryerjen e akteve të prostitucionit, (amended Art. 155 PC), dhe; rrëmbimi me qëllim nënshtrimin e personit për vepra prostitucioni (Art. 156, not amended).

Kur krimi i *trafikimit* është një ccështje ndërkombëtare, zbatohen nenit e reja si në vijim: 159a; 159b, dhe; 159c. Tteksti kryesor i Nenit 159a përmbledh të gjithë elementet e trafikimit të përfshira në Protokollin e Palermos. Pavarësisht nga miratimi i viktimës është i dënueshëm.

Gjithashtu përmenden edhe mënyrat e veccanta për kryerjen e krimit; përdorimi i forcës, mashtrimin, rrëmbimi, përdorimi i pushtetit, etj. Sanksionet më të rrepta, nga pesë vjetë në pesëmbdhejtë vjetë burg, zbatohen në raste te recidivizmit të rrezikshëm, ose kur krimi është kryer në konteksit e veprimtarisë të një grupi të krimit të organizuar. Një zhvillimi liegjislaviv i kohëve të fundit, miratuar në përballje me një shtimi të rasteve të një nga formave më të rënda, është amendimi i Kodit Penal përsa i përket trafikimit të grave me qëllim tregëtinë e foshnjave. Dënimi i propozuar për këtë lloj trafikimi është më i rreptë. Përsa i përket *Procedurës Penale*, viktimat nuk lejohen të mbrojnë të drjtat e tyre në stadet përkatëse të procedurave ligjore kundër autorëve të krimit, sicc kërkohet nga Protokollin e Palermos. Sipas, Kodit të *Procedurës Penale*, viktimat është pjesëmarrëse në fazën hetimore, dhe nuk mund të jetë një akuzues privat. Si rrjedhim, vetëm në fazën gjyqësore mund të ketë një deklavim. Këto kufizime i heqin të drjtën viktimës, (shumicën e rasteve grua) të drejtën e saj/të tij të marrë pjesë në procedurat ligjore dhe të mbrojnë interesat dhe dëmtimet e saj/të tij. Për më tepër që nuk ka një mbrojtje të veccantë për viktimat gra. Këto

dy faktorë kanë një efekt mosbindës. Si pasojë, shumica e grave refuzojnë të dalin në gjyq dhe marrin rolin e akuzuesit privat. Kjo situatë lehtëson detyrën e të pandehurit dhe kjo është arsyeja kryesore pse në shumë raste të trafikimit të grave, dënimet e dhëna nuk korrespondojnë me ashpërsinë e krimve të kryera. Megjithatë viktimat që bashkëpunojnë me hetuesit vendosen nën mbrojtje të veçantë, është e vështirë për to të bashkëpunojnë, për shkak të kushteve të krijuara nga sistemi i procedurës penale dhe mungesës efektive të mbrojtjes së të drejtave të grave. Legjislacioni për mbrojtjen e dëshmitarëve i miratuar më Nëntor 2004 nuk është vënë plotësisht në zbatim për shkak të fondeve të pamjaftueshme.

#### Komente

Nuk ka një sektor të veçantë që i referohet *të drejtave të viktimave*.

Kapitulli *Mbrojtja dhe Mbështetja e Viktimave të Trafikimit* fokusohet në masat administrative dhe të mbrojtjes. Mbrojtja dhe mbështetja iu ofrohet *vetëm viktimave që* vendosin të bashkëpunojnë me hetuesit; tduke vendosur në këtë mënyrë shumicën e viktimave në një pozitë më pak të favorshme gjatë procedurave penale. Mbrojtja e viktimave nuk duhet bëhet vetëm me kushtin e dhënies së faktve dhe bashkëpunimit me sistemin e drejtësi penale dhe autoritete e tjera.

Nuk ka një të drejtë të veçantë për *ndihmë ligjore*, e cila do të sigurontë përfaqësimin e drejtë të interesave të viktimës gjatë procedurave penale.

*Dokumenti për Përkrahjen e Punësimit* duhet saktësisht të parashikojë që viktimat e trafikimit i përkasin kategorisë së grupeve vulnerabël, si një masë rehabilitimi dhe përfshirjeje.

*Periudha një mujore e reflektimit*, gjatë të cilës viktimat duhet të vendosin nëse do të bashkëpunojnë me autoritetet, është shumë e shkurtër për një grua që vuan nga trauma aq të rënda pasi është trafikuar.

Mungon mekanizmi që garanton të drejtën e *kompesimit* për viktimat e trafikimit. Kjo duhet të sistemohet në legjislacionin shtesë.

Ligji nuk ka një *trajtim gjinor*. Nuk ka një pajisje të veçantë për mbrojtjen e grave viktimat të trafikimit, as në emërtimin e Ligjit, as në kapitullin e *Parandalimit*, as në kapitullin mbi sistemin e veprimtarisë së strehëzave.



Dënimet për trafikantët nuk janë mufatueshëm të rënda për ti shkruajuar apo mosbindur në krijimin e rrjeteve kriminale. Ato janë shumë të lehta krahasuar me dhimbjen dhe dënim e vuajtur nga viktimat e trafikimit.

Zgjidhja e ndërmarrë në lidhje me tregëtinë e fishnjave, që dënon nënat që shesin foshnjat e tyre është e diskutueshme. Nëse nuk ndërthuret me masat e nevojshme për të luftuar rrënjët e kësaj tregtie, gratë do të viktimizohen dhe do të ngurrojnë të bashkëpunojnë më autoritetet për të dëshmuar kundër trafikantëve.

Garancitë për *mbrojtjen e dëshmitarëve*, sipas Nenit 97a të Kodit të Procedurës Penale nuk janë të mjaftueshme për viktimat e trafikimit.

Ndryshimet në Kodin Penal dhe miratimi i Ligjit të ri tregon qartë që qeveria Bullgare ka ndryshuar trajtimin e deri më sotëm të trafikimit të qënieve njerëzore si një problem të krimit të organizuar në drejtim të kuptimit të këtij fenomeni si një shkelje e të drejtave të njeriut.. Por, legjislacioni ka akoma nevojë për përmirësime, që të arrijë standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të viktimave të trafikimit.

## B. Plani Kombëtar i Veprimit

*Ligji mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore* krijoi një Komision Kombëtar, që drejtohet nga Këshilli i Ministrave. Ky komision kryesohet nga Zëvendës Kryeministri dhe dy zëvendësa. Komisioni Kombëtar përbëhet nga përfaqësues të Ministrive dhe agjensive të angazhuara në aktivitete anti-trafikim, sicc janë, Ministria e Brendshme, e Punëve të Jashtme, Punës dhe Politikave Sociale, Drejtësisë, etj (neni 4 i ligjit). Organizatat Jo qeveritare që merren me trafikimin mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e këtij komisioni. Detyra kryesore e Komisionit Kombëtar është të rregullijë, koordinojë dhe kontrollojë vëniën në zbatim të politikave kombëtare kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave. Vecc kësaj, sipas Ligjit, *komisione lokale* duhet të krijohen nën okelion e Komisionit Kombëtar. Mandate i tyre përfshin zbatimin e politikave kombëtare në nivelin local dhe paraqitjen e *raporteve vjetor* Komisionit Kombëtar. Komisioni Kombëtar përgatit *raporte/programe vjetore* mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qënieve njeëzore si edhe mbi mbrojtjen e viktimave. Ato paraqiten për

miratimin pranë Këshillit të Ministrave. Deri më sot, asnjë raport vjetor nuk është vënë në dispozicion të opinionit publik, ndërsa nuk ka një ëbsite zyrtar të Komisionit Kombëtar ose burime të tjera për aktivitetet e tij në monitorimin, kërkimin dhe analizën.

Në Janar 2005, Komisioni Kombëtar Anti-Trafikim mbajti mbledhjen e tij të dytë, gjatë të cilës miratoi formalisht një *Strategji Kombëtare Anti-trafikim*. Sidoqoftë, deri në fund të vitit, Komisioni nuk ka mbajtur mbledhje të rregullta, nuk ka emëruar një sekretariat funksional dhe akoma nuk ka krijuar komisionet rajonale anti-trafikim që parashikohen nga strategjia kombëtare.

Në 2005 dhe 2006, Qeveria miratoi *Programin Kombëtar për luftën dhe parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore dhe për mbrojtjen e viktimave*. Programi përfshin masa institucionale, që synojnë krijimin e strukturave administrative për parandalimin dhe ndjekjen penale të trafikimit të qënieve njerëzore, si edhe, për mbrojtjen e viktimave. Shtatëmbëdhjetë institucione qeveritare duke përfshirë edhe tetë ministri janë përgjegjëse për zbatimin e Programit. Organizta të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si IOM-Sofie, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale, e Drejtësisë, e Edukimit dhe Shkencës, Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve janë planifikuar të kontribuojnë me punën e tyre.

*Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHMF)* është institucioni i vetëm që ka një sistem aktivitetesh vepruese në fushën e mbrojtjes së fëmijëve nga trafikimi. Agjensia ka miratuar një *Plan Kombëtar Veprimi kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve*. Objektivat kryesore përfshijnë ndërgjegjësimin e fëmijëve për shfrytëzimin seksual dhe zhvillimin e mekanizmave parandaluese, rritja e kualifikimit të profesionistëve që punojnë me fëmijët dhe politikat mediatike të institucioneve për sensibilizimin e opinionit public mbi shfrytëzimin seksual të fëmijëve. Në fushës e mbrojtjes, Plani Kombëtar I Veprimit i Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve përqëndrohet në harmonizimin e legjislacionit vendas me standartet ndërkombëtare dhe përmirësimin e mbrojtjese së të drjtave të fëmijëve–viktima. Këto objektiva ushtrohen nëpërmjet:

Amendamenteve të Kodit të Procedurës Penale (KPP)

Sigurimi i fshehtësisë së dëshmimeve të dëshmitarëve (regjistrime)

Respektimi i të drejtës së fëmijës për të qëndruar në një vend të sigurtë, ndërsa inetrvistohet për hetim, dhe

Ngritja e mekanizmave, përfshirë edhe ato financiare, për riatdhësimin e fëmijëve të pashoqëruar.

Plani ka një kapitull të veçantë mbi *informimin* dhe *bashkëpunimin ndërkombëtar* për ngritjen e një mekanizmi kombëtar të shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve dhe organizatave përgjegjëse. Gjithashtu është krijuar edhe posti i *Koordinatorit Kombëtar*, aktivitetet e të cilit zbatohen së bashku nga Ministri I Brendshëm dhe Kryetari i ASHMF.

#### Komente

*Komisioni Kombëtar* ka një hapësirë të madhe kompetencash, por nuk funksionon mirë. Më specifikisht, nuk është caktuar asnjë buxhet i veçantë ngritjen e strehëzave, qendrave dhe komisioneve. Nuk është dhënë asnjë ndihmë as për qendrat e ngritura nga organizatat joveritare (OJQ-të) dhe për parandalimin e trafikimit në 2005. Praktikisht, më shumë se dy vjet pasi ka hyrë në fuqi, Ligji akoma nuk zbatohet, ndërsa Komisioni Kombëtar ka ngelur një institucion në letër. Problemi i koordinimit efektiv, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet të gjithë institucioneve dhe organizatave të përfshira në *zbatimin e Programit Kombëtar* është akoma i pazgjidhur.

### III. Kuadri i Përgjithshëm

#### A. Ngritja e Kapaciteteve

Dokumentet zyrtare sigurojnë një sërë masash. *Programi Kombëtar* parashikon ngritjen e *komisioneve anti-trafikim* në nivelin lokal në strukturë të bashkive. Kryetari i bashkisë është përgjegjësi për ngritjen dhe funksionimin e komisioneve bashkiake. Sipas Programit, nuk janë caktuar fonde të veçanta për komisionet bashkiake dhe burimet financiare për komisionet lokale duhet të mblidhen nga projektet. Kapitulli i dytë I programit synon parandalimin dhe ndërgjegjësimin public për trafikimin e qënieve njerëzore. Përfshin masa, si *edukimi* i veçantë në shkollë, *trainimi* i *oficerëve të policisë* dhe *juristëve* që punojnë në fushën e trafikimit të qënieve njerëzore, si edhe të *nënpunësve konsullorë* që punojnë në ambasadat e Bullgarisë jashtë vendit. Gjithashtu janë në focus *shpërndarja e materialeve* dhe *fushatat e informimit publik*. Kapitulli i tretë dhe i katërt i Programit rregullojnë përkatësisht, *edukimin* dhe *trainimin e personelit*, si dhe *mbrojtjen, rehabilitimin dhe ri-integrimin* e viktimave të trafikimit. Nismat më të sukseshme për ngritjen e kapaciteteve gjatë tre viteve të fundit, janë ndërmarrë nga organizatat, si, IOM-i, në kuadër të njëj

projekti të finacuar nga USAID-i; OJQ si Fondacioni *Nadya*, the Fondacioni *Association Animus*, *Care-Bullgari*, Shoqata *Demetra-Burgas*, dhe organizata të tjera lokale me synim *trainimin* e autoriteteve *policore*, *gjqësore* dhe *lokale*..

Gjithashtu janë organizuar nga organizatat e mësipërme dhe nga *Face to Face* dhe *Aleanca e Grave për Zhvillim* programe në *shkolla* për *mësuesit* dhe *nxënësit*, *si edhe*, leksione dhe diskutime midis të rinjve. Gjatë këtyre ngajrjeve, një theks i veçantë i është vënë nevojës së ngritjes së kapaciteteve për parandalimin e trafikimit të fëmijëve. *Bashkëpunimi ndërkombëtar* është një nga mjetet kryesore për ngritjen e kapaciteteve. *Vizita studimi* dhe *seminare trainimi* janë organizuar nga agjensitë dhe organizatat e SH.B.A, nga agjensitë dhe OJQ-të hollandeze, Inisiativa e Ballkanit kundër Trafikimit dhe Korrupsionit ACTA, etj. Një shumëllojshmëri *materialesh informative parandaluese* janë publikuar nga IOM-i, *Animus-i*, deh OJQ-të e tjera të përmendura më lart.

#### Komente

Për shkak të mungesës së koordinimit efektiv dhe bashkëpunimit midis të gjitha institucioneve të përfshira në zbatim, Programi Kombëtar, nuk është vënë plotësisht në zbatim, përfshirë edhe ngritjen e kapaciteteve.

Qeveria duhet të ndërmarrë masa konkrete për të ngritur kapacitetet e mbrojtjes së viktimave duke siguruar ngritjen e komisionve anti-trafikim dhe mbështetjen e tyre..

Një shqetësim kryesor është mungesë e burimeve financiare, duke marrë parasysh që të gjitha aktivitetet e lartpërmendura mbështeten kryesisht nga buxheti i OJQ-ve dhe burimeve të projekteve.

#### Analiza, Kërkime dhe Mekanizmat Monitorues

Akoma nuk ka një mekanizëm të posaccëm për kerkimin, monitorimin, analizën dhe trafikimin e qënieve njerëzore. *Komisioni Kombëtar kundër trafikimit* koordinon dhe kontrollon zbatimin e politikave kombëtare anti-trafikim, ndërsa komisionet lokale duhet të veprojnë në nivelin lokal. Sipas Ligjit Komisioni Kombëtar si edhe Komisionet lokale duhet të paraqesin Raporte Vjetore.

Raportet, e përgatitura nga Ministria e Brendshme, janë fokusuar më shumë në luftën kundër krimit të organizuar. Këto raporte nuk janë zyrtare dhe nuk janë në dispozicion të publikut. Vetëm OJQ-të ,

kryesisht ato të lartpërmendura, kaneë kryer kërkime, analiza dhe monitorime, që janë botuar në raportet e tyre. Një kërkim i kohëve të fundit është kryer nga *Bulgarian Gender Research Foundation* dhe *MBMD polling Agency*. Synon në identifikimin e problemeve të tanishme në parandalimin e trafikimit për shfrytëzim seksual dhe prostitucion, duke adresuar gjithashtu edhe kërkesën për shërbimet seksuale. Si përfundim u arrit në faktin që zbatimi i ligjit në nivelin parandalues është i ulët dhe joefektiv. Aktivitetet e institucioneve shtetërore në fushën e trafikimit janë vlerësuar si shumë të pakënaqshme nga të anketuarit.

#### Komente

Qeveria duhet të sigurojë përforcime të dhënave të qarta të trafikimit duke *veccuar kontrabandën* e të huajve dhe *statistikat e trafikimit të qënieve njerëzore*.

Nuk ka *asnjë Raport Vjetor* në dispozicion të publikut, ndërsa Komisioni Kombëtar nuk ka një ëebsite zyrtar, ose ndonjë burim për aktivitetet e tij mbi monitorimin, kërkimin dhe analizën.

C. Bashkëpunimi dhe Rrjeti në Nivelet Rajonale dhe Kombëtare Inisiativa e qeverisë për bashkëpunimin rajonal në kuadër të BE-së kryesisht fokusohet në luftën kundër krimit të organizuar dhe migrimit ligjor, se san ë mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Në të kundër, rrjetet e OJQ-ve, si *La Strada*, me pikë kryesore bullgare Shoqatën *Animus* vendos në focus mbrojtjen e viktimave. Rrjetet e OJQ-ve *Koalicioni Kundër Trafikimit të Grave (KKTG)* dhe *Lobi i Grave Europiane (LGE)* po zbatojnë një project parandalues, financuar nga qeveritë e SH.B.A-ës dhe Suedisë. Platforma Bullgare e LGE-së koordinohet nga Fondacioni Bullgar për Kërkim Gjinator.

Rrjeti Ballkanik i të Drejtave të Njeriut (RRBDNJ), nën koordinimin e FBKGJ, është gjithashtu aktiv në zhvillimn dhe zbatimin e programve parandaluese.

*Rrjeti ARIADNE*, një rrjet i krijuar së fundmi, koordinohet nga Qendra për Mbrojtjen e Të drejtave të Njeriut, Greqi ka si objektiv të rrisë bashkëpunimin e ngushtë, jo vetëm midis OJQ-ve në rajon, por edhe midis OJQ-ve, qeverive dhe organizatave ndërqeveritare në fushën e parandalimit dhe lufës kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

D. Mobilizimi i burimeve

Nuk ka një *buxhet të veçantë* caktuar nga qeveria Bullgare për OJQ-të. Mirëpo, institucionet qeveritare mbështeten në aktivitetet e OJQ-ve, sidomos në fushën e ndërgjegjësimit dhe parandalimit, si edhe në shërbimet ndaj viktimave. Si rrjedhim, OJQ-të bullgare mbështeten financiarisht nga donator të huaj, si USAID-i, Fondi Botëror për gratë, ambasadat e huaja në Bullgari, grante të tjera të vogla, etj..

*Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë* (OSBE) dhe veccanërisht, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (ODIHR) është në pararojë të përpjekjeve ndërkombëtare për të luftuar dhe parandaluar trafikimin e qënieve njerëzore. Misionet e OSBE-së luajnë një rol jetësor në përpjekjet anti-trafikim në vende pritëse.

Aktorë të tjerë aktivë janë *Këshilli i Europës* dhe agjensitë e *Kombeve të Bashkuara*, *Other active players are the Council of Europe and UN agencies*, including the United Nations Office of the High Commissioner for Human Rights, the United Nations Children's Fund, the United Nations Population Fund, the United Nations High Commissioner for Refugees, the United Nations Development Fund for Women, the United Nations Development Programme, the United Nations Interregional Crime and Justice Research Institute, and the United Nations Office on Drugs and Crime. Organizata të tjera janë Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Qendra Ndërkombëtare për Politikën e Zhvillimit të Migrimin dhe Europol-i. Roli i tyre nuk është një rol shumë financiar por është shumë i rëndësishëm ndikimi i tyre në politikën kundër trafikimit në Bullgari. Donatori kryesor gjatë 3-4 viteve të fundit ka qenë USAID-i, që mbështet IOM-Sofia.

Një burim tjetër financiar është *Programi Danez kundër trafikimit njerëzor*, që punon kryesisht me organizata ndërkombëtare dhe OJQ, kryesisht në Bjellorusi, Moldavi dhe Ukrainë. Përbërës rajonal të Programit janë edhe Bullgaria dhe Rumania. Objektivi i programit është mbështetja e autoriteteve kombëtare, organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve kundër trafikimit nëpërmjet masa të përshtatshme të parandalimit, fuqizimit të ligjit dhe masave të mbrojtjes/asistencës. Përveç kësaj, gjatë periudhës 2005-2006, Bullgaria është ndër dymbëdhjetë shtete që kanë marrë ndihmë në luftën kundër trafikimit njerëzor nga një nismë e përbashkët Amerikane-Suedeze. Qeveritë e SH.B.A. dhe Suedisë kanë kontribuar financiarisht për një projekt parandalimi, kryesuar nga Koalicioni Kundër Trafikimit të Grave (KKTG) dhe Lobi i Grave Europiane (LGE).

#### Komente

Ekziston rreziku që në qoftë se qeveria nuk do të mbështesë nga buxheti kombëtar aktivitetet e OJQ-ve, nismat e lartpërmendura dhe praktikat më të mira do të ndërpriten dhe ekspertiza e krijuar do të humbasë. Viktimat e trafikimit që mbështeten fuqimisht nga shërbimet e OJQ-ve do të dëmtohen.

### III. Vënia në zbatim e ligjeve anti-trafikim

#### A. Parandalimi dhe ndërgjegjësimi

Sicc është përmendur edhe më lart, qeveria Bullgare miratoi, në 2005 dhe 2006, dy *Programe Kombëtare Anti-Trafikim*. Programet bllokajn njëri-tjetrin dhe aktivitetet e përfshira në programin e 2005 nuk janë zbatuar ende dhe janë transferuar në 2006. Shumica e aktiviteve të Programit të 2006 janë parashikuar në Dhjetor 2006, që lejon qeverinë ti shtyjë (edhe një herë tjetër) në 2007. Për më tepër qeveria ka deklaruar që nismat e saj parandaluese kanë si target grupet vulnerable, dukepërfshirë shërbime educative dhe psikologjike për fëmijët e rrugës dhe vendosjen e tyre në kujdestari mbrojtëse. Sidiqoftë, nuk ka një strategji të veçantë për mbështetjen dhe fuqizimin e grave në fushën e e dukimit dhe në jetën ekonomike.

Një numër programesh parandalimi dhe ndërgjegjësimi janë zbatuar nga OJQ-të. Projekti i parandalimit, i zbatuar nga *Koalicioni Kundër Trafikimit të Grave (KKTG)* dhe *Lobi i Grave Europiane (LGE)*, synon në luftën kundër trafikimit për shfrytëzim seksual duke adresuar dhunën kundër grave, kërkesën për shërbimet e viktimave dhe lidhjet mes prostitucionit dhe trafikimit. Analiza dhe fushata të informimit të veçantë janë organizuar në cdo vend të Europës Jug-Lindore të përfshirë në projekt. Dhuna ndaj grave dhe shkelja e të drejtave themelore social-ekonomike të vajzave të reja u shfaqën si arsyt kryesore të trafikimit dhe prostitucionit.

Një nisëm tjetër që synon parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore është vënë në zbatim nga *Rrjeti Ballkanik i të Drejtave të Njeriut (RRBDNJ)*. Përfaqësuesit e anëtarëve të RRBDNJ-së në gjashtë vende të Ballkanit, nën koordinimin e FBKGJ, ka kryer një analizë për identifikimin e shkaqeve të trafikimit të grupeve më vulnerable, të lidhjeve ndërmjet trafikimit dhe shërbimeve seksuale me pagesë dhe mbi mënyrat e fuqizimit të bashkëpunimit midis OJQ-ve dhe institucioneve qeveritare. Analiza Bullgare paraqet që vjzat e reja

bullgare, të moshës 18-24 vjecc, janë të motivuara të kalojnë kufijtë kundrejt ofertave për punë të mira si kamariere, au-pairs dhe kërcimtare në vendet e Europës Perëndimore dhe Qëndrore. Në vend të këtyre, ato detyrohen forcërisht të kryejnë shërbime seksuale për klientët. Prirja tregon që ka një numër të rritur të vajzave shumë të reja që ofrojnë shërbime seksuale në Bullgari. Shumë raste lidhen me trafikimin e brendshëm dhe të jashtëm.

#### Komente

*Komisioni Kombëtar* nuk është efektiv dhe nuk mund të koordinojë vënien në zbatim të programit të miratuar.

Deri më sot nuk është vendosur një *bashkëpunim efektiv* midis institucioneve shtetërore dhe OJQ-ve në fushën e edukimit dhe aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësisimit.

Qeveria duhet të adresojë përpjekjet për *përmirësimin e situatës ekonomike*, veçanërisht të grupeve vulnerabël dhe të marrë masa për të garantuar siguri në tregun e punës dhe mbrojtje të përshtatshme sociale.

*Strategjitë parandaluese* duhet të jenë afat gjata dhe duhet të sybojnë uljen e varfërisë, zhvillimin e strukturave sociale dhe dhënien e mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat.

#### B. Mbrojtja dhe Asistenca

*IOM-Sofie* është *agjensia kryesore referuese* që asiston viktimat Bullgare të trafikimit të rikthehen në Bullgari dhe nënshtetasit e huaj të riatdhesuar nga Bullgaria. *Organizata mbështet vetëm viktimat që pranojnë të marrin pjesë në programin riatdhesues*. Qeveria Bullgare ka miratuar një masë të veçnatë për pajisjen e viktimave të trafikimit me leje qëndrimi dhe pune, ndërsa janë duke marrë pjesë në procedurat penale.

Bullgaria ka vetëm një *qendër krizas* në Sofie, drejtuar nga OJQ-ja *Shoqata Animus*, me mundësi të pakta akomodimi, deri në 8 ditë, për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit. Në fshat, ndodhen edhe tre strehëza të tjera, me kapacitete dhe qëndrueshmëri të vogël, të cialt drejtohen nga OJQ-të. I vetmi strehim i veçantë për viktimat e trafikimit drejtohet nga zyra e IOM-it, në Sofie. Në Sofie, shoqatae Animus drejton një linjë ndihme telefoni 24 orë. Gjithashtu OJQ të tjera kanë linja me kapacitete të kufizuara.



*Linja e Ndhmës* është programi më popullor dhe më i aritshëm për të mbijetuarit e dhunës. Kjo linjë ofron mundësinë e vetme anonime për mbështetje psikologjike dhe mirëkuptim. Ky shërbim është i përshtatshëm për gratë që jetojnë në një situatë dhune, por nuk janë gati për të ndërmarrë hapat për ta ndryshuar, për gratë që kanë dalluar shenjat e para të dhunës në familje dhe kanë nevojë për këshillim, si edhe gratë që janë viktima të dhunës dhe kanë nevojë për asistencë në marrjen e një vendimi. Linja ka një bazë të dhënash të strukturave të specializuara që gratë mund ti përdorin për të marrë ndihmën e nevojshem. Në një situatë krize, pas një ngjarjeje të kohëve të fundit të dhunës, këshilluesit e linjës zhvillojnë një plan sigurie dhe e referojnë gruan tek Njësia e Krizave ose në institucione të tjera përkatëse. *Shoqata Animus*, *Shoqata Demetra* dhe OJQ të tjera janë specializuar në kurse të ngritjes së kapaciteteve për shërbimet e mundshme të viktimave të trafikimit.

### C. Prokuroria

Sipas Raportit 2004 të Departamentit të Shtetit të SH.B.A.-së, qeveria gjatë atij viti, raportoi shtatë dënime dhe 27 padi për raste të dyshuara trafikimi sipas dispozitave të reja të trafikimit të Kodit Penal. Gjatë periudhës së raportimit, Shërbimi Kombëtar Hetimor ka zhvilluar një manual metodologjik për hetimin e ccështjeve të trafikimit, që i është shpërndarë edhe policisë. Më tej, qeveria raportoi rreth 900 vendime në 2004 për shkelje të lidhura me trafikimin, duke përfshirë prostitucionin e detyruar, nxitjen e prostitucionit dhe kontrabandën e njerëzve. Në vitin 2005 janë shpallur 34 vendime për trafikimin e njerëzve.<sup>11</sup> Nuk ka asnjë të dhënë për programe të veçanta të zhvilluara për lehtësimin e hetimeve.

Megjithëse zyrtarë të nivele të larta të qeverisë janë shprehur publikisht kundër trafikimit dhe nuk ka fakte për përfshirjen e qeverisë në trafikim, në nivele institucionale, oficerë të policisë<sup>12</sup> janë raportuar si të përfshirë në trafikimin nëpërmjet korrupsionit. Posaccërisht për këtë, në 2004, *Shërbimet e Prokurorisë* dhe *Shërbimet e Prokurorisë Ushtarake* bënë një numër padish anti-korrupsion në rreth 100 dënime për zyrtarë të inkrimuar. Në të njëjtin vit, Qeveria e Bullgarisë në mënyrë të lavdërueshme zgjeroi fushatat anti-korrupsion dhe ngriti fokusin e saj në korrupsionin e niveleve të larta.

---

<sup>11</sup> 2006 Trafficking in Persons Report of the US Government.

<sup>12</sup> Ibid.

Në Nëntor 2004, Qeveria e Bullgarisë miratoi *legjislacionin e mbrojtjes së dëshmitarëve* që përfshin edhe sigurimin e viktimave të trafikimit. Ky legjislacion do të ofrojë masa të veçanta mbrojtjeje për viktimat dhe familjet e tyre të cilat kanë bashkëpunuar me autoritetet mbi hetimin dhe akuzimin e trafikantëve. Qeveria ka raportuar disa raste në të cilat janë zbatuar masat e mbrojtjes. Ministria e Brendshme ka raportuar identifikimin dhe asistencën për 474 viktima të trafikimit gjatë 2004.

#### Komente

Qeveria duhet të tregojë në mënyrë aktive vullnetin për të luftuar të gjitha bashkëfajësitë e trafikimit nëpërmjet akuzave dhe dënimeve të forta.

Shenja të qarta të korrupsionit janë identifikuar. Disa oficerë policie ose të autoriteteve të tjera qeveritare, duke përfshirë autoritetet lokale dhe oficerët e doganave supozohet që lehtësojnë trafikimin njerëzor, megjithëse nuk ka fakte të bashkëpunimit të zyrtarëve. Shpesh zyrtarët pranojnë rryshfete për të injoruar trafikimin, megjithëse disa zyrtarë mund të jenë përfshirë më shumë. Ata që u përfshinë në lehtësimin e trafikimit ishin oficerë me nivel shumë të ulët, të keq paguar në zoant rurale dhe rajonet e kufirit.<sup>13</sup>

#### IV. PRAKTIKAT MË TË MIRA

Nismat e ndërmarra kryesisht nga dëshira e OJQ-ve, jo vetëm kanë realizuar aktivitete dhe fushata të suksesshme, por gjithashtu kanë vendosur një bashkëpunim të ngushtë midis autoriteteve locale dhe kombëtare në zbatimin e veprimeve dhe strategjive të përbashkëta. Ndërmjet aktiviteteve parandaluese dhe të ndërgjegjësimit publik më të suksesshme të zbatuara janë:

***Bashkëpunimi Publik- Privat në Parandalimin e Trafikimit dhe Shfrytëzimin Seksual të Minorëve në Industrinë e Turizmit dhe Udhëtimit.*** Projekti zbatohet si një përpjekje e përbashkët e Shoqatës *Animus*, Agjencia Shetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve, OJQ-ja Austriake Respekt, Instituti për Harmonizimin e Turizmit dhe Zhvillim, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE)/ Zyra për Aktivitete Ekonomike dhe Mjedisore (OCEEA). Qëllimi është njohja e një trajtimi të ri në luftën kundër trafikimit dhe

<sup>13</sup> Ibid. The representatives of the BGRF have serious doubts on the isolation of the low-level from the higher level corruption.

shfrytëzimit seksual të fëmijëve duke paraqitur **Kodin e Sjelljes** për Parandalimin e Trafikimit dhe Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve në Turizëm, industrisë së dhumëtimit dhe turizmit në Bullgari. Kodi Bullgar është pjesë e një përpjekjeje botërore. Është përpunuar bazuar në origjinalin e Kodit Nërcombëtar të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Udhëtime dhe Turizëm të **Ndalimit të Prostitucionit të Fëmijëve, Pornografisë të Fëmijëve dhe Trafikimit të Fëmijëve për Qëllime Seksuale**, që mbështetet nga UNICEF-i dhe Organizata Botërore e Turizmit. Në process morën pjesë përfaqësues të qeverisë, sektorit joqeveritar dhe sektorit privat. Ministria e Ccështjeve të Brendshme dhe disa Deputetë të Asambleesë së 40 Kombëtare publikisht kanë propozuar *legalizimin e prostitucionit*. Fondacioni Bullgar për Kërkim Gjinnor kundërshtoi këtë ide dhe mori nismën e një letre të hapur për Ministrin, e publikuar nga mediat. Në këtë letër, nënshkruar nga Platforma Bullgare e Lobit të Grave Europiane, paraqiten argumentat kundër legalizimit të prostitucionit. Në 2006, u organizuan nga OJQ-të një konferencë ndërkombëtare dhe takimë të ndryshme me deputetë dhe përfaqësues të institucioneve, me qëllim nxitjen e një debate public rreth pasojave të legalizimit të prostitucionit. Shumica e OJQ-vë bullgare të grave tërhoqën vëmendjen që legalizimi i prostitucionit është një dhuratë për tutorët, trafikantët dhe industrinë e seksit, sepse “bisnezi” i tyre i legalizuar do të shndërrohet në një biznes të mirëfilltë dhe do të legalizonte sipërmarrjet seksuale. Legalizimi i prostitucionit dhe industrisë seksuale do të përkrahte trafikimin seksual. Në këtë kontekst, OJQ-të bullgare të grave, ia dolën mbanë për herë të parë, të të nxisnin një *debat publik* mbi problemin e *prostitucionit*, mbi lidhjet midis prostitucionit dhe trafikimit, mbi pasojat e mundshme të rritjes së trafikimit si rezultat i legalizimit të prostitucionit, etj. Si pasojë, institucionet publike u parandaluan në marrjen e ndonjë vendimi mbi prostitucionin, ndërsa vëmendja e tyre u fokusua në nevojën për zbatimin efektiv dhe real të legjislacionit mbi trafikimin e njerëzve.

## V. MANGËSITË

*Mungesa e informacionit*, si një document zyrtar (të dhëna, prirje, kërkime dhe rezultate nga analizat) nuk janë në dispozicion të publikut. I vetmi burim publik është Raporti i Vendit mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin njerëzor të Departamentit të Shjhetit të SH.B.A.-së. Edhe IOM-i, Bullgaria nuk ofron statistika për publikun. Kjo situatë

mbështjellë në errësirë problemin e trafikimit dhe vështirëson punën e OJQ-ve.

*Mungesa e mbështetjes së qëndrueshme qeveritare OJQ-ve që punojnë kundër trafikimit të njerëzve.* Institucionet bullgare kanë filluar të punojnë drejt një bashkëpunimi të qëndrueshëm me OJQ-të. Duke pranuar faktin që, pa një mbështetje të qëndrueshme, nuk mund të arrihen rezultate të qëndrueshme, pa objektiva dhe marrëveshje afat gjata, puna e OJQ-ve do të jetë vetëm e copëzuar dhe pa një vision afat gjatë.

*Mungesa e një bashkëpunimi të ngushtë* midis institucioneve dhe organizatave qeveritare dhe joqeveritare dhe mungesa e koordinimit të institucioneve dhe vetë OJQ-ve.

*Mungesa e edukimit në shkollë* përsa i përket trafikimit të qënieve njerëzore.

Mungesa e *trainimeve* të veccanta për gazetarët. Mediat nuk përdoren në mënyrë efektive për luftën kundër trafikimit.

*Mungesa procedurave monitoruese* efektive në nivelin e parandalimit, hetimit dhe mbrojtjes.

*Mungesa e rrjeteve kombëtare* të medias, organizatave qeveritare dhe joqeveritare që punojnë kundër trafikimit njerëzor.

Mungesa e *ëeb siteve* dhe internetit për shkëmbimin e *ekspertizës profesionale, informacionit* dhe *këshillave* për viktimat.

*Mungesa e mundësive* për gratë e reja dhe vajzat në tregun e punës.

*Mungesa e strategjive* dhe programeve të *ri-integrimit*.

## VI. VLERËSIMI I NEVOJAVE

Duke marrë parasysh mangësitë dhe komentet e përfshira në këtë raport dhe nevojën për përmirësimin e situatës, një listë rekomandimesh paraqitet më poshtë.

### REKOMANDIME

*Zbatimi i legjislacionit*, veccanërisht ai i 2005, mund të vlerësohet si i dobët, pavarësisht nga pajtimi me standartet ndërkombëtare dhe mekanizamt qeveritarë për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Strukturat e reja të paraqitura ofrojnë mundësi të gjëra për OJQ-të që të marrin pjesë në parandalimin, procesin e luftës ndaj trafikimit dhe në mbështetje dhe rehabilitimin e viktimave. Si rrjedhim, OJQ-të mund të zhvillojnë një trajtim më të rëndësishëm të të drejtave të njeriut. Fatkeqësisht, deri më sot nuk është dhënë asnjë mbështetje e qëndrueshme.

*Sesione trainimi të veçantë dhe të përbashkëta duhet të organizohen për policinë, prokurorinë dhe OJQ-të, në mënyrë që të zbatohen veprime efektive të njëjta dhe të përkrahët bshkëpunimi i ngushtë. Është shumë e rëndësishme të realizohen trainime të specializuara mbi të drejtat e viktimave për oficerët e policisë. Një trajtim *Interdisciplinary and multi-stakeholder* duhet të zbatohet dhe OJQ-të duhet të luajnë një rol të njëjtë me institucionet qeveritare. Është e rëndësishme të *trainohen anëtarët e ushtrisë dhe misionet të paqes për trafikimin njerëzor.**

*Kërkime dhe analiza duhet të realizohen, duke synuar përgatitjen e strategjive efektive parandalimi kundër trafikimit, si edhe analizimin e mekanizmave për trafikim dhe shfrytëzim seksual të përdoryra nga grupet e krimit të organizuar.*

*Analiza të veçantë duhet të kryen duke u fokusuar në aspektet e kërkesës dhe supply.*

*Shkëmbimi i informacionit dhe praktikat më të mira midis OJQ-ve, punonjësve social dhe organizatave të tjera që punojnë me viktimat në vendet e origjinës, destinacionit dhe tranzitit duhet të zhvillohen.*

*Roli qëndror i OJQ-ve duhet të vlerësohet dhe mbështetet financiarisht, dhe përveç kësaj të ndihmohen në përpjekjet e tyre në ngritjen e ndërgjegjësimit. Gjithashtu, OJQ-të duhet Moreover, NGO should be further mandated to undertake other activities related to trafficking.*

*Duhet të sigurohet një mbështetje e sigurtë ekonomike për të gjitha organizatat që punojnë në fushën e trafikimit.*

*Në fushën e parandalimit, duhet të përgatitet një strategji kombëtare e kuptueshme me theksin në të drejtat social ekonomike, edukimin, punësimin, shëndëtin, tregun e punës dhe mundësitë ekonomike, uljen e varfërisë, etj.*

*Fushatat e ndërgjegjësimit public duhet të jenë një aktivitet kombëtar i vazhdueshëm, jo aktivitete të organizuara herë pas here në disa zona. Viktimat e trafikimit duhet të pranohen si viktimat të krimeve serioze dhe të fitojnë të drejtën e një sërë shërbimesh, si, strehëza, ndihmë mjekësore dhe mbështetje ligjore. Nevojat e veçantë të fëmijëve dhe grave duhet të adresohen.*

*Ka nevojë për funksionimin e më shumë linjave të ndihmës dhe përdorimi i tyre si një burim i pavarur informacioni dhe këshillimi për viktimat e trafikimit.*

## LIST OF ABBREVIATIONS

ACTA	Balkan Initiative Against Trafficking and Corruption
ARIADNE	NGO Network against human trafficking in SE and E. Europe
BHRN	Balkan Human Rights Network
BGRF	Bulgarian Research Development Foundation
Care Bulgaria	International NGO
CATĒ	Coalition Against Trafficking in Ēomen
ECPAT	End Child Prostitution, Child Pornography and International Trafficking of children for Sexual Purposes
EĒL	European Ēomen's Lobby
FYROM	former Yugoslav Republic of Macedonia
IOM	International Organization for Migration
MBMD	polling agency
MP	Member of the Parliament
OCEEA	OSCE's Office of Economic and Environmental Activities
ODIHR	OSCE's Office for Democratic Institutions and Human Rights
OSCE	Organization for the Security and Cooperation in Europe
PC	Penal Code
PPC	Penal Procedure Code
SACP	State Agency for Child Protection
SG	State Gazette
UNICEF	United Nations Children's Fund
USAID	United States Agency for International Development

## KROACIA

### I. Hyrje

Republika e Kroacisë kufizohet nga Sllovenia në veriperëndim, nga Hungaria në verilindje, nga Serbia, Bosnja dhe Hercegovina në very dhe jug, Mali i Zi në lindje dhe deti Adriatik në perëndim. Kroacia është një udhëkryq i lëvizjeve të migracionit midis Lindjes dhe Perëndimit. Përveç pozicionit gjeografik që e shndërron të përshtatshëm për migrim, Kroacia, si vende të tjera të Europës Jug Lindore është duke kaluar një tranzicion social, politik dhe ekonomik, duke marrë parasysh që lufta përkrahu paqëndryshmërinë politike dhe mungesën e infrastrukturës sociale, ligjore dhe teknike. Të lartpërmendurat lehtësuan krijimin e të ashtuquajturit “korridor

Ballkanik”, i përdorur nga emigrantët e parregullt dhe trafikantët, duke krijuar një “mjedis të favorshëm” për trafikimin e qënieve njerëzore. Deri në mesin e viteve ’90, rruga kryesore e migrimit ishte nëpërmjet Hungarisë. Në fund të viteve ’90 përdorëshin rrugë të reja, drejt Kroacisë nga Bosnja dhe Hercegovina dhe nëpërmjet Kroacisë drejt Sllovenisë, ose nga deti nga bregdeti kroat drejt Italisë. Rrugë të tjera të zakonshme janë nga Mali i Zi drejt rajonit të Dubrovnikut dhe nga Serbia drejt Kroacisë/Sllovenisë.



Gjatë gjysmës së parë të viteve ’90-të, personeli ushtarak ndërkombëtar dhe vendas, si edhe elita politike vendase dhe ekonomike, “përfituan” nga trafikimi. Në gjysmën e dytë të viteve ’90-të trafikimi u përhap gjeografikisht në territorin kroat me biznese që u ngritën në qytetet turistike dhe reth bazave ushtarake. Në fund të viteve ’90-të, ndodhën ndryshime të rëndësishme përsa i përket aspekteve si organizative dhe operative të trafikimit në Kroaci.

Përsa i përket modelit të trafikimit, Kroacia është kryesisht një vend tranziti për trafikimin e qënieve njerëzore, por në ditët e sotme<sup>14</sup> shtohen faktet që tregojnë për një vend që po kthehet në një vend destinacioni. Nga 41 viktimat të identifikuara në Kroaci nga Korriku 2002 deri në fund të 2005, 29 ishin nënshjetas të huaj dhe 12 ishin nënshjetas Kroat, duke siguruar shumë qartë që Kroacia është gjithashtu edhe një vend burimi për trafikimin. Gjithashtu, Kroacia është një vend që përjeton një rritje të trafikimit të qënieve njerëzore Brenda kufinjve të saj (trafikim i brendshëm).

Për shkak të natyrës së fshehtë dhe të rrezikshme të trafikimit, është e vështirë të përcaktohet numri i saktë i personave të trafikuar sidomos i grave dhe të miturve të trafikuar për qëllimin e shfrytëzimit seksual. Gjithashtu është e vështirë që ndjekësh zhvillimin e modeleve të trafikimit.

<sup>1414</sup> Yearly Report on Counter Trafficking in Croatia, based on official statistics.

## Komente

Elementët kycc dhe faktet historike të mbledhura nga IOM Zagreb lejojnë vërejtjet e mëposhtme:

skemat e trafikimit përfshijnë trafikimin “alternues” përmes të të cilit gratë trafikohen Brenda dhe jashtë Bosnje Hercegovinës dhe Kroacisë, sigurisht si një dredhi për ti’iu shmangur zbulimit policor, por edhe si një skemë “rezervë” e krijuar për të plotësuar “kërkesat” e herëpashershme;

trafikimi po zhvillohet në një veprimtari sezonale që vepron përkrah linjave të turizmit seksual ndërkombëtar;

gratë e trafikuar janë më tepër duke u shfrytëzuar seksualisht në apartamente nën kujdesin e “tutorëve” dhe të ashtuquajturve “të dashur”.

ka një numër në rritje të grave të reja që vijnë në Kroaci me viza turistike nëpërmjet agjensive që ofrojnë “ndihmën” për ti martuar në Kroaci;

duke u përballur me mungesën e kërcimtareve vendase, pronarët e klubeve po i sjellin ato kryesisht nga vendet e Europës Lindore;

numri i lejeve të punës për punëtorët e huaj që vijnë të punojnë dhe të jetojnë është rritur shumë gjatë viteve të fundit;

numri i të miturve të pashoqëruar viktimë ose viktimë të mundshme të trafikimit është duke u rritur.

## II. KUADRI LIGJOR KOMBËTAR

### A. Ligji Kombëtar

Republika e Kroacisë ka ratifikuar UN Convention against Transnational Organized Crime and the UN Protocol to Prevent, Suppress and Punish Trafficking in Persons. Pas ratifikimit, institucionet kombëtare kanë filluar të harmonizojnë kuadrin ligjor kombëtar me Komventën e Kombeve të Bashkuara dhe Protokollin e lartpërmendur. Megjithsë harmonizimi është akoma në process, amendamentet e Kodit Penal në Korrik 2004 kanë shënuar një përpërim domethënës kundrejt një kuadri ligjor për mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit (VT)dhe në dënimin e trafikantëve dhe bashkëorganizuesve të krimit. Më saktë, Ministri I brendshëm ka nxjerrë “*Udhëzimin mbi procedurat e rregullimit të rezidencës së viktimave të trafikimit*”, duke përmirësuar në këtë mënyrë mbrojtjen VT duke rregulluar statusin e tyre. Mirëpo, duke qenë se VT nuk



përmenden si përfitues në asnjë ligj ( Dekret për të Huajt, Ligji mbi Shëndetin dhe Ndhimën Sociale), kuadri ligjor i përshtatshëm dhe dispozitat e veçanta duhet të përfshihen në legjislacionin kombëtar në mënyrë që të përmirësohet mbrojtja dhe asistenca e viktimave. Përveç Udhëzimit të lartpërmendur, ligji e mëposhtme sigurojnë një kuadër legjislativ të përshtatshëm për mbrojtjen VT; Akti i Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Akti i Procedurave Penale; Akti i Azilit; Akti i Përgjegjësisë Ligjore Penale të Personit; Ligji mbi Gjykatat e të Miturve.

Republika e Kroacisë ka nënshkruar dhe ratifikuar gjithashtu Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve.

## Republika e Maqedonisë

### Autorët

- Shoqata për Mbështetje dhe Mbrojtje të Familjeve dhe fëmijëve në rrezik “Për një fëmijëri të lumtur”
- Komiteti i Helsinkit për Të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë

## Republika e Maqedonisë

### I. Hyrje

Republika e Maqedonisë është një vënd i rrethuar nga vënde të tjera dhe i pozicionuar në zemër të gadishullit të Ballkanit. Vëndi ka kaluar një periudhë të gjatë në tranzicion, e karakterizuar nga varferimi i një mase të gjerë të popullsisë. Jostabiliteti rajonal, për shkak të lufrave të kohëve të fundit në Ballkan, dhe tranzicioni që minoi klimën investuese, kontribuan në rritjen e pasigurisë sociale. Regjimi strikt i vendosur për vizat, që rezultoi në kufizimin e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, shtoi një element tjetër negativ në kushtet e përgjithshme jo favorizuese për vëndin. Korrupsioni ishte një problem tjetër serioz, i cili pengon përpjekjet në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

Republika e Maqedonisë është konsideruar kohët e fundit si një pikë kyçe për trafikimin e drogës, armëve dhe qënieve njerëzore për Ballkanin. Gjatë katër viteve të fundit, trafikimi i qënieve njerëzore ishte një nga aktivitetet kryesore kriminale në vënd. Perceptimi i Republikës së Maqedonisë, si një vënd tranzit dhe pritës për trafikimin ndërkombëtar të femrave po ndryshon gradualisht. Ditët e sotme, Maqedonia konsiderohet si një vënd burim, tranzit dhe më pak pritës për gratë dhe fëmijët e trafikuar për shfrytëzim seksual. Në vijim, ‘trafikim i brendshëm’ njihet si pjesë e problemit, megjithëse qeveria i mohon lidhje të tilla.

Nivelet e larta të varfërisë dhe papunësisë janë arsye kryesore pse të rinjtë luftojnë për shanse jashtë atdheut të tyre. Arsimimi i pakët dhe mungesa e informacionit u krijon rrisht të lartë për të qënë viktima të trafikimit. Sipas të dhënave të mbledhura nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), 756 viktima të trafikimit janë identifikuar, ndihmuar dhe riatdhesuar në vëndet e tyre të origjinës gjatë katër viteve të fundit (12% e të cilëve ishin fëmijë).

Sipas të njëjtave statistika, shumica e viktimave (një përqindje e lartë që nuk pritej prej 90% ), nuk ishin në dijeni të faktit që do të përdreshin për shërbime seksuale dhe do të ishin subjekt i abuzimit seksual dhe formave të tjera.

Sipas një vëzhgimi të Ministrisë së Brendshme, shumica e viktimave kishin hyrë ilegalisht në vënd ose ishin tranferuar aty nëpërmjet rrjeteve të ngritura nga lëvizja ilegale e emigrantëve. Sipas burimeve të Ministrisë së Brendshme, viktimat e trafikimit vinin kryesisht nga dy qendra rekrutimi: Kisinau (Moldovë) dhe Odesa (Ukrainë). Nga aty, ata transferohen në një qendër ‘kolektive’ në Termisuara. Destinacioni i tyre është zakonisht Greqia, Turqia, Lindja e Mesme, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, dhe pjesa përëndimore e Maqedonisë.

Republika e Maqedonisë është gradualisht duke ngritur një politikë komprehsive dhe një rrjet të institucioneve për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Megjithatë, përpjekje serioze janë fokusuar kryesisht në problemin e trafikimit të femrave për qëllime shfrytëzimi seksual. Raportet e fundit, nga UNICEF, OSCE, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara,

dhe organizata ndërkombëtare dhe OJF, theksojnë që trafikimi brenda dhe nga Maqedonia është një problem i dukshëm dhe që nuk duhet të neglizhohet nga Qeveria.

## II. Kuadri ligjor Kombëtar

### A. Ligji Kombëtar

Migrimi ilegal është i rregulluar nga legjislacioni kombëtar nëpërmjet Ligjit të Shkeljes së Kufirit Shtetëror dhe Lëvizjes pranë Kufirit Shtetëror, si dhe nga Ligji mbi Lëvizjen dhe Qëndrimin e të Huajve.

Trafikimi i qënieve njerëzore si një akt kriminal i veçuar u dëmtua me adoptimin e Ligjit për ndryshime dhe amendamente të Kodit Kriminal të Republikës së Maqedonisë. Qëllimi i krimit të trafikimit të qënieve njerëzore (Neni 418-a) u ripërcaktua në 2004, duke përfshirë rekrutimin, transportimin, transferimin, pritjen ose akomodimin e fëmijëve për qëllime shfrytëzimi, si brenda ashtu edhe jashtë një vëndi. Qëllimi i shfrytëzimit përfshim prostitucionin ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime me forcë, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë ose heqja e organeve. Rishikimi i ligjit ka paraqitur dënim më të fortë për autorët e krimit, si dhe konfiskimin e mjeteve të përdorura për kryerjen e krimit.

Ky Ligj paraqet dy nene të reja: smuggling i emigrantëve (Neni 418-b) dhe organizimi i grupit ose inkurajimi i angazhimit të sulmit ndaj trafikimit të njeriut dhe smuggling të emigrantëve (Neni 418-c). Një ligj i ri për mbrojtjen e dëshimtarit u adaptua gjithashtu në vitin 2005. prostitucionin nuk është akt kriminal, por është shkelje administrative. Ndërhyrja në ushtrimin e prostitucionit (neni 191) siguron sanksione kundër personit që rekruton, merr përsipër, stimulon ose josh një tjetër për prostitucion, ose ndaj personit, që në një farë mënyre, merr pesë në transformimin e nje personi në një tjetër për qëllime prostitucioni.

### B. Marrëveshjet bilaterale

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me dëshirën për të kontribuar në zhvillimin e marrëveshjeve bilaterale, ka nënshkruar

dhe ratifikuar Marrëveshje Bashkëpunimi në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit ilegal të drogave narkotike, substancave psikotrofike, migrimit ilegal dhe akteve të tjera kriminale me: Shqipërinë, Bullgarinë, Serbinë dhe Malin e Zi, Rumaninë, Slloveninë, Francën, Ukrainën, Konfederatën Zvicerane, dhe Mbretërinë e Norvegjisë.

Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është rritja e bashkëpunimin në parandalimin dhe gjykimin e krimit të organizuar. Këto marrëveshje vendosin komunikim të drejtpërdrejtë midis Ministrive të Brendshme/policive të palëve kontraktuale.

Në bazë të marrëveshjeve të mësipërme, u nënshkruan dhe dokumentat e mëposhtme: Protokolli mbi direktivat përcaktuese dhe metodat e bashkëveprimit në fushën e kontrollit të kalimit të kufirit dhe parandalimin e migrimit ilegal midis Ministrisë së Brendshme të Republikës së Maqedonisë dhe ministrive respektive të Republikës së Bullgarisë, Shqipërisë dhe Greqisë. Bashkëpunimi ndërkuftar me vendet fqinje bazohet në marrëveshjet e përfunduara bilaterale/ndërkombëare që rregullojnë fusha specifike të bashkëpunimit. Për më tepër, njësi të përbashkëta janë ngritur për bashkëpunimin në fusha specifike të interesit.

Bashkëpunimi me vendet fqinje është mbajtur gjithashtu nëpërmjet mbledhjeve të ndryshme, të rregullta, si dhe ad hoc, ku diskutimet zënë vend dhe zgjidhje propozohen për lloje të ndryshme të problemeve, që mund të shfaqeshin gjatë bashkëpunimit ndërkuftar, në veçanti bashkëpunimi me vendet fqinje mund të klasifikohen si vijon:

A Marrëveshja e Stabilizim Asocimit është firmosur nga Republika e Maqedonisë dhe Bashkimit European. Në mbledhjen e parë të këshillit të stabilizim asocimit, çështja u ngrit rreth nënshkrimit të një Marrëveshjeje bilaterale readmission me KE. Duhet të nënvizohet gjithashtu që Republika e Maqedonisë ka nënshkruar marrëveshje readmission me këto vende: Republika e Shqipërisë, Republika e Bullgarisë, republika Italiane, konfederata zvicerane, Republika e Sllovenisë, Republik Franceze, Republika e Kroacisë, Rumania, Republika federale e Gjermanisë dhe Hungaria.

C. Plani kombëtar i veprimit

Programi kombëtar për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, dhe migrimit ilegal është dokumenti bazë i politikës antitrafikant i kohëve të sotme. Ai shpreh përputhshmërinë e Maqedonisë me parimet e Protokollit të Palermos, dhe qëllimi i tij është zhvillor dhe të implementojë një fushatë kombëtare.

Programi kombëtar, i adaptuar në 2002, është i përbërë nga 6 pjesë: aktivitetet ligjore, veprimet parandaluese, asistencë dhe mbështetje për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, riatdhesim dhe ri-integrim të viktimave, trajnim të stafit dhe koordinim të aktiviteteve nga Bashkimi për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore (nën Departamentin e politikës kriminale të Ministrisë së Punëve të Brendshme), si dhe Komisioni kombëtar dhe sekretariati për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimin ilegal në Republikën e Maqedonisë. Në këtë kontekst, Strategjia për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit ilegal, si dhe Plani kombëtar i veprimit, u adaptuan nga Qeveria më 21.03.2006.

### Koment

Si strategjia ashtu dhe plani kombëtar i veprimit, nuk morën parasysh dy kundërshtime kryesore:

Politika aktuale antitrafikimit nuk është i bazuar as në ndjeshmërinë gjinore as në të drejtat e njeriut. Për shëmbull, modeli i bazuar në të drejtat e njeriut, vetëm sa është përmendur në kontekstin e “ngritjes së kapaciteteve” dhe nuk ka asnjë gjë të referuar te plan veprimi, ku ky objektivi strategjik është përpunuar më tej.

Të drejtat njerëzore të grave nuk ka explicitly të referuar në strategji dhe një plan veprim. Megjithatë një OJF lokale në raportin e tij në raportin e tij hije mbi implementimin e CEDAË tregoi çështje të ndryshme në lidhje me dhunimin e të drejtave të njeriut të viktimave të trafikuar.

III.

### III. Kuadri i përgjithshëm

#### A. Ngritja e kapaciteteve

Lista e mëposhtme përcakton projektet e ngritjes së kapaciteteve që janë implementuar nga agjentë kyç të ndryshëm:

Ministria e Brendshme:

- Projekti për strategjinë e politikës bazuar në komunitet dhe implementimin, Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar UK, implementuar nga Atos Consulting, Britania e Madhe;
- Reforma për policinë (faza II dhe III), Asistencë për Komunitetin për Ristrukturim, Zhvillim dhe Qëndrueshmëri (CARDS) 2001 dhe 2004, Agjensia Europiane për Ristrukturim (EAR);
- Fuqizimi i kapaciteteve implementuese të Ministrisë së Brendshme, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR);
- Mbështetje për Akademinë e Policisë (faza II), CARDS 2003, EAR.

#### Policia Kufitare:

- Makina për policinë kufitare, CARDS 2003 (kombëtare), Agjensia e Implementimit, EAR;
- Ndërtimi i faciliteteve për Qendrën e Koordinimit dhe Manaxhimit të Kufirit Kombëtar dhe Policisë Kufitare, CARDS 2004 (kombëtare) EAR;
- Sigurimi i pajisjeve për nevojat e Policisë Kufitare “TETRA”, CARDS 2004 (kombëtare), EAR;
- Sigurimi i kufirit dhe kontrolli EXBS – eksport, Ambasada Amerikane në Shkup;
- Mbështetje dhe koordinim për strategjitë e manaxhimit të integruar të kufijve për Vëndet e Ballkanit Perëndimor, CARDS 2002 (rajonale), Ministria e Brendshme (MOI);
- Programi i kooperimit kufitar në Europën Juglindore, (SEE) (OSCCP), implementimi dhe financimi nga OSCE, Vienë;
- Plani i veprimit për manaxhimin e integruar të kufijve, CARDS 2002, EAR;
- Zhvillimi i sistemeve të procesimit të të dhënave IBM, CARDS 2003 (kombëtare), EAR;
- Strategjia dhe Plani i veprimit për manaxhimin e integruar të kufijve (Faza II), CARDS 2002, EAR;
- Pikat e kalimit të kufijve: Rrjeti i komunikimit (faza I), CARDS 2001, EAR.

#### Policia Kriminale:

- Zhvillimi i sistemeve të besueshme dhe funksionale të policisë, rritja e luftës kundër aktiviteteve kryesore kriminale dhe bashkëpunimi i policisë (CARPO), CARDS 2002 (rajonale);
- Mbështetje për zhvillimin e manaxhimit të regjistrimit të policisë dhe kapaciteteve analitike, CARDS 2004, EAR

#### Interpol:

- Modernizimi i Byrosë qendrore kombëtare të interpolit në 5 vëndet e CARDS të rajonit të Ballkanit, CARDS 2001 (rajonale), IOM;
- Çështjet e emigrimit dhe të huaja;
- Asistencë teknike për zhvillimin dhe implementimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Migrimin dhe Azilin, CARDS 2002, EAR;
- Zhvillimi i mëtejshëm i strategjive të emigrimit dhe azilit, legjislacionit dhe planit të veprimit, CARDS 2003, EAR;
- Vendosja e një kuadri institucional, rregullator, ligjor, dhe në përputhje me BE, në fushat e azilit, migrimit dhe çështjeve të vizave, CARDS 2002 (rajonale).

#### Komisioni Kombëtar për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe migrimit ilegal:

- Zgjerimi i Strategjive të implementimit për plan veprimet kombëtare anti-trafikim në Vëndet e Europës Juglindore, programi rajonal CARDS: mbështetje për shoqërinë civile për të ndihmuar në uljen e krimit të kalimit të kufirit, duke përfshirë veprimet rajonale për të ndihmuar në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe inisiativave anti-korrupsion;
- Kundër – trafikimi: parandalimi dhe aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve në Kosovë dhe në Republikën e Maqedonisë, Finlandë, IOM;
- Fuqizimi i ligjit për përforcimin e kapaciteteve kundër trafikimit në vëndet e Europës Juglindore, Hollandë dhe Zvicër, Qendra

Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit / Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (ICMPD/UNDP) Rumani;

- Lufta kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe migrimit ilegal – forcimi i kapaciteteve, IOM;
- Rritja e Strategjive të Implementimit të Planeve të Veprimit Kombëtare kundër trafikimit në vëndet e Europës Juglindore, në bashkëpunim me Rritjen e strategjive të Implementimit për Planet e Veprimit Kombëtare kundër trafikimit në Bullgari, Moldovë dhe Rumani, në kuadrin e programit rajonal CARDS. Mbështetje për shoqërinë civile për të ndihmuar në ulen e krimit të kalimit të kufirit, duke përfshirë veprimet rajonale për të ndihmuar në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe insiativave anti – korrupsion, CARDS (rajonale), ECMPD;
- “Rezidencë 2005”, OSCE/USAID, Open Gate/La Strada, Maqedoni.

Reformat e sistemit gjyqsor:

- “Trafikimi i qënieve njerëzore”: dy mbledhje konsultore me një numër total prej 144 pjesëmarrësish, nga të cilët 75 gjyqtarë, dhe 35 pjesëmarrës nga prokuroria;
- Trafikimi i qënieve njerëzore: implementimi i manualit rajonal për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, tre seminare, me një asistencë financiare nga OSCE – ODIHR dhe Trajnim për asistencë në zhvillimin e prokurorisë ndërkombëtare (OPDAT), me një numër total pjesëmarrësish prej 89, nga të cilët 44 gjyqtarë, 2 bashkëpunëtorë profesionalë dhe 28 prokurorë.
- Zhvillimi dhe trajnimi i prokurorëve (OPDAT) – me pjesëmarrjen e 8 gjyqtarëve (organizata për këshillim mbi trafikimin e qënieve njerëzore, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Shkup – Programi i Ministrisë së Drejtësisë US për asistencë, zhvillim, dhe trajnim për prokurorinë).
- Manuali për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore për të gjithë prokurorët publikë që nuk kanë patur mundësinë të marrin pjesë në një prej 5 seminareve që u zhvilluan për këtë temë.

B. Mekanizmat e analizës, kërkimit dhe monitorimit



Kërkimi sistematik qeveritar mbi aspektet e ndryshme të trafikimit të qënieve njerëzore në shoqëri nuk ka filluar ende. Megjithatë, ekzistojnë disa projekte jo qeveritare për kërkimin.

Megjithëse kërkimi dhe analiza nuk janë përmënduar si tituj të veçuar në Strategji, në kapitullin mbi Edukimin, ekziston një objektiv i qartë i vendosur si një prej prioriteteve kryesore. Bën fjalë rreth inisiativës dhe realizimit të projekteve të kërkimit në lidhje me studimin e trafikimit të qënieve njerëzore dhe fenomeneve të lidhura me të, në veçanti studimi i shkaqeve (faktorëve) të këtij fenomeni social veçanërisht kompleks, ose tipi të krimit.

Në pjesën e dytë të Planit të Veprimit, nën titullin Parandalimi, një objektiv më vehte, është përcaktuar në lidhje me identifikimin e shkaqeve dhe pasojave të trafikimit të qënieve njerëzore dhe studimit të fenomenit në përgjithësi dhe në veçanti në Republikën e Maqedonisë. Ky qëllim është supozuar të jetë arritur duke rritur aktivitetet kërkuese në aspektet e trafikimit të qënieve njerëzore nëpërmjet analizës së kushteve, të dhënave dhe raporteve dhe nëpërmjet vendosjes së bashkëpunimit me qendrat kërkimore në rajon. Sipas Planit të Veprimit, Komisioni Kombëtar duhet të përgarisë një Raport Publik në 2006, dhe duhet të emërojë një Raportues Kombëtar.

### C. Bashkëpunimi dhe rrjeti në nivelet rajonale dhe kombëtare

Bashkëpunimi bilateral dhe multilateral i Republikës së Maqedonisë u zhvillua me qëllim luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe ka qënë zakonisht i drejtuar nga Ministria e Brendshme. Bashkëpunimi është zhvilluar veçanërisht me vendet fqinje dhe vende të tjera të rajonit, dhe është rritur nëpërmjet ratifikimit të disa marrëveshjeve ndërkombëtare kundër krimit të organizuar.

Një numër OJF vendase, për programet e zhvillimit dhe të implementimit në fushën e trafikimit janë përfshirë në rrjetin Asocimi civil i OJF-ve në luftën kundër trafikimit “kufitar” të qënieve njerëzore. Ky rrjet është formuar një vit e gjysëm më parë dhe është i përbërë prej 12 OJF-ve nga qytete të ndryshme të Republikës së Maqedonisë. Këto OJF kanë eksperiencë në projektet e lidhura me parandalimin e trafikimit njerëzor. Ato kanë vendosur gjithashtu

bashkëpunim me qendrat lokale të punës sociale, stacionet policore dhe zyrat lokale të punës. Asocimi kufitar bashkëpunon me të tjerë rrjete në vënd, të tilla si: Open Gate – La Strada, dhe Inisiativa qytetare – Antico. Anëtarët OJF të rrjeteve janë gjithashtu anëtarë të Sekretariatit, brenda Komisionit Kombëtar për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

#### D. Mobilizimi i Burimeve

Gjatë viteve të fundit, fondet janë alokuar për projektet lidhur me trafikimin e qënieve njerëzore, të mbështetura nga organizata ndërqeveritare, qeveritare, ndërkombëtare dhe vëndase, ndërkohë që katër ministri (e Drejtësisë, e Brendshme, e Punës, Politikës Sociale dhe Edukimit) janë duke punuar nga ana strategjike për problemin e trafikimit. Është gjithashtu një lëvizje e konsiderueshme e shoqërisë civile në përpjekje për të parandaluar, luftuar këtë fenomen.

Kontribute të rëndësishme janë bërë gjithashtu nga disa organizata ndërkombëtare dhe / ose ndërqeveritare (UNICEF, Inisiativa Bashkëpunimit Juglindor (SECI), INTERPOL, OSCE, USAID, ICMPD, Kvinna till Kvinna, Agjensia e bashkëpunimit dhe zhvillimit ndërkombëtar Suedez (SIDA), IOM, si dhe nga disa qeveri, nëpërmjet ambasadave të tyre lokale (veçanërisht Ambasadat e Norvegjisë, SHBA, dhe Suedisë).

### IV. Implementimi i ligjeve Anti - trafikimit

#### A. Parandalimi dhe rritja e ndërgjegjësimit

Disa projekte për parandalimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit janë implementuar, kryesisht nga agjentë jo-qeveritarë. Për shëmbull, IOM në bashkëpunim me OJF të ndryshme, ka realizuar katër fushata ndërgjegjësimi dhe ka mbështetur trembëdhjetë fushata të OJF-ve, në periudhën 2001 – 2004. Një numër i konsiderueshëm i fushatave të ndërgjegjësimit publik të realizuara nga OJF-të janë mbështetur nga OSCE.

Spektori i marrëdhënive me publikun të Ambasadës Amerikane ka mbështetur një fushatë të madhe parandaluese të OJF, e cila përfshiu gjithashtu aktivitete të ndryshme si, shpërndarja e fletëpalosjeve dhe broshurave parandaluese dhe sigurimi i mbështetjes ligjore dhe asistencë për viktimat e trafikimit. Pjesë të këtyre aktiviteteve janë mbështetur dhe nga

ambasada të tjera. Aktivitetet më të mëdha parandaluese janë implementuar nga Shoqata “Për një fëmijëri të lumtur” dhe nga Open Gate – La Strada, Maqedoni, në bashkëpunim me partnerë të tjerë OJF.

Gjatë vitit 2005, qeveria ka drejtuar ose mbështetur programe trajnimi të specializuara për gjyqtarët, prokurorët, policët, dhe punonjësit socialë, shumë prej të cilëve janë të fokusuar në parandalimin e trafikimit dhe identifikimin e viktimave aktualë ose potencialë.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka organizuar një seri sesionesh për trajnimin e punonjësve socialë nga të gjitha 27 qendrat sociale të vëndit. Gjithashtu është krijuar një mekanizëm kombëtar për viktimat e trafikimit njerëzor, si një mjet për identifikimin e viktimave potencialë, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit në institucionet qeveritare dhe publikë rreth problemit në fjalë.

## Koment

Megjithëse Programi Kombëtar thekson një numër aktivitësh parandaluese, pjesa më e madhe e projekteve të parandalimit dhe ndërgjegjësimit janë implementuar nga OJF-të, ndërsa qeveria vetëm ka siguruar vetëm mbështetje jo financiare.

## B. Mbrojtja dhe Asistenca

Republika e Maqedonisë, duke respektuar dhe implementuar principet bazë ndërkombëtare për mbrojtjen e viktimave, u ka siguruar mbrojtje të përshtatshme në Qendrën Tranzitore për viktimat e huaja të trafikimit, si dhe një Strehë për viktimat (qytetarë maqedonas) të trafikuar jashtë ose brenda vëndit. Viktimat janë nën mbrojtje nga momenti që janë identifikuar si të tillë dhe janë çliruar prej trafikuesve. Mbrojtja e viktimave zgjat deri në riatdhesimin e tyre në vëndin e origjinës, në rast se janë qytetarë të huaj. E drejta për mbrojtje ekziston për të gjitha viktimat e dhunës, pavarësisht vendimit të tyre për të bashkëpunuar me autoritetet e ndjekjes së krimit dhe vendimit të tyre për të dëshmuar ose raportuar për krimin.

Qendra Tranzitore për viktimat e huaja është e drejtuar nga tre organizata: Ministria e Punëve të Brendshme, IOM dhe Shoqata “Për një Fëmijëri të lumtur”. Secila prej këtyre organizatave ka një funksion të caktuar në

kujdesin, mbrojtjen dhe asistencën ndaj viktimave. Këto institucione sigurojnë akomodim, mjekime, asistencë ligjore dhe psikosociale, edukim, këshillim, punësim dhe psikoterapi për viktimat. Këto principe janë aplikuar që në 2000-shin kur trafikimi u identifikua si një problem serioz, dhe kur Republika e Maqedonisë u bë e njohur si vënd tranzit dhe destinacion për një numër jashtëzakonisht të lartë të qytetarëve të huaj të trafikuar.

IOM ka drejtuar intervista për identifikimin e viktimave, duke siguruar mbështetje mjekësore dhe ligjore dhe ka organizuar riatdhesimin e tyre në vëndet e origjinës. Shoqata “Për një fëmijëri të lumtur” përgjegjëse për manaxhimin e përditshëm, organizon dhe siguron asistencë psikosociale, aktivitete sociale, edukim, këshillim dhe terapi për viktimat. Programi implementohet nëpërmjet grupeve të punës individuale nga skuadra profesionale të përbërë nga psikologë dhe punonjës socialë. Objektivi është të arrihet stabilizimi psikologjik i viktimave, ulja e reagimeve post traumatike, ndihmesas drejt rehabilitimit të tyre dhe fillimi i ri-shoqërizimit si dhe zhvillimi i një projekti personal për të ardhmen e tyre duke i përgatitur për t’u ri-integruar në vëndin e origjinës. Një program i posaçëm për rehabilitimin dhe ri-integrimin është për një grup më të vogël viktimash të trafikimit të qënieve njerëzore.

Në një periudhë katër vjeçare, 765 viktima të trafikimit njerëzor u asistuan në Qendrën Tranzitore. Asistencë psikosociale, këshillim, edukim dhe terapi u siguruan për 322 gra dhe fëmijë (12% e numrit të përgjithshëm ishin fëmijë nën moshën 18 vjeç). Trajnim profesional u ofrua për rreth 80% e grave dhe vajzave (në varësi të kohëzgjatjes së qëndrimit). Të gjitha gratë morën edukim shëndetsor për mbrojtjen nga sëmundjet seksualisht të trasmetuara dhe për varësinë ndaj drogave.

Të gjitha gratë e mbrojtura janë riatdhesuar dhe transferuar në vëndet e tyre të origjinës. Riatdhesimi i viktimave është organizuar nga Agjensia e Informacionit Maqedonas (MIA) dhe IOM. Para atdhesimit, shërbimet për luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të qënieve njerëzore drejtuan një vlerësim të rrisqeve të lidhura me kushtet e viktimës dhe familjen/ambientin social të viktimës. Për këtë qëllim, ata bashkëpunojnë me Ministrinë respektive në vëndin e origjinës së viktimës.

Në qershor 2005, pas rasteve të para të raportuara të qytetarëve maqedonas si viktima të trafikimit njerëzor, një Qëndër Strehëz u hap për viktimat vëndase

nga OJF “Open Gate”. Strehëza për viktimat i trafikimit njerëzor të brendshëm u themelua një vit më parë dhe siguron pritjen, sigurinë private dhe ushqim për viktimat, ndërsa është gjithashtu përgjegjëse për manaxhimin ditor të qëndrës. Deri tani, 13 viktima të trafikimit njerëzor janë asistuar nga kjo qëndër, dhe tre viktima janë duke u asistuar.

## Koment

Republika e Maqedonisë nuk ka adaptuar ende ndonjë ligj as për qëndrimin e përkohshëm të viktimave të trafikimit në vënd, as për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të viktimave.

## C. Ndjekja

Deri në 2003, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme, ndaluan së publikuari të dhëna për rastet e regjistruara. Nga zyra e Prokurorisë publike, nuk ka të dhëna të mundshme për ndjekjen e përgjegjësve në 2005. Sipas raportit 2006 të Departamentit të Shtetit US, “... qeveria dhe OJF-të kanë raportuar rënie të trafikimit në 2005’, ndërkohë që në të njëjtën kohë, “qeveria ka rritur në mënyrë të konsiderueshme numrin e rasteve të ndjekura”.

Në lidhje me të drejtat e viktimave në procedurat gjyqësore, analiza e praktikave të gjykatave vendase konfirmon që ka mungesa serioze: ushtrimi i të drejtës për kompensim është problematik; e drejta e palës së dëmtuar për të sugjeruar evidenca të reja është e limituar në pak raste; dhe së fundmi në lidhje me të drejtat e viktimave për mbrojtje, masa të veçanta për ekzaminimin e dëshmitarëve nuk janë aplikuar nga gjykata.

Në rastet e viktimave – dëshmitarëve, shumë viktima nuk janë këshilluar për të drejtën e tyre të refuzimit të përgjigjes ndaj disa pyetjeve dhe ka të dhëna që dëshmitarët nuk janë informuar për të drejtën e tyre të mos treguar të dhënat personale. Indikatorë të tjerë të inefficiensës së politikës së ndjekjes të Republikës së Maqedonisë në lidhje me trafikimin njerëzor janë: periudha e zgjatur e procedurave kriminale; mëshira e tepërt e gjykatave ndaj dënimit të trafikuesve; përdorimi i rrallë i ligjeve të konfiskimit të pasurive në procedurat kriminale dhe mos publikimi i vendimeve.

## Koment

Pavarësisht faktit që në 2005, në 73% të rastave të gjykatave (nga të cilat 15 raste të përfunduara ishin raste të negociimit në trafikim dhe prostitucion), viktimat ishin jo vetëm dëshmitarë por gjithashtu palë e dëmtuar që kishin bërë ankesë; asnjë prej ankesave për mosdëmtim material nuk ishte i suksesshëm.

## V. Praktikrat më të mira

- Ngritja e Sekretariatit për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore si dhe Nën-Komisioni për luftën kundër trafikimit të fëmijëve brenda Komisionit Kombëtar.
- Adaptimi i një Strategjie Kombëtare të kuptueshme dhe Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.
- Mënyra multi-institucionale për mbrojtjen e viktimave të huaja në Qendrën Tranzitore, e cila është e manaxhuar nga tre organizata të ndryshme (Ministria e Punëve të Brendshme, IOM dhe Shoqata “Për një fëmijëri të lumtur”, me misione dhe aktivitete të ndryshme.
- Përpjekje të rëndësishme në ngritjen e kapaciteteve dhe mobilizimin e burimeve.
- Përdorimi i video konferencave, me qëllim dëgjimin e dëshmitarëve gjatë gjyqit.

## VI. Mangësitë

- Mungesa e transparencës në punën e Komisionit Kombëtar dhe në punën e anëtarëve – Ministrive.
- Mungesa e një database zyrtar kombëtar për viktimat e trafikimit njerëzor.
- Mungesa e një metode bazuar në të drejtat e njeriut në politikën e përgjithshme kundër trafikimit në Republikën e Maqedonisë. Në veçanti, mungesa e mekanizmave efektivë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të viktimave.
- Mungesa e ndjeshmërisë gjinore në politikën e përgjithshme kundër trafikimit në Republikën e Maqedonisë, duke marrë parasysh që trafikimi njerëzor është një fenomen i lidhur me gjininën.

- Politika anti – trafikim nuk është diferencuar mjaftueshëm nga politika për të luftuar necogimin në drejtimin e prostitucionit dhe nga politika kundër migrimit ilegal. Në këtë kontekst, shteti shpesh ndërmerr aktivitete kundër prostitucionit, se sa kundër shfrytëzimit të prostitucionit.
- Mungesa e kërkimeve të mbështetura nga shteti dhe analiza e aspekteve të ndryshme të fenomenit.
- Mungesa e ligjeve rregulluese për qëndrimin e përkohshëm të viktimave të trafikuar.
- Ka vështirësi të dukshme në ushtrimin e të drejtës së viktimës për kompensim.

## VII. Vlerësimi i nevojave

Duke marrë parasysh mungesat dhe komentet e përfituara në këtë raport dhe nevojën për përmirësim të situatës, një listë rekomandimesh është si vijon:

### Rekomandime

1. Një Database gjithëpërfshirës të aktiviteteve ekzistuese duhet të ngrihet brenda Komisionit Kombëtar dhe një person duhet të emërohet për marrëdhëniet me publikun.
2. Një database gjithëpërfshirës për viktimat e trafikimit njerëzor (vëndas dhe të huaj) duhet të ngrihet.
3. Fenomeni i trafikimit të qënieve njerëzore duhet të modelohet si një dhunim flagrant i të drejtave të njeriut dhe si çështje e diskriminimit gjinor se sa vetëm si një çështje e sigurimit kombëtar.
4. Rregullatorë ligjorë duhet të adaptohen për: (a) statusin e viktimave të trafikuar; (b) garancinë e mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut për viktimat, duke përfshirë të drejtën e viktimave për t'u kompensuar dhe (c) qëndrim të përkohshëm të viktimave, duke përfshirë një periudhë reflektimi prej minimumi 30 ditësh.
5. Duhet të hartohen protokolle të qartë për identifikimin e viktimave të trafikimit njerëzor dhe dallimi i tyre nga viktimat e shfrytëzimit të prostitucionit dhe punonjeseve të seksit.
6. Duhet të ngrihet një qendër për kërkimin, analizën dhe dokumentimin si një njësi e sponsorizuar nga shteti.

## **LISTA E EMËRTIMEVE**

CARDS	Program i financuar nga BE: Asistencë Komunitare për Ristrukturimin, Zhvillimin dhe Stabilizimin
CEDAË	Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave
EAR	Agjensia Europiane për Ristrukturim
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikës së Migrimit / Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
Interpol	Policia Ndërkombëtare
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
MOI	Ministria e Brendshme
OSCE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë
ODIHR	Zyra e OSCE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
UMCEF	Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Emergjencën e Fëmijëve
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
SIDA	Agjensia e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ndërkombëtar Suedeze



Greqia

I. Hyrje

Greqia është e vendosur në nja gadishull në jug të Ballkanit. Ajo kufizohet me Shqipërinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, me Bullgarinë në verë dhe me Turqinë në veri-perëndim dhe perëndim. Ajo është e rrethuar nga deti Mesdhe në jug dhe jug-perëndim.

Linja e ndihmës pa pagesë Kombëtare Moldave – 0800 77777 menaxhohet nga Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Grave “La Strada”. Linja e ndihmës është një linjë telefonike me shumë kanale dhe pa limit kohor që siguron këshillim konfidencial ose asistencë tjetër në çështje të ndryshme të lidhura me migrimin dhe parandalimin e trafikimit. Telefonatat e bëra tek Linja e ndihmës janë pa pagesë brënda kufijve të Republikës së Moldavisë. Te kjo linjë kanë gjithashtu akses jashtë kufijve (0037322) 23 33 09. Në fillim të 2006, IOM dhe “La Strada” mbështetën hapjen e një Linje Ndihme për rajonin Transnistria në anën e majtë të lumit Nistria, te menaxhuar nga OJF Ndërveprimi.

Në Moldavi, një numër OJF, duke përfshirë: Save the Children, Bordi Ndërkombëtar i Kërkimeve dhe i Shkëmbimit (IREX) dhe Einrock International, kanë ndërrmarre gjithashtu fushata ndërgjegjësimit dhe informimi në zona të përzgjedhura të vëndit. Einrock International ka vendosur linja informimi rajonale dhe ka zhvilluar sesione trajnimit për fuqizimin e grave rurale. Save the Children ka ndermarre fushata që synojnë parandalimin e trafikimit të fëmijëve. Një numër OJF (rajonale) po shpërndajnë postera informues dhe fletë palosje për grupet në rrezik, publikojnë revista në çështjet e trafikimit dhe përdorin faqet e tyre të ëeb –it për të publikuar informacion mbi çështjen.

## Koment

- Përgjithësisht, mund të përfundohet se këto fushata dhe rritja e përpjekjeve kanë arritur në një shkallë të gjërë objektivat e tyre dhe rreziku i trafikimit është tashmë i njohur në Moldavi. Sipas një studimi të fundit<sup>82</sup>, 77.5 % e të rinjve ndërmjet moshës 18 – 29 vjeç dhe 80.6 % e personave ndërmjet moshës 30 – 39 vjeç janë të informuar mbi fenomenin e trafikimit të qënieve njerëzore dhe njohin se ky është një problem shumë serioz për Moldavinë.
- Një nga burimet më të rëndësishme të informimit është media masive dhe veçanërisht televizioni. Një numër agjencish japin shfaqje filmash kombëtare dhe ndërkombëtare dhe dokumentarë mbi çështjet e trafikimit. Megjithatë, falë kostos së lartë, OJF – te përballen me probleme për shfaqjen e reklamave sociale në median masive. Për momentin, aksesit në reklamat sociale është problematik. Është e nevojshme marrja e masave shtetërore për mbështetjen e reklamave sociale.

<sup>82</sup> Studim i ndërrmarre nga Qendra Moldave për Sociologji Komunitare dhe Studime Gjinore për impaktin e fushatës sociale “Mua më intereson” që synon thyerjen e stigmës kundrejt personave të trafikuar dhe shtrirjen e aksesit për persona të trafikuar zhvilluar nga Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Grave “La Strada” gjatë Nëntor 2005 – Maj 2006. Raporti i publikuar në Gusht 2006

Puna për zbutjen e vulnerabilitetit synon grupet në rrezik, vecanërisht gratë dhe vajzat nga zonat rurale që vinë nga familje “problematike” te disavantazuara dhe te varfra, janë një prioritet. Programet në këtë fushë duhet të fokusohen në sigurimin e aksesit në trajnime profesionale dhe asistencë në gjetjen e punësimit.

Duhet përmëndur që programe të tilla kanë filluar në Moldavi vetëm në dy vitet e fundit. Shëmbuj të programeve të tilla përfshijnë: akses falas në formin profesional, orientim në tregun e punës, asistence në gjetjen e punësimit, konsultime dhe sigurim fondesh për ndërtimin e bizneseve të vogla, akses në sistemin e përgjithshëm të edukimit, ndihmë teknike dhe njerëzore, etj. Këto programe janë kryesisht të implementuara nga IOM, ILO – IPEC përmes partnerëve: Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Grave “La Strada”, Qendra për Keshillime Biznesi, Einrock International, Terre des Homes dhe UNDP.

Përpjekjet e OJF – ve dhe komunitetit nderkombëtar ndihmohen nga masat e marra nga shteti dhe përfshijnë *inter alia*, duke përhapur aksesin e të rinjve në trajnimin profesional pa pagese dhe punësimin. Sistemi bazë i formimit profesional dytësor pa pagesë në Moldavi është në rënie në vitet e fundit. Megjithatë, së fundmi, qeveria ka filluar të mbledhë burime buxhetore për të mbuluar ushqim falas në shkolla dhe për sigurimin e një numri të caktuar vëndesh për formin profesional të financuara nga shteti. Gjithsesi një numër i tillë vëndesh është i kufizuar dhe masa të tilla janë në mënyrë të dukshme jo te përshtatshme.

## Koment

- Ka një nevojë të fortë për programe fuqizimi ekonomik që synojnë të diplomuarit në shkolla konviktore dhe jetimë duke qënë se këta persona janë më të ekspozuar ndaj trafikimit.
- Një nga pengesat në zbatimin e programeve të tilla është mungesa e një sistemi të përshtatshëm trajnimi profesional në zonat rurale. Udhëtimi drejt zonave urbane për një kurs ju krijon papërshtatshmëri pjesëmarrësve, duke krijuar kosto shtesë; një pengesë tjetër është mungesa e mundësive të punësimit në zonat rurale, të terma të numrit të kufizuar të vëndeve të punës dhe pagat e ulëta.
- Është e nevojshme marrja e masave në kuptimin e sigurimit të aksesit të lirë për trajnim profesional dhe zhvillimin e tregut të punës në zonat rurale.
- Në mënyrë që të parandalohet trafikimi në persona është gjithashtu e nevojshme lufta kundër dhunës në familje.

## Mbrojtje dhe Ndihmë

### Identifikimi i rasteve të trafikuar

Për momentin, viktimat Moldave të trafikimit në njerëz identifikohen kryesisht nga:

Policia e shteteve të tjera, në territorin e të cilave qytetarët Moldavë bëhen viktima të trafikimit. Në këto raste viktimat e trafikimit kryesisht ri – atdhesohen në Republikën e Moldavisë.

Nga Policia e Republikës së Moldavisë kur analizojnë informacionin e ardhur rreth krimeve të kryera në vënd.

OJF ose Organizata që punojne drejtpërdrejt me viktimat e trafikimit ose veprojnë mbi informacionin e marrë nga të afërmit e viktimave.

Studimi i zhvilluar nga Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Grave “La Strada” ne 2005 <sup>83</sup> zbuloi një

sërë problemesh në fushën e identifikimit të viktimave të personave të trafikuar duke përfshirë mungesën e një përkufizimi zyrtar i nocionit të “identifikimit”, të procedurave dhe gjithashtu kritereve për identifikimin e viktimave. Studimi gjithashtu zbuloi që sistemi i identifikimit të viktimave të trafikimit nuk është i zhvilluar në mënyrë të përshtatshme në Moldavi.

<sup>83</sup> “Identifikimi i Trafikimit të Qënieve Njerëzore” në Cështje Tematike La Strada Express Nr.2 ., 2006, edituar nga Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Grave “La Strada”.

Shume kanale të informimit në rastet e mundshme të trafikimit nuk janë përdorur efektivisht (shërbimi kufitar, trupat përfaqëuses diplomatike të huaj të Republikës së Moldavisë, shërbimet sociale, etj.).

## **Komente**

Është e nevojshme:

- Përpunimi i një koncepti të qartë për identifikimin e viktimave të trafikimit bazuar në rregullimet ligjore kombetare dhe të përshtatura për problemet specifike të Moldavisë;
- Zhvillimi i një sistemi për identifikimin e viktimave të trafikimit bazuar në përkufizimin e trafikimit të qënieve njerëzore, të dhëna të gatshme për rastet e trafikimit të qënieve njerëzore, studime psikologjike dhe sociologjike mbi çështjen, etj.
- Zhvillimi i rekomandimeve për identifikimin e viktimave të qënieve njerëzore për strukturat e forcimit ligjor dhe OJF – të e bazuara në legjislacionin kombëtar.
- Zhvillimi i bashkëpunimit të mëtejshëm midis policisë dhe OJF – ve në fushën e identifikimit të viktimave të trafikimit sepse viktimat janë më të predispozura të flasin me përfaqësues të OJF – ve.

Është për tu përmendur që bashkëpunimi midis trupave shtetërore dhe OJF – ve për identifikimin e viktimave të qënieve njerëzore dhe drejtimin e tyre të mëtejshëm për asistencë dhe mbrojtje është elementi kryesor i Mekanizmave Referues Kombëtar (NRM)<sup>84</sup>, një strategji e re Europiane për neutralizimin e trafikimit në njerëz. NRM ndihmon në zgjidhjen e problemeve të identifikimit dhe asistencës për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore si dhe përmirësimin e gjithë sistemit të neutralizimit të krimeve në vënd.

## **Koment**

Është i nevojshëm krijimi i sistemit të bashkëpunimit brenda NRM për të refruar viktimat e trafikimit në vëndë ku ata mund të marrin ndihmën e nevojshme.

<sup>84</sup> Mekanizma që referojnë viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore në nivel kombëtar . Mbledhja e forcave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit në njerëz. “Manuali praktik OSCE/BDIHR, Varshave, 2004.

Ndihma në riatdhesim dhe vlerësimi i rreziqeve

Aktualisht, dy strukturat madhore të përfshira në riatdhesimin e njerëzve të trafikuar në Moldavi janë prezantuesit diplomatike të Moldavisë dhe IOM. Zakonisht, viktimat nuk zotërojnë dokumenta identifikimi në këtë mënyrë autoritetet e konsullatës Moldave vazhdojnë më identifikimin e viktimave dhe lëshimin e tyre me dokumenta identifikimi.

Sipas kodit 19 të Ligjit Moldav për *Parandalimin dhe Ndërprerjen e Trafikimit të Qënieve Njerëzore*, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Integritimit Europian, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të brendshme dhe Ministrinë e Përpunimit të Informacionit, duhet të shqyrtojnë dhe aprovojnë Rregullimet për Procedurat e Riatdhesimit të Viktimave të Trafikimit të Qënieve Njerëzore. Për momentin, ky dokument është në formatin e draftit përfundimtar.

Riatdhesimi i viktimave të trafikimit shpesh shfaq probleme të caktuara. Viktimat përballen me të njëjtat probleme me të cilat janë përballur para se të largohen, mungesë e një burimi të përhershëm jetese, borxhe, probleme familjare etj. Ata gjithashtu përballen me disa probleme shtesë si probleme shëndetësore, trauma psikologjike dhe frike nga diskriminimi social nëse e kaluara e tyre bëhet e njohur. Nëse një viktimë dëshmon në polici në vëndin e destinacionit, ai/ajo gjithashtu trëmbet nga ndjekja nga trafikuesit.

Protokolli i Parandalimit, Ndërprerjes dhe Ndëshkimit të Trafikimit të Qënieve Njerëzore, Vecanërisht Grave dhe Fëmijëve, plotesojnë Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar përcakton në kodin 18 (1) :



Kur një shtet partner kthen viktimat e trafikimit në njerëz një shteti partner ku ai person ka nacionalitetin ose në të cilin ai ose ajo kanë, në momentin e hyrjes në territorin e shtetit partner marrës, të drejtës e residencës së përhershme, ky kthim duhet të jetë i një kujdesi të vecantë për sigurinë e personit dhe për statusin e cdo zhvillimi ligjor që lidhet me faktin që personi është një viktimë e trafikimit dhe kjo preferohet të bëhet në mënyrë të vullnetshme <sup>85</sup>.

Në realitet rreziku i riatdhesimit nuk është gjithmonë i matshëm. Disa nga viktimat, pasi rikthehen në Moldavi, vazhdojnë të përballen me probleme dhe vazhdojnë të kërkojnë për mundësi punësimi jashtë shtetit. Statistikat e IOM tregojnë që në periudhën 2001 – 2004 një mesatare 8 % e viktimave (nga 12 % në 2001 në 4.3 % në 2004) janë trafikuar në mënyrë të përsëritur <sup>86</sup>.

<sup>85</sup> Protokollin e Parandalimit, Ndërprerjes dhe Ndëshkimit të Trafikimit të Qënieve Njerëzore, Vecanërisht Grave dhe Fëmijëve që plotëson Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2000, i gatshëm nga:

<http://ëëë.un.org/russian/documen/convents/orgcrime.pdf>

<sup>86</sup> Raporti i Dytë Vjetor për Viktimat e Trafikimit të Qënieve Njerëzore në SE Europe, 2005. Raporti Shtetëror: Republika e Moldavisë. IOM, Gjeneve, 2005, fq.24.

Përfaqësuesit e strukturave zyrtare në vëndet e destinacionit duhet të vlerësojnë rrezikun e riatdhesimit të viktimave, dhe nëse është e nevojshme, të kërkojnë alternativa për një riatdhesim të tillë.

## **Koment**

Republika e Moldavisë ka detyrim të mbrojtë interesat e qytetarëve të saj që janë bërë viktime të trafikimit. Është, megjithatë, e nevojshme firmosja e marrëveshjeve bilaterale me vëndet e destinacionit, duke u siguruar për detyrimet e këtyrë vendëve për të vlerësuar rrezikun e riatdhesimit të viktimave të trafikimit dhe kërkimi i alternativave për një riatdhesim të tillë.

Shelter, kujdes shëndetësor, ndihmë psikologjike dhe humanitare

Që në 2001, një shelter e specializuar për viktimat e trafikimit po zhvillon aktivitetin e saj për viktimat e trafikimit në Republikën e Moldavisë nën menazhimin e misionit IOM në Moldavi. Është e vendosur në Chisinau, kryeqyteti i Republikës së Moldavisë. Në 2004 UNICEF ndihmoi në hapjen dhe pajisjen e një fraksioni të vecantë për fëmijët viktime të trafikimit. Ky shelter që është i financuar nga komuniteti ndërkombëtar në vënd te qeverisë, ofron ndihmë dhe rehabilitim të menjëhershëm dhe në terma kohorë mesatarë mbi baza vullnetare.

Viktimat e trafikimit marrin ndihmën mjekësore të nevojshme drejtpërdrejt në shelterin ku ata janë referuar menjëherë pas rikthimit të tyre në Moldavi. Probleme në sigurimin e ndihmës shëndetësore shfaqen kur ka nevojë për ndërhyrje serioze, si ndërhyrje kirurgjikale. Moldavia ka prezantuar një sistem shtetëror të sigurimeve shoqërore dhe kujdes shëndetësor pa pagesë ofrohet vetëm për ata që kanë sigurime shëndetësore.

Përgjithësisht, shelteri i specializuar i IOM i jep përfituesve mundësinë për të qëndruar atje rreth tre muaj, që normalisht është e mjaftueshme për tu shëruar. Megjithatë, në praktikë, ka raste kur një viktimë kërkon një periudhe rehabilitimi më të gjatë – një vit ose më shumë. Disa herë, qëndrimi i përkohshëm për një periudhë më të gjatë qëndrimi është thelbësore për ata që nuk kanë të afërm, janë marxhinalizuar nga familjarët e tyre, janë nëna të vetmuara ose marrin trajnim profesional në një vënd te ndryshëm nga vëndi i tyre i residences. Në këto raste ka probleme me sigurimin e asistencës me terma të gjatë.

Se fundmi janë bërë përpjekje për të zhvilluar një rrjet shërbimesh që do të ndihmojë viktimat në vëndin e tyre të residencës. UNDP ka ndihmuar tashmë në hapjen e tre shelterave në rrethe të ndryshme të Moldavisë. Ka një plan për hapjen e pesë shelterave të tjera. Shumë shpesh viktimat e trafikimit kanë nevojë për ndihmë humanitare, si veshmbathje, mjete higjene etj. Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Grave “La Strada” ne 2005 siguron një ndihmë të tillë.

### **Koment**

Eshte e nevojshme vendosja e shelterave/shërbimeve që ofrojnë ndihmë afatgjatë ku viktimat e trafikimit mund të qëndrojnë dhe të marrin ndihmën e nevojshme për të paktën një vit.

Akses në mundësitë e edukimit profesional – punësimit dhe zhvillimin e bizenseve të vogla – ri integrimin social të viktimave

Sipas standarteve ndërkombëtare, viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore kanë të drejtën e një edukimi profesional. Në të tashmen, kryesisht misioni IOM në Moldavi, Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Grave “La Strada” dhe CPTË sigurojnë këtë ndihmë nën marrëveshje me Agjensite Kombëtare të Punësimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Tregtisë. Viktimat që nuk kanë një profesion ose kanë një profesion për të cilin ka mungesë kërkesë në tregun e punës, kryesisht trajnohen në parukeri, gatim, rrobaqepësi ose profesione të tjera sipas kërkesës së tregut lokal të punës. Studentët e mëparshëm të Institucioneve të Edukimit të Lartë ndihmohen në riintegrimin e tyre dhe tarifat e tyre mbulohe. Ky program zbatohet që në 2002 nga Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Grave “La Strada” Moldavi me ndihmën e misionit të OSCE në Moldavi.

Viktimat gjithashtu ndihmohen në gjetjen e punësimit nëpërmjet departamentëve lokale të Agjensisë Kombëtare të Punësimit, Ministrisë së Ekonomisë dhe Tregtisë.

Kjo megjithatë rezulton e vështirë falë nivelit të lartë të papunësisë dhe pagave të ulëta të parashikuara. Misioni i IOM në Moldavi dhe CPTË i ofrojnë viktimave mundësi për të zhvilluar biznese të vogla. Personat e

përzgjedhur për fonde ndihmohen në zhvillimin e një plani biznesi dhe ju jepen grante të vogla për blerjen e pajisjeve të nevojshme, materialeve, etj.

Qëllimi kryesor i aktiviteteve të lartpërmëndura është sigurimi i riintegritit social i viktimave dhe parandalimi që ata të bien përsëri vitkima të trafikut në të ardhmen. Ri-integrimi social i viktimave të trafikimit, të shfrytëzuara për një vit ose më shumë, është një proces i vështirë dhe i ngadaltë. Shumë shpesh gjëndja e tyre psikologjike nuk i lejon të përqëndrohen në aktivitete të caktuara për një periudhë të gjatë kohe dhe të punojnë në mënyrë efektive. Për këtë arsye, OJF – të që i ofrojnë ndihmë viktimave ndërrmarrin monitorime në afat të gjatë të progresit të tyre dhe i ndihmojnë ata në mënyrë që të kalojnë problemet psikologjike.

### **Koment**

Është e nevojshme ndërrmarrja e monitorimeve në afate të gjata kohore të progresit të viktimave të qënieve njerëzore në mënyrë që ti mbrojë ata nga cdo përfshirje e mundshme në situata të ngjashme.

## Ndihmë Ligjore

Viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore ndihmohen për të rimarrë dokumentat e humbura dhe ju sigurohet ndihmë ligjore mbi familjen, strehimin, dhe çështje të tjera. Ndihma sigurohet nga një OJF e specializuar, Qendra për Parandalimin e Trafikimit të Grave (CPTË).

## Akses në procedurat ligjore civile dhe dëmshpërblimi

Viktimat e trafikimit kanë të drejtën e dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar ndaj tyre<sup>87</sup>. Dëmshpërblimi për dëmet është shumë i rëndësishëm për viktimat e trafikimit, si një shprehje e drejtësisë. Dëmshpërblimi mund të ketë një *efekt ndreqës si dhe parandalues, sepse ju jep viktimave mundësinë për të rifilluar një jetë të re kur kthehen në vëndin e tyre të origjinës dhe parandalon që ata të bien përsëri në duart e trafikuesve*<sup>88</sup>

Viktimat e trafikimit mund të kërkojnë dëmshpërblim moral ose/dhe për materialet e humbura duke ngritur padi kundër trafikuesve<sup>89</sup>.

<sup>87</sup> Sipas pjesës (2) të kodit 23 të Ligjit të Parandalimit dhe Ndalimit të Trafikimit të Qënieve Njerëzore të Republikës së Moldavisë

<sup>88</sup> Mekanizmat Referues Kombëtar të viktimave të trafikimit. Mbledhja e Forcave për Mbrojtjen e të Drejtave të Viktimave të trafikimit të Qënieve Njerëzore. Guidë Praktike. OSCE/ODIHR, Varshavë, 2004, fq.97

<sup>89</sup> Rregullat për Padi të tilla rregullohen nga kapitulli 1 i seksioni VII i Kodit të Proceduarve Penale të Republikës së Moldavisë

## Komente

- CPTË është e vetmja OJF që ju jep ndihmë ligjore viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore dhe përfaqëson interesat e tyre në gjykatë. Të punësuarit e kësaj organizate ndihmojnë viktimat në marrjen e dëmshpërblimit. Sipas tyre është praktikisht e pamundur marrja e kompensimit për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore. Megjithëse autoritetet gjyqësore vendosin që dëmshpërblimi duhet tu paguhet viktimave, fatkeqësisht kriminelet i largohen detyrimeve të tyre duke mos regjistruar asnjë pronësi në emrat e tyre.

## Ndjekja Penale

### Ndjekja penale e krimit dhe denimi i krimineleve

Sipas nenit 56 të Kodit të Procedurave Penale të Moldavisë<sup>90</sup>, strukturat e ndjekjes penale janë:

Minsitria e Punëve të Brëndshme;  
Sistemi i Sigurisë dhe informimit të Republikës së Moldavisë;  
Departamenti i Doganës  
Qendra për Luftën e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

Nën Ministrinë e Punëve të Brëndshme të Republikës së Moldavisë ka një nën - ndarje të vecantë për anti – trafikimin, Qendra per Luftën Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore. Kjo është e vetmja nën – ndarje e specializuar në strukturat e punëve të brëndshme për të luftuar trafikim në vëndet CSI. Krijimi i strukturave të tilla të specializuara mbi faktin që trafikimi i qënieve njerëzore u rrit në mënyrë të ndjeshme në vitet e fundit. Në 2005, 344 raste të trafikimit në qenie njerëzore u regjistruan duke përfshire 240 raste kriminale nën nenin 165 të Kodit Kriminal (Trafikimi i Qënieve Njerëzore) dhe 104 raste kriminale nën nenin 2006 (Trafikimi i fëmijëve).

Megjithatë zyrtarët e ndjekjes penale jo gjithmonë arrijnë të mbledhin mjaft prova që një rast të dërgohet ne gjykatë. Sipas nje informacioni

të Zyrës së Përgjithsme të Ndjekjes Penale, në 2005, 222 raste kriminale të trafikimit janë transferuar në gjyq (192 nën nenin 165 të Kodit Kriminal dhe 30 nën nenin 206 të Kodit Kriminal)

<sup>90</sup> Nr. 122-XV

Për më tepër analiza e praktikave gjyqësore tregon se pjesa më e madhe e rasteve të lart përmendura janë rishqyrtuar në bazë të nenit 220 të Kodit Kriminal. Përveç numrit domethenës të rasteve kriminale të raportuara në gjyq vetëm 36 persona u dënuan nën nenin 165 të Kodit Kriminal dhe 19 persona nën nenin 206 të Kodit Kriminal. Gjykata e Lartë e Drejtesisë së Moldavisë analizoi rastet kriminale të trafikimit të qënieve njerëzore, (duke përfshirë transferimin e paligjshëm jashtë vëndit dhe trafikimin e grave për shfrytëzim seksual), të trajtuara nga gjykata në 2004 dhe nëntë muajt e parë të 2005. <sup>91</sup> Kjo analizë zbuloi një sërë të metash dhe dhunimesh. Të dhënat e Gjykatës së Lartë të Drejtesisë konfirmoi se në më shumë se 50% të rasteve të analizuara dhe masave të dëmit janë zbatuar nën nenin 220 dhe nene të tjera të Kodit Kriminal në vën të nenit 165.

Dhunimet e mëposhtme janë identifikuar:

Shfajësime të pa bazuara të mbrojtësve

Dëgjim publik i rasteve në kundër nevojës për të mbrojtur privatësinë e viktimave

Shfajësim i mbrojtësve bazuar në marrëveshje të vullnetshme të viktimave të shfrytëzimit, gjë e cila nën Ligjin Ndërkombëtar, nuk ndikon në vlerësimet ligjore dhe kriminale të trafikimit në qenie njerëzore

Rindjekje e gabuar e rasteve për lirimin nga dënimi si pasojë e amnistisë

Perceptim i gabuar i rekrutimit si një tentativë krimi, në vënd të faktit që tentativë krimi përben një krim të ndarë nga trafikimi i qënieve njerëzore.

Pyetje e viktimave në prani të familjarëve dhe/ose të mbrojtësve

Sipas gjykimit të Gjykatës së Lartë ‘Këto dhunime shkaktohen nga fakti që disa gjyqtarë kanë pamjaftueshmëri njohurish të legjislacionit, praktikat gjyqësore nuk janë të zhvilluara sa duhet dhe zbatimi i legjislacionit anti – trafikim nuk justifikohet plotësisht’.

<sup>91</sup> Informacion mbi rastet e përgjithësuara në praktikat gjyqësore të trafikimit të qënieve njerëzore, Trafikimi në Fëmijë, Marrja e Paligjshme e Femijëve jashtë Vëndit dhe shfrytëzimi seksual. Buletini i Gjykatës së Lartë të Republikës së Moldavisë 2006, Nr.5, fq 34

#### **Koment**

- Është i nevojshëm organizmi i sesioneve të trajnimit për gjykatësit dhe prokurorët
- Është i nevojshëm konsolidimi i materialit bazë për forcimin e strukturave ligjore dhe zhvillimi i bazave normative për ndjekjen penale të trafikimit të qënieve njerëzore dhe shfrytëzimit seksual në mënyrë që të ndahen në mënyrë të qartë këto krime.

Mbrojtja e Viktimave



Ligji i Republikës së Moldavisë për Mbrojtjen Shtetërore të Viktimave, Dëshmitareve, dhe personave të tjerë që marrin pjesë në Procedurat Ligjore<sup>92</sup> përshtat masat për mbrojtjen e jetës, shëndetit, pronës, të drejtave ligjore dhe interesave të personave që marrin pjesë në procedurat ligjore, si dhe të anëtarëve të familjes dhe të personave të tjerë të afërm. Duke u ndikuar nga rrethanat e vecanta, ligji parashikon dy lloj masash: të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Masat e zakonshme janë si më poshtë:

Mbrojtës personal, mbrojtës të shtëpisë dhe pronës  
Lëshim i mbrojtjes së vecantë personale, komunikim, dhe mjete të vecanta për njoftimin e rrezikut  
Vendosje e përkohshme në një vend të sigurt

Msa të jashtëzakonshme:

Ndryshim i vëndit të punës (shërbimit) ose studimit;

Ndryshim i banimit dhe sigurimi i një akomodimi të ri (shtëpi, apartament);

Lëshimi i një karte identiteti nën një emër tjetër dhe ndryshim i pamjes;

Dëgjim në gjyq të mbyllur

#### **Koment**

- Në shume instanca, mungesa e mjeteve ndalon zbatimin e këtij Ligji. Vetëm në disa raste Ministria e Brëndshme, në bashkëpunim me IOM dhe CPTË, siguroi viktimat me

<sup>92</sup> Nr. 71458 – XIII, 28.01.1998

Në vitin 2000, Moldavia u bë shtet anëtar i Iniciativës së Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SECI) – një organizate ndërqeveritare e 12 shteteve të Europës Juglindore. Kjo organizatë koordinon veprimet e strukturave shtetërore të zbatimit ligjor me

synim luftën e krimit ndërkombëtar. Qëllimi kryesor i kryetarëve të kësaj organizate, të vendosur në Bukuresht, është sigurimi i shkëmbimit të shpejtë dhe efektiv të informacionit për krime të ndryshme, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore. Një shkëmbim sigurohet nga komunikimi i vecantë i zyrtarëve – përfaqësues të shteteve partnerë, të vendosur në zyrat qendrore. Për më tepër, SECI siguron ndihmë në lëshimin dhe riatdhësimin e viktimave të krimit në territorin e shteteve të tjera partnerë, në ndjekjen e kriminelëve, etj. Në 2005, dëshmia e parë gjyqësore e dhënë në video konference në një vënd tjetër u organizua me ndihmën e SECI. Në atë konferencë një qytetar nga Moldavia, një viktimë e trafikimit në territorin e ish – Republikës Jugosllave të Maqedonisë, dëshmoi me anë të komunikimit vizual në atë shtet. Mbështetja e SECI është e një vlere të lartë për punën e strukturave të detyrimit ligjor në Moldavi, e cila shpesh ka mungesën e burimeve financiare për të luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar.

## V. Praktikrat më të mira

Praktikat më të mira të sistemit kundër trafikimit në Moldavi mund të gjenden në këtë raport, në kapitujt përkatës.

## VI. Mangësitë

Mangësitë në sistemin kundër trafikimit në Moldavi mund të gjenden në këtë raport, në kapitujt përkatës.

## VII. Vlerësimet e Nevojave

Duke marrë në konsideratë magësitë dhe komentet që përmban ky raport dhe nevojën për përmirësimin e situatës, një listë më rekomandimë është hartuar si më poshtë:

### Rekomandime

Në mënyrë që të përmirësohet sistemi kundër trafikimit në vënd është rekomanduar të përshtaten masat e mëposhtme:

**Rritja e Kapaciteteve:** Ka nevojë për programe trajnimi të mirëorganizuara, në mënyrë që të trajnohen specialistet që kanë kontakte me viktimat e mundshme të trafikimit.

**Kërkim dhe Menaxhim Informacioni:** Eshtë e nevojshme të sistematizohet mbledhja e informacionit mbi trafikimin njerëzor, psh. organizimi i mbledhjes, analizës dhe shkëmbimit i informacionit midis gjithë pjesëmarrësve në aksionin kundër trafikimit njerëzor. Është nevoja e vendosjes së një organizmi qëndror përgjegjës për mbledhjen dhe sistematizimin e informacionit dhe për shpërndarjen e këtij informacioni të gjithë agjentëve/institucioneve të përfshirë në luftën kundër trafikimit. Prioritet para vendosjes së procedurës së mbledhjes, sistematizimit dhe shkëmbimit të informacionit, është e nevojshme të përcaktohet cili është lloji i informacionit që pjesëmarrësit duan.

### Koordinimi i Veprimeve

Komiteti Kombëtar i Anti-trafikimit nuk ka një sekretariat të përhershëm. Është gjithashtu e nevojshme krijimi i një nën – ndarje qeveritare (1 – 2 njësi) përgjegjës për luftën kundër trafikimit në njerëz.

Përfaqësues të shpëqërise civile dhe strukturave ndërqeveritare nuk janë zyrtarisht. Është e nevojshme përfshirja e përfaqësuesve të OJF – ve që punojnë në mënyrë aktive në këtë fushë në strukturat zyrtare të Komitetit Kombëtar.

Republika e Moldavisë nuk i kushton sa duhet vëmendje problemit të trafikimit të qënieve njerëzore në nivel rajonal. Është i nevojshëm organizimi i sesioneve të trajnimit për anëtarët e komisioneve rajonale në çështjet e trafikimit të qënieve njerëzore dhe në kundërveprimet e fenomenit.

### Mobilizimi i Burimeve

Për momentin, aktivitetet për zbutjen e trafikimit të qënieve njerëzore në Moldavi janë financuar nga ndihma ndërkombëtare. Shteti gjithashtu duhet të mbledhë burime për të mbështetur programe dhe aktivitete kundër trafikimit

### Parandalimi i Trafikimit të Qënieve Njerëzore

Është e nevojshme përshtatja e masave që mbështetin Fushatat e Informimit Publik nga OJF.

Në mënyrë që të mbështeten grupet vulnerabël, është e nevojshme marrja e masave që sigurojnë akses të lirë trajnimit profesional për të varfrit.

Në mënyrë që të luftohet trafikimi i qënieve njerëzore, është e nevojshme lufta kundër dhunës në familje.

Ndihmë dhe Mbrojtje për Viktimat e Trafikimit të Qënieve Njerëzore

Është e nevojshme:

Zhvillimi i një përkufizimi të qartë të viktimave të trafikimit bazuar në rregullimet ligjore kombëtare dhe i drejtuar drejt zgjidhjeve të problemeve specifike të vëndit.

Zhvillimi i një sistemi për identifikimin e viktimave të krimeve të lidhura me trafikimin, bazuar në përkufizimin e trafikimit, mbledhjen e të dhënave dhe studimeve spikologjike dhe sociologjike në këtë çështje.

Zhvillimi i rekomandimeve për strukturat e detyrimit ligjor dhe OJF – të, bazuar në legjislacionin kombëtar për identifikimin e viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore.

Krijimi i një sistemi bashkëpunimi brenda NRM për të referuar viktimat e trafikimit në vënde ku ata mund të marrin ndihmën e nevojshme

Nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale me vëndet e destinacionit, që detyrojnë këto shtete të vlerësojnë rrezikshmërinë e riatdhesimit të viktimave të trafikimit dhe kërkimi i alternativave për një riatdhesim të tillë.

Hapja e shelterave me afate të gjata ku viktimat mund të qëndrojnë dhe të marrin ndihmë për të paktën një vit.

Zhvillimi i monitorimeve afat – gjate për ri – integrimin e viktimave në mënyrë që të ofrohet mbështetje dhe të parandalohet përfshirja e tyre në situata të ngjashme.

Zhvillimi i sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe aplikimi i masave detyruese sipas legjislacionit.

Sigurimi që viktimat e trafikimit janë të informuar në mënyrë të saktë rreth të drejtave të tyre për dëmshpërblim asistuar ligjerisht në lëshimin e padive civile kundër trafikuesve.

Ndjekja e njerëzve fajtorë për Trafikimin e Qënieve Njerëzore

Është i nevojshëm organizimi i sesioneve të trajnimit për gjykatësit dhe prokurorët. Është i nevojshëm konsolidimi i materialit bazë për strukturat e detyrimit ligjor.

Është i nevojshëm zhvillimi i masave normative të përndjekjes penale të trafikimit të qënieve njerëzore dhe shfrytëzimit seksual në mënyrë që të qartësohet ndryshimi midis këtyre dy krimeve.

Është e nevojshme marrja e masave për zhvillimin e kurseve në Anglisht për zyrtarët e strukturave të ndjekjes penale në Republikën e Maqedonisë, në mënyrë që të promovohet komunikim dhe kuptim më i mire.

Është gjithashtu e nevojshme zhvillimi i procedurave të vecanta ligjore për ndjekjen penale të trafikuesve,

## Lista e Shkurtime

CIS	Commonëalth i Shteteve të Bashkuara
CPTË	Qendra pëe parandalimin e Trafikut të
Grave	
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IPEC	Programi Ndërkombëtar për eliminimin
e punës së fëmijëve	
IREX	Bordi i Shkëmbimeve dhe Kërkimeve
Ndërkombëtare	
NRM	Mekanizmat Referues Kombëtarë
OSCE	Organizata per Siguri dhe Bashkëpunim
në Europë	
SECI	Organizata për Bashkëpunim në
Europën Juglindore	
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të
Bashkuara	
UNICEF	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Fonde
për Femijët	
USAID	Agjensia e Kobeve të Bashkuara për
Zhvillim Ndërkombëtar	

Mali i Zi

Autorë: Lobimi i Grave Malazeze

## Mali i Zi

### Hyrje

Mali i Zi i vendosur në gadishullin Ballkanik ishte një nga entitetet përbërëse të ish – Republikës së Jugosllavise dhe më vonë u bë pjesë e një Federate me Serbinë. Në 2006 u në një shtet i pavarur. Ajo kufizohet me Bosnjën dhe Hercegovinën në veri – perëndim, Serbinë në veri – lindje, Shqipërinë në jug – lindje dhe Kroacinë në jug – perëndim. Ajo gjithashtu është fqinje me Italinë nëpërmjet detit Adriatik.

Duke marrë në konsideratë se kriza sociale e dekadës së fundit shkaktoi shume ndryshime dhe rënie dhe rënie në vënd dhe në gjithë Ballkanin dhe në gjithë Europën Lindore, Mali i Zi është vecanërisht i prekur nga trafikimi i qënieve njerëzore. Ndryshime të forta dhe dramatike kanë ndodhur në këtë zonë si një rënie e dukshme e kushteve të jetesës, izolimi i vëndit dhe një rritje e papunësisë. Si rezultat dëme të rënda janë ndërthurur në strukturën dhe zhvillimet familjare.

Zyrtarisht, sipas Zyrës së Koordinatorit Kombëtar, Mali i Zi është një vënd tranziti. Megjithatë, sipas të dhënave të siguruara nga OJF – të që merren me këtë çështje<sup>93</sup>, është një vënd origjine dhe destinacioni njëkohësisht. Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna për viktimat Malazeze të cilat përfundojnë në vënde të huaja. Këto të dhëna janë vlerësuar në bazë të telefonatave të kryera pranë linjës SOS për viktimat e trafikimit. Këto telefonata janë kryer nga të afërm që kanë raportuar njerëz të humbur ose që kanë dyshime se të afërmit e tyre janë viktima të trafikimit.

Sipas statistikave të OJF – së *Lobimi i Grave Malazeze* (MËL)<sup>94</sup>, pjesa më e madhe e grave që janë viktima të trafikimit vinë nga Ukraina, Rumania, Lituania dhe Serbia. Megjithatë, nuk janë vetëm gratë që janë viktima të trafikimit në Malin e Zi; katër burra nga Bangladeshi dhe pesë burra nga Ukraina janë identifikuar gjithashtu si viktima, të trafikuar për punë të detyruar gjatë periudhës 2005 – 2005.

Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se një përqindje e lartë e viktimave të trafikimit janë fëmijë<sup>95</sup>, të cilët janë grupi më vulnerabël i trafikimit

93. “” OJF – të Lobimi i Grave Malazeze dhe Shtëpia e Sigurt e Grave  
94. “” Lobimi i Grave Malazeze ka një shelter për viktimat e trafikimit  
95. “” Personat nën 18 vjec kosniderohen si fëmijë

## Baza Ligjore Kombëtare

### Ligji Kombëtar

Nuk ka përkufizim të qartë të Trafikimit të qënieve njerëzore në Ligjin Malazez. Një instrument ndërkombëtar, i përdorur zakonisht nga prokurorët për rastet e trafikimit, është Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Abuzimit me Fuqi, i përshtatur në 1985. Deklarata përkufizon si viktimë njerëzit që vuajnë nga dhimbje fizike ose mendore ose janë subjekt i dhimbjeve emotive ose humbjeve ekonomike, ose që në mënyrë të vazhdueshme nuk gëzojnë të drejtat e tyre.

Kodi Kriminal i Malit të Zi (neni 444), që përkufizon trafikimin e qënieve njerëzore si një krim, përcakton si më poshtë:

Një person që rekruton, transferon, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose me mjete të tjera shtrengimi, rrëmbimi, mashtrimit, abuzimi me fuqi ose me një pozite që kanë personat vulnerabël, ose marrja dhe dhënia e pagesave ose favoreve për arritjen a pranimit nga një person, kontrolli mbi një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin, prostituimin ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual,



punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robëri ose zhvendosje e organeve, ose për përdorim në konflikte ushtarake, dënohet me burgim bga një në dhjetë vjet.

Në raste të viktimave minorene, zbatohet i njëjti dënim si më lart, edhe nëse krimi kryhet pa përdorimin e forcës, kërcënimit ose mjeteve të tjera.

Në raste të viktimave minorene, autorët e krimit dënohen me të paktën tre vjet burgim.

Nëse dëmtime të rënda fizike i është shkaktuar viktimave, autori i krimit dënohet nga një deri në njëmbëdhjetë vjet burgim.

Në rast të vdekjes së viktimave, autorët e krimit dënohen me dhjetë vjet burg

Nëse krimi është kryer nga grupe të organizuara, autorët dënohen me të paktën pesë vjet burgim.

#### Trafikimi i fëmijëve për adoptim (neni 445)

Një njeri që merr një fëmijë, më të ri se 14 vjec, për adoptimin e tij, ose që adopton një fëmijë të tillë, bën marrëveshje për adoptimin e tij, ble, shet ose dorëzon një person më të ri se 14 vjec, ose i jep atij/asaj transport, akomodim, ose e fsheh atë, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet

Kur krimi i lartpërmëndur kryhet nga një grup personash ose në mënyrë të organizuar, autorët e krimit dënohen me të paktën tre vjet burg.

#### Skllavëria ose situata të ngjashme me skllavërinë (neni 446)

Një person që vendos ose mban një person tjetër në skllavëri ose në një gjëndje të ngjashme, dhe ble, shet, i jep një personi tjetër, ose bën marrëveshje për të ose mbështet një person tjetër që të shesë lirinë e tij, dënohet me burgim një deri në dhjetë vjet

Një person që transporton persona të tjerë, nga një shtet në tjetrin, me qëllim skllavërimin ose vendosjen në kushte të ngjashme, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Nëse krimi i lartpërmëndur është kryer mbi një minorene, autorët e krimit dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

#### Marrëveshje Bilaterale

Duke qënë se Mali i Zi është bërë i pavarur vetëm së fundmi, procesi i ratifikimit të konventave ndërkombëtare sapo ka filluar. Për disa arsye, asnjë marrëveshje bilaterale apo Konventa Ndërkombëtare nuk janë ratifikuar që kur Mali i Zi është bërë një shtet i pavarur.

## Plani Kombëtar i Veprimit

Në 2005, Strategjia Kombëtare e qeverisë së Malit të Zi për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore është pranuar. Kjo strategji konsiston në tre pjesë, dënim, mbrojtje e viktimave dhe parandalim i trafikimit.

## Struktura e përgjithsme

### A. Rritja e kapaciteteve

Agjencite e mëposhtme po zhvillojnë aktivitete për rritjen e kapaciteteve në Malin e Zi:

#### Organizata Jo – Qeveritare

Lobimi i Grave Malazeze (MËL)  
Shtëpia e Sigurt e Grave

#### Organizata Qeveritare

Koordinimi Kombëtar për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore  
Grupi Special i Policisë për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore

#### Organizata Ndërkombëtare

Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë  
Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM)

Këto dy organizata ndërkombëtare kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore në Malin e Zi, njëkohësisht si donatore dhe si bashkëorganizues të shumë projekteve domethënës të OJF – ve, si sesione trajnimi për nxënësit,

punonjës sociale, punonjës të shëndetit dhe personelin e policisë. Mandati i IOM gjithashtu përfshin riatdhesimin e viktimave në vëndin e tyre të origjinës.

Shumë OJF NË Malin e Zi, si Lobimi i Grave Malazeze, Telefoni SOS për dhunë familjare, *Save the Children UK*, *Horizonte* të reja dhe *Stella*, kanë organizuar aktivitete në fushën e parandalimit të trafikimit seksual që synojnë target – grupe të ndryshme (nxësës, studentë, oficerë policie, mësues, komuniteti lokal, menaxhere spitalesh, etj) në Malin e Zi. Këto sesione trajnimi në formën e seminareve katër, tre, dy ose një ditore ku pjesëmarrësit janë prezantuar me problemet e trafikimit

## B. Analizë, Kërkime dhe mekanizmat monitorues

Bordi i Projekteve, një strukturë e përbëre nga agjensitë Ndërkombëtarë, Shteti dhe OJF – të lokale, që merren me çështjet e trafikimit në Malin e Zi, u themelua në 2004. Bordi mblidhet cdo tre muaj dhe aktiviteti i tij kryesor përfshin vlerësimin e situatës dhe shkëmbimin e informacionit, ndërkohë që vendos dhe për aktivitetet e ardhshme.

Moderatori i Bordit të Projekteve është Koordinatori Kombëtar për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

## Bashkëpunimi dhe Netëork në nivel rajonal dhe kombëtar

Ne nivel rajonal, një Memorandum Kuptimi dhe Bashkëpunimi u firmos në 2005 midis Ministrisë së Shëndetësisë, Policisë, Qendra për përkujdesje Sociale dhe Punë e Lobimit të Grave Malazeze. Ky instrument synon promovimin e një perceptimi më të mirë të fenomenit të trafikimit përmes bashkëpunimit të institucioneve të lartpërmendura dhe në vendosjen e bashkëpunimit të ngushtë midis tyre dhe si rrjedhojë sigurimi i një mbrojtjeje më të mirë për viktimat.

Për më tepër, Bordi i Projekteve i përmendur më lart, i përbërë nga Lobimi i Grave Malazeze, Shtëpia e Sigurt e Grave. Grupi Special i Policisë, Zyra për Barazi Gjinore, OSCE, IOM, Këshilli i Europës, UNICEF, USAID, dhe Save the Children, është një strukturë e themeluar për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet agjentëve të ndryshëm që punojnë në Malin e Zi.

Në nivel Ndër - Shtetëror vëndet e Ballkanit kanë themeluar Nëtëorkun Petra në mënyrë që të shkëmbejnë eksperiencën dhe të forcojnë

bashkëpunimin e tyre në luftën kundër trafikimit. Aktivitetet e tij përfshijnë koordinimin e punës së shërbimeve të linjës telefonike SOS dhe shelterave për viktimat e trafikimit.

Në nivel OJF, Netëorku ARIADNE është një hap i mëtëjshëm në përpjekjet drejt forcimit të bashkëpunimit rajonal kundër fenomenit të trafikimit. Netëork – u themelua në Qershor 2005 dhe ka një rol të rëndësishëm në luftën kundër trafikimit në nivel rajonal. Koordinuesi i këtij netëork – u është Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEPAD), e vendosur në Athinë, Greqi. Anëtarët e këtij netëork – u janë shtetet e Europës Lindore dhe Juglindore të cilët janë më shumë të prekur nga trafikimi i qënieve njerëzore.

Një tjetër mjet për *Bashkëpunim Rajonal* është *Netëork – UNODC*, i koordinuar nga zyra UNODC në Vjenë. Në këtë netëork vëndet e Europës Juglindore përfaqësohen nga një OJF nga cdo shtet (Mali i Zi përfaqësohet nga *MËL*). Netëork – u UNODC organizoi një fushatë informuese që përfshinte prodhimin dhe ndarjen e posterave, fletë - palosjeve dhe videove. Bashkë netëorku dhe fushatat e tij ishin të suksesshme dhe zgjuan interesin e medias.

## Mobilizimi i Burimeve

Në Malin e Zi nuk ka fonde të caktuara nga buxheti i shtetit për aktivitetet anti – trafikim, me përjashtim të punës së shelterave dhe funksionimit të Grupit të vecantë të Policisë. Burimet financiare sigurohen nga OJF – të dhe organizatat e huaja, si OSCE, Fondi Botëror për Gratë dhe Care International.

## IV. Zbatimi i Ligjeve Anti – Trafikim

### Parandalimi dhe Ndërgjegjësimi

Fushatat e Rritjes së Ndërgjegjësimit janë organizuar në Malin e Zi që në vitin 2001, me qëllim sigurimin e informacionit për publikun në lidhje më trafikimin e qënieve njerëzore. Në 2001 – 2002, IOM organizoi fushatën *Ajo mund të jetë vajza jote, motra ose gruaja* dhe në 2003 – 2004 fushatën *Ndihmoni atë*. Në 2004, UNODC organizoi fushatën *Thirrje për ndihmë*. Në 2005 dy fushata të tjera u organizuan, Trafikimi në qenie njerëzore – problem social dhe global për mua, për

ty, për ne dhe *le të ndalim heshtjen*, nga Care International dhe Zyra e OSCE për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)

Këto fushata kanë ngritur nivelin e ndërgjegjësimit rreth trafikimit në Malin e Zi, më tepër nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese (postera, karta, video), ose organizimit të sesioneve publike dhe tavolinave të rrubullakëta.

Për më tepër, kurse trajnimi për parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore janë ngritur në shkolla fillore dhe të mesme në Malin e Zi. Këto kurse u mësuan nga Save the Children, Lobimi i Grave Malazeze, me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore të përfshira në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Policinë dhe Koordinaotrin Kombëtar.

## B. Mbrojtje dhe Ndihmë

### Shelterat Për Viktimat e Trafikimit

Një shelter për viktimat e trafikimit është hapur, në mënyrë që të sigurojë akomodim të sigurt të viktimave deri në riatdhesimin e sigurt të tyre drejt një vendi të tretë. Shelteri u hap nën iniciativën e Qeverisë së Malit të Zi dhe funksionon nën administrimin e Lobit të Grave Malazeze, Ajo kryesisht strehon gra dhe fëmijë që janë viktimat e trafikimit, por në disa raste shelteri ka strehuar burra. Në të tilla raste, gratë dhe fëmijët janë strehuar të ndarë nga burrat.

Shelteri siguron akomodim të përkohshëm, nga dy javë deri në disa muaj, në mënyrë që të ndihmohen viktimat për të kaluar eksperiencën e tyre traumatike. Ajo gjithashtu siguron ushqim, përkujdes mjekësor, mbështetje psikologjike, dhe këshillim ligjor. Aktivistët e MËL i shoqërojnë viktimat në polici, të shoqëruar me eksperte mjekësore, avokatë, psikologë, dhe i mbështesin ata gjatë procesit gjyqësor. Në shelter mbahet një database që përmban informacion mbi profilin e viktimave, kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në shelter, ekperiencat dhe nevojat e tyre.

Në 2004, dhjetë viktimat u akomoduan në shelter; në 2005, 28; dhe në 2006 tre.<sup>96</sup> Në mënyrë që të arrijë qëllimet e veta, dhe duke konsideruar faktin se Netëork – et e Trafikimit janë të fuqishme dhe të mirëorganizuara, Shëlteri punon në bashkëpunim të ngushtë me MËL, Qeverinë e Malit të Zi, Koordinatorin Kombëtar, Minsitrinë e Punëve

të Brëndshme, Drejtësisë, Shëndetësisë, Punës dhe Mbrojtjes Sociale, Edukimit, si dhe IOM dhe OSCE.

Objektivat kryesorë të Shelterit janë përmbledhur si më poshtë:

Të sigurojë një vënd të sigurt për viktimat e trafikimit gjatë qëndrimit të tyre në Malin e Zi dhe gjithashtu pas rikthimit të tyre në vëndin e origjinës

Të sigurojë ndihmë për viktimat në termat e këshillimit shëndetësor, ligjor dhe psikologjik

Mbajtja e një database për viktimat e trafikimit. Informacioni i kalohet policisë

Të asistojë IOM në lëshimin e dokumentave të udhëtimit për riatdhesimin e viktimave

Të zhvillojë bashkëpunim të ngushtë me Koordinatorin Kombëtar, Institucionet Qeveritare, OJF – të dhe Organizatat Ndërkombëtare në mënyrë që të krijojë një netëork të përbashkët për të luftuar trafikimin e qënieve njerëzore

Të forcojë bashkëpunimin midis shelerave rajonale nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës, ose duke organizuar Fushata të përbashkëta të ndërgjegjësimit publik.

Të zhvillojë mekanizmatë për mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet Institucioneve Qeveritare, OJF – ve dhe Organizmave Ndërkombëtare.

Target – grupi i aktiviteteve të shelterit është si më poshtë:

Viktima të trafikimit, gra dhe fëmijë të përfshirë në industrinë e seksit, lypje apo forma të tjera të punës së detyruar.

Shoqëria në tërësi

<sup>96</sup> Në 2004, dhjete viktima u akomoduan, nga te cilat kater gra, kater burra, nje minoren dhe nje femije; ne 2005 nga 28 viktima te akomoduara, 13 ishin gra, 4 burra dhe 11 minorene

### **Koment**

Ndihma psikologjike është gjithashtu e nevojshme për aktivistët që punojnë në shelter . Për të arritur këtë MWL gjithashtu po punon për sigurimin e mbështetjes psikologjike për personelin e saj.

Linja – SOS për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore (2001 – 2006)

Një nga përbërësit më të rëndësishëm dhe të nevojshëm të Programit për Mbrojtje e Viktimave të Trafikimit është linja - Sos kundër trafikimit, që luan një rol të rëndësishëm në fushën e edukimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit.

Linja SOS drejtohet nga OJF MËL. Aktivitetet e linjës SOS përfshijnë si më poshtë:

Linja SOS është e hapur 24 orë në ditë, në mënyrë që të sigurojë gatishmëri të përhershme për viktimat e mundshme dhe qytetarët që përcjellin informacion të rëndësishëm.

Këshillim, informacion dhe alternativa i jepen viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit

Informacion mbi fenomenin e trafikimit i sigurohet qytetarëve Komunikim i qëndrueshëm promovohet ndërmjet institucioneve të rëndësishme: Grupi Special i Policisë, OJF dhe Organizata Ndërkombëtare, në mënyrë që të ofrohet më shumë ndihmë dhe mbështetje për viktimat, dhe të jenë më eficientë në luftën kundër trafikimit.

Aktivitetet koordinohen dhe ekperiencat shkëmbehen me Ojft të tjera në mënyrë që të mblidhet informacion mbi viktimat, trafikuesit dhe vënde të dyshuara ku mund të kryhet trafikimi ose lokalizime të dyshimta ku mund të lindë trafikimi

Informacioni i mbledhur nga linja – SOS është bashkuar në një database

Aktivistët e punës së linjës – SOS punojnë më parandalimin dhe edukimin e target – grupeve, si gratë, të rinjtë, qytetarët, përfaqësuesit e institucioneve nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme dhe iniciativa të tilla si fushata publicitare, ëorkshop, seminare, pyetësore.

Gjatë 2005 linja SOS mori 832 telefonata, mesatarisht dy telefonata në ditë. Pjesa më e madhe e këtyre telefonatave (33%) u kryen gjatë shtatorit, tetorit dhe nëntorit pas realizimit të një fushate mediatike. – Trafikimi në qenie njerëzore – problem social dhe global për mua, për ty, për ne – i cili ishte pjesë i Programit Care International, i organizuar nga MËL, Grupi i grave Stella, Gratë për një të nesërmë më të mirë, Horizonte të Reja, dhe organizata të tjera.

Telefonatat e marra<sup>97</sup> u bënë kryesisht nga njerëz të rinj dhe viktimat si dhe viktimat të mëparshme<sup>98</sup>.

## Denimi

Grupi Special i Policisë u themelua në 2004, dhe ka pesë anëtarë. Në nivel kombëtar ky grup ishte nën – grup në të shtatë qendrat e Sigurisë në Malin e Zi. Detyra e tyre është të kontrollojë dhe të asistojë në aktivitete, duke zbuluar, luftuar dhe shtypur trafikimin. Pasi ata marrin një rast nga Linja – SOS për viktimat e trafikimit, Grupi Special i Policisë ndërmerr një aksion të përshtatshëm për të zgjidhur çështjen. Kur është lokalizuar një viktimë që ka nevojë për akomodim dhe mbrojtje, Grupi Special i Policisë kontakton shelterin dhe e dërgon viktimën atje, ku atij/asaj i sigurohet mbështetje dhe mbrojtje. Në vitet e fundit shumë gjyqe kanë nisur në Malin e Zi, por vetëm katër prtej tyre kanë arritur vendimin përfundimtar.

## V. Praktikant më të Mira

Tre persona nga Mali i Zi dhe një nga Ukraina u dënuan më katërmëdhjetë vjet burgim për trafikimin e qenieve njerëzore, në vecanti ata kanë trafikuar katër burra nga Ukraina për punë të detyruar. Ky është një ndër katër rastet e përfunduara të trafikimit.

Viktimat e mëparshme që ishin akomoduar në shelter, pasi ata janë riatdhesuar, zakonisht informojnë MËL për kushtet e tyre të tanishme. MËL përpiqet të vendosë kontakte me OJF në vëndin e viktimave për



të ndihmuar në procesin e tyre të ri-integrimit, (gjetja e një pune, marrja e trajnimeve etj).

## VI. Mangësitë

Ka pasur shtyrje evidente të gjyqeve që kanë rezultuar me largimin e shumë viktimave nga Mali i Zi pa marrë asnjë dëmshpërblim ose para dënimit të autorëve të Krimit.

Mungesa e Prokurorëve dhe Gjykatësve për rastet e trafikimit

Mungesa e fondeve për aktivitetet kundër trafikimit

Mungesa e mekanizmave sistematikë dhe efektivë të monitorimit

Ka faktorë shtesë, në bazë të të cilëve trafikimi i qenieve njerzore dhe migrimi konsiderohen si dy fenomene të ndryshme; këto janë prezenca të shtrëngimit dhe forcës osë detyrimit me synim shfrytëzimin. Këta faktorë dallues janë shpesh shumë të qartë por të vështirë për tu vërtetuar pa hetim aktiv.

<sup>97</sup> Telefonatat e marra ndahen si me poshte: 62 % (514) telefonata nga qytetaret, vecanerisht te rinjte te cilet ishin te interesuar rreth fenomenit dhe formave te ndryshme te trafikimit; 18 % (149) nga te rinj ose familjare qe kerkonin agjencine ose oferta pune ne internet; 11 % (92) telefonata te kryera nga media ose institucione; 9 % (77) telefonata te kryera nga viktimat (kryesisht nga te afermit e tyre ose qytetare qe denoncuan vendndodhje te dyshimta.

<sup>98</sup> Viktima te meparshme, persona qe jane mbrojtur dhe akomoduar ne shelter, dhe me pas jane rikthyer ne vendin e tyre te origjines zakonisht informojne MËL nepremjet linjes SOS per situaten e tyre aktuale nderkohe qe MËL i referon ata tek OJF ne vendin e tyre te origjines per te gjetur pune ose per te marre edukim ose trajnim shtese

## VII. Vlerësimi i Nevojave

Duke marrë në konsideratë mangësitë dhe komentet që përmbahen në këtë raport dhe nevojën për përmirësimin e situatës, një listë me rekomandimë është hartuar si më poshtë.

## Rekomandime

Ndryshimet Sociale duhen analizuar dhe metoda të reja duhen zhvilluar në mënyrë që shoqëria Malazeze të përparojë, vecanërisht drejt përmirësimit të nivelit të përkujdesjes sociale dhe kujdesit për fëmijët.

Sistemi Ligjor duhet të sigurojë prokurorë dhe gjykatës të vecantë për rastet e trafikimit në mënyrë që ata të bëhen me efikas.

Viktimat e trafikimit duhet të identifikohen në mënyrë eksplicite si viktima të krimit. Atyre duhet tu sigurohet ndihmë pavarësisht statusit të tyre apo statusit të trafikuesit (i arrestuar, i ndjekur penalisht ose i liruar)

Mbrojtje duhet të sigurohet gjithashtu edhe për të afërmit e viktimave. Faktoret që dallojnë trafikimin e qënieve njerëzore nga emigrimi duhet identifikuar në mënyrë të qartë gjatë hetimit të policisë.

\*\*\*\*\*

## Lista e shkurtimeve

ARIADNE	Netëork i OJF – ve kundër trafikimit të qënieve njerëzore në Europën Lindore dhe Juglindore
CARE Internatonal	OJF Ndërkombëtare
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrimin
MËL	OJF Lobimi i Grave Malazeze
ODIHR dhe të Drejtat e Njeriut	Zyra e OSCE për Institucione Demokratike
OSCE Europë	Organizata per Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
PETRA Netëork	Netëork Ballkanik në Nivel Shtetëror
UNODC dhe Krimin	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën
UNICEF Femijët	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Fonde për Femijët
USAID Zhvillim Ndërkombëtar	Agjensia e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar



RUMANIA

Autor

ARCA- Forumi Rumun për Refugjatët dhe Emigrantët

## RUMANIA

### I. Prezantim

Rumania ndodhet në Europën Juglindore dhe kufizohet në perëndim nga Hungaria dhe Serbia, në veri-lindje nga Ukraina dhe Moldavia dhe në jug nga Bullgaria. Rumania ka gjithashtu shtrirje bregdetare në Detin e Zi. Evolucionin social dhe ekonomik i Rumanisë që prej viteve 1990, lehtësoi krijimin e pabarazive shoqërore dhe në mënyrë jodirekte formimin e grupeve vulnerabël. Nga fundi i viteve 1990 dhe fillimi i një dekadës të re, afërsia gjeografike me vatrën e konfliktit, shtetet e ish-Jugosllavisë, solli rritjen e fenomenit të trafikut njerëzor në Rumani. Në nivelin rajonal, kriza e Ballkanit gjatë dekadës së kaluar ka sjellë një rritje të fenomenit. Sipas statistikave ndërkombëtare, Rumania është një vend origjine dhe tranziti për një numër të madh femrash të ardhura kryesisht nga Azia, por gjithashtu nga vendet fqinje, si Ukraina, Moldavia dhe Bjellorusia. Vendet e destinacionit janë vendet e ish-Jugosllavisë veçanërisht Kosova, Turqia, Greqia apo vende të tjera perëndimore. Policia rumune ka identifikuar gjatë këtyre viteve disa rrugë trafikimi. Këto rrugë trafikimi varen nga ligjet e vendeve të destinacionit dhe/ose në strukturën e rrethit të trafikuesve, kontakteve dhe marrëdhënieve të tyre në një rrugë të caktuar. Sipas përvojës së policisë rumune (99), rruga e parë e trafikimit fillon nga Moldavia, përmes Rumanisë dhe Hungarisë, mbërrin në Europën Perëndimore, veçanërisht Francë dhe Gjermani. Rruga e dytë është Beogradi, një qendër e famshme për trafikimin e qënieve njerëzore, duke vazhduar me shtetet e tjera të ish-Jugosllavisë, pastaj Itali dhe Greqi. Rruga e tretë përshkon Bullgarinë dhe shkon drejt Greqisë e Turqisë, ose drejt Maqedonisë apo Shqipërisë. Gjatë dekadës së kaluar trafikimi i qënieve njerëzore u kthye në një problem madhor në nivelin kombëtar dhe atë ndërkombëtar, me përfshirje të thellë sociale dhe ekonomike duke prekur një numër të madh vendesh dhe individësh. Në formën e tij më evidente trafikimi i qënieve njerëzore përfshin shfrytëzimin e femrave dhe fëmijëve në industrinë e seksit, në lypje dhe punë të detyruar. Në formulimin e politikave bashkëkohore për parandalimin dhe luftimin e trafikimit, janë përgatitur statistika nga Inspektoriati i Përgjithshëm i Policisë Rumune. Trafikimit të qënieve njerëzore i shtohen një sërë faktorësh, të cilët rrjedhin fillimisht nga njohuritë e pamjaftueshme

rreth përmasave të vërteta të fenomenit si pasojë e rritjes së lëvizjes së njerëzve dhe mallrave përtej kufinjve. Fakti që, trafiku njerëzor zakonisht ngrihet në kontekstin e veprimtarive të cilat paraqiten si të ligjshme, e bën identifikimin e fenomenit edhe më të errët. Për shembull, agjencitë e ndërmjetësimit të punës, premtojnë punë të ligjshme, por faktikisht viktimat shfrytëzohen në veprimtari të jashtëligjshme. Rumania është një vend origjine dhe tranziti për femrat dhe fëmijët që trafikohen për shfrytëzim seksual.

Femra nga Moldavia, Ukraina dhe Rusia trafikohen përmes Rumanisë për në Itali, Spanjë, Gjermani, Greqi, Francë, Austri dhe Kanada. Ka pasur gjithashtu raportime se djem dhe burra të rinj rumun trafikohen në vende të Europës Lindore për qëllime të shfrytëzimit seksual. Vajzat rumune gjithashtu trafikohen brenda vendit për qëllim shfrytëzimi, ndërsa djemtë trafikohen nga Rumania Lindore dhe Veriore për qëllim shfrytëzimi në punë të detyruar.(100) Pritet që me antarësimin në Bashkimin Europian, Rumania do të bëhet gjithashtu një destinacion i trafikut të qenieve njerëzore, sepse do të tërheqë njerëz nga vendet fqinje më pak të zhvilluara. Prandaj, është e domosdoshme të zhvillojmë një sistem efikas, në gjëndje të përballojë një numër të madh nështetasish të huaj, të cilët do të kenë nevojë për përkrahje dhe riatdhesim. Statistika nga agjencitë kombëtare të përforcimit të ligjeve apo nga Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM) janë jo të plota dhe paraqesin vetëm një pjesë të problemit. Vendet e Europës Juglindore, përfshirë Rumaninë, bëjnë përpjekje për të përmirësuar sistemet e tyre të mbledhjes së të dhënave, në mënyrë që të sigurojnë informacion sa më të mirë rreth politikave të anti-trafikut dhe të lehtësojnë parashtrimin e shkaqeve të shumta socialo-ekonomike të fenomenit.

## II. Struktura Kombëtare Ligjore

### A. Ligji kombëtar

Legjislacioni kombëtar i anti-trafikut erdhi në fuqi mes viteve 2001-2003, duke i mundësuar agjencive për përforcimin e ligjeve të ndërmarrin ndërveprime në mënyrë që të kufizojnë trafikimin dhe të sjellin legjislacionin rumun në një vijë me standartet ndërkombëtare. Ligjet e përshtatura për të luftuar trafikimin e qënieve njerëzore janë si më poshtë:

Ligji 678/2001 mbi parandalimin dhe luftimin e trafikut njerëzor;

G.D 1216/2001 mbi miratimin e një Plani Veprimi Kombëtar

Ligji 682/2002 mbi mbrojtje e dëshmitarit;

Ligji 565/2002 mbi ratifikimin e Konventës së BE kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Protokollet plotësuese,

Ligji 39/2003 mbi parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar,

G.D 299/2003 mbi miratimin e Rregullores së Zbatimit të Ligjit 678/2001,

Ligji 656/2002 kundër pastrimit të parave,

### B. Plani Kombëtar i Veprimit

Drafti i Planit për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të fëmijëve është produkt i një Grupi Ndërministror, duke shfrytëzuar ekspertizën e organizatave me eksperiencë në fushën e trafikimit të fëmijëve, si psh; UNICEF, ILO, IOM, UNDP dhe Save the Children. Grupi Ndërministror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Krimit të Organizuar dhe Lëndëve Narkotike (DGCCOA) mbajti në Mars 2004 disa bisedime rreth draftit të këtij Plani, me pjesëmarrjen e më shumë se 50 specialistëve.



Në pranverë 2001, në ndjekje të nismës së Ministrisë së Brendshme, Punëve të Jashtme dhe Drejtësisë ekspertët e Grupit Ndërministror bënë draftin e Planit Kombëtar të Luftës kundër Trafikut Njerëzor. Plani ishte një përpjekje e përbashkët e Ministrisë së Arsimit, Punës, Rinisë dhe Kulturës. Duke i bashkangjitur një kornizë të paracaktuar, specialistët nga organizata qeveritare, joqeveritare dhe ndërkombëtare përpunuan një formë përfundimtare të Planit, i cili më vonë u përshtat nga vendimet e qeverisë në 2001 (G.D. 1216/2001). Plani përcakton objektiva praktike në tre drejtime strategjike: parandalimin, ndjekjen ligjore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, në përputhje me rekomandimet e përshtatura nga Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore, organizata përgjegjëse për zbatimin e Konventës së BE për Krimin e Organizuar dhe Protokollet e tij Plotësuese. Zhvillimi i një sistemi efikas kundër trafikut njerëzor është një nga kërkesat e domosdoshme që Rumania duhet të përmbushë në procesin e saj të pranimit dhe integritit në Bashkimin Europian. Në përputhje me prirjet ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e trafikut të qënieve njerëzore, Qeveria e Rumanisë e ka bërë këtë një prioritet primar. Në këtë kontekst, Strategjia Kombëtare Kundra Trafikut lidhur ngushtë me Planin Kombëtar të Veprimit për parandalimin dhe luftën e trafikut njerëzor, për periudhën 2006-2007.(101)

---

101 'Strategjia Kombëtare Anti-Trafik 2006-2010', UNICEF-Rumani.

## Komente

Tre vjet pas miratimit të NAP-së u identifikuan avantazhet dhe dizavantazhet e mëposhtme:

Gjatë zbatimit të saj doli qartë angazhimi i qeverisë për të luftuar trafikun njerëzor;

Bën të mundur forcimin e bashkëpunimit mes agjencive dhe shoqërisë civile;

Jep mundësinë e përdorimit të eksperiencës së agjencive përforcuese të ligjit në fushtën parandaluese;

Bën të mundur përmirësimin e bashkëpunimit mes Rumanisë dhe partnerëve të saj ndërkombëtarë;

Ngre detyra për të gjithë komponentët qeveritarë dhe joqeveritarë;

Nuk siguron një buxhet të veçantë, as në nivel qeveritar dhe as në nivel joqeveritar;

Ajo nuk përcakton një kornizë të përhershme për bashkëpunim;

Nuk zhvillon një sistem koordinimi efektiv mes aktorëve të ndyshme të përfshirë;

Disa aktivitete janë përcaktuar në mënyrë shumë të përgjithshme dhe si pasojë është e vështirë të monitorosh realizimin e tyre;

Aktivitetet me qëllim parandalimin dhe mbrojtje e viktimave nuk përcatohen qartësisht, por theksi është vënë tek ndjekja ligjore. (102)

### III. Përshkrim i Përgjithshëm

#### Ngritja e Kapaciteteve

Autoritet Rumune kanë njohur nevojën për trajnime të vazhdueshme kombëtare dhe rajonale, si pjesë të strategjisë së tyre për të parandaluar dhe luftuar trafikun njerëzor. Seanca të rregullta trajnimi organizohen për të gjithë agjentët e përforcimit të ligjit të përfshirë në këtë fushë.

---

102 Raporti Vjetor I Rumanisë, 2003-2004.\_

Trajnimi bazohet në Manualin e Praktikave të Përforcimit të Ligjit në Luftën Kundër Trafikimit Njerëzor në SEE, planifikuar nga UNDP-Rumani dhe e njohur gjerësisht si një standart rajonal në këtë fushë. Dy takime kombëtare në përforcimin e ligjit për nëpunësit që punojnë me rastet e trafikut njerëzor ishin organizuar me mbështjen financiare të FBI, SECI Qendra Rajonale dhe UNDP Rumani. Pothuajse 200 pjesëmarrës, përfshirë oficerët e policisë, policë kufitar, prokurorë dhe nëpunës bashkëpunëtorë të huaj ndoqën këto takime.

#### Komente

Takimet e lartpërmendura ishin një mundësi shumë e mirë për të ndarë eksperiencën dhe praktikën më të mira në këtë fushë, për të harmonizuar dhe hetuar praktikën në rastet e trafikimit njerëzor dhe për të përcaktuar standarde kombëtare.

Të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të, në bashkëpunim me agjencitë qeveritare, zhvilluan programe për seminare trajnimi për agjencitë e përforcimit të ligjit, personel nga shërbimet sociale, mësues, media etj.

#### B. Analizë, kërkim dhe mekanizma monitorues

Ekzistenca e të dhënave statistikore është parësore për analizën, për rastet e trafikut njerëzor, për identifikimin e grupeve në rrezik, si dhe për zhvillimin e një politike të përshtatshme anti-trafikut. Si të gjitha aktivitetet ilegale, trafiku njerëzor ka një fytyrë “të padukshme”, e cila nuk mund të paraqitet në asnjë sistem të dhënash apo analizë. Për më tepër në Rumani ka një mangësi të theksuar në të dhëna. Përgjegjësitë institucionale në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi trafikun njerëzor varen nga:

Qendra e Burimeve pranë Departamentit për Luftën Kundër Krimit të Organizuar, në fushën e ndjekjes ligjore;

Inspektoriati i Përgjithshëm i Policisë Kufitare, si pjesë të detyrave të tij, raporton vetëm rastet e trafikut njerëzor lidhur me emigracionin;

Zyra Kombëtare për parandalimin e Trafikimit të Qënieve Njerëzore e Institutit të Kërkimeve dhe Parandalimit, e cila është riorganizuar, në janar 2006, në Agjencinë Kombëtare të Anti-Trafikut, në fushën e parandalimit dhe asistencës;

Autoriteti Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve, i cili nisi organizimin e një sistemi të dhënash për trafikimin e fëmijëve. Autoriteti

Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve raporton numrin e minoreneëve të pashoqëruar, të cilët riatdhesohen, pa shquar llojin e abuzimit dhe shfrytëzimit, objekt i të cilave kanë qenë ekspozuar;

Të dhënat e *IOM* për viktimat të cilat janë asistuar nga organizata.

Të dhënat ekzistuese mbulojnë kryesisht raste të shfrytëzimit seksual.

Të dhëna, të cilat i përkasin formave të tjera ë trafikimit, si për qëllim shfrytëzimit në punë, apo në organe njerëzore, janë të paqarta dhe të pamjaftueshme për analizë statistikore. Në menyrë të ngjashme, të dhëna që i përkasin trafikut të brendshëm nuk janë regjistruar apo nuk lejojnë bërjen e në analize përkatëse.

Në vitin e parë të aktivitetit, Grupi Ndërmintor ka punuar vazhdimisht për monitorimin e aktiviteteve të agjencive shtetërore në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikut Njerëzor. Megjithëse Grupi Ndërmintor nuk ka fuqi

vendimmarrjeje ndaj organizatave qeveritare e parashikuar nga G.D.

1216/2001, anëtarët e tij kanë ngritur një forum, ku çështje të rëndësishme të luftës kundër trafikut njerëzor diskutohen hapur.

Forumi është gjithashtu një vegël e rëndësishme për të monitoruar zbatimin e Planit si dhe lehtësimin e punës së tij.

#### *Komente*

Qeveria e Rumanisë nuk përmbush plotësisht standartet minimale ndërkombëtare për eliminimin e trafikut. Megjithëse, ajo bën përpjekje të shumta për t'i arritur këto standarte. Rumania ka rritur përforcimet ligjore të luftës kundër trafikut dhe ka hedhur hapa drejt përmirësimit të koordinimit qeveritar, duke krijuar Agjencinë Kombëtare për Parandalimin e Trafikut në 2005 ajo do të financohet nga buxheti kombëtar dhe do të ketë autoritetin për të drejtuar agjenci të tjera, në marrjen e iniciativave të anti-trafikut.

Shumica e institucioneve të kësaj fushe kanë nisur vetëm së fundmi të mbledhin të dhëna për *ROMANIA 175 lect data*. Rrjedhimisht, të dhënat ekzistuese nuk lejojnë një analizë dinamike të fenomenit.

Të dhënat e vlefshme nuk janë të matshme dhe nuk janë të vazhdueshme. Arsyeja është se të dhënat nuk janë të përqëndruara në një database të vetëm, i cili të jetë i lirë për të hedhur të dhënat të gjitha organizatat kompetente, qeveritare dhe joqeveritare. Megjithëse çdo institucion duhet të mbledh të dhëna veçmas në mënyrë që të monitorojë aktivitetin e saj, unifikimi është absolutisht i domosdoshëm nga këndvështrimi i metodologjisë së përdorur. Kjo metodologji duhet të jetë në të njëjtën linjë

me përcaktimet ndërkombëtare, e cila do të bëjë të mundur një analizë krahasuese në një shkallë ndërkombëtare. (103)

Për shëmbull, për së i përket trafikimit të fëmijëve, ka disa burime institucionale të të dhënave - GIBP, DOCC, NAPRC dhe NOPT – secila prej tyre përdor metoda të ndryshme të ruatjes së të dhënave dhe metodave të raportimit të tyre.

Policia Kufitare koleksionon dhe raporton të dhëna për të miturit e riadhesuar.

NAPRC raporton të dhëna për të miturit e riadhesuar. Të dhënat regjistrohen nga autoritetet sipas lajmërimeve.

Qendra Burimore, operon me DOCC, raporton të dhëna të cilat regjistrohen nga policia, rreth fëmijëve viktimë.

NOPT siguron të dhëna që i përkasin fëmijëve viktimë, të cilët kanë marrë çfarëdo lloj përkrahjeje.

The DOCC Qendra Burimore ka filluar punë në vitin 2004 për zhvillimin e një sistemi të dhënash për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore, përfshirë abuzimin seksual, në punë, lypjen dhe forma të tjera të trafikimit. Për një person, që të raportohet si viktimë duhet të përmbushë së paku një nga kushtet e mëposhtme: të ketë dorëzuar një deklaratë apo ankesë pranë një trupi gjyqsor, ku ai/ajo deklaron të ketë qenë pjesë e lënduar e një trafikimi; të jetë i siguruar nga hetimet e policisë që ai/ajo ka qenë viktimë e trafikimit; të jetë gjendur gjatë një aksioni policor

Monitorimi nuk është i mundur në çdo sferë të veprimtarisë së anti-trafikut, veçanërisht për sa i përket asistencës së viktimës. Viktimat e trafikut njerëzor janë të regjistruara si ‘raste sociale’ në mënyrë që të kenë akses në programet sociale të ri-integrimit (shkollim, punësim), apo të përfitojnë shërbime të kujdesit shëndetësor. Në kushte të tilla nuk është e mundur të përcaktohet numri/proporcioni i viktimave të trafikut njerëzor të cilët kanë marrë ndihmë.

Mungesa e një sistemi të unifikuar identifikimi të viktimave dhe mungesës së procedurave të qarta të bashkëpunimit ndër-institucional lidhur me mbledhjen, shkëmbimin dhe aksesit të të dhënave, ul ndjeshëm mundësinë e sistemit për të prodhuar statistika dhe analizë rasti, të cilat duhet të dretojnë politikën dhe veprimtarinë e anti-trafikut.

---

103 Strategjia Kombëtare Antitrafikimit 2006 – 2010<sup>9</sup>, UNICEF Rumania.

C. Bashkëpunimi dhe rrjetet në një nivel rajonal dhe kombëtar  
Nisma të ndryshme në rrjet janë zhvilluar lidhur me forma të ndryshme të trafikimit, me bashkëpunimin e aktorëve të ndryshëm: organizata ndërkombëtare, OJF dhe institucione qeveritare me aktivitete të përbashkëta rreth parandalimit, asistencës së viktimave dhe ndjekjes ligjore. Rrjeti i IOM është një shëmbull i mirë i zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta në ndihmë të viktimave.

#### D. Rekrutimi i burimeve

Financimi i veprimtarive të anti-trafikut sigurohet nga buxheti i ministrive përkatëse. Gjithsesi, aktualisht, kostoja e llogaritur për veprimtaritë e anti-trafikut nuk është bërë akoma e vlefshme nga ministritë që përfshihen në këtë çështje (Ministria e Administrimit dhe Punëve Publike, Ministria e Drejtësisë). Fushatat e parandalimit janë zhvilluar në partneritet me institucionet publike dhe organizata nga shoqëria civile, organizata ndërkombëtare dhe media. As këto kosto nuk janë mbuluar. Në fushën e zhvillimit institucional dhe përkrahjes së viktimave, shumica e burimeve financiare që shkojnë për veprimtari të anti-trafikut vijnë nga organizata ndërkombëtare.

Përsa i përket asistencës së viktimave, ministritë përkatëse – Ministria e Shëndetësisë, Punës Çështjeve Sociale dhe Familjës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës – nuk publikojnë kosto të tilla. Vetëm Departamenti i Përgjithshëm i Asistencës Sociale dhe Mbrojtjes së Fëmijëve bën të mundur vlerësimin e burimeve të tyre financiare, të cilat shkojnë drejt përkrahjes së viktimave të trafikimit. (104)

Përsa i përket ri-atdhesimit të nënshtetasve rumun, të cilët bien viktima të trafikimit njerëzor, Ministria e Punëve të Jashtme dhe misionet diplomatike në Rumani nuk marrin fonde nga buxheti i shtetit për t'i siguruar përkrahje viktimave. Kohët e fundit, sistemi mbështetet në donatorët vendas (në vendet e destinacionit) ose organizatat ndërkombëtare për të financuar ri-atdhesimin e viktimave, ose siguron forma të tjera asistence si financimi për ri-integrimin e viktimave.

## Komente

Nuk është e mundur të bëhet një analizë për buxhetin që shkon për veprimtaritë antitrafikuese, apo për burimet financiare përfshirë në Planin Kombëtar të Veprimit 2006-2007.

Menjëherë pasi Rumania të bëhet anëtare e Bashkimit Europian, pritet që burimet ndërkombëtare financiare do të pakësohen ndjeshëm. Për këtë arsye është jetësore të identifikohen burime të reja financimi. Për periudhën 2006-2007, për Rumaninë bëhet një prioritet kryesor zhvillimi në nivelin e brendshëm, i një sistemi identifikues të viktimave rumune dhe të huaja, të cilat do të jenë objekt asistence dhe riatdhesimi. (105)

---

104 Buxheti i qendrave publike për asistencën e viktimave është konsideruar nga menaxheret e tyre si “i pamjaftueshëm”

105 Strategjia Kombëtare Antitrafikimit 2006 – 2010’, UNICEF Rumania.

#### IV. Zbatimi i Ligjeve të Anti-Trafikut

##### A. Parandalimi dhe ndërgjegjësimi

Në periudhën 2001-2005, fushatat parandaluese zhvilloheshin nga institucionet shtetërore në partneritet me organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare dhe medias. Studimet e përfaqësuesve mbi popullsinë në moshë të rritur në Rumani, tregojnë se pjesa dërrmuese e shoqërisë (85%) ka dëgjuar për fenomenin e trafikimit të qënieve njerëzore. Nën koordinimin e Institutit Kërkimor të Krimeve dhe Parandalimit (ICRP), në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare për Parandalim të Trafikut të Qënieve Njerëzore (NOPT), 42 divizione për parandalimin e trafikut njerëzor janë ngritur në nivel të Inspektoriatit të Policisë së Vendit(CPI). Këto divizione mbartin informacion dhe bëjnë fushata ndërgjegjësuese, në bashkëpunim me policinë dhe përfaqësues të OJF-ve. Megjithatë, në mungesë të burimeve vetjake të financimit zbatimi i veprimtarisë parandaluese të trafikut njerëzor ishte objekt i këtyre dy kushteve: ekzistenca aktive e OJF-ve në këtë fushë dhe prioritetet financuese të sponsorve. Më shumë se 3 000 studentë morën pjesë në seminarët ndërgjegjësuese dhe orë të hapura në shkolla publike të organizuara nga OJF dhe qeveria në vitin 2005. Qeveria financoi një program në nivel kombëtar fokusuar në trafikimin e fëmijëve. Nëpër shkolla u shpërndanë postera, baner si dhe materiale të tjera me temë Anti-trafikun.

#### Koment

Fushatat e informimit publik kanë rezultuar të suksesshme. Megjithëse, në mungesë të një sistemi koordinimi, këto aktivitete parandaluese kanë mbuluar territorin e vendit në mënyrë të ç'rregullt. Për shembull, pjesa Jugore e vendit, e cila përfaqëson edhe burimin kryesor të viktimave të trafikimit, nuk gëzon burimin njerëzor dhe financiar njëkohësisht, të cilat janë të domosdoshme për aktivitetet parandaluese.



## B. Mbrojtja dhe Përkrahja

Në janar 2006, shtatë streha asistence për viktimat në të rritur të trafikut njerëzor u përcaktuar nga Ligji 678/2001. Dy qendra të tjera janë në procesin e kthimit në funksionale në pjesën jugore të Rumanisë. Nën Programin e Interesit Kombëtar –Ligji 415/2004, dymbëdhjetë Qendra Tranziti për fëmijët viktime të trafikut u hapën. Për më tepër, që nga janari 2006, ekziston gjithashtu një strehë për femrat e riatdhesuara, viktime të trafikut, të vendosura në bazë të Marrëveshjes mes Qeverisë së Rumanisë dhe IOM (G.D. 1226/2001). Tre qendra të tjera drejtohen nga këto OJF: ADPARE në Bukuresht. Këto qendra sigurojnë shërbim asistence afatgjatë.

### Koment

Përgjithësisht, OJF-të ofrojnë shërbime përkrahjeje afatgjata, ndërsa strehëzat shtetërore janë të ngritura në raste urgjence. Megjithatë, në rastet kur viktimat janë fëmijë disa qendra publike ofrojnë shërbime me afat të gjatë, ashtu si shërbime me afat të mesëm apo të shkurtër, në bazë të një plani riintegrimi individual.

Harta e qendrave të ndihmës për viktimat e trafikut në Rumani (106)



Qendrat Publike të vendosura në përputhje me Ligjin 678/2001 dhe PNI 415

Rezidenca qe ofrojnë shërbime afatgjata (OJF)

Shërbime Ditore (OJF)

## Komente

Viktimave ju ofrohet ndihmë mjeksore, ligjore dhe sociale, megjithëse cilësia e përkujdesjes së ofruar ndyshon në strehët e drejtuara nga shteti.

Problemet e financimit kanë bërë që disa strehë të mbyllen dhe të rihapen.

Qendrat që drejtohen nga shteti janë të projektuara kryesisht për një afat të shkurtër; viktimat lejohen të qëndrojnë në qendër për 10 ditë, megjithëse ky afat mund të shtyhet lehtësisht deri në tre muaj për të rriturit dhe gjashtë muaj për fëmijët, në raste të veçanta, më shumë se tre muaj për të rriturit bazuar në kërkesën e zyrtarëve ligjor.

Policia dhe prokurorët janë të detyruar të informojnë viktimat për të drejtën e tyre për të vizituar një strehë shtetërore, por faktikisht, shumë viktimat nuk e kanë përdorur këtë të drejtë për shkak të periudhës së shkurtër në të cilat përkrahja ofrohet si dhe për shkak të mungesës së besimit në institucionet dhe procedurat shtetërore.

Vetëm 29 nga 175 viktimat përkrahur nga qeveria përdorën strehët shtetërore. Pjesa më e madhe e viktimave preferonin qendrat e drejtuara nga OJQ-të ku edhe niveli i përkujdesjes së ofruar është më i lartë. OJQ-të kanë marrë disa fonde për përkrahjen e viktimave nga qeveria lokale.

Mbështetja e përgjithshme ka qenë jo e vazhdueshme dhe shpesh e papërshtatshme. (107)

### C. Ndjekja ligjore

Në fushën e ndjekjes ligjore, janë të përfshira institucionet e mëposhtme:

MAIA – Ministria e Administrimit dhe Punëve të Brendshme;

DOCC – Departamenti i Luftës kundër Krimit të Organizuar, përmes qendrave rajonale të saj, apo gjithashtu përmes shërbimeve në varësi të Inspektoriatit të Policisë së Vendit (CIP);

Qendra Burimore, një strukturë me qëllim mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të marra nga të gjitha agjencitë dhe institucionet e përfshira në luftën kundër trafikut njerëzor;

GIBP – Inspektoriat i përgjithshëm i Policisë, përmes strukturave të tij territoriale (shërbimesh dhe zyrash) e specializuar në trafikun njerëzor;

MPA – Ministria e Punëve Publike;

DIOCT – Departamenti i Investigimit Sulmeve, Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit;

MJ – Ministria e Drejtësisë;

Rrjeti Kombëtar i Drejtësisë (përbëhet nga 56 gjykatës), u vendos më 02.07.2004, i specializuar në rastet e trafikut njerëzor;

Organizatata bashkëvepruese rajonale dhe përtej kufirit si:SECI;

#### Komente

Qeveria Rumune ka përmirësuar ndjeshëm përpjekjet për përforcimin e ligjit kundër krimeve dhe trafikimit gjatë vitit të fundit. Në vitin 2005, policia Rumune drejtoi 231 hetime; 124 raste trafikimi u ndoqën ligjërisht, të cilat rezultuan me dënimin 235 trafikantëve. Kjo do të thotë më shumë se ka 100 përqind rritje nga viti i kaluar (103 trafikant të dënuar në vitin 2004). Nga 235 trafikant të dënuar në vitin 2005, 128 u dënuan me burgim, ndërsa 98 nuk morën dënim me burgim. 64 trafikant u dënuan nga 1 deri në 5 vite burgim ndërsa 64 të tjerë u dënuan nga 5 deri në 10 vite burgim. (108)

Studim rasti

‘Ana’

Kushtet para trafikimit

Ana u rrit në një institucion shtetëror dhe në moshën 14 vjeçare u bashkua me familjen e saj. Mamaja e saj ishte e sëmurë rëndë dhe i ati i alkolizuar dhe agresiv. E motra ishte e sëmurë mendore ndërsa vëllai i alkolizuar. Në moshë 16 vjeç Ana vendos të martohet. Burri i saj ishte i alkolizuar dhe shumë agresiv dhe pak pas martesës, Ana bëhet një viktimë e dhunës në familje. Në moshën 20 vjeçare, pa ushqim, pa mbështetje emocionale nga familja e saj dhe pasi kishte pësuar dhunë vazhdimisht, Ana vrapon nga shtëpia e bashkëshortit të saj tek një komshi.

Rekrutimi për trafikim

Pas dy javësh në shtëpinë e fqinjëve (shoqe e saj, nëpunëse në një institucion shtetëror), një burrë Rumun vjen dhe i propozon Anës të shkojë në Greqi për tre muaj si pastruese në restorante. Burri i premton se do të hapë një llogari bankare në Rumani për të, kështu ajo të mund ti dërgojë para vajës së saj. Ajo i kërkoi një muaj kohë për tu menduar; por ai e shtyu ti jepte kartën e identitetit me qëllim përgatitjen e pasaportës për të.

Transporti

Pas një jave, burri kërkoi t’ a çonte me makinë në stacionin e policisë për të marrë pasaportën e saj të re. Por, në fakt ata u drejtuan direkt për në kufirin serb, të cilin e kaluan ilegalisht. Në Serbi Ana kuptoi se ishin në një vend tjetër sepse tabelat rrugore kishin emra ndryshe. Kur ajo pyeti burrin, e vetmja përgjigje që mori ishte se ajo ishte shitur.

Shfrytëzimi

Nga ‘shitja’ e parë Ana u shit përsëri tek një pronar klubi seksi serb. Ai i tha asaj që ajo kishte një borxh të madh për të paguar prandaj ajo ishte e detyruar të puonte për të gjashtë muaj. Pas kësaj periudhe ajo do të ishte e lirë të ikte. Gjatë natës së saj të parë në klub, Ana u përdhunua nga një klient pasi ajo refuzoi t’ i ofronte atij shërbime seksi. Pasi ajo refuzoi të bashkëpunonte pranari i klubit e shiti tek një tjetër pronar klubi pas një muaji.

Që nga ajo kohë, Ana u shit më shumë se dhjetë herë në Serbi dhe Maqedoni. Kjo zgjati për një periudhë më shumë se dy vjet, gjatë së cilës Ana u detyrua të ofronte shërbime seksuale, të pastronte lokale, të pinte, të zbaviste klientët në disa raste të bënte dhe striptiz. Gjatë këtyre dy viteve ajo u kthye në një alkolistë dhe mbijetoi vetëm sepse donte të shihte përsëri të bijën.

Ajo arriti të arratisë me sukses nga një klub në Maqedoni, por në kufi policët e rrahën dhe e rishitën.

Arratisja

Gjatë një operacioni policie, pronari i një klubi në Maqedoni fsheh viktimat në një shtëpi private, por Ana arriti të arratiset me sukses me ndihmën e një klienti. Klienti e ndihmoi atë të kalonte kufirin në Kosovë dhe e informoi atë ku ndodhej konsullata rumune. Nga atje ajo u dërgua në një strehë të IOM në Prishtinë, ku ajo mori përkrahje për një muaj.

Riatdhesimi

Ana u shoqërua në kufi dhe u ri-atdhesua nga sektori rumun i IOM dhe pastaj u bë pjesë e një programi përkrahjeje në Prill 2003.

Përkrahja për ri-integrimin

Përkrahja për kalimin e krizës

Pasi viktimat u ri-atdhesua, veprimi i parë ishte ndihma për të bashkuar atë me të bijën. Kur ajo vizitoi familjen e saj ajo gjeti një situatë jo të mirë: e bija ishte dërguar në një institucion shtetëror dhe familja e saj kishte një sërë borxhesh financiare, përfshirë faturat e elektricitetit, ujit, etj, rrjedhimisht shtëpia ishte pa drita, pa ujë, pa ngrohje, etj). E vënë përballë një situatë të tillë, Ana kërkoi të pranohej në strehë. Ana mori strehim në strehën e IOM-it për tetë muaj, ku iu dha ndihmë mjeksore dhe shkollim për të zhvilluar tek ajo aftësi të një jete të pavarur. Gjatë kësaj periudhe ajo u përkrah në të gjitha format nga ADPARE, duke filluar që nga ndihma për të përdorur dokumente të reja identifikimi, mbështetje psikologjike, mbështetje ligjore, përkujdesje mjeksore dhe shkollim, kurse kualifikimi, etc.

Rezultati: Gjatë këtyre tetë muajve Ana u divorcua me ish burrin e saj, hoqi dolë nga alkoli, mbaroi një kurs kualifikimi në parukeri dhe filloi punën në një salon bukurie. Ky ishte një përmirësim i ndjeshëm duke pasur parasysh që kur Ana erdhi në strehë ajo vuante nga stresi post-traumatik (socio-fobi, vlerësim të ulët të vetes dhe mungesë besimi tek të tjerët, probleme me kujtesën, makthe të përsëritura).

Përkrahja me afat të gjatë

Pas kësaj periudhe përkrahjeje, Ana u vendos në programin afat-gjatë të ADPARE.

Metoda e përkrahjes ishte Menaxhim Rasti. Ana përfitoi nga strehimi, një apartament veçmas dhe ishte në gjendje të gjente një vend tjetër punë me pagë më të lartë (në një fabrikë çokollatash). Ana mësoi të menaxhonte paratë e saj dhe gradualisht u bë më e pavarur. Ajo gjithashtu fitoi përsëri kujdesin për vajzën e saj dhe tani ato jetojnë bashkë.

Ajo vazhdon të bëjë terapi dhe të përkrahet me qëllim riintegrimin e saj të plotë.

## VI. Mangësitë

Qeveria e Rumanisë nuk i përmbush plotësisht standartet minimale për eliminimin e trafikut.

Statistikat ekzisuese, të siguruara nga agjencitë përforcuese të ligjit ose nga IOM janë jo të plota.

## VII. NEVOJA PËR VLERËSIM

Duke marrë parasysh mangësitë dhe komentet që përmban ky raport si dhe nevojën për një përmirësim të situatës, poshtë është një listë me rekomandime:

### REKOMANDIME(109)

1. Në këndvështrimin pranimit të Rumanisë në BE, është e rëndësishme të zhvillohet një sistem efikas, i cili do përballojë numrin e lartë të shtetasve të huaj të trafikuar në Rumani nga vende të tjera fqinje më të varfra, të cilët do të kenë nevojë për përkrahje dhe riatdhesim.
2. Rumania duhet të përmirësojë mënyrat e identifikimit të viktimave dhe të krijojë një sistem funksional referimi të viktimave.
3. Qeveria duhet të punojë më afër me OJQ-të e anti-trafikut dhe t'i sigurojë atyre fonde të nevojitshme.
4. Policia duhet të informojë viktimat rreth shërbimeve që këto OJQ ofrojnë. Meqënëse shumë viktimat të trafikut zgjedhin të mos shkojnë në strehë shtetërore, qeveria duhet të zhvillojë strategji të reja që t'i ofrojnë viktimave përkrahjen e nevojitur.
5. Qeveria nuk duhet të penalizojë në asnjë mënyrë viktimat e trafikut.

---

109 Departamenti i Shtetit Amerikan *Raporti Vjetor i Trafikut të Qënieve Njerëzore*, lëshuar më 05.06.2006.

## LISTA E SHKURTIMEVE

CPI Instektoriati i Policisë së Vendit  
DGCCOA Drejtoria e Përgjithshme e Luftës Kundër Krimit të Organizuar dhe Lëndëve Narkotike  
DIOCT Departamenti i Investigimit të Sulmeve, Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit  
DOCC Departmenti i Luftës Kundër Krimit të Organizuar  
FBI Zyra Federale e Hetimeve  
GIBP Inspektoriati i Përgjithshëm i Policisë Kufitare  
ICRP Instituti Kërkimor i Krimeve dhe Parandalimit  
ILO Organizata Ndërkombëtare e Punës  
IOM Organizata Ndërkombëtare e Migrimit  
MAIA Ministria e Administrimit dhe Punëve të Brendshme  
MJ Ministria e Drejtësisë  
MPA Ministria e Punëve Publike  
NATA Agjencia Kombëtare e Anti-Trafikut  
NAP Plani Kombëtar i Veprimit  
NAPRC Autoriteti Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve  
NATS Strategjia Kombëtare e Anti-Trafikut  
NOPT Zyra Komëtare për Parandalimin e Trafikut të Qënieve Njerëzore  
SECI Iniciativa Bashkëpunuese e Europës Juglindore  
UNDP Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara  
UNICEF Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara



## SERBIA

Autor

Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve

Komiteti ligjor për të drejtat e njeriut - YUCOM

## SERBIA<sup>16</sup>

Parathënie

Serbia është e vendosur në Evropën Juglindore dhe kufizohet nga Shqipëria, BiH, Bullgaria, Hungaria, Kroacia, FYROM, Rumania dhe Mali i Zi. Trafikimi i qenieve njerëzore është një problem serioz dhe kompleks në Serbi. Është e vështirë për të përcaktuar ekzaktësisht karakteristikat e këtij fenomeni sepse është një numër shumë i vogël i viktimave të trafikimit që i janë drejtuar për ndihmë organeve të policisë apo organizatave që mbrojnë viktimat e trafikimit. Përderisa nuk ekziston një sistem unik i monitorimit dhe analizimit janë shifra të ndryshme të ofruara nga burime të ndryshme qeveritare, jo-qeveritare dhe organizma ndërkombëtare. Mbledhja e të dhënave të mundshme

---

<sup>16</sup> Kur kjo punë kërkimore filloi Serbia ishte një nga anëtarët e Unionit Shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi (S&M). Bazuar në Kartën Kushtetuese dhe Kartën e të Drejtave të Njeriut dhe të të Drejtave dhe Lirive civile të Minoriteteve (më tej Karta e D.NJ), e cila është adoptuar në vitin 2003, zbatuar në S&M dhe parashikon në mënyrë më të qartë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Megjithatë papajtueshmëria e kushtetutave individuale të dy shteteve përbërëse të Unionit vazhdon që të përbëjë problem të rëndë në garantimin e të drejtave të garantuara nga Karta D.NJ. Mirë po Karta D.NJ parashikon se ajo është automatikisht e zbatueshme, kështu që në një farë mase problemi i papajtueshmërisë i përmendur më lartë zgjatet në kohë për shkak të ndryshimeve në Kushtetutën e re, veçanërisht të Serbisë, nga kjo rezulton një ngadalësi dhe inefficence në harmonizimin e s legjislacionit të shteteve anëtare me standardet ndërkombëtare. Kushtetuta aktuale e cila është garantuar dhe miratuar gjatë regjimit të Milosheviçit, është e përshtatshme për një regjim totalitar diktatorial dhe jo për një regjim demokratik siç është aktualisht Serbia. Megjithatë Serbia është në procesin e draftimit të një kushtetute të re e cila aspiron standarde demokratike dhe parimeve të një shoqërie civile. Fatmirësisht kushtetuta e re do të parashikojë bazat dhe mekanizmin për një respektim të plotë të lirive dhe të drejtave të njeriut.

për sa i përket trafikimit e grave, fëmijëve dhe burrave janë sporadike dhe të pamjaftueshme për të arritur në një konkluzion të përgjithshëm. Serbia është më së shumti një vend transit, origjine dhe qëndrimi të përkohshëm ose të përhershëm, për viktimat e trafikimit, kjo varet nëse viktima është grua, fëmijë ose burrë.

Për sa i përket viktimave femra, Serbia është vend transit, origjine dhe qëndrimi të përkohshëm ose të përhershëm, si edhe vend i trafikimit të brendshëm më së shumti për femrat serbe. Shumë prej viktimave janë qytetarë të huaj, zakonisht prej Rumanisë, Rusisë, Ukrainës, Moldavisë dhe Serbisë. Rrugët më të zakonshme të trafikimit të femrave fillojnë nga vendet e ish-Bashkimit Sovjetik (Ukraina dhe Moldavia), lëvizin nëpërmjet Rumanisë, Bullgarisë e ndonjëherë edhe nga Hungaria dhe përfundon në S&M. Viktimat hyjnë në Serbi në rrugë legale ose ilegale, zakonisht në këmbë ose mjetet të tjera transporti. Rrjeti i trafikimit shtrihet në Serbi, nga jugu në veri (Kosova dhe FYROM, ose Mali i Zi, Itali dhe Shqipëri), nga lindja në perëndim (Republika Srpska dhe Kroacia) ose në veri (Hungari). Beogradi është destinacioni më i shpeshtë i këtyre viktimave. Gratë serbë janë viktima si të trafikimit të brendshëm dhe të atij ndërkombëtar, zakonisht përfundojnë në BiH, FYROM dhe Itali. Zakonisht trafikimi i brendshëm (Serbë dhe të huaj), kalon nëpër të njëjtën rrugë të përdorur për trafikun ndërkombëtar. Lidhjet më të fuqishme në këtë aspekt janë qytetet e mëdha veçanërisht Beogradi dhe Novi Sadi, si edhe qytetet që ndodhen afër kufirit si Novi Pazar i cili është klasifikuar si një vend destinacioni të përkohshëm dhe të përhershëm më së shumti për gratë serbe.

Për sa i përket viktimave meshkuj Serbia është më së shumti një vend transit, megjithatë ka disa dyshime që është edhe vend origjine. Bazuar në studimin kryer nga një OJF *Shoqata Serbe e Viktimologjisë*, shtetas kinezë ose nga vende të Europës Lindore shpesh përdore si punëtorë të paligjshëm. Megjithatë të dhënat e disponueshme nuk japin një informacion të plotë nëse kemi të bëjmë apo jo me raste të trafikimit.

Për sa i përket trafikimit të fëmijëve Serbia është vend i origjinës (veçanërisht nga komuniteti rom), gjithashtu edhe vend transit ose i qëndrimit të përkohshëm për vajzat e mitura, të cilat së bashku me femra të rritura, janë përfshirë në kanalet ndërkombëtare të trafikimit për shfrytëzim seksual. Ekziston gjithashtu edhe një rrjet i brendshëm trafikimi kryesisht për fëmijë të kombësisë serbe. Viktimat zakonisht vijnë prej qyteteve të vogla me destinacion Beogradin, Novi Sadin dhe

Nishin. Trafikimi i fëmijëve në Serbi supozohet që të jetë një nga format më të rrezikshme të krimit të organizuar. Viktimat janë zakonisht vajza të reja të kombësisë serbe, me origjinë rome ose jo-rome. Gjithashtu edhe shtetas të huaj të përfshirë në trafikun ndërkombëtar.

Bazuar në të dhënat e organizatave dhe agjencive vendase dhe të huaja trafikimi i fëmijëve (veçanërisht fëmijëve rom) ka tendencë që të rritet. Trafikimi i brendshëm gjithashtu është rritur. Bazuar në të dhënat e OJF-së *ASTRA*, 70% e viktimave janë të kombësisë serbe, 44% e të cilëve janë fëmijë. Gjithashtu raporti i fundit i Departamentit të Shtetit vëren se Serbia nuk shënuar progres në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Megjithatë legjislacioni serb ka shënuar progres përgjatë vitit 2005. P.sh ligji i ri përfshin disa të drejta bazë ndërkombëtare dhe standarde Europiane. Megjithatë zbatimi i ligjit vazhdon të mbetet problematik, mungesa e zbatimit të ligjit pengon gëzimin dhe garantimin e të drejtave. Administrata dhe sistemi gjyqësor në Serbi zbaton normat ndërkombëtare vetëm në raste sporadike, pjesërisht për faktin se për shumë kohë është zbatuar vetëm ligji i brendshëm dhe pjesërisht se ata nuk janë njohur me traktatet ndërkombëtare në të cilat bëjnë pjesë Serbia dhe Mali i Zi.

Një pikë e rëndësishme për tu marrë në konsideratë kur lexojmë këtë raport është adoptimi i ligjeve të reja në Serbi: Kodi Penal, i cili hyn në fuqi në 01.01.2006, Ligji “Për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve pjesëmarrës në proceset penale”, i cili hyn në fuqi në 01.01.2006 dhe “Kodi i Procedurës Penale” i cili hyn në fuqi në 01.06.2007. Miratimi i vonë i këtyre akteve ligjore do të thotë që faktet e tabelat e paraqitura në këtë raport bazohen më së shumti në parashikimet ligjore dhe praktikave të zbatuara në bazë të legjislacionit të mëparshëm. Megjithatë në këtë raport është përfshirë edhe një analizë e kuadrit të ri ligjor. Një pikë tjetër që duhet patur parasysh është se pas Referendumit të vitit 2006 në Malin e Zi, Unioni Shtetëror Serbi dhe Mali i Zi pushoi së ekzistuari. Kjo ngre shumë pyetje për sa i përket garantimit të të drejtave të parashikuara në Kartën Kushtetuese dhe Kartën e të Drejtave dhe Lirive Civile të Njeriut dhe të Minoriteteve.

OJF-të aktive në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore mendojnë se pengesa më e madhe në luftën kundër trafikimit lidhet me sistemin gjyqësor. Ndonëse në vitet e fundit sistemi policor ka shënuar progres në këtë drejtim, sistemi gjyqësor mbetet i dobët në luftën

kundër trafikimit sepse ai ka dështuar në zbatimin e efektshëm të legjislacionit aktual.

## Komente

Kuadri ligjor ekzistues i paraqitur, pavarësisht nga disa parashikime, nuk është i plotë për të garantuar mbrojtje të plotë dhe eficiente të të drejtave dhe lirive të qytetarëve. Sistemi shtetëror serb vuan nga veprime te pafuqishme, në një numër të konsiderueshëm të institucioneve të cilat nuk funksionojnë normalisht dhe kanë dështuar në forcimin e ligjit.

Ndonëse në vitet e fundit sistemi policor ka shënuar progres në këtë drejtim, sistemi gjyqësor akoma mbetet i dobët në zbatimin e legjislacionit anti-trafikim. Puna për të ndihmuar viktimat e trafikut dhe ndërgjegjësimi i publikut është ndërmarrë vetëm nga OJF-të

## II. Kuadri i Brendshëm Ligjor

### Karakteristikat e sistemit të brendshëm ligjor

Ky seksion paraqet karakteristikat e sistemit të brendshëm ligjor i cili ndikon në gëzimin e të drejtave të njeriut në tërësi, por gjithashtu edhe në mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe ndëshkimin e autorëve. Në 2005 Serbia miratoi Kodin e Ri Penal dhe Civil dhe forcoi atë Procedural, por disa prej këtyre ndryshimeve do të hyjnë në fuqi në vitin 2006. Kodi Penal Serb është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare, megjithatë ai i shmanget në të dënimeve të trafikut të qenieve njerëzore, kontrabandës njerëzore dhe punës së detyruar. Ai gjithashtu ka reduktuar dënimet, ka ulur marzhin e dënimit për disa krime të rënda, përfshirë trafikun e qenieve njerëzore, diçka që ngre mjaft pikëpyetje në këndvështrimin e skllavërisë moderne dhe në faktin se Serbia ka një ndjeshmëri të madhe për sa i përket trafikut të qenieve njerëzore dhe kontrabandës. Veç kësaj Kodi penal ul ndjeshëm dënimet penale për disa vepra të tjera penale sidomos heqja e paligjshme e lirisë dhe dhënie e dëshmisë me dhunë. Kjo është në interes të praktikës gjyqësore për të dhënë dënime të lehta ose për të pezulluar vendimet në çështje penale.

## Komente

Karakteristika e përgjithshme e legjislacionit të brendshëm është se nuk përcakton masa ligjore kundër procedurave gjyqësore të

stërzgjatura<sup>17</sup>, dhe kjo çon në rritjen e mosbesimit ndaj sistemit gjyqësor<sup>18</sup>

Legjislacioni anti-trafik

Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë vitet e mëparshme për të ndryshuar politikat penale në lidhje me veprat e rënda penale.

Vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore është përfshirë në legjislacionin serb nga Ligji Penal aktual në nenin 111/a. Përkufizimi i përdorur në këtë ligj është ai i përcaktuar në Protokollin e Palermos.

Përfshirja e e këtij neni në Ligji Penal Serb, i cili ngre bazat për ndërtimin e legjislacionit anti-trafik, ishte rezultat i punës së vazhdueshme dhe bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Punëve Sociale dhe Drejtësisë, OJF-ve lokale.(p.sh *Shoqata Serbe e Viktimologjisë, ASTRA, Këshilli Kundër Dhunës në Familje*) dhe komuniteti ndërkombëtar (*OSCE, IOM dhe UNOHCHR*)

Kodi i ri Penal përmban amendime dhe modifikime të vogla në përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore (neni 388). Ai përfshin disa metoda të reja përcaktimin e veprave penale (refuzimi për dhënien e letër-njoftimit, ose mitmarrja), si edhe disa arsye të reja për klasifikimin si vepër penale (mitmarrja, puna e detyruar, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, skllavëria ose statusi i ngjashëm me skllavërinë)

Nëse vërtetohet se vepra penale është konsumuar autori mund të dënohet nga 2-10 vjet, nëse viktima vdes atëherë dënimi nuk mund të jetë nën 10 vjet burg dhe nëse është pjesë e një organizate kriminale jo më pak se 10-vjet burg. Kodi Penal gjithashtu parashikon që nëse viktima është nën 14-vjeç autori është fajtor pavarësisht përdorimit ose jo të forcës, kërcënimit ose çdo forme tjetër për të realizuar veprën dhe

---

<sup>17</sup> Bordi Mbikëqyrës Brenda Gjykatës së Lartë të Serbisë është i autorizuar të gjejë çështjet e pa zgjidhura brenda periudhe të arsyeshme kohore, por ai nuk ka fuqinë që të kompensojë viktimat e këtyre rasteve.

<sup>18</sup> Rritja e mosbesimit ndaj sistemit gjyqësor përbën një problem shqetësues. Bazuar në studimin e kryer nga *Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut*, më tepër se gjysma e të intervistuarve besojnë se gjyqtarët janë të paefektshëm dhe të lidhura me qarqe politike dhe nëse të drejtat e tyre dhunohen ata preferojnë që kontaktojnë persona të fuqishëm ose me influencë se sa ti drejtohen gjykatës. Gjithashtu në vëzhgimin e fundit të *Qendrës për zgjedhje të Lira dhe Demokraci (CeSID)*, qytetarët kanë më shumë besim tek OJF-të se tek qeveria, parlamenti, sistemi gjyqësor apo partitë politike. Është një ndjenjë në rritje se pushteti ekzekutiv ndikon fuqishëm në sistemin gjyqësor si edhe në vendimet e gjykatave. Veç kësaj publiku beson se miratimi i ligjeve të fundit ishte një rezultat i kompromisit politik dhe jo pjese e strategjisë së përgjithshme për reformimin e sistemit ligjor dhe ekonomik.

këtë ia referon mbrojtjes së veçantë të të miturve e ky fakt përbën një hap mjaft të rëndësishëm. Gjithashtu ky ligj parashikon si vepër të veçantë penale trafikimin e fëmijëve për qëllime adoptimi (neni 389). Kjo vepër dënohet nga 1-5 vjet dhe nëse kjo vepër konsumohet në mënyrë të vazhdueshme, si profesion dhe si një strukturë kriminale e organizuar nga një ose më shumë persona jo më pak se 3-vjet burgim.<sup>19</sup>

Masat kundër trafikut të qenieve njerëzore përfshin si synim për luftën ndaj këtij krimi edhe heqjen e organeve trupore, Neni 388 (1) KP për transplantim. Parashikimi për ndarjen ose heqjen e organeve njerëzore dhe pjesëve të trupit i cili ekziston në legjislacionin penal serb qysh prej Prillit 2003 (Neni 54/4 i Kodit të vjetër), nuk është përfshirë në Kodin e Ri me anë të të cilit ky i dyti devijon nga standardet ndërkombëtare të parashikuara në Rekomandimin Nr 1611 (2003) të Asamblesë Parlamentare të KE-së për Trafikimin e Organeve. Rekomandimi thekson rëndësinë e amendimit të legjislacionit dhe ndëshkimin e trafikantëve e organeve njerëzore si edhe personelin mjekësor të përfshirë në transplantet e paligjshme. Trafikimi i organeve njerëzore gjithashtu është i ndaluar shprehimisht vetëm nga një akt të ish-federatës “*Akti mbi Kushtet për Heqjen dhe Transplantimin e Organeve Njerëzore*” (SI, list SFRJ, 63/90, 22/91; SI, list SRJ, 28/96)

*Akti për Lëvizjen dhe Qëndrimin e të Huajve (Neni 34(4) SI, list SRJ, 68/02)* nuk përmban ndonjë parashikim për lejimin e qëndrimit të përkohshëm të viktimave të trafikut, ndonëse grandet për rezidencat e tyre rregullohen nga ligji që prej vitit 2004. Megjithatë, legjislacioni për të huajt dhe azilkërkuesit është e nevojshme të modernizohet dhe të përafrohet me standardet ndërkombëtare për të siguruar një shkallë më të lartë për mbrojtjen e tyre<sup>20</sup>.

---

<sup>19</sup> Parashikim i ngjashëm ekziston edhe për krimin e skllavërimit (neni 390 KP), ishte minimumi 3 vjet burgim dhe u reduktua nga 1-10 vjet burgim.

<sup>20</sup> Vepra “Për kalim të paligjshëm të kufirit” (neni 350§1 KP) parashikon maksimum deri në 1 vit burgim për personat të cilët kalojnë kufirin pa u pajisur me dokument udhëtimi, edhe ata që janë të armatosur ose janë të dhunshëm. Kodi i ri dënon kontrabandën e qenieve njerëzore (neni 350§2 KP), dënohet çdokush i cili për qëllime përfitimi i krijon mundësinë çdo personi i cili nuk është qytetar i S&M, për të hyrë ilegalisht, qëndruar apo transit në S&M mund të dënohet me burgim 3muaj -6 vjet. Rrezikimi i jetës ose shëndetit së emigrantëve ilegal përcaktohet si rrethanë rënduese dhe dënohet 1-10 vjet burgim (neni 350§3 KP), Kodi i Ri nuk e merr në konsideratë këtë të fundit duke bërë një devijim nga standardet ndërkombëtare.

## Komente

Karta e DNJ (neni 13) e ndalon skllavërinë dhe Kushtetuta e Serbisë e cila nuk e parashikon skllavërinë duhet të harmonizohet në përputhje me Kartën e DNJ. Ndalimi i Skllavërisë gjithashtu duhet të parashikohet edhe në Kushtetutën e Re të Serbisë

Duke marrë në konsideratë shtimin e formave moderne të skllavërisë mbetet e paqartë pse politikbërësit serb ndërhyjnë në ligj duke ulur masën e dënimit. Veç kësaj KP serb përcakton transportin e personave të skllavëruar nga një vend në tjetrën si ndihmë për kryerjen e krimit. Kjo do të thotë që transporti i të skllavëruarve nuk është krim nëse realizohet brenda vendit, me përjashtim të rasteve kur ata nxirren jashtë kufirit.

Veç kësaj , analiza e praktikës së policisë serbe (bazuar në nenin 14 të ligjit “Për rendin dhe sigurinë publike” dhe nenit 106,107 të ligjit “Për të lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve”), tregon që rastet e prostitucionit dhe emigracionit (i)legal shpesh mund të fshehin raste te trafikut të qenieve njerëzore.

## Plani Kombëtar i Veprimit (PKV)

Serbia nuk ka akoma një Plan Kombëtar Veprimi kundër trafikut të qenieve njerëzore, gjithashtu kjo nuk është e përfshirë edhe në synimet afatgjata të saj.

Grupet e punës janë takuar disa herë për të përgatitur këtë pjesë si pjesë të PKV kundër trafikut të qenieve njerëzore. Drafti i parë i PKV u paraqit përpara Task Forcës për Paktin e Stabilitetit në vitin 2001. Ky draft parashikonte të krijonte një model bashkëpunimi ndërmjet agjencive të ndryshme dhe përshkruante këtë ndërhyrje në nivel federal. Bordi Inicues gjithashtu hartoi dhe pranoi një model sistemi referues për viktimat e trafikut të quajtur “Mekanizmi Kombëtar i Referimit dhe Skuadra Lëvizëse”. Në Prill 2002 agjencia anti-trafik e FRY (ish Republika Federative Jugosllave) paraqiti “Koordinatorin Kombëtar kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore për Republikën e Serbisë”, nën autoritetin e Ministrisë së Brendshme me përgjegjësinë për krijimin e një strukture anti-trafik në Serbi. Në Maj 2002 kjo strukturë e re thirri një takim për krijimin e “Ekipit Kombëtar Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore”.Kjo strukturë deri në Prill 2003 u takua

3 herë me përfaqësues nga institucione qeveritare, ndërkombëtare dhe OJF. Me krijimin e S&M kjo strukturë u nda në dy pjesë nën autoritetin e Koordinatorit Kombëtar. Ekipi serb miratoi planin e punës ndër të tjera në lidhje të ngushtë me Ministrinë e Brendshme. Në vijim të këtij programi në Qershor 2002 u krijua Ekipi Special i Policisë kundër Trafikut në të cilin bënin pjesë përfaqësues nga të gjitha departamentet e Ministrisë së Brendshme. Megjithatë mund të themi se Serbia akoma nuk ka një strategji të plotë për luftën kundër trafikut.

### III STRUKTURA E PËRGJITHSHME

#### Ngritja e kapaciteteve

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut in vëzhgimet e tij përmbledhëse të raportit Fillestar për Serbinë për zbatimin e ICCPR përgjatë viteve 1992-2002 vëren shfaqjen e mungesë së ndërgjegjësimit në lidhje me trafikun e grave dhe fëmijëve në radhët e punonjësve zyrtarë si prokurorët dhe gjykatësit. Ka pasur trajnime jo shtetërore në të drejtat e njeriut dhe për forcimin e ligjit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Të drejtat e njeriut nuk janë pjesë e programeve mësimore në shkolla dhe universitete dhe është në varësi të preferencave personale nëse dikush dëshiron që të marrë informacion mbi këtë fushë. Mungesë ndërgjegjësimit ka kryesisht në trafikimin e fëmijëve dhe te burrave. Mundësi edukimi dhe marrje informacioni ka vetëm në Beograd, por jo në pjesët e tjera të Serbisë. Megjithatë situatë është përmirësuar në mënyrë të ngadaltë në strukturat policore.

Gjatë viteve 2001-2002, rreth 350 punonjës të Ministrisë së Brendshme janë kanë marrë pjesë në trajnimet me temë mbi trafikimin e qenieve njerëzore. Këto trajnime janë organizuar nga organizma ndërkombëtarë (OSBE, IOM, UNFPA, Komiteti Ndërkombëtar për Zhvillimin e Politikave të Emigracionit), nga OJF vendase dhe Ministria e Brendshme. Numri pjesëmarrësve në fund të vitit 2005 parashikohet të jetë rreth 800.

Trajnimi i organeve zbatuese të ligjit në të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe trafikimit të qenieve njerëzore në veçanti janë organizuar nga OJF vendase dhe organizma ndërkombëtarë. Për sa i përket kësaj mund të përmendim se trajnimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve është organizuar nga Qendra e Trajnimeve Gjyqësore



(Beograd), OSBE, Shoqata e Gjyqtarëve për Mbrojtjen nga Keqbërësit, trajnimi i punonjësve të policisë është ofruar më së shumti nga OSBE, trajnimi i punonjësve të tjerë zyrtarë (përfaqësues nga ministri të ndryshme) në përgjithësi ofrohet nga OJF-të. Organizata më aktive është ASTRA e cila ofron trajnime jo vetëm për punonjësit zyrtar, por edhe për studentët, të rinjtë, punonjës të OJF-ve dhe gazetarë.

### Komente

Në përgjithësi qeveria është pasive në vend që të ndërmarrë veprime aktive për sa i përket ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Vëzhgimi më i fundit i Shoqatës Serbe të Viktimologjisë tregon një keq peshim të ndjeshëm në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në radhët e punonjësve zyrtar aktual. Ndërmjet tyre pak njohuri kishin të punësuarit në institucionet studentore dhe të ndihmës sociale. Gjithashtu shumë pak ndërgjegjësim dhe njohuri u vunë re në punonjësit e sistemit gjyqësor, shërbimit të prokurorisë dhe të policisë në nivel lokal.

### Analizë e mekanizmit të kërkimit dhe monitorimit.

Nga ana e shtetit nuk ka patur një analizë korrekte të kërkimit në zbatimin e legjislacionit anti-trafik dhe ballafaqimi i tyre me standardet ndërkombëtare, me përjashtim të një Vëzhgimi në praktikat të Autoritete Anti-keqbërës në Beograd në lidhje me prokurorinë dhe emigrantët (i)legal si incidente të cilat mund të fshehin raste të trafikimit të qenieve njerëzore. Ky vëzhgim u realizua nga Shoqata e Gjyqtarëve për Mbrojtjen nga Keqbërësit. Ky vëzhgim u bazua mbi vendimet përfundimtare të Autoritetit Anti-Keqbërës të Beogradit përgjatë vitit 2002, bazuar në nenin 14 të Ligjit “Për rendin dhe sigurinë publike” dhe nenit 106,107 të ligjit “Për të lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve”). Duhet theksuar se fokusi i analizave të tilla në Serbi është trafikimi i femrave, ndërsa janë neglizhuar aspekte të trafikimit të fëmijëve dhe të burrave. Qëllimi i vëzhgimeve në lidhje me trafikun e femrave ka një fushë të kufizuar përderisa ajo kufizohet më së shumti në faktorë të cilët kontribuojnë në këtë fenomen dhe qëndrimin përkatës. Për këtë arsye, duhet patur parasysh se të dhënat

nga vëzhgime të tilla nuk japin informacion të menjëhershëm dhe të plotë në fushën dhe karakteristikat e trafikimit.<sup>21</sup>

#### Rrjeti dhe bashkëpunimi rajonal

Ky seksion fokusohet në rrjetin kombëtar dhe rajonal të bashkëpunimit ndërmjet OJF-ve në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

Në nivel kombëtar funksionojnë këto rrjete: ASTRA Netëork (përfshin grupe grash nga Vojvodina, Serbia Qendrore dhe Jugore), Rrjeti i Shpresës (i krijuar nga disa vjet përpara me iniciativën e Qendrës së Traumës së Incestit, Beograd dhe përfshin OJF që punojnë kundër dhunës, veçanërisht dhunës ndaj grave dhe fëmijëve), Rrjeti CHRIS (përfshin 6 Komitete për të Drejtat e Njeriut në gjithë Serbinë të cilat merren me asistencën ligjore dhe përfaqësimin gjyqësor të viktimave të dhunimit të të drejtave të njeriut)

Në nivel rajonal janë dy rrjete aktivë i pari është ACTA (Iniciativa Ballkanike Kundër Trafikut dhe Korrupsionit), krijuar në Qershor 2004. Kjo është një organizatë rajonale jo qeveritare për krijimin e një shoqërie pa trafik dhe korrupsion. Ajo përfshin 11 organizata nga rajoni. i dyti është ARIADNE rrjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Evropën Lindore dhe Juglindore. Ajo është krijuar në 2005 e bashkon 17 organizata dhe qëllimi i saj të luftojë trafikimin e qenieve njerëzore nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet vendeve të origjinës, transit dhe të destinacionit.

#### Mobilizimi i burimeve

Fondet për luftën kundër trafikut janë jo qeveritare dhe në Serbi koncepti i fondeve private është akoma në përpunim e sipër. OJF-të janë aktorët kyç në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore nëpërmjet iniciativës për ndryshime ligjore dhe ofrimit të shërbimeve të ndryshme të nevojshme. Megjithatë OJF-të janë të varura nga ndihmat e ofruara nga ambasadat e huaja ose organizma ndërkombëtarë dhe vazhdimisht puna e tyre varet nga politikat dhe prioritetet e dhuruesve. Dhuruesit të cilët më së shumti përkrahin aktivitetin e OJF-ve në këtë fushë janë: OSBE, Agjencia Kanadeze për

---

<sup>21</sup> Vëzhgimet më të shpeshta në këtë fushë përfshijnë ; “Trafikimi i qenieve njerëzore në Serbi”, (Shoqata Serbe e Viktimologjisë me mbështetjen e OSBE-së), “Trafikimi i të Miturve” (ASTRA në bashkëpunim me Save the Children, Romania);“ Vëzhgim mbi qëndrimin e studentëve të Beogradit dhe nxënësve të shkollave të mesme rreth trafikimit të seksit” ASTRA. Raporte Alternative në organizma ndërkombëtarë.

Zhvillim Ndërkombëtar, Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Komisioni Europian, Save the Children, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Beograd, The Geneva Global Inc dhe Shërbimi i Ndhmës Katolike.

#### IV. Zbatimi i legjislacionit anti-trafik

##### Parandalimi dhe ndërgjegjësimi

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, në Komentet e Përgjithshme Nr.28, paragrafët 12 dhe 30, u rekomandon shteteve palë të marrin masa në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, përfshirë gratë dhe fëmijët e huaj, nga dhunimi i të drejtave të tyre, siç është trafikimi nëpërmjet kalimit të kufirit, ushtrimi i prostitucionit nëpërmjet dhunës dhe forma të tjera të fshehta të punës së detyruar si detyrim personal.

Fushata më e rëndësishme për rritjen e ndërgjegjësimit është organizuar para pak vjetësh, u quajt “Hapi sytë” dhe u implementuar gjatë viteve 2002-2003. Kjo ishte ndër fushatat e para të këtij lloji në Serbi dhe u iniciua nga ASTRA. Objektivi kryesor i kësaj fushate ishte të bënte të dukshëm problemin e trafikimit të grave, të rriste ndërgjegjësimin e punonjësve zyrtarë dhe publikut në përgjithësi si edhe të inaugurate bashkëpunimin ndërmjet OJF-ve dhe organeve shtetërore. Fushata e dytë “Kjo është e çuditshme” u realizua përgjatë viteve 2004-2005. Ajo u organizua nga ASTRA në bashkëpunim me Zyrën e OKB-së për Drogën dhe Krimin. Objektivi kryesor përveç informimit të publikut të gjerë në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore ishte inkurajimi i viktimave, viktimave potenciale të afërmeve dhe ambientin shoqëror të tyre për të kërkuar ndihmë dhe informacion si edhe të motivojë qytetarët për të ndihmuar viktimat e trafikut të qenieve njerëzore. Fushata e tretë “Shpëtoni fëmijët nga trafiku u qenieve njerëzore” ka filluar që prej vitit 2005. Ajo është iniciuar nga “Save the Children me asistencën e Ambasadës së Britanisë së Madhe në Beograd. Kjo fushatë është gjithashtu një ftesë për të gjithë organizmat dhe organet shtetërore përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi. Fushata e katër është quajtur “Trafikimi i fëmijëve – realiteti ynë” dhe ka filluar të implementohet që prej vitit 2006. Ajo është iniciuar nga ASTRA me mbështetjen financiare të “Save the Children”. Ajo është një fushatë mediatike e shkallës së gjerë me objektiv parandalimin e trafikimit të fëmijëve.

## Komente

Trajtimi i parandalimit nuk është pjesë e praktikës shtetërore, ajo është përdorur më së shumti në aktivitetin e OJF-ve, të cilat janë mjaft aktive në këtë drejtimi si edhe kanë organizuar aktivitete të një shkalle të gjerë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe luftën ndaj trafikut të qenieve njerëzore në Serbi.

## Mbrojtja dhe asistenca

### Dëshmitë/mbrojtja e viktimave

Dëshmitë e viktimave janë më së shumti të lidhura me gjykimin e trafikantëve. Amendimet në KPr.P (SI.list.SRJ,68.02), kanë të bëjnë me mbrojtjen nga gjykata të dëshmitarëve nga fyerjet, kërcënimet ose hakmarrja çdo forme tjetër të hakmarrjes (neni 109). Prokurorit publik i janë dhe kompetenca për mbrojtjen e dëshmitarëve gjatë fazës hetimore kur ka raste të hetimit të rasteve të krimit të organizuar, prokurori mund të urdhërojë marrjen e masave të veçanta mbrojtjeje për dëshmitarët , bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe të afërmeve të tyre (neni 504). Ndryshimet në ligjin “Për Organizimin dhe Juridiksionin e Organeve Shtetërore për Shtypjen e Krimit të Organizuar”(SI.glasnik, RS,67/03), parashikon se gjykata mund të marrë vendim për mbrojtje të veçantë për dëshmitarët dhe familjarët e tyre me kërkesën e tyre ose të palëve të interesuara (neni 15) dhe nëse është e mundur të garantojë pjesëmarrjen e tyre ose palëve të dëmtuara në proceset gjyqësore nëpërmjet video-konferencës ose formave të tjera ndihmëse. Shërbimi i Ndihmës për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore filloi të funksionojë në Mars 2004 dhe në Qershor të këtij viti Ministria e Brendshme miratoi një udhëzim për kushtet e qëndrimit të shtetasve të huaj viktimat të trafikut. Më 29.09.2005, Parlamenti Serb miratoi ligjin “Për mbrojtjen e dëshmitarëve në proceset penale” (SI. Glasnik RS,85/05), e cila parashikon aplikimin e masave të mbrojtjes së veçantë për dëshmitarët në procese penale delikate sidomos ato të krimit të organizuar. Format e mbrojtjes së paraqitura në këtë ligj janë katër : mbrojtja fizike të personit dhe pasurisë, transferimi në një vendqëndrim ose institucion penitenciar tjetër, fshehja e identitetit dhe të dhënat pasurore, ndryshimi i identitetit. Ai përvijon bashkëpunim ndërkombëtar për zbatimin e Programit, i cili bazohet në marrëveshjet ndërkombëtare të reciprocitetit. Ky ligj ka filluar të implementohet në 01.01.2006.

## Asistenca për viktimat

Viktima përfaqësohet ligjërisht nga një avokat përgjatë procesit. Avokati ka të drejtë që të njihet me të gjitha dokumentet e gjykatës, të përfshihet në veprimet hetimore e gjyqësore, paraqesë dokumente, të ekzaminojë faktet, të paraqesë dëshmitarë, ekspert etj. Ai ka të drejtë të ngrejë pretendime dhe akuza nëse prokurori publik tërhiqet nga akuza. Për këtë arsye avokatët të cilët marrin pjesë në këto procese duhet të jenë të çliruar nga paragjykimet gjinore, ksenofobia si edhe të jenë të gatshëm të luftojnë pavarësisht rrezikshmërisë që këto raste paraqesin. Përgjatë periudhës as avokati as viktima nuk janë palë në proces dhe jo vetëm pjesëmarrës gjykata nuk ka detyrimin që të dërgojë ndonjë padi, gjetje ligjore apo vendim përfundimtar. Viktima nuk ka të drejtën e apelimit përveç rasteve në lidhje me shpenzimet. Për këtë arsye bashkëpunimi me zyrën e prokurorit publik është jetësor për mbrojtjen e të drejtave të viktimës. Ndihma ligjore për viktimat e trafikut të qenieve njerëzore të cilat zakonisht janë në pozitë mjaft të dobët e pa mbështetje financiare për përballimin e shpenzimeve të procesit, ofrohet vetëm nga OJF-të që punojnë në këtë fushë.

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut në vëzhgimet përfundimtare në Raportin Fillestar të Serbisë në zbatimin e ICCPR-së për periudhën 1992-2002, nënvizon se strehat dhe linjat telefonike SOS menaxhohen nga OJF-të, të cilat gjithashtu kanë organizuar fushata ndërgjegjësuere dhe shpreh keqardhje për mungesën e përfshirjes së autoriteteve shtetërore në këto iniciativa. Komiteti i rekomandon S&M marrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e trafikimit dhe për dënimin e autorëve. Shteti nuk ofron shërbime të tilla si strehat apo linjat SOS. Asistencë e drejtpërdrejtë këtyre viktimave i ofrohet nga ASTRA, IOM Streha për Viktimat e Trafikut. Linjë SOS ofrohet vetëm nga ASTRA. Ka edhe linja të tjera SOS por ato funksionojnë vetëm për dhunën në familje. Një linjë e cila mund të konsiderohet se ka dhënë një ndihmë për mbrojtjen e qytetarëve nga dhunimi i të drejtave të tyre është ajo e ngritur nga Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Minoriteteve<sup>22</sup>, por aktiviteti kryesor i kësaj linje ishte referimi i viktimave tek OJF-të të cilat ofrojnë asistencë ligjore, sociale etj. Në 2005 u hapën shumë linja telefonike por edhe këto vetëm për gratë e dhunuara dhe fëmijët.

---

<sup>22</sup> Kjo Ministri vazhdoi të ekzistonte në ish- Unionin Shtetëror SSM.

“Streha për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore” koordinuar nga Vesna Stanojeviç është e vetmja e këtij lloji në Serbi. Kjo strehë luan rol të fuqishëm në ndryshimin e praktikave të deritanishme të zyrtarëve, forcimin e ligjit si edhe në ofrimin e ndihmës direkte për viktimat kryesisht ato të nënshtetësisë së huaj.

#### Komente

Mund të thuhet se janë bërë të gjitha amendimet ligjore për mbrojtjen e viktimave të trafikut përgjatë fazës hetimore dhe gjyqësore si edhe gëzojnë një status të favorshëm përgjatë këtij procesi.

Strehat e krijuara nga OJF-të janë të paqëndrueshme dhe varen fuqimisht nga donacionet. Kombinimi i mungesës sistematike të kujdesit shtetëror dhe e fuqizimit të menjëhershëm të ligjit e dobëson dhe e rrezikon akoma më shumë pozitën e viktimave të trafikut.

#### V. Praktikrat më të mira

Evidencat për krimin e trafikut të qenieve njerëzore mund të sigurohen edhe pa miratimin e viktimës (mungesa e dëshmisë së viktimës në mjaft raste ka ndikuar negativisht në fillimin e proceseve gjyqësore ose në pushimin e atyre të filluara). Për shembull një polic ndalon në një bar dhe sheh se në listën e pijeve është edhe emri i një gruaje pa çmim të përcaktuar (dmth që mund të negociohet), mund të vërej se jemi përpara ushtrimit apo shfrytëzimit të prostitucionit. Ndërsa në një rast tjetër polici vëren se dritat e dhomës në një motel ndizen e shuhen në mënyrë periodike që do të thotë se dhoma është e lirë ose e zënë. Gjithashtu i njëjti polic vëren se zyra e prokurorisë nuk ndërhyr për hetimin e rasteve të tregtimit të seksit nëpër gazeta.

Ekipi Kombëtar Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore është një shembull pozitiv për bashkëpunimin ndërmjet organeve shtetërore dhe OJF-ve. Ky shembull mund të shërbejë për fuqizimin e bashkëpunimit institucional të OJF-ve me qeverinë.

Viktimat (femra) të përdorura nga trafikantët, i drejtohen policisë për ndihmë, policia i siguron mbrojtje të menjëhershme dhe i krijon kushte për të bashkëpunuar me prokurorinë për fillimin e procesit gjyqësor ndaj autorëve.

Gjykata mbron të drejtat e viktimës nëpërmjet sigurimit të asistencës psikologjike dhe mjekësore. Pastaj ai merr vendimin për paraqitjen e viktimës nga një gjykatës tjetër.

## VI. Mungesa

Sistemi gjyqësor është një pikë e dobët sepse ai nuk zbaton kuadrin ligjor ekzistues Asistenca për viktimat dhe ndërgjegjësimi i publikut realizohet vetëm nga OJF-të.

Zyra e Prokurorit Publik ka dështuar në ekspozimin rasteve të dhunimit e të drejtave të njeriut dhe hetimet policore shpesh janë të gjata dhe të dështuara gjë që nuk ka sjellë rezultate të ndjeshme. Procedurat gjyqësore janë të stërzgjatura gjë që e rëndon më tej shkallën e mosbesimit ndaj sistemit gjyqësor në Serbi.

Në kundërshtim me të mëparshmin Kodi i ri Penal nuk parashikon një definicion të qartë të kualifikimit të trafikimit të qenieve njerëzore si veprë penale, kur kjo realizohet ndaj disa personave në mënyrë të veçantë kur kjo realizohet nëpërmjet dhunës ose çdo forme tjetër degraduese. Meqenëse viktimat zakonisht janë trajtuar në mënyrë të dhunshme dhe shpesh janë më shumë se një dhe në bazë të Protokollit të Parë pengmarrja është një nga format e konsumimit të krimit (neni 3 (a)), mbetet e paqartë se përse përkufizimi ekzistues nuk është përfshirë në Kodin e ri Penal.

Ulja dënimit minimal nga 3-5 vjet burgim për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore për bën një nga handicapët më të rënda të Kodit të Ri Penal.

Legjislacioni vendas nuk kriminalizon shërbimet e ofruara nga viktimat e trafikut (në rastet kur ato e bëjnë me dëshirë). Në këtë aspekt Rekomandimi 1545 (2002) i Këshillit të Europës kërkon ndëshkimin për të gjithë ata që me vetëdije marrin shërbime seksuale nga viktimat e trafikut.

## VII. Vlerësimi i nevojave

Duke marrë në konsideratë përkufizimet, faktet dhe komentet e paraqitura në këtë raport dhe nevojat për përmirësim e situatës janë paraqitur rekomandimet në vijim:

### Rekomandime

Transportimi i personave të skllavëruar duhet të klasifikohet si krim, pavarësisht faktit nëse ata janë nxjerrë jashtë kufirit ose kanë qëndruar brenda tij. Ndëshkimi duhet të adresohet jo vetëm tek trafikantët por edhe tek ata që i ndihmojnë në realizimin e qëllimeve të tyre me vetëdije.

Mandati i Bordit Fillestar për Luftën Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, linçuar nga Koordinatori Kombëtar për Trafikimin (miratuar nga qeveria e FRY në Prill 2001), për “Koordinimin e zhvillimit afatgjatë dhe multidisiplinar kundër trafikimit” mund të mbulojë edhe këto fusha: parandalimin, rritjen e ndërgjegjësimit, mbrojtjen e viktimave, forcimin e ligjit, dhe mbledhjen e të dhënave. Miratimi i një Plani Veprimi Kombëtar për të luftuar trafikun e qenieve njerëzore për të gjetur zgjidhje sistematike dhe të qëndrueshme për këtë qëllim.

Zhvillimi i masave parandaluese

Qeveria duhet të miratojë një linjë pro-aktive për parandalimin, ngritja e kapaciteteve dhe aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit në këtë aspekt të:

Përfshirjes së një numri shërbimesh për viktimat dhe mbrojtjen e dëshmitarëve.

Përfshirjes së zyrtarëve aktual në një sërë programesh edukuese në lidhje me trafikun e qenieve njerëzore, në bazë të balancimit gjeografik të pjesëmarrësve.

Organizimit të punës kërkimore dhe vëzhgimeve në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore e në veçanti për trafikun e fëmijëve dhe burrave.

Formalizimit të bashkëpunimit ndërmjet OJF-ve dhe organeve shtetërore për zbatimin e protokollove përkatëse të cilat qartësisht pasqyrojnë të drejta dhe detyrat përkatëse.

Monitorimi i zbatimit të ligjit dhe vlerësimi i funksionimit të mekanizmave shtetërorë.

Përmirësimi i sistemit gjyqësor në lidhje me rastet e trafikut të qenieve njerëzore.

\*\*\*\*\*

## LISTA E SHKURTIMEVE

KP

Kodi Penal

CeSID

Qendra për Zgjedhje të Lira dhe Demokraci



KE	Këshilli i Europës
KPrP	Kodi i Procedurës Penale
FRY	Ish-Republika Jugosllave
ICCPR	Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Civile
dhe Politike	
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Emigracionin
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin
European	
S&M	Serbia dhe Mali i Zi
UNOHCHR	Zyra e Komisionerit të OKB-së për të Drejtat e
Njeriut	
UNFPA	Fondi i Popullatës së OKB-së

## SHËNIM

Aktualisht Serbia është duke miratuar një akt formal për të pranuar detyrimet e saj në bazë të traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat i ka nënshkruar si S&M.

Kosova

Autor:

CPËC – Qendra për mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve

KOSOVA<sup>23</sup>

## I. Hyrje

---

<sup>23</sup> UNMIK u krijua më datë 10.06.1999, kur Këshilli i Sigurisë me Rezolutën 1244 autorizoi Sekretarin e Përgjithshëm të ngrrejë në provincën e Kosovës të shkatërruar nga lufta një administratë civile të përkohshme të drejtuar nga Kombet e Bashkuara ku popullata e saj do të gëzonte autonomi të konsiderueshme në mënyrë progressive. Në veçanti, rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurisë i kërkon UNMIKut të: kryej funksionet bazë të administratës civile; promovojë vendosjen e një autonomie të konsiderueshme dhe vetë-qeverisjen në Kosovë; të ndihmojë në procesin politik në përcaktimin e statusit të Kosovës; të kordinojë asistencën humanitare dhe në raste katastrofash të ofruar nga agjensitë ndërkombtare; të mbështesë rindërtimin e infrastrukturës së domosdoshme; të ruajë rendin publik dhe ligjin; të promovojë të drejtat e njeriut; dhe të garantojë kthimin e sigurtë dhe pa pengesa në shtëpitë e tyre në Kosovë për të gjithë personat e zhvendosur. Duke punuar nga afër me udhëheqësit e Kosovës dhe popullatën misioni kryen tërësinë e funksioneve administrative themelore dhe shërben duke mbuluar fusha të tilla si shëndeti dhe arsimiti, bankat dhe financat, postën dhe telekomunikacionin, rendin dhe ligjin. Në janar 2000 u krijuan departamente administrative të përbashkëta; në tetor 2000 u mbajtën zgjedhjet lokale në 30 bashki të Kosovës; në Maj 2001 u miratua korniza kushtetuese e Kosovës. Zgjedhjet në mbarë vëndin u mbajtën në nëntor 2001.

E vendosur në gadishullin e Ballkanit Kosova ka qënë një entitet përbërës i Ish Republikës Jugosllave. Ajo kufizohet me Shqipërinë, Malin e Zi, Serbinë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Popullata e Kosovës është mbi 2 milion prej së cilës rreth 90% janë Shqiptarë etnik (mylsimanë ose katolik). Pjesa e mbetur janë Serb, Egjiptianë, Roma, Ashkali, Turq dhe minoritete të tjera.

Sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKBsë 1244 e miratuar sipas kapitullit VII të Kartës së OKBsë, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) luan rolin e administratës civile ndërkombtare të përkohshme që nga qeshori i vitit 1999. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (SRSG) ushtron përgjegjësitë e UNMIK. Trupat paqeruajtëse (KFOR) funksionojnë në kuadrin e rezolutës 1244, i raportojnë NATOs dhe janë përgjegjëse për ruajtjen e sigurisë dhe për kryerjen e operacioneve paqeruajtëse në rajon.

Kosova është identifikuar si një zone destinacioni dhe më pak si vëndi i origjinës dhe tranzitit të grave dhe vajzave të trafikuar. Rugët kryesore të kalimit për në Kosovë mendohet të jenë nga veriu nëpërmjet kufirit me Serbinë dhe nga te gjitha drejtimet e Maqedonisë. Disa gra janë trafikuar nga Mali i Zi dhe Shqipëria. Gjithashtu, ka patur raste të grave të trafikuar më transport ajror nga Turqia, Austria, dhe Zvicra për në Kosovë<sup>24</sup>.

Vajzat dhe Gratë e trafikuar sillen në Kosovë për shfrytëzim seksual dhe prostitucion të detyruar, por edhe për shfrytëzim të krahut të punës duke përfshirë lypjen dhe punë krahu të rëndë. Viktimat kryesore të Kosovës përdoren për shfrytëzim brënda Kosovës por një përqindje e konsiderueshme dërgohet për shfrytëzim jashtë vëndit.

Njësia e Investigimit të Trafikimit dhe Prostitucionit (TPIU) mban një sistem të dhënash të të gjitha grave të huaja të cilat kontaktojnë policinë, shpeshherë, gjatë kontrolleve në bare. Gjatë 2001 sipas të njëjtit burim numri i viktimave u rrit. Por, në 2002 pati një ndryshim të vogël të mënyrës së trafikimit të viktimave në Kosovë<sup>25</sup>. TPIU thotë

---

<sup>24</sup> 'Trafikimi i Qënieve Njerëzore në Evropën Juglindore 2003', publikuar nga PNUD.

<sup>25</sup> TPIU ka identifikuar 391 raste. Sipas të dhënave të TPIU në 2001 janë identifikuar 5 viktimave Kosovare dhe 167 viktima me

se biznesi i trafikimit i ka transferuar aktivitet nga vëndet publike në vendbanime privatë. Në të njëjtën kohë thotë se medohet se gratë e intervistuar marrin pagesa të mira, gëzojnë kushte të mira jetese. Kështuqë, mund të jene përfshirë më dëshirën e tyre në industrinë e seksit (*happy trafficking*).

Pas verifikimit të ambjentit familjar të viktimave nëhet e qartë se ato vijnë nga shtresa të shoqërisë që janë më të prekura. Në shumë raste, varfëria, familjet me probleme, niveli i ulët i arsimit dhe zakonet që e motivojnë diskriminimin e vajzës dhe të guras krijojnë një ambjent në kontekstin e të cilit viktimat zakonisht kanë qënë më parë objekt të dhunës në familje apo dhunës seksuale. Mjedise të tilla e bëjnë gratë dhe vajzat objekte të trafikimit dhe dëmton mundësitë për ri-integrim në shoqëri, shpesh duke i rikthyer në ciklin e trafikut.

Opinionin e përgjithshëm në Kosovë, të cilin e shprehin edhe NGO vendore, është se trafikimi nga Kosova mund të përshkallëzohet në sajë të përkeqësimit të situatës ekonomike dhe rritjes së papunësisë, veçanërisht për gratë e reja.

Megjithëse ka pak fakte për gratë Kosovare të trafikuar jashtë vëndit, përkeqësimi i situatës të tyre ekonomike, rritja e varfërisë dhe e papunësisë, ndryshimet në strukturën e familjes tradicionale, dhuna kundër gruas dhe tendencat në rritje të formave të prostitucionit që pranohen dhe janë të dukshme në shoqëri mund të kontribuojnë në

---

nënshtetësi të huaj; në 2002 janë identifikuar 3 viktima Kosovare dhe 86 viktima me nënshtetësi të huaj në 2003 nuk është identifikuar asnjë viktima kosovare ndërkohë që numri i viktimave të huaj ishte 34; në 2004 janë identifikuar 12 viktima kosovare dhe 35 të huaja; dhe në 2005 janë identifikuar 18 viktima kosovare dhe 31 të huaja. Sipas të të njëjtit burim trafikantët e arrestuar në 2004 ishin: 43 Kosovar, 20 Shqipatërë, 4 Bulgar, 1Moldov, 1 Rumun, dhe 1 me kombësi të paidentifikuar. Në 2005 trafikantët e arrestuar ishin: 45 Kosovar, 31 Shqiptarë, 3 Bulgar, 2 Moldov, 4 Ukrainas, 2 Rumun, 1 Serb dhe 2 me kombësi të tjera. Sipas IOM në 1999 janë identifikuar vetëm dy viktima; në 2000 janë identifikuar 114 viktima; në 2001, 136 viktima; në 2002, 85 viktima; në 2003, 44; në 2004, 34, dhe deri më qeshor 2005 janë identifikuar vetëm 6 viktima.

bërjen e Kosovës një rajon burimi të grave dhe vajzave për trafikim jashtë vëndit.

## II. Kuadri i Legjislacionit Vendor

### A. Legjislacioni Vendor

Sipas rregullores 2001/09 të UNMIK, ku parashikohet krijimi i kornizës kushtetuese për vetë qeversije të përkohshme të Kosovës, instrumentat kryesore të drejtatve nderkombtare të njeriut janë të aplikueshme edhe në legjislacionin vendor. Legjislacion vendor mbart pak instrumenta ligjorë që rregullojnë trafikun e qënieve njerëzore dhe fenomenet që lidhen me të:

Rregullorja 2001/4 e UNMIK mbi ndalimin e *Trafikimit të Personave në Kosovë* dekretuar në janar 2001;

Direktiva Administrative 2005/03 mbi zbatimin e Rregullores 2001/04 të UNMIK për *emrimin e Kordinatorit të Asistencës të Viktimave* brënda *Departamentit të Drejtësisë*;

*Kodi Penal i Përkohshëm dhe Procedura Penale e Kosovës* me kapitujt e veçantë që trajtojnë trafikimin në plotësim të Rregullores 2001/2004 të UNMIK.

### Koment

Për arsye se Kosova është ende në procesin e finalizimit të statusit të saj në arenën nderkombtare dhe është ende në periudhë tranzicioni duhet thënë se të gjitha ligjet bazohen në Rregulloret e UNMIK. Ligjet e tjera në Kosovë janë të një natyre të përkohshme. Për arsye të statusit ligjor të papërcaktuar Kosova nuk është e listuar në tabelën e ratifikimeve në Aneksin e këtij publikim.

### B. Plan i Veprimit

Hartimi i Planit të Veprimit filloi në mars 2002 dhe vazhdoi në disa faza që nga qeshori 2004 deri më prill 2005. Plani veprimit do të vihet në realitet jo më vonë se 2007 kur mekanizmat e shqyrtimit të lejislacionit në parlament (Mekanizmat referues të veprimit) do të jenë

krijuar në Kosovë. Struktura e planit të veprimit bazohet në standardet ndërkombtare dhe të BEsë. Në veçanti, i referohet një model shabllon të pranuar në maj 2004 nga të gjitha vëndet e rajonit të Evropës Juglindore në kuadrin e projektit CARDS të BEsë mbi *Përmirësimin e Zbatimit të Strategjive Kombtare për Planin e Veprimit të Anti-Trafikimit në vëndet e Evropës Juglindore*. Ky model u përpilua nga Qendra ndërkombëtare për zhvillimin e politikës së migrimit (ICMPD). Gjithashtu, në Planin e Veprimit reflektohen edhe elementet e Udhëzuesit të Paktit të Stabilitetit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktime të trafikimit /UNICEF

### III. Kuadri i Përgjithshëm

#### A. Ndërtimi i Kapaciteteve

Pjestarët e Grupit të Punës Ndër-institucional për Anti-trafikimin pohojnë për nevojën e organizimit të kurseve të trainimit mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerzore. Eështë ngritur një Grup Pune për hartimin e një Direktive Administrative për zbatimin e Rregullores

Nr. 2001/4 mbi *Ndalimin e Trafikimit të Personave në Kosovë*, që përfshin të drejtën për tu përfaqësuar, këshillimin dhe strehimin e përkoshëm. Gjithashtu, Direktiva Administrative përcakton kompetencat e Njësisë së Avokimit dhe Asistencës së Viktimave (VAAU) dhe Kordinatorit të Asistencës së Viktimave. VAAU ka përgjegjësinë për krijimin e strukturave përkatëse. Drafti i Direktivës Administrative iu paraqit zyrës lighore të UNMIK në prill 2002.

Sekretariati i *Anti-Trafikimit*, si strukturë e brëndshme e Zyrës për Qeverisje të Mirë (OGG), skicoi dhe organizoi një program trainimi me Ministrinë e Drejtësisë, IOM, OSBE, strehën e viktimave të huaja të trafikimit dhe prostitucionit të detyruar (PVPT) dhe Njësinë e Investigimit të Trafikimit të Qënieve Njerzore / Shërbimi Policor i Kosovës (KPS/HTIU).

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Organizatën Botrore të Punës (ILO) dhe Programi Botror për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Puna

(IPEC) organizoi një seri kursesh trainimi mbi monitorimin e punesimit të detyruar të fëmijëve përfshirë trafikimin.

KPS/HTIU përfundoi kursin e katërt mbi investigimin e trafikimit të qënieve njerëzore. Objektivi kryesor ishte trainimi i oficerëve të policisë në sektorin HTIU për ti përgatitur për punën në terren. Agjensitë partnere në këto aktivitete ishin Akademia e Policisë, Prokuroria, IOM dhe Ministria e Drejtësisë. OGG dhe IOM bënë prezantime dhe dhanë leksione studentëve të psikologjisë, sociologjisë, gazetarisë dhe pedagogjisë rreth trafikimit të qënieve njerëzore. Gjithashtu, u organizuan sesione trainimi rreth trafikimit të qënieve njerëzore dhe rolin e shkollave në parandalimin e saj. 17 trainues nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MEST) të cilët janë ekspertë të çështjeve gjinore ishin pjesmarrës në këto trainime.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (MLSË) në bashkëpunim me IOM organizuan një trainim dy ditor rreth ri-integrimit të viktimave në familje të trafikuar me qëllimin për zbatim më efektiv të projekteve të anti-trafikimit. Përveç përfituesve të drejtpërdrejtë morën pjesë edhe 30 punonjës në total nga të gjitha Qëndrat për Çështjet Sociale në Kosovë ( katër prej të cilëve nga minoriteti Serb). Ministria e Shëndetësisë dhe kontributin e saj për rritjen e ndërgjegjësimit midis punonjësve të shëndetësisë përse i përket problemeve shëndetsore me të cilat përballen viktimat e trafikimit, format e dhënise së ndihmës si dhe rolin që ata mund të luajnë në ri-integrimin e viktimave. Gjithashtu, aktivitetet tjera për ndërtimin e kapaciteteve për punonjësit e shëndetësisë të cilat fokusohen në parandalimin e menjëhershëm të trafikimit të qënieve njerëzore janë në zbatim e sipër.

Një kurs tre ditor u organizua me 13 pjesmarrës për Operatorët e Ndhmës më Linjë Telefonike. Një session trainimi mbi Asistencën dhe Ri-integrimin e Viktimave të Trafikimit, ku morën pjesë 23 pjesmarrës prej së cilëve 8 avokatë të viktimava nga Ministria e Drejtësisë, u mbajt për partnerët nga qeveria dhe sektori i OJQve. I njëjti trainim u përsërit për 26 punonjës të Qëndrave për Çështjet Sociale si dhe për personelin që merret me strehimin.

Gjithashtu, në një tryezë të rrumbullakët të organizuar nga *Norma*, IOM bëri katër prezantime mbi riatdhetsimin dhe ri-integrimin e viktimave të trafikimit. Tematika e çështjeve gjinore në këtë trainim

synonte gratë vëndase, OJQtë dhe punonjësit e bashkive. IOM ka organizuar sesione trainimi për hetuesit dhe prokurorët me qëllimin për të përmirësuar procedurat e identifikimit të viktimave. Tematika e këtyre sesioneve ishte “Si të kuptojmë anti-trafikimin, forcimin institucional dhe çeshtjet ligjore” IOM ishte gjithashtu i ftuar nga KPS për të marrë pjesë si prezantues i iniciativave të anti-trafikimit në Kosovë dhe për të diskutuar rreth përfshirjes së IOM në këtë çështje.

PVPT u përfshi në seminarët për rritjen e ndërgjegjësimit të viktimave të strehuara në ambjentet e tyre. Në të njëjtën kohë PVPT u përfshi në programe të ndryshme me qëllimin për të përmirësuar bashkëpunimin midis të rinjve dhe policisë më synimin për të reduktuar rastet e trafikimit të qënieve njerzore në Kosovë.

## B. Mekanizmat analitikë, hulmëtues dhe monitorues

OGG është aktualisht duke u përpjekur për të krijuar një sistem të monitorimit, vlerësimit dhe rishikimit të strategjisë së anti-trafikimit dhe Planit të Veprimit për të vlerësuar ecurinë e zbatimit dhe impaktin e saj në goditjen e trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit në të gjitha etapat.

## C. Bashkëpunimi dhe krijimi i netëorkut në nivel rajonal dhe kombëtar.

Kordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerzore i cili është edhe Drejtor i Zyrës së Këshillimit për Qeverisjen e Mirë (AOGG), mbështetet nga një Sekretariat dhe Grupi Kosovar për Luftën kundër Trafikimit (Grup Ndër-institucional) në misionin e tij për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit. Sekretariati i AOGG u krijua për të mbështetur Kordinatorin Kombëtar dhe Grupin e Punës. Ai mer pjesë në iniciativat e organizatave të tjera për anti-trafikimin si për shëmbull në procesin e hartimit të *Termave të Referencës* për Grupin e Kosovës të IOM. Termat e Referencës parashikojnë krijimin e *Grupi të Punës Ndër-institucional* që synon të luftojë trafikimi e qënieve njerzore i cili është propozuar nga ekspertët e Këshillit të Evropës dhe mbështët nga konsulentët e Misionit të OSBE-së në Kosovë.



Grupi i Asistencës së Menjëhershme dhe Mbështëtjes së Viktimave të Huaja të Trafikimit u krijua sipas *Proceduarave Standarde të Punës* (SOPs) të përpiluara në 2000 dhe të azhornuara në 2004 të cilat kanë hyrë në fuqi që më 06.12.2004 (shih faqen 216). Ky Grup përbëhet nga: Policia e UNMIK, HTIU, Departamenti i Drejtësisë, Njësia për Asistencën dhe Mbështëjen e Viktimave të Trafikimit në UNMIK, Zyra e IOMit Kosovë, Njësia e Luftës kundër Trafikimit, Misioni i OSBEsë në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Zbatimit të Ligjit, MLSE dhe OJQ të ndryshme.

#### D. Mobilizimi i Burimeve

Donatorët kryesorë të cilët kanë kontribuar në zbatimin e aktiviteteve të anti-trafikimit në Kosovë janë: Buxheti i Konsoliduar i Kosovës – KCB (institucion qeveritar), OSBE, *Save the Children*; UNICEF; IOM; Shtylla I dhe III e UNMIK; *Kvinna Till Kvinna*; Organizata Ndërkombtare për Eleminimin e Varfërisë (NOVIB); *Christian Aid*; Fondi i OKBsë për Popullsinë (UNFPA); Pakti Stabilitetit; Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut (ODIHR); *Comité Catholique contre la Faim et pour le Développement* (CCFD).

#### IV. Zbatimi i Ligjit për Anti-trafikimin

Janë bërë disa përpjekje për zbatimin e ligjit për anti-trafikimin në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga instrumentat ndërkombtarë përkatësisht Protokollin e Trafikimit të OKBsë. *Kuadri i zbatimit* bazohet në tre boshte: parandalimin, hetimin, dhe mbrojtjen.

##### A. Prandalimi dhe rritja e ndërgjegjësimit

*Kuadri i Parandalimit* të Kosovës është i institucionlaizuar dhe do të hyjë në fuqi në 2007. Ky kuadër ka tre *objektiva*:

*Ndërgjegjësim* rreth pasojave të trafimit të qënieve njerëzore si dhe të kornizës ligjore për anti-trafikimin në fuqi.

*Reduktim të kërkesave* për shërbim ndaj viktimave

*Reduktim të dobësive* të viktimave potenciale.

Aktivitet kryesore të Kuadrit të Parandalimit përfshijnë:

Identifikimin e nivelit të ndërgjegjësimit rreth trafikimit të qënieve njerzore të grupeve me risk të lartë si dhe të nivelit të kërkesave për shërbim ndaj viktimave duke e shoqëruar me fushatën ndërgjegjësuere shumë disiplinore dhe shumë gjuhëshë për organizatën e cila u drejtohet grupeve me risk të lartë.

Monitorim të zbatimit të strategjisë së edukimit dhe zbatimit të aktivitetve për parandalimin e braktisjes së vajzave dhe grupet e tjera të cënuara;

Rishikim të kodit të punës në funksion të mbrojtjes së femijëve të punësuar

Lobimin e agjensive të përfshira në programet e zhvillimit ekonomik për të përfshirë grupët më risk të lartë dhe viktimat e trafikuar në projekte për të përmisuar gjëndjen e tyre ekonomike.

Monitorim të zbatimit të *Planit Gjinator të Veprimit* dhe të *Planit të Veprimit të Anti-trafikimit*.

Aktivitet e sipërpërmendura zbatohen nga *agjensitë* e mëposhtme:

Kabineti i Kryeministrit, AOGG, Ministria e Arsimit, Ministria e Punës dhe çështjeve sociale, Policia, Istitituti i Poilitikave Sociale, UNICEF, ILO, IOM, OSBE, PNUD, Banka Botëore, UNIFEM, *Save the Children*, Zyra e Komisionerit, Shoqata e Gazetarëve të Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Departamenti i Drejtësisë, IPEC, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Dhoma e Ekonomisë së Kosovës, Unioni i Sindikatave të Punëdhënësve të Kosovës, Zyra për Mbeshtetje Ligjore (OLA), Zyra e Çështjeve gjinore e UNMIK, Komitetet e Barazisë Gjinore, Komitetet Bashkiake dhe Grupet e Punës Ndër-ministore.

## B. Mbrojta dhe Asistenca

Kuadri Mbrojtës i Kosovës është i institucionalizar dhe hyn në fuqi në 2007. Dokumenti përcakton objektivat e *mëposhtme*:

*Asistencë për viktimat dhe mbrojtje sociale* përfshi përcaktimin e masave standarde për identifikimin e viktimave.

Bashkëpunim ndërmjet të gjithë palëve që merren me mbrojtjen për të siguruar asistencë të bashkërenditur për të mbijetuarit dhe viktimat e

trafikimit (shëndetësi, edukim, strehim, trajtim psikologjik, ndihmë financiare)

*Rinintegrim/përfshirja në shoqëri* dukë konsideruar nevojat e veçanta të viktimave të riatdhetsuara.

Aktivitet kryesore të Kuadrit Mbrojtës përfshijnë:

Përcaktimin e procedurave për *identifikimin* e viktimave dhe të *kalimit për hetim* në polici. Përpilimin e udhëzuesit të standardizuar për identifikimin e viktimave dhe transmetimin drejt palëve të interesuara. Përpilim dhe zbatim të stadarëve të shërbimit për viktimat si edhe shembuj të modeleve të menaxhimit

Rishikim dhe finalizim të *Procedurave Standarde të Punës (SOP)* për viktimat e trafikimit vendase dhe të huaja.

Përcamtimin e procedurave /udhëzuesit për periudhën e reflektimit në dispozicion të viktimave

*Përforcimin e kordinimit dhe monitorimit* të kapaciteteve në punë dhe inspektimeve sanitare për identifikimin e viktimave. Krijimin e kapaciteteve monitoruese për ndjekjen e rasteve të ri-integritimit. Krijimin e projekteve që rrisin ndërgjegjësimin e komunitetit për parandalimin e stigmatizimit të viktimave.

*Trajnimit e Policisë* dhe të palëve të tjera mbi identifikimin e viktimave dhe njoftimin e organeve përkatëse

Më 06.12.2004, pjestarët e *Grupit për Asistencë të Menjëhershme dhe Mbështetje të Viktimave të Huaja të Trafikimit* nënshkruan një marrëveshje që autorizon përdorimin e *Procedurave Standarde të Punës për viktimat e huaja të trafikimit*. Qëllimi i kësaj marrëveshje është qartësimi i përgjegjësive të secilit partner apo agjensi në vendosjen e bashkëpunimit të afërt dhe kordinimit në kuadrin e sistemit të referimit.

Amendimi i *Procedurave standarte të veprimit (SOPs)* synon në rregullimin e asistencës së ofruar ndaj viktimave të brendshme të trafikimit. Ky përmbledh, *inter alia*, partnerët e përfshirë kohët e fundit, në veçanti Departamentin e drejtësisë së UNMIK dhe Njësinë e asistencës (VAAU), Ministrinë e punës dhe të mirëqënies sociale, si edhe OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare.

*Një linjë ndihme telefonike* për asistencë të drejtpërdrejtë ndaj viktimave administrohet nga *IOM*. Asistenca ndaj viktimave të

trafikimit ofrohet nga agjensi të ndryshme të cilat punojnë në bashkëpunim të ngushtë me Seksionin e mbështetjes dhe avokimit për viktimat në Departamentin e Drejtësisë të Shtyllës I të UNMIK-ut, OSBE-në, IOM dhe një rrjet organizatash lokale dhe ndërkombëtare. Për më tepër, OJQ-të po luajnë një rol kyç në ofrimin e shërbimeve të lidhura drejtpërdrejt me MLSË, të tilla si shërbimet shëndetsore, mbështetje psiko-sociale, edukim [i paçertifikuar me orë mësimi në strehë], këshillim për familjet, trajnim profesional, mbështetje material, gjenerim të ardhurash, asistencë për punësim, dhe aftësi për jetën.

TPIU, OSBE, dhe IOM si dhe PVPT janë antarë të Grupit të koordinimit të asistencës direkte kundër trafikimit. Ky grup, i njohur më parë si Grupi i koordinimit të strehës, është pika referuese mbi trafikimin, përgjegjës për të ndihmuar gratë e trafikuar në Kosovë. Ai shërben si një forum për diskutimin e rasteve individuale dhe të nevojave të përgjithshme të përfituesve. Ai siguron strehim në azile për të gjitha viktimat e trafikimit, pavarësisht nga dëshira e tyre për të bashkëpunuar me autoritetet. Vëmendje e veçantë i është kushtuar ruajtjes dhe sigurisë së personlit të azilit dhe në sigurimin e fshehtësisë së informacionit të përfutur, si dhe në sigurinë dhe të drejtat personale të viktimave të trafikimit.

Në Kosovë janë dy azile kundër trafikimit: *Shërbimi i përkohshëm i sigurisë* (ISF) për viktimat e brendshme të trafikimit, i cili është krijuar nga TPIU dhe VAAU, dhe *PVPT- Azili për viktimat ndërkombëtare të trafikimit dhe prostitucionit me dhunë*. Në të dy azilet ploësohen nevojat bazë të viktimave në përputhje me parimet e Udhëzimeve të Paktit të Stabilitetit/UNICEF-it. Gjatë akomodimit të tyre në azile, viktimave u ofrohen mundësi trajnimi i cili lehtëson ri-integrimin e tyre në të ardhmen, punësimin dhe pavarësinë pas përvojave traumatike.

Në bazë të SOPs, UNMIK, OSBE dhe IOM, gjithmonë në bashkëpunim me Zyrat ndërlidhëse janë përgjegjëse për *riatdhesimin* e ndihmave të huaja. Ato bashkëpunojnë me vendet e origjinës, dhe ofrojnë shërbim transporti dhe dokumente udhëtimi për viktimat. *Shërbimet e ri-integrimit* ofrohen nga agjensi të ndryshme që veprojnë nën koordinimin e *Ministrit së punës dhe mirëqënies sociale*. Viktimat e trafikimit marrin ndihmë të drejtpërdrejtë. Për shembull, *Njësia e asistencës dhe e avokimit për viktimat* (VAAU) ofron

asistencë dhe përfaqësim ligjor, ndërkohë që shërbimet e saj financohen nga IOM.

*IOM* luan një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të ri-integrimit dhe bashkëpunon ngushtë me të gjitha agjensitë, si ato qeveritare dhe jo-qveritare që punojnë për viktimat e trafikimit. Në të njëjtën kohë, shumë agjensi qeveritare psh. Qendra për mirëqënie sociale janë të përhira direkt në këto aktivitete. Ministria e arsimit në bashkëpunim me OJQ-të lokale, ofron orë mësimore shtesë për viktimat që ndjekin shkollën fillore dhe atë të mesme.

### C. Ndëshkimi

*Kuadri i ndëshkimit* është i instituciolizuar në Kosovë dhe do të veprojë deri në 2007. Ai ka *objektivat* e mëposhtme:

Krijimin e *mekanizmit të shkëmbimit të informacionit* ndërmjet OJQ-ve, policisë, si dhe agjensive të tjera të zbatimit të ligjit për ndëshkimin e trafikantëve.

Nxitja e *forcimit institucional* të policisë dhe sektorit gjyqësor për të luftuar trafikimin.

Hartimin e masave të veçanta për *mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve*.

*Koordinimin* e përmirësuar ndërmjet agjensive kompetente.

*Aktivitetet kryesore* të kuadrit të ndëshkimit përfshijnë:

*Monitorim* më të mirë të gjyqtarëve dhe prokurorëve që trajtojnë raste të trafikimit.

*Trajnim* të gjyqtarëve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë mbi ndikimin psikologjik të trafikimit tek viktimat, përdorimin e provës së ekspertit, teknikat efektive dhe sensitive të intervistimit për personat e trafikuar, duke përfshirë fëmijë, hetime të krimit të organizuar që përfshijnë operacionet e fshehta dhe konfiskimi e pasurive.

Trajnim të *gjqtarëve, prokurorëve, avokatëve* dhe personelit tjetër ligjor për të ofruar mbrojtje më të mirë gjatë sesioneve dëgjimore publike dhe trajtimin e informacionit sensitive me theks të veçantë tek dëshmitarët fëmijë.

Trajnim të *punonjësve social* dhe avokatëve të tjerë të viktimave mbi intervistat me fëmijë.

Organizim të *takimeve në tryeza të rrumbullakëta* me pjesëmarrje të gjyqtarëve dhe prokurorëve për t'i trajnuar ata në trajtimin e rasteve të trafikimit.

*Trajnim* intensive për prokurorë të përzgjedhur vendor me ekspertizë të veçantë.

Krijim i një *baze të dhënash me rastet* të cilën mund ta përdorin gjyqtarët, prokurorët, policia dhe Departmenti i Drejtësisë [DoJ].

Krijimi i një *ekipi kombëtar* i përbërë nga prokurorë dhe oficerë policie me synim nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe koordinimin e rasteve.

Ngritja e '*fondeve të shpejta*' për operacionet e fshehta.

Amendament të *politikës së vlerësimit të policisë*, në mënyrë që të lejohen promovimet brenda TPIU me qëllim minimizimin ndikimin e kundërt të rotacionit/transferimeve.

Rekrutimin e *më shumë oficerëve femra*, dhe rritjen e burimeve teknike të disponueshme për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Arrijten e *marrëveshjeve dypalëshe të ekstradimit* për ushtruesit e trafikimit.

Amendament i *Kodit të procedurës penale*, me qëllim për të lejuar përdorimin në gjykatë të viktimave.

Krijimin e *një ekipi të gjyqtarëve dhe prokurorëve* të specializuar në rastet e trafikimit.

Krijimin e *paneleve gjyqësore* për rastet e trafikimit, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve vendas dhe ndërkombëtarë.

Vendosjen e një *pike kontakti* ndërmjet agjensive kundër trafikimit dhe njësisë për luftë kundër pastrimit të parave.

*Aktorët e përfshirë në aktivitetet e mësipërme janë si më poshtë:* Departamenti i Drejtësisë dhe Departamenti i Administrimit gjyqësor (MPS), KJI, Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës (OPPK), Ministria e Punës dhe mirëqënies sociale, Zyra e Kryeministrit, Shërbimi policor i Kosovës KPS, Drejtoria kundër krimit të organizuar (Shtylla I), Prokurorët publik, Zyra e Kryeprokurorit në Kosovë, Zyra e Ndhmës juridike, Kryetarët e gjykatave të rretheve, dhe Seksioni i hetimeve financiare (DOC).

## V. PRAKTIKAT E MIRA

*Avokim mbi riatdhesimin:* Qendra për mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve (CPËC) ka realizuar riatdhesimin e viktimave të trafikimit në Kosovë. Viktima e dërguar tek CPËC nga IOM, u strehua dhe mori trajtimin e duhur. Gjatë kësaj periudhe CPËC kontaktoi me qendra të tjera të rajonit dhe bëri përpjekje të takonte familjen e viktimës me qëllim kthimin e saj të sigurtë në shtëpi. Përfaqësues të CPËC dhe të CSË më në fund arritën të bindnin viktimën dhe familjen e saj që mënyra më e mirë e ri-integrimit ishte kthimi në familje. Rasti u mbyll me sukses, ndërkohë që CPËC ende monitoron viktimën përmes kontakteve me CSË dhe me familjen e saj.

*Avokim në institucione shëndetsore:* CPËC ka ofruar ndihmë ndaj një viktime minorene e mbetur shtatzënë, në Klinikën obstetrike-gjinekologjike.

## VI. MANGËSI

Mungesa e institucioneve që ofrojnë *programe afatgjata rehabilitimi*, veçanërisht për viktimat që vuajnë nga trauma të rënda psikologjike;

Mungesa e një *sistemi efektiv për mbrojtjen e dëshmitarit*;

*Mungesa e fondeve për ndërtimin e një sistemi kombëtar të referimit;*

*Vështirësi në identifikimin e saktë dhe trajtimin e viktimave të trafikimit;*

## VII. VLERËSIMI I NEVOJAVE

Duke marrë në konsideratë mangësitë dhe komentet e përfshira në këtë raport, si dhe nevojën për përmirësim të situatës, më poshtë është paraqitur një listë me rekomandime.

### REKOMANDIME

*Një sistem i mbledhjes së të dhënave duhet të zhvillohet midis të gjithë aktorëve që ndihmojnë viktimat e trafikimit, me qëllim përfitim të një panorame me shifra dhe tendenca dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit.*

*Pjesëmarrja e grave dhe fëmijëve në iniciativat për ndërgjegjësim mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e grave e të fëmijëve duhet të përforcohet.*

*Nxitja e mundësive të barabarta për vajzat në arsim dhe në tregun e punës është një detyrim, me qëllim shmangien e varësisë së tyre nga familja apo persona të tretë të cilët mund të përfitojnë nga ndjeshmëria e tyre.*

*Struktura mbështetëse më të mira për vajzat dhe gratë që janë viktime të krimeve seksuale duhet të krijohen dhe funksionojnë në mënyrë të rregullt.*

Duke marrë në konsideratë se Kosova po kalon një periudhë tranzicioni, gjatë së cilës rreziku i trafikimit të qënieve njerëzore është më i lartë, *kontrolle më të rrepta të kufinjve dhe bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet vendeve të Evropës juglindore bëhen të domosdoshme për parandalimin e këtij fenomeni.*



*Sistemi efektiv i mbrojtjes së dëshmitarit* duhet të vendoset për të garantuar të drejtat e viktimës dhe të dëshmitarit.

## LISTA E SHKURTIMEVE

AOGG – Zyra këshilluese për qeverisje të mirë

CARDS- Program i financuar nga BE për asistencën komunitare në rindërtim, zhvillim dhe stabilizim.

CCFD – Komiteti katolik kundër urisë dhe për zhvillim

CPËC – Qendra për mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve

CSË– Qendrat për Punë sociale

DOC – Seksioni i hetimit financiar

DoJ – Departamenti i Drejtësisë

ICMPD- Qendra ndërkombëtare për zhvillimit të politikës së migrimit

ILO – Organizata ndërkombëtare e punës

IOM – Organizata ndërkombëtare e migrimit

IPEC – Programi ndërkombëtar për eleminimin e punës së fëmijëve

ISF – Shërbimi i përkohshëm i sigurisë

KCB – Buxheti i konsoliduar i Kosovës

KFOR – Forca paqeruajtëse në Kosovë

KJI – Institucionet gjyqësore të Kosovës

KPS – Shërbimi policor i Kosovës

KPS/HTIU – Shërbimi policor i Kosovës/Njësia e hetimit për trafikimin e qënieve njerëzore

MEST – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MLSË- Ministria e punës dhe e mirëqënies sociale

MoJ – Ministria e Drejtësisë

MPS – Departamenti i administratës gjyqësore

NATO – Organizata e marrëveshjes së atlantikut të veriut

NOVIB – Organizata ndërkombëtare për eliminimin e varfërisë

ODIHR – Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejta të njeriut

OGG – Zyra për qeverisje të mirë

OLA – Zyra për ndihmë juridike

OSCE/OSBE – Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë

OPM – Zyra e Kryeministrit

OPPK – Zyra e prokurorit publik të Kosovës

PVPT – Azili për viktimat e huaja të trafikut dhe prostitucionin e dhunshëm

SOPs – Procedurat standarte të veprimeve

SRSG – Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm

TPIU – Njësia e hetimit të trafikimit dhe prostitucionit

UNDP – Programi i zhvillimit të Kombeve të Bashkuara

UNFPA – Fondi i Kombeve të Bashkuara për popullsinë

UNICEF – Fondi i Kombeve të Bashkuara për fëmijët

UNIFEM – Fondi i zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë

UNMIK – Misioni i përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

VAAU – Njësia e asistencës dhe e avokimit për viktimat

## TURQIA

### I. Hyrje

E lokalizuar ne verilindje te detit Mesdhe ne Europen juglindore dhe Azine jugperendimore, Turqia eshte nje udhekryq i shume kulturave. Ajo rrethohet nga deti i Zi ne veri dhe deti Egje ne perendim.

Kufizohet nga Greqia dhe Bullgaria ne perendim, Rusia, Ukraina dhe Rumania ne veri (nepermjet detit te Zi), Gjeorgjia, Armenia, Azerbaixhani dhe Irani ne lindje, dhe Siria me Irakun ne jug.

Mbas viteve 90, nga nje vend tradicional emigracioni, Turqia u kthye ne nje pike terheqese per migrimin ilegal. Nje numer gjithnje e me i madh migrantesh hyne ne Turqi, kryesisht nen mbulesen e turizmit.

Ndersa, ne fund te viteve 80, shumica e tyre vinte nga Ballkani, menjehere mbas kollapsit te USSR, vendin e pare e zune ish Republikat Sovjetike. Ne kete kontekst, Turqia u kthye ne nje shtet destinacion per trafikun e qenieve njerezore.

Shumica e rasteve te dokumentuara perfshin femra te trafikuar me qellim prostitucioni. Statistikat nacionale tregojne se shumica e grave te trafikuar ne Turqi vine nga Moldavia, Rusia e Ukraina. Pjesa tjeter e viktimave jane shtetase te Kyrgistanit, Uzbekistanit, Rumanise, Azerbaixhanit, Kazakistanit, Turkmenistanit, Gjeorgjise e Bjellorusise.

Sipas statistikave nazionale, nje total prej 239 viktimash jane identifikuar nga autoritetet shteterore si viktimat e trafikut ne 2004. Kjo shifer ishte 256 ne 2005 dhe 138 per gjysmen e pare te 2006. Sidoqofte, nuk eshte e mundur te nxirret nje numer i sakte i viktimave ne Turqi. Sipas statistikave te *Human Resources Development Foundation* (HRDF), shumica (61%) e viktimave jane nga 18 ne 24 vjec. Viktimat e grupmoshes nga 25 ne 30 perbejne 25,5%, ndersa mbi 30 perben 11%. Minorenat perbejne 2,7% te numrit total te viktimave. Statistikat e Organizates Internacionale per Migrimin jane te ngjashme. Provizioni i pare legal qe perfshiu definicionin e Trafikut ne Qenie Njerezore (TQN) ishte artikulli 201/b i kodit penal ne vitin 2002. Ky artikull i denonte rende trafikuesit, nga 5 ne 10 vjet burg. Kodi i ri Penal i Turqise qe hyri ne veprim ne 01.06.2005 perfshinte gjithashtu definicionin e TQN (Artikulli 80) dhe parashikonte nga tete ne dymbedhjete vjet burgim dhe nje gjobe te barasvlefshme me dhjetemije dite burgimi. Ai pershkruan gjithashtu masa sigurie per personat e perfshire ne TQN.

#### *Trafiku i Qenieve Njerezore / Artikulli 80;*

- Konsensi i viktimes nuk eshte i vlefshem ne rastet kur veprimet qe perbejne krimin jane kryer me qellimin e pershkruar ne nen-paragrafin e pare.
- Ne rastin e perfshirjes te minoreneve per qellimet e pershkruara ne nen-paragrafin e pare , gjithashtu kalimi i kufirit, levizja ose dergimi i tyre nga nje vend ne nje tjetër si dhe strehimi i tyre, i pandehuri denohet , sic pershkruhet ne nenparagrafin e pare, pavaresisht nese ka ushtruar kercenim, force ose dhune, abuzim autoriteti, me ose pa konsensin e tyre.
- Masa sigurie do te aplikohen ndaj entiteteve ligjore ne pershtatje me keto krime.

#### **Koment**

Praktika tregon se aplikimi i Artikullit 80 te kodit penal nuk eshte gjithmone i mundur sepse definicionet e perdorura ne te jane te limituara. Ne keto raste perdoret Artikulli 227 qe i perket prostitucionit. Artikulli 80 duhet te modifikohet ne menyre qe te mbuloje te gjitha format e trafikut te qenieve njerezore.

*Ligje dhe rregulla te tjera*

· Sipas Ligjit per lejet e punes per te huajt, Ministria e Punes dhe Sigurise Sociale eshte autoriteti i leshimit te te gjitha formave te lejeve te punes. Punesimi ne sherbimet shtepiace eshte i mundur nen kete ligj. Ai synon te ofroje mbrojtje ligjore per te huajt kunder shfrytezimit ne tregun e punes dhe zgjeron mbrojtjen ligjore dhe administrative ne akordet private. Ministria e Punes dhe Sigurise Sociale ka pregatitur nje kontrate model si ne turqisht dhe ne gjuhen e aplikanteve.

□ Ne akord me amendamentin e Ligjit te Nenshtetesise, kerkohet nje periudhe probatore prej tre vjetesh per te marre nenshtetesine turke nepermjet marteses. Ata qe kane nje pune te papajtueshme me institucionin e marteses dhe ata qe nuk ndajne te njejten shtepi me bashkeshortin nuk mund te marrin qytetarine turke.

□ Rregullorja e transportit rrugor, qe eshte efektive prej 25.02.2004, parashikon se patenta do te anulohet per tre vjet per personat e denuar per krime, midis te cilave trafikuku i qenieve njerezore.

□ Ministria e Shendetsise ka marre masat e nevojshme ligjore per te ofruar asistence mjekesore falas per viktimat e trafikut te qenieve njerezore.

□ Ministria e Brendshme ka autorizuar administraten e provincave te leshoje, aty ku eshte e nevojshme, viza humanitare dhe leje qendrimi te perkohshme per viktimat, ne menyre qe ti lejoje te qendrojne ne Turqi per tu rehabilituar e trajtuar per nje kohe deri ne 6 muaj, te rinovueshme.

## B. Marreveshje te Dyanshme

Turqia ka firmosur 64 Marreveshje Bashkepunimi per Sigurine me 52 shtete per te luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin. Te gjitha marreveshjet parashikojne menyra bashkepunimi kunder migrimit ilegal dhe trafikut te qenieve njerezore. Protokolle bashkepunimi i jane propozuar Gjeorgjise, Bullgarise, Rumanise, Moldavise, Federates Ruse, Azerbaixhanit, Bjellorusise, Uzbekistanit dhe Ukraines ne menyre qe te aktivizohen klauzolat e marreveshjeve. Gjate tre viteve te fundit Ministria e Brendshme Turke ka nenshkruar Memorandume te ndryshme me ministrine e brendshme te disa shteteve:

□ Protokolli i implementimit te Artikullit 1 te Marreveshjes te bashkepunimit kunder Krimin midis Qeverise turke dhe Qeverise se Ukraines (07.06.2005) dhe Moldavise(08.02.2006).

- Me Bjellorusine ne fushen e bashkepunimit ne luften kunder trafikut ne qenie njerezore dhe migrimit ilegal (28.07.2004).
- Me Gjeorgjine dhe Azerbaixhanin ne implementimin e Artikullit 9 per te luftuar terrorizmin, krimin e organizuar dhe te tjera krime te medha (10.03.2005).

Keto marreveshje perfshine masa qe lehtesojne:  
 Shkembimin e informacionit ne lidhje me trafikantet e viktimave;  
 Procese investigative te perbashketa;  
 Njohje e institucioneve e sherbimeve nga ana e viktimave;  
 Sensibilizim;  
 Informacionin per kuadrin ligjor;

### C. Plani Kombetar i Veprimit

I filluar ne 2003, Plani Kombetar Turk perfshin 12 pika per te parandaluar dhe luftuar trafikun ne qenie njerezore. Nje permbledhje e shkurter:

Ngritja e strehezave;  
 sigurimi i kthimit pa rrezik te viktimave;  
 Help line, falas, 24 ore, 7 dite ne jave;  
 Periudhe probatore prej tre vjetesh perpara marrjes se nenshtetesise Turke nepermjet marteses;  
 Viza humanitare per viktimat;  
 Pjesemarrja e organeve te mbrojtjes se ligjit ne aktivite trajnimi;  
 Ligj i vecante per mbrojtjen e deshmitareve;  
 Leshimi i lejeve te punes vetem nepermjet Ministrise se Punes e Sigurimit Social;  
 ONG jane te inkurajuara te marrin pjese ne luften kunder krimin;  
 Statistika te detajuara;  
 Sigurim i trajtimit dhe rehabilitimit te viktimave;  
 Suport i viktimave nen nje fond special;  
 Rritje e sensibilizimit.

Qeveria Turke eshte duke modifikuar Planin Kombetar te Veprimit. Eshte ngritur nje grup pune qe perfshin anetare te OJF-ve aktive dhe te organeve zyrtare.

### III. Kuadri i pergjithshem

#### A. Ngritja e Kapaciteteve

Nje numer kursesh trajnimi jane organizuar per target te ndryshem ne Turqi; organizuesit kryesore jane Ministria e Brendshme (MB), Organizata Internacionale per Migrimin (OIM) dhe Fondacioni per Zhvillimin e Risorseve Humane (FZRH) (31.10.2005).

Drejtoria e pergjithshme e Sigurimit organizon trajnim te rregullt te stafit te saj te brendshem. Duke filluar nga 2004, trafiku i qenieve njerezore u be pjese e ketij trajnimi. Nje total prej 332 oficeresh policie kane mare pjese ne kete program trajnimi ne 2004; 515 ne 2005 dhe 201 ne gjashte mujorin e pare te 2006. Pavec trainimit te mesiperem, nje numer seminaresh dhe aktivitetesh jane organizuar nga organizata te ndryshme. Perfaqesues te OJF-ve, oficerere policie, prokurore e gjykates kane marre pjese gjithashtu ne seminare internacionale e kurse trajnimi. Gjithashtu, jane botuar nje numer manualesh dhe eshte duke u bere nje studim per te standartizuar modulet qe do te perdoren per trajnimin e forcave te zbatimit te ligjit.

#### Komente

- duke qene se oficeret e policise transferohen rregullisht, numri i atyre qe trajnohen duhet te jete me i madh.
- Trajnimi duhet te jete i vazhdueshem dhe te perfshije metodat e reja.
- Duhet te sigurohet standartizimi i moduleve.

#### B. Mekanizmat e analizes, punes kerkimore dhe monitorimit

Rritja e numrit te migranteve ilegale solli nevojën e krijimit te nje departamenti te ri ne Ministrine e Brendshme (zyra e migrimit ilegal ne byrone e te huajve, Kufijve dhe Azilit) ne 1997. Ministria e Puneve te Jashtme formoi gjithashtu Njesine e Luftes kunder Imigracionit ilegal ne 2001. Keta dy organizma jane aktive ne luften kunder trafikut human ne Turqi. Nen drejtimin e Ministrise se Puneve te Jashtme, u caktua nje koordinator kombetar per bashkepunimin internacional. U formua nje task force kombetare e perbere nga eksperte nga Ministrite dhe OJF-te ne 2002 dhe mblidhet dy here ne vit. Ky organizem multidisiplinor dhe kros sektorial, monitoron e rishikon implementimin

e veprimeve kunder trafikut ne Turqi. Nese ceshtje te vecanta kerkojne kujdes te vecante, atehere formohen grupe ad hoc per te diskutuar e zgjidhur ceshtjet ne fjale. Regjistrimi i te dhenave dhe informacioni mbi trafikun e qenieve njerezore jane te pamjaftueshem ne Turqi. Asnje raport zyrtar nuk eshte pregatitur deri tani. Organizatat qeveritare e jo qeveritare pregatisin raporte per perdorim te brendshem. OIM ka pregatitur dy raporte kombetare per kete ceshtje, nje ne 2004 dhe tjetrin ne 2006.

## Komente

- Ka nje mungese te mekanizmave analitike, kerkues e monitories. Mekanizmat kombetare te luftes kunder trafikut human duhen ristrukturuar.
- Duhet te pregatiten e botohen nga qeveria raporte vjetore me informacion mbi numrin e viktimave, sherbimet e trajnimit per aspekte te ndryshme

### C. Kooperimi e ndertimi i rrjetit regjional e kombetar

#### *Marreveshje kooperimi midis forcave te ligjit e OJF-ve*

Drejtoria e Pergjithshme e Sigurimit e Ministrise se Brendshme Turke adoptoi dy Protokolle, nje me FZRH (04.09.2003) dhe nje me Fondacionin per Soldaritetin e Grave (31.10.2005). Per me teper, Komanda e Pergjithshme e Xhandarmerise hyri ne nje marreveshje bashkepunimi me FZRH (14.06.2004). Objekti i ketyre marreveshjeve eshte percaktimi i pergjegjesise se partnereve brenda kuadrit te luftes kunder trafikut human. Forcat e ligjit dhe OJF-te jane partneret. Te paret bejne pjese ne kategorine e mbeshtetesve institucionale te programit . ndersa te fundit ne agjensite implementuese te tij. Pervec futjes se masave parandaluese (sensibilizim i opinionit, ndihme juridike) dhe masave kapacitet ngritese (Trajnime, Rrjeti i OJF-ve), Marreveshjet e bashkepunimit midis Institucioneve te zbatimit te ligjit dhe OJF-ve, fokusohen ne identifikimin, referimin e riatdhesimin e viktimave te trafikut.

#### Marreveshjet e Bashkepunimit midis Bashkive e OJF-ve

FZRH-ja ka nenshkruar nje marreveshje me Bashkine e Stambollit (29.06.2004). Objektivi eshte percaktimi i pergjegjsive te partnereve



brenda kuadrit te “hapjes dhe operimit te strehezave per viktimat femerore te trafikut”

#### *Perpjekjet per te ngritur rrjetin*

*Pervec marreveshjeve te bashkepunimi, Qeveria turke ka bere edhe perpjekje per te ngritur rrjetin. Ne mes te vitit 2006 Drejtoria e pergjithshme e Sigurimit organizoi nje takim me perfaqses te Ambasadave te disa vendeve per te diskutuar mundesite praktike te bashkepunimit dhe zgjidhjen e problemeve egzistuese.*

*OJF-te Turke nisin bashkepunimin dhe ngritjen e rrjetit me OJF ne vende te tjera. FZRH-ja u be anetar i ARIADNE Netëork kunder trafikut te Qenieve Njerezore ne Europen Juglindore dhe Lindore ne qershor 2005.*

#### D. Mobilizimi i Risorseve

Donatoret qe japin fonde per programe anti trafik jane te rralle ne Turqi. Pervec qeverise Turke, perfshire dy administrata locale, Bashkia e Stambollit dhe e Ankarase, edhe qeveria Amerikane, Unioni European, Banka Boterore, SIDA, qeveria Norvegjeze, dhe Phillip Morris Inc. Altria Funds kane dhene fonde per disa aktivitete anti trafik. Gjithashtu, ambasadat e Hollandes, Danimarkes, Suedise, Australise, Canadase si edhe British Council, the Catholic Relief Services Bullgar e disa agjensi te UN kane dhene fonde me pak te konsiderueshme per aktivitete ne zhvillim.

Per shkak te veshtiresise ne financim, OJF-te lokale nuk jane shume aktive ne luften kunder trafikut te qenieve njerezore.

#### Koment

Ka nje nevojë urgjente per donatore kombetare e nderkombetare qe te japin fonde jo vetem per konferenca e takime, por edhe per asistencë praktike per viktimat.

#### IV. Implementimi i Ligjeve kunder Trafikut

##### A. Parandalimi dhe Sensibilizimi

Ne tre vitet e fundit jane organizuar disa evente sensibilizuese ne Turqi. Drejtoria e Pergjithshme per Statusin e Grave ka organizuar tre evente publike ne 2002, 2003 dhe 2006. Eventi me i vonshem, i organizuar ne Antalia, ishte nje conference internacionale ku perfaqsesit e qeverise, agjensite interqeveritare e OJF-ve nga Rusia,

Bjellorusia, Moldavia, Ukraina, Azerbaixhani, Georgjia, Uzbekistani, Kyrgystani dhe Turqia u takuan e diskutuan mundesite e bashkepunimit midis kufijve.

FZRH ne bashkepunim me *Catholic Relief Services*-Bulgaria ka organizuar nje konference internacionale ne Stamboll ne 2004 me pjesemarrjen e perfaqsesve te agjensive qeveritare e joqeveritare te Moldavise, Bullgarise, Rumanise dhe Turqise. Mjeket e *Monde-Greece* se bashku me nje OJF-ne kombetare *International Blue Crescent*, organizuan dy takime kombetare duke perdorur mediat per te sensibilizuar opinionin.

Aktualisht, sasia dhe shumellojshmeria e materialit te shtypur eshte e limituar. Egziston nje help line e mbajtur nga OIM ne bashkepunim me qeverine Turke. OIM ka shperndare 500,000 fletepalosje ne aeroportet e Stambollit e Antalias e ne portin e Trabzon. Kohet e fundit, OIM ka promovuar gjithashtu nje fushate mediatike te quajtur "E Ke Pare Nenen Time?" Materiale per parandalimin jane duke u shperndare gjithashtu ne vendet e origjines.

## B. Mbrojtja dhe asistenca

Aktualisht, qellimi i mekanizmit te referimit nacional, eshte riatdhesimi i sigurte i shtetasve te huaj te cilat bien viktime e trafikut ne Turqi. Sistemi i referimit nuk perfshin rastet kur viktimat do te qendroje ne Turqi per nje periudhe me te gjate kohe.

Egzistojne dy streheza qe u ofrojne sherbime viktimave te trafikut ne Turqi. Nje person i trafikuar i referohet strehezes ne Stamboll ose Ankara nga Policia Kombetare Turke. Ka nje mekanizem qe rregullon se ku do te referohet viktimat ne momentin qe ai/ajo identifikohen jashte Stambollit ose Ankarase. Te dyja strehezat kane adresa te fshehta qe dihen nga shume pak njerez.

Fondacioni i Zhvillimit te Risorsave Humane (FZRH), i formuar ne 1988, eshte nje organizate Turke aktive ne fushat e promovimit te te drejtes se riprodhimit dhe mbrojtjen e fashave te popullsise qe jane ne rrezik. FZRH formoi srehezen e pare ne Turqi, ne Stamboll ne vitin 2004. Kjo strehez qe ka vetem 10 shtreter ka strehuar mbi 260 viktimat deri ne 2006.

Streheza ne Ankara mbahet nga Fondacioni per Solidaritetin e Grave (FSG). Kjo OJF Turke eshte e drejtuar ndaj levizjes feministe. Streheza ne Ankara u hap ne Shtator 2005 ne bashkepunim me OIM dhe ka nje kapacitet prej 11 shtreterish.

Te dyja strehezat ofrojne sherbim keshillimi psikologjik dhe lehtesojne shfrytezimin e sherbimit mjekesor falas, duke dhene strehe e asistence sociale. Riatdhesimi i viktimave sigurohet nga OIM ne bashkepunim me FZRH ne Stamboll dhe me FSG ne Ankara. Asistence ligjore e limituar ju ofrohet viktimave nepermjet punes te OJF-ve.

Personat e trafikuar ne Turqi mund te aplikojne per nje leje qendrimi humanitare gjashte mujore te rinovueshme, e cila leshohet nga Departamenti i te Huajve, Kufijve dhe Azilit te Policise Kombetare Turke. Disponibiliteti i viktimes per te denoncuar trafikuesit nuk eshte kusht per te marre kete leje. Viza munt te zgjatet mbas leshimit. Sidoqofte, asistenca per viktimat ne Turqi nuk aplikohet per qendrimet me te gjata, duke e bere perdorimin e vizave humanitare disi problematike.

Egziston nje help line (157). Kjo help line mbahet nga OIM ne bashkepunim me qeverine Turke dhe punon 24 ore ne dite per 7 dite ne jave. Operohet nga persona qe flasin turqisht, rusisht, rumanisht e anglisht dhe thirrjet domethenese i raportohen policies ose xhandarmerise me telefon ose e-mail.

Institucionet e zbatimit te ligjit reagojne ndaj ketyre telefonatave per te shpetuar personat e interesuar. Egzistojne gjithashtu dy help line te tjera ne Turqi, help line e policise (155) dhe e xhandarmerise (156). Keto help line perdoren me teper nga klientet e viktimave per te raportuar.

### Komente

□ Nje pjese e madhe e asistences eshte e financuar nga burime internacionale. Duhet gjetur nje zgjidhje e vete-rinovueshme per te siguruar vazhdimesine e ketyre sherbimeve.

□ Mekanizmi kombetar i referimit duhet te ofroje zgjidhje te ndryshme nga riatdhesimi i viktimave.

□ Ndhima ligjore duhet te behet pjese e programeve te asistences.

□ Perdorimi i strukturave qeveritare per asistence eshte i limituar.

Institucionet egzistuese duhet te modifikohen per tu bere te afta t'u sherbejne me mire viktimave te trafikut duke siguruar perfshirjen e OJF-ve ne kete process.

### C. Ndjekja Ligjore

Autoritetet gjyqesore: Nuk egziston nje departament i dedikuar per trafikun e qenieve njerezore ne Ministrine e Drejtesise; sidoqofte,

gjykatesit e prokuroret kane marre pjese ne ne kurse trajnimi e seminare kombetare e nderkombetare per te rritur njohurine e tyre ne fushe. Provizionet ligjore qe rregullojne statusin e viktimes ne proceset ligjore kane pak rendesi ne rastet e trafikut. Personat e trafikuar praktikisht nuk marrin pjese ne gjyq, per faktin se nderkohe jane riatdhesuar. Zakonisht viktimat deshmojne ne fillim te procesit, kur akoma jane ne Turqi. Ne se kjo eshte e pamundur, pasi viktima eshte riatdhesuar tashme, ose nevojiten te tjera deshmi per te vazhduar procesin, keto mund te merren nepermjet perdorimit te kanaleve internacionale te bashkepunimit.

Megjithese marreveshjet e Bashkepunimit te Ndersjellte (p.sh me Ukrainen ose Bjellorusine) lejojne marrjen e statusit te deshmitarit edhe duke mos qene fizikisht ne Turqi, keto procedura duhet akoma te aplikohen ne praktike. Shpesh eshte gjithashtu e pamundur te gjenden viktimat ne atdheun e tyre.

Sipas procedures penale turke, pergjegjsia e marrjes se masave proceduriale per te mbrojtur te drejtat e viktimave qe marrin pjese si deshmitare ne proceset gjyqesore, i takon prokurorit. Egzistojne masa, si intervista e viktimes-deshmitar ne nje vend sekret, mbajtja e sekretit te identitetit, pyetja mbas nje pasqyre ose me video ne menyre qe te eliminohet konfrontimi i drejtperdrejte me te akuzuarin. Pyetja me video mund te perdoret gjithashtu per te percjelle deshmitare e viktimave qe tashme jane riatdhesuar ose nuk jane prezent.

Policia: Ministria e Brendshme Turke luan nje rol kryesor ne koordinimin e ceshtjeve operative qe i perkasin identifikimit e references se viktimave e investigimin e trafikanteve.

Drejtoria e Pergjithshme e Sigurimit dhe Komanda e pergjithshme e xhandermarise jane pergjegjes per te luftuar trafikun e qenieve njerezore.

Te dy organizmat kane brenda tyre njesi speciale qe trajtojne te huajt dhe krimin e organizuar.

Policia dhe Xhandermaria punojne se bashku me organizatat jo qeveritare dhe internacionale.

Qeveria Turke ka nisur nje projekt binjakezimi te EU te quajtur “Te forcojme Institucionet ne Luften Kunder Trafikut te Qenieve Njerezore”, i cili zhvillohet se bashku nga Policia Kombetare Turke, Agjensia e Policise Kriminale te Berlinit dhe Boltzmann Institute of Human Rights ne Viene. Qellimi i ketij projekti 18 mujor eshte te pregatise Turqine te arrije standartet minimale per zhdukjen e trafikut

ne qenie njerezore, si dhe te forcoje institucionet qe merren drejperdrejt me trafikun, te identifikojte nje strategji anti trafik dhe te zhvilloje nje plan aksioni sektorial.

#### Koment

Duhet bere ndryshime ne kodin penal ne menyre qe te sigurohet pjesemarrja ose perfaqsimi i viktimave ne procesin gjyqesor

#### V. BEST PRACTICES – Shembuj

· Bashkepunimi Qeveri – OJF: FZRH filloi programin e saj te luftes kunder trafikut te qenieve njerezore ne vitin 2003 dhe i kerkoi Ministrise se Brendshme te nenshkruaje nje Protokoll i cili con drejt nje bashkepunimi me te ngushte e cilesor te te gjitha pjesemarrjesve ne zone. Drejtoria e Pergjithshme u pergjigj menjehere dhe pozitivisht dhe Protokollin u nenshkrua ne 2003. Qe atehere, te gjitha viktimat e identifikuarai i jane raportuar strehezes se FZRH nga Policia. E njejta procedure u ndoq me strehezen e Ankarase nje vit me vone.

· *Bashkepunimi i dyanshem*: nje grua Azere u identifikua si viktime e trafikut ne Turqi. Gjate intervistes rezultoi se trafikantet kercenonin djalin e saj qe jetonte ne Baku. Policia kontaktoi interpolin dhe policine Azere, dhe me ndihmen e tyre, djali u transferua ne nje ambjent te sigurte. Viktima Azere ra dakort te bashkepunojte me policine Turke.

· *Rrjeti i OJF-ve dhe bashkepunimi Qeveri – OJF*:

*NGO netëorking and Government - NGO collaboration*:

Nje OJF nga vendi i origjines se nje viktime kontaktoi FZRH per te kryer nje denoncim. Mbasi mesoi detajet, FZRH kontaktoi Policine Turke duke dhene informacionin. Policia Turke zhvilloi nje aksion ne adresen e dhene nga OJF-ja dhe kerkoi nga FZRH-ja te dergonte nje keshilltar nga streheza per te asistuar ne procesin e identifikimit duke shoqeruar viktimen.

· *Bashkepunimi regional*: Forcat e policies Turke dhe Rumune kane zhvilluar aksione simultane ne adresa te trafikanteve ne Bukuresht dhe Stamboll. Trafikantet u arrestuan.

· *Bashkepunimi bilateral*: policia Turke veproi mbas nje informacioni te ardhur nga ambasada Bjelloruse. Informacioni u pasua nga nje investigim i hollesishem. Trafikantet u arrestuan.

#### VI. MUNGESAT

- Aplikimi i artikullit 80 te kodit penal nuk eshte gjithmone i mundur per shkak te perkufizimeve te limituara te dhena ne kete artikull. Ne keto raste aplikohet Artikulli 227 mbi prostitucionin.
- Trajnimi per zbatimin e ligjit duhet zgjeruar.
- Mekanizmat egzistues te identifikimit te viktimave nuk garantojne plotesisht qe te gjitha viktimat do te identifikohen dhe mbrohen.
- Ka nje mungese ne mekanizmat analizes, kerkues e monitorues
- Perdorimi i strukturave qeveritare per asistencen e viktimave eshte i limituar
- Ka nje mungese fondesh per te suportuar projektet e asistences se viktimave. Pjesa me e madhe e fondeve vjen nga burime internacionale.
- Mekanizmi i referimit kombetar eshte i limituar vetem ne riatdhesimin e viktimave.
- Sistemi i keshillimit ligjor duhet zhvilluar me teper.
- Mungesa e bashkepunimit regjional midis agjensive kompetente te shteteve te origjines dhe destinacionit mund te coje ne ritrafikim e riviktimizim
- Marrja pjese e viktimave ne gjyq nuk eshte e siguruar. Si rezultat, denimi i trafikanteve nuk eshte efektiv.

## VII. Vleresim nevojash

Duke marre parasysh mungesat e komentet qe permbahen ne kete raport dhe nevojen per permiresim te situates, nje liste me rakomandime paraqitet me poshte.

### RAKOMANDIME

1. Artikulli 80 duhet te modifikohet ne menyre qe te perfshije te gjitha format e trafikut te qenieve njerezore.
2. Trajnimi i pjesemarrsesve te institucioneve te zbatimit te ligjit duhet zgjeruar duke marre parasysh se ata periodikisht transferohen.
3. Trajnimi duhet te jete i vazhdueshem dhe i updatuar

4. Duhet siguruar standartizimi I moduleve te trajnimit.
5. Mekanizmat e identifikimit te viktimave duhet te permiresohen.
6. Mekanizmat kombetare per te luftuar trafikun duhet te ristrukturohen ne menyre qe te perfshine mekanizmat analizues, kerkimore e monitories.
7. raportet vjetore qe permbajne informacionin mbi numrin total te viktimave , sherbimin e ofruar e trajnimet duhet te pregatitet e publikohet nga Qeveria.
8. Strukturat qeveritare te asistences ndaj viktimave duhet te modifikohen ne menyre qe te suportojne viktimat e trafikut, duke siguruar perfshirjen e OJF-ve ne process.
9. Donatoret kombetare e nderkombetare duhet te inkurajohen per te siguruar fonde jo vetem per takime e konferenca, or gjithashtu per asistence praktike ndaj viktimave. Duhet gjetur nje zgjidhje e rinovueshme dhe stabile ne menyre qe te sigurohet vazhdimesia e ketyre sherbimeve.
- 10.Mekanizmat kombetare duhet te perfshine zgjidhje te ndryshme nga riatdhesimi.
- 11.Sherbimi I ndihmes ligjore duhet zhvilluar.
- 12.Ligjet, rregullat e sherbimet duhet te harmonizohen brenda regjonit dhe mekanizmat e komunikimeit mes shteteve te origjines dhe destinacionit te stabilizohen. Ky mekanizem sherben dhe si folloë up i reatdhesimit e reintegrimin ne menyre qe te evitohet ri viktimizimi.
- 13.Duhet bere modifikime ne menyre qe te sigurohet pjesemarrja e viktimave ne procesin gjyqesor.
- 14.Duke pasur ne mendje se refugjatet dhe kerkuesit azil, duke qene vulnerabel, mund te jene subject i trafikut, dhe anasjelltas, viktimat e trafikut mund te gezojne te drejten si azil kerkues, lidhja midis ketyre dy regjimeve duhet te jete e njohur dhe te zhvillohet me tej.

## UKRAINA

### 1.Parathënie.

Ukraina është një shtet i vendosur në Evropën Lindore. Në verilindje kufizohet nga Rusia, në veri nga Bjellorusia, në perëndim nga Polonia, Sllovakia dhe Hungaria, në jugperëndim nga Rumania dhe Moldavia ndërsa në jug nga Deti i Zi.

Kohët e fundit, për shkak të nivelit të ulët ekonomik të Ukrainës si edhe rritjes së nivelit të papunësisë, qytetarët emigrojnë me qëllim kërkimin e mundësive të punësimit jashtë vendit. Pamjaftueshmëria e përpjekjeve për reforma në sferën politike dhe ekonomike, korrupsioni në administratë, natyra vetëm deklaruese e politikave sociale, hendeku në rritje midis minorancës së pasur dhe majorancës së deprivuar. Pritshmëritë e pabarabazuara të viteve të para të pavarësisë rezultuan në mungesën e besimit në mundësinë për ndryshime pozitive në vend.

Kështu që, emigrimi konsiderohet nga brezi i ri, jo vetëm si një mënyrë për të zgjidhur përkohësisht problemet financiare, por gjithashtu si një aspiratë për stil jetese dhe një strategji për karrierë. Në ditët e sotme, pagat ekstremisht të ulëta, mirëqënia në nivelin e varfërisë, madje edhe për punë që lërkojnë kualifikim të lartë ( psh: mjek, personel mjekësor, mësues), konsiderohen si shkaktari kryesor i varfërisë, rezultojnë në një përmirësim të qëndrueshëm të kushteve të jetesës si edhe në rritjen e kriminalitetit.

Një faktor shtesë që ushqen dëshirën për të ikur nga vendi, është dhuna ndaj grave, sidomos dhuna në familje, e cila shpesh i shtyn gratë të kërkojnë kushte më të mira jetese jashtë Ukrainës.

Rreth 5 milion ukrainas kanë punuar jashtë shtetit të paktën për një vit. Më tepër se 1 milion prej tyre kanë punuar në Rusi. Megjithatë, në sezone të një lëvizshmërie të lartë ky numër shkon deri në tre milionë. Shumë ukrainas gabimisht i konsiderojnë vendet e Bashkimit Sovjetik si të sigurt, duke qenë se shumica e tyre kuptojnë gjuhën ruse. Një tjetër faktor tërheqës është fakti se proceduarat për të shkuar në këto vende të Evropës lindore nuk janë shumë të vështira, fakt i cili i bën këto kufij një itinerar perfekt për trafikimin e qenieve njerëzore. Rruga kryesore për trafikimin nga Ukraina janë: nga Republika autonome e Krimesë në Greqi, Turqi, Emiratet e Bashkuara Arabe, Portugali, Qipro, Izrael, Siri dhe Maqedoni; nga Donetsk, Lugansk dhe Kharkiv në Rusi, Serbi, Turqi, Liban, Maqedoni dhe Israel; nga



Ternopili në Itali,Greqi,Portugali dhe Spanjë; nga Zona e Zakarpatski ne Poloni,Hungari, Republikën Ceke dhe Rumani.

Një nga objektivat kryesore të kërkimit shkencor të realizuar në Ukrainë për vlerësimin e fenomenit të trafikimit, ishte studimi I etjes/padurimit të qytetarëve për t'u larguar jashtë vendit . rezultatet ne një nga anketimet e fundit janë zhgënjyese: 47% e qytetarëve nën 40 vjec kanë dëshirë të emigrojnë. Si për contrast, vetëm 10% e popullatës dëshirojnë të qëndrojnë në Ukrainë për gjithë jetën, 21% për disa vjet dhe 16% vetëm për disa muaj.

Kjo do të thotë se 50% e popullsisë I përket një grupi shumë të riskuar I cili shume lehtë mund të bëhet viktimë e rrjeteve të organizuara ë trafikimit. Sipas studimeve të Institutit Shtetëror për problemet e rinisë dhe familjes dhe ojf-ve të ndryshme ,lëvizjet më të mëdha të emigrimit vijnë nga qendrat rajonale, qytetet dhe fshatrat, që përfshijnë edhe njerëz të rinj të sapodiplomuar ose rreth moshës 25-27 vjec me familje të reja ( 50-60% e tyre kanë fëmijë).

### Koment

Punësimi jashtë vendit ka aspekte positive dhe negative: ofron mundësi dhe prespektiva më të mira, në terma materiale dhe jomateriale, porn ë të njëjtën kohë shkakton dëme të pariparueshme të strukturës familjare, sidomos për aq kohë sa bëhet fjalë për fëmijë në moshë të rritur.

Të dhënat e fundit të kërkimeve në lidhje me Ukrainën zbulojnë se pjesa më e madhe e viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore janë gra të reja në moshën 18-26 vjec , beqare, me arsimim të mesëm ose professional, me origjinë nga zonat rurale të Ukrainës.

Secili prej tyre ka nivel të ulët ekonomik. Përsa I përket meshkujve, shumica e tyre janë të martuar, 31-50 vjec, që lënë vendin për një kohë të shkurtër me qëllim që të fitojnë para mjaftueshëm për të siguruar kushte të mira jetese për familjet e tyre. Niveli I tyre arsimor është zakonisht I njëjti me ato të grave të trafikuar.

Shumica e fëmijëve të trafikuar janë të moshës 13 dhe 18 vjec, kryesisht vajza. Më shpesh vijnë nga familje problematike dhe që I janë nënshtruar dhunës në familje, nga baballarët apo njerëz të tyre. Trafikimi I fëmijëve për qëllime pornografike dhe prostitucion është në rritje. Përvec sa u përmend më lart,format e trafikimit të qënieve njerëzore dhe mënyrat e transportit ndryshojnë në mënyrë konstante duke paraqitur kështu sfida të reja. Përvoja e forcimit të strukturave

ligjore dhe puna e organizatave jo qeveritare me viktimat e trafikimit, lejon klasifikimin e viktimave në kategoritë e mëposhtme:

-Gratë që kane ikur jashtë vendit me dëshirën e tyre me qëllim

punësimit dhe janë bërë viktimat të trafikimit, përveç faktit se atom und të jenë përfshirë vetë ne rrjetin e prostitucionit.

-Gratë dhe më pak burrat, që e kanë lënë vendin me dëshirën e tyre, duke shpresuar punësimit në industri, por më vonë janë bërë viktimat të trafikimit.

- Njerëzit që janë larguar nga vendi i tyre me dëshirë por janë bërë viktimat të trafikimit për shkak të punës së detyruar.

-Njerëz që janë bërë viktimat të trafikimit brenda Ukrainës dhe më pas janë cuar jashtë vendit me dëshirën e tyre.

## Studim rasti

Në moshën 22 vjecare Olga kishte 2 fëmijë dhe kishte jetuar në Ukrainë gjatë gjithë kësaj kohe. Një shoqe i tregoi asaj për mundësinë e të punuarit si kërcimtare në një Klub të famshëm gjerman. Kjo shoqe i gjeti asaj 2 bileta për në Rusi. Kur Olga arriti në Moskë, kompania që i kishte siguruar biletat i mori pasaportën dhe e vendosi në një apartament me gra të tjera që vinin nga vende të ndrrshme të ish-Bashkimit Sovjetik.

Të gjitha gratë besonin se do të shkonin jashtë shtetit ku do të punonin për disa kohë. Një nga gratë i tha Olgës që grupi do të udhëtonte nga Gjermania në Egjipt.

Gratë ishin kthyer 2 herë nga Egjipti për në Rusi. Përveç faktit se stafi i aeroportit i kishte paralajmëruar disa herë për praktikën e shitjes së grave të reja në shtëpitë publike të Egjiptit dhe Israelit, ato nuk i morën parasysh këto paralajmërime dhe Olga besonte se së shpejti grupi i tyre do të arrinte në Gjermani. Megjithatë në vend të vajtjes në Evropë gratë e gjetën veten në shkretëtirë në drejtim të Israelit. Gjatë këtij udhëtimit, Olga u shit dhe u rishit 8 herë.

Ajo u detyrua të punojë në një shtëpi publike për 10-12 orë në ditë.

Pronari nuk e lejoi të përdorte kondomë pasi klientët paguanin më tepër për “seks natyral”. Kur Olga mbeti shtatzënë, ajo ju lut pronarit që ta lejonte të abortonte menjëherë, por ë vend të kësaj, ajo u cu ate mjeku kur ishte 4 muajshe.

Olga mundi t’ia mbathte nga shtëpia publike dhe filloi të punonte si kamarierë në një lokal. Gjatë një kontrolli rutinë për dokumentacion, ajo u arrestua dhe u dergua në burg në pritje të kthimit në vendin e saj.

Aty ajo takoi përfaqësues nga një OJF Israelite. Olga kërkoi që të kthehej në vendin e saj dhe kjo OJF e ndihmoi të kthehej e sigurt. Kur u kthye në Ukrainë, ajo u takua me punonjës in social të shoqatës: International Women’s Rights Centre ‘La Strada’ në Ukrainë, e cila I siguroi asistencë të mëtejshme.

Numri I fëmijëve të trafikuar me qëllimin e punësimit illegal, shfrytëzimit seksual, pornografi, adoptim illegal dhe lypje të detyruar , rritet në mënyrë të qëndrueshme. Fëmijët trafikohen si jashtë ashtu edhe brenda vendit, nga fshatrat në qendrat e mëdha industriale apo në qytete turistike. Në Ukrainë, më shpesh fëmijët bëhen viktima të trafikimit të brendshëm . Gjysma e viktimave-fëmijë, të trafikimit ndërkombëtar, zakonisht janë cuar në vendet fqinjë, kryesisht në Rusi dhe Moldavi.

Mënyra kryesore për ti detyruar fëmijët të trafikohen është duke i ofruar shpërblime dhe kushte favorizuese.

Megjithatë, ka shumë raste kur rekrutuesit kanë përdorur forma të ndryshme force. Është me vlerë përmendja e faktit se janë trafikuar fëmijë jo vetëm nga familje të varfra por edhe nga familje emër dhe të shtresave të larta.

Një anketë e realizuar nga ILO tregon se kontakti i parë me një trafikues, zakonisht ndodh afërsisht 4 muaj para trafikimit. Turizmi I seksit të fëmijëve, është përcaktuar si një shfrytëzim seksual I të miturve nga qytetarë të huaj- si nga gra ashtu edhe nga burra, që udhetojnë nga njëri vend në tjetrin vetem për këto qëllime. Kërkimet nga ECPAT International në Itali, tregojnë se mosha e turistëve të seksit është 21-40 vjec, megjithatë, turizmi i seksit nuk është një nga problemet më madhore në Ukrainë. Trafikimi I fëmijëve është një problem shumë dimensional. Marketi global “punëson” miliona fëmijë, duke dhunuar të drejtat e tyre për një fëmijëri të lumtur dhe nje jetë të denjë dhe produktive. Me qëllim përballimin e situatave të tilla, organizatat sociale dhe publike, duhet të dallojnë format e ndryshme të trafikimit dhe të gjejnë mënyra të përballueshme të riparimit dhe të identifikojnë prioritetet.

## Studim rasti

Në Yevpatoria ( Republika autonome e Krimesë), një nënë gjatë verës kishte përdoruar djalin e saj 10 vjecar për kontakte homoseksuale. Në Kiev, një nënë kishte shitur në dollarë vajzën e saj 9 vjecare. Ajo tha

se ishte shumë e kënaqur që po e shiste të bijën me një cmim të mirë, kështu që mund ti harxhonte ato para me shoqet e saj. Në rajonin e Zhytomyr, prindërit të cilët ishin alkoolikë, i dërguan vajzat e tyre të vogla “për një shëtitje” (shërbime seksi) dhe morën vodka si shpërblim. Fëmijët shtyhen drejt prostitucionit jo vetëm për të plotësuar nevojat më minimale, si strehimi, ushqimi por edhe për para xhepi apo të mira materiale që ata nuk mund ti përballojnë ndryshe. Sipas UNICEF, cdo ditë rreth 2800 fëmijë janë detyruar të prostitutojnë. Ato janë vajza dhe djem dhe ekspertët vërejnë një rritje të qartë të numrit të djemve që detyrohen të prostitutojnë.

## Studim Rasti

Natalka, sot 13 vjec, u lind në Luhansk. Ajo jetoi me nënë e saj që kur i ati i la kur ajo ishte vetëm 7 vjec. E ëma ndihej e dëshpëruar dhe filloi të pinte dhe në një moment, filloi të sillte në shtëpi burra të ndryshëm dhe e detyroi Natalkën të ikte nga shtëpia në mënyrë që ajo të kishte “një jetë private normale”.

Natalkës i duhej të flinte disa herë jashtë shtëpisë.

Një ditë Natalka, erdhi në shtëpi dhe e pa të ëmën duke bërë rrobat gati. Ajo e pyeti se çfarë ka ndodhur dhe e ëma e lumtur i tha se kishte takuar një njeri të mirë, i cili i kishte ftuar të dyja në Moskë. Ai ishte i pasur dhe to do të mund të vizitonin teatre dhe muzeume. Natalka u gëzua shumë, më në fund ajo do të kishte mundësi të kalonte shumë kohë me nënën e saj duke bërë shëtitje të gjata dhe duke vizituar qytetin e ri.

Në Moskë, ato takuan një burrë, një shokun e shokut të së ëmës. Ato hipën në makinë dhe shkuan në shtëpinë e tij.

Ai u tha se mund të rrinin atje për pak kohë. Ditën tjetër, e ëma e Natalkës dhe shoku i saj, i thanë vajzës se duhej që ti priste, pasi ata duhej të blinin biletat për në Luhansk.

Orët po kalonin dhe e ëma nuk u duk më. Ajo nuk u kthye kurrë dhe Natalka as sot nuk ka lajme prej saj. Burri që takoi Natalkën dhe nënën e saj në stacionin e trenit, e rrëmbeu vajzën dhe i tha se ajo duhet të punonte për të që nga ai moment. Ai do të ushqente, do ti blinte rroba dhe do ta lejonte të rrinte në apartamentin e tij, por në këmbim ajo do të bënte shërbime seksi për të.

Një mbrëmje, kur abuzuesi i saj ishte i dehur, Natalka ia mbathi. Ajo po ecte vetëm në errësirë kur e mori një patrulle policie. Ajo u cua në rajonin e policisë në qendrën e Administrimit të Ministrisë së

Brendshme të Ukrainës në Kiev. Për momentin, Nataalka jetoi në qëndrën e pritjes dhe megjithëse ajo është e lumtur atje, nuk është e sigurt se çfarë do të bëjë në të ardhmen.

Ndërgjegjësimi se trafikimi I qënieve njerëzore është një kërcënim për sigurinë kombëtare dhe për ekzistencën e një shteti demokratik, pa ashtu edhe një shkelje e madhe e të drejtave të njeriut, Ukraina u angazhua në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

Të dhënat e mbledhura rreth trafikimit të qënieve njerëzore në Ukrainë kanë nevojë për një trajtim gjithëpërfshirës të këtij krimi. Një trajtim I tillë kërkon :

Rishikim të legjislacionit; mbylljen e marrëveshjeve ndërkombëtare; përmirësimin e efikasitetit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e forcës së strukturave ligjore, institucioneve shtetërore dhe departamenteve; krijimin e një sistemi të masave parandaluese dhe adaptimin e masave të rehabilitimit social të viktimave.

## Kuadri ligjor kombëtar

### Ligji vendas

Platforma ligjore për luftën kundër trafikut të qënieve njerëzore në Ukrainë është e bazuar në parime që rrjedhin nga instrumenta ndërkombëtare të ratifikuara nga qeveria e Ukrainës si edhe nga Kushtetuta e Ukrainës e cila njih vlerat shoqërore dhe dinjitetin e qënieve njerëzore (neni 3), mbrojtje të veçantë për nënat e reja dhe për fëmijët (neni 51), si edhe mbështetje shtetërore për jetimët dhe fëmijët e privuara nga kujdesi prindëror (neni 52)

Deri në Mars 2008 Ukraina nuk ka patur një legjislacion penal specifik për trafikun e qënieve njerëzore, ku qeveria filloi që të ndërhyjë paraprakisht me ndryshimin e nenit 124/1 të Kodit Penal të mëparshëm të titulluar “Trafikimi I Qënieve Njerëzore”.

Ky formulim I ri shtrin ndëshkimin jo vetëm për trafikantët e femrave nëpërmjet forcës për industrinë e seksit, por gjithashtu edhe për çfarëdolloj qëllimi tjetër, trafikimin e fëmijëve si edhe trafikun e organeve.

Në vitin 2001, neni 124/1 I Kodit Penal u zëvendësua nga neni 149 me titull “ Trafikimi I personave ose marrëveshje të tjera të paligjshme për transferimin e individit”. Qysh prej Nëntorit 2005, numër I çështjeve penale bazuar në këtë nen ka arritur në 1 300.

Neni 149 e përcakton trafikun e qënieve njerëzore si: “ shitje ose formë tjetër pagese të një personi, ose çfarëdolloj tjetër transaksioni ilegal në lidhje me këtë person, përfshirë transferimin e ligjshëm ose të paligjshëm të këtij personi përgjatë kufirit shtetëror të Ukrainës, me ose pa pëlqimin e vetë personit me qëllimin e mëtejshëm të shtijes ose ndonjë forme tjetër pagese tek person(a) të tjerë për tu përdorur për shfrytëzim seksual, pornografi, përfshirjen në aktivitete kriminale, shlyerje borxhi, adoptimin për arsye komerciale, përdorimin në konflikte të armatosura ose për punë të detyruar”. Këto vepra penale dënohen me 3-8 vjet burgim.

Të njëjtat vepra penale ndëshkohen me 5-12 vjet burgim dhe me konfiskimin ose jo të pasurisë, ku kryhet ndaj të miturve, një grupi personash, në mënyrë të përsëritur, nëpërmjet një marrëveshje të fshehtë paraprake e një grupi, nëpërmjet shpërdorimit të detyrës, ose nga ndonjë person prej të cilit viktimja ka patur varësi financiare ose të çdo lloji tjetër.

Kur kjo realizohet nga një grup i organizuar, përfshirë transferimin e paligjshëm jashtë vendit, ose ndalimin e kthimit të tyre në Ukrainë, ose me qëllimin bindës për heqjen e organeve nga viktimja, ose dhurimin nëpërmjet forcës dhe kur kjo rezulton që të jetë e vazhdueshme vepra e përshkruar ndëshkohet me 8-15 vjet burgim, me ose pa konfiskim të pasurisë

Me qëllimin e përshtatjes së legjislacionit në lidhje me këtë subjekt, Qeveria e Ukrainës hartoi dhe miratoi Rregulloren Ndërdepartamentale e Këshillit Koordinues për Luftën Kundër Trafikut” (Nr.1961 dt.25.12.2002) dhe Rregullat Standarde për Qendrat e Rehabilitimit të Viktimave të Trafikut” (Nr.987, dt.27.06.2003).

Për të përmbushur detyrimet e Konventës Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, u amenduan nenet 149,303 të Kodit Penal.Në Janar 2006 Këshilli i Lartë i Ukrainës (Verkhovna Rada) miratoi ligjin “Për disa ndryshime në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Ukrainës si Përgjegjësi për Trafikun e Qënieve Njerëzore, për Qëllime Prostitucioni”.Në 12 Janar 2006 Parlamenti ukrainas miratoi ligjin “ Për disa ndryshime në Kodin Penal të Ukrainës në Përmirësimin e Përgjegjësive për Trafikun e Qënieve njerëzore dhe Shtyrjes në Prostitucion”

Ky ligj ndryshoi nenin 149 të Kodit Penal si më poshtë:

Neni 149: “Trafikimi i Personave ose marrëveshje të tjera të paligjshme për këtë qëllim”

Trafikimi i personave ose çfarëdolloj transaksioni tjetër ku objekti është një individ si edhe rekrutimi, transportimi, strehimi transferimi ose marrja e personit me qëllim përdorimin nëpërmjet mashtrimit, rrëmbimit ose duke shfrytëzuar pozitën e vështirë të tij dënohet me burgim 3-8 vjet

Kur veprat e mësipërme kryhen ndaj të miturve<sup>128</sup>, dy ose më shumë personave, në mënyrë të përsëritur, me marrëveshje të fshehtë ndërmjet personave, nëpërmjet shpërdorimit të detyrës, se nga ndonjë person prej të cilit viktima ka patur varësi financiare ose të çdo lloji tjetër, ose e shoqëruar me dhunë që rrezikon jetën ose shëndetin e personit të trafikuar ose familjarëve të tij ose çfarëdo lloj tjetër dhune autori dënohet me burgim 5-12 vjet si edhe me konfiskimin ose jo të pasurisë. Në se aktet e parashikuara në paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni konsumohen ndaj një personi infantil<sup>129</sup>, nga një grup i organizuar, ose e shoqëruar me dhunë që rrezikon jetën ose shëndetin e personit të trafikuar ose familjarëve të tij, ose shfaq vikueshmëri autori mund të dënohet me burgim 8-12 vjet si edhe me konfiskimin ose jo të pasurisë<sup>130</sup>.

#### Komente :

Konsiderohet si hap i rëndësishëm përfshirja në legjisllacionin së Ukrainës të parimeve të përshikuara në traktatet ndërkombëtare në fuqi, të miratuara nga Këshilli Suprem I Ukrainës. Në këtë mënyrë traktatet ndërkombëtare të përmendura më sipër plotësojnë kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar në Ukrainë.

Në përputhje me nenin 9 të Kushtetutës dokumentat ndërkombëtarë bëhen pjesë e legjisllacionit të brendshëm pas ratifikimit të tyre nga Parlamenti i Ukrainës. Në rast mospërputhje ndërmjet legjisllacionit vendas dhe atij ndërkombëtar ky I fundit ka prioritet.

Analistë ekspert kanë përcaktuar të meta në formulimet dhe përkufizimet e përfshira në kuadrin ligjor duke i dhënë një theks të veçantë faktit se është e mundur që të fillohet një procedim në lidhje me një transksion të paligjshëm vetëm kur kjo realizohet vetëm përtej kufirit shtetëror të Ukrainës (transferimet Brenda kufirit nuk dënohen nga ligji)

<sup>128</sup> Sipas Kodit të Familjes të Ukrainës I mitur konsiderohet çdo person 14-18 vjeç

<sup>129</sup> Sipas Kodit të Familjes të Ukrainës infantil konsiderohet çdo fëmijë mbi 14 vjeç

<sup>130</sup> Përkthim jozyrtar

## Marrëveshjet Dypalëshe

Nuk ka marrëveshje dypalëshe të veçanta të Ukrainës me shtete të tjera. Ky bshkëpunimi funksionin vetëm mbi bazën e parimeve të përgjithshme.

### c. Plani Kombëtar I Veprimit

Programi I Detajuar Anti-Trafik Lidhur me Parandalimin e Trafikut të Qënieve Njerëzore për 2002-2005 i miratuar me vendimin nr 766 dt.05.06.2002 të Këshillit të Ministrave ka përmirësuar punën në këtë drejtim.<sup>131</sup>

Sipas këtij programi tre janë drejtimet e punës kundër trafikut të qënieve njerëzore: parandalimin e trafikut të qënieve njerëzore, dënimi I trafikantëve dhe mbrojtja dhe riintegrimi I viktimave. Ky program i adresohet të gjitha viktimave në kundërshtim me të parin i cili u adreshej vetëm femrave dhe fëmijëve. Ndryshimi i emrit të tij ka një rëndësi të madhe, sepse e shtrin konceptin e trafikimit jo vetëm tek prostitucioni, por në një shkallë më të gjerë, e parashikuar kjo edhe në legjislacionin ukrainas dhe në Protokollin Plotësues për Parandalimin për Shfrytëzimin dhe Ndëshkimin e Individit, Veçantërisht të Grave dhe Fëmijëve, të Konventës së OKB-së Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

Puna për Programin e Veçantë Shtetëror 2006-2010 ka filluar në pranverën e vitit 2005, me diskutimet ndërmjet Ministrisë së Familjes, të Rinisë dhe Sporteve, UNICEF, dhe Qendrës Ndrëkombëtare për të Drejta e Grave (La Strada, Ukrainë), për ti dhënë një shtysë procesit. Këto objektiva u diskutuan edhe në tryeza të rrumbullakëta dhe tashmë ka një draft të gatshëm.

Ekipi Zbatues Qendëror po punon për hartimin e Programit Shtetëror në Luftën Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore 2006-2010, i cili në përputhje më rekomndimet e organeve qendërore ekzekutive, organizatat shoqërore dhe ndërkombëtare, mund të përfshijë edhe përcaktimet për emigracionin e punës, përshtatjen e legjislacionit,

---

<sup>131</sup> Ky është programi I 2-të qeveritar, Programi I Parë për Parandalimin e Trafikimit të Fëmijëve dhe Femrave u miratua me vendimin nr1768 të shtatorit 1999 të Këshillit të Ministrave. Programi i 3-të qeveritar për periudhën 2006-2010 është në proces miratimi



parandalimi i trafikut të fëmijëve, transplantit të organëve, rehabilitimit të viktimave etj.

### Komente:

Nga një vëzhgim sipërfaqësor I fakteve të mësipërme për punën e Programit Shtetëror në Luftën Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore rezulton se kjo nuk është asgjë tjetër përveç se zbatim në praktikë I parimit të bashkëpunimit ndërmjet organeve shtetërore me OJF-të vendase organizmave ndërkombëtare. Koordinimi I brendshëm I Programit Kompleks Anti-Trafik realizohet nga Këshilli Koordinues Ndërdetamentar për Luftën Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore I Këshillit të Ministrave të Ukrainës i drejtuar nga zv/kryeministri për çështjet e të drejtave të njeriut.

## Struktura e Përgjithshme

### Ngritja e Kapaciteteve

#### Shërbimi Social Shtetëror

Sistemi aktual I shërbime sociale është një rrjet me 700 qendra operative të rregullta në qytetet e vogla dhe fshatra.

Aktivitetet shoqërore praktike të Qendrave Rinore shtrihen në këto drejtime: ndihmë sociale për familjet, parandalimi I fenomeneve negative tek të rinjtë dhe të miturit, ndihmë për punësim dhe arsimim suplementar të adoleshentëve, punë shoqërore me ushtarët dhe oficerët, shkollë kombëtare e vullnetarëve, këshillim për jetën familjare për adoleshentët, punë shoqërore me familjet e paprivileguara dhe të mëdhaja, mbrojtje sociale për gratë e reja, aktivitete educative për parandalimin e HIV/AIDS, trafikimit të qënieve njerëzore etj. Ky program zbatohet në formën e shfaqjeve kulturore publike, trajnime, leksione, mbështetje sociale dhe inspektimi social. Qendrat për kundërveprim të trafikut të qënieve njerëzore ofrojnë këto forma të ndihmës: këshillime telefonike (191 linja ndihme telefonike), ndihmë ligjore, psikologjike dhe mjekësore për viktimat dhe mbështetje sociale për to

Ministria e Fëmijëve, Rinisë dhe Sporteve ka zhvilluar një punë praktike me publikun dhe viktimat e trafikut në bashkëpunim me OJF-të dhe qendrat e të rinjve. Është mbledhur një sasi të dhënash më së shumti nëpërmjet shërbimit helpline të realizuara nga shërbimi social dhe OJF-të si edhe nga organet zbatuese të ligjit. departamentet ministrore ofrojnë forma të ndryshme ndihme për viktimat e trafikut, ndihmë financiare, program shëndetësor për fëmijët, ndihmë nëpërmjet punësimit dhe edukimit, ndihmë shëndetësore dhe reduktim të borxheve të banesave.

Ministra e Punës dhe Politikave Sociale kontribuon në luftën kundër trafikut nëpërmjet: përgatitjes së shërbime këshillimore për të punësuarit dhe organizimit të trajnimeve profesionale për të papunët veçantërisht për të rinjtë, mësimet për përballimin e tregut të punës duke marrë në konsideratë karakteristikat e rajonit, zgjidhja e problemit të punësimit për të diplomuarit në universitete dhe në shkolla të mesme, ndihmë punësimi për të rinjtë nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit, monitorimi dhe ndërmjetësimi I aktiviteteve të ekipeve të punësimit, agjensi udhëtimi dhe martesë etj. Qendra Kombëtare e Punësimit është department I kësaj ministrie me aktivitet zbatimin e politikave shtetërore të punësimit. Ajo funksionon në rang qendror dhe local.

Ministria e Shëndetit Publik është një nga institucionet kryesore që ofrojnë ndihmë sociale për viktimat. Në kuadër të Programit Kompleks Anti-Trafik, ky institucion është përgjegjës për ndihmë ndaj viktimave dhe detyrat në vijim: hartimi dhe miratimi I rregullave specifike për qendrat e krizës dhe riintegrit, strehat për viktimat e trafikut dhe të dhunës, organizimi I seminareve dhe tryezave të rrumbullakëta, konferencave dhe trajnimeve në lidhje me trafikimin, avancimi i punës së mekanizmave të ndihmës për këto viktima në aspekt qendror dhe local, organeve zbatuese të ligjit, trupit diplomatic dhe konsullatave, institucioneve arsimore, qendrave shëndetësore, shërbimeve sociale, policisë së emigracionit dhe kufitare dhe përfaqësuesve të organizatave shoqërore. Përfaqësues të OJF-ve të cilat kanë mjek mund të aplikojnë në institucionet shëndetësore për ndihmë ndaj viktimave.

Ministria e Edukimit dhe Shkencës kujdeset kryesisht për mbështjen e të rinjve. Megjithatë kjo ministri veçantërisht Departamenti për Jetimët dhe Fëmijët e Privuar nga Kujdesi Prindëror, mund të përfshihen në punë sociale me fëmijët viktima të trafikut.

Departamente dhe institucione të tjera të kësaj ministrie ndihmë organizative dhe administrative për implementimin e programit anti-

trafik. Instituti Qendror i Edukimit Pedagogjik Pas-Universitar organizon rregullisht seminare me këtë subjekt duke ftuar përfaqësues të Qendrës Ndërkombëtare për të Drejta e Grave (La Strada-Ukrainë). Ekspertë të Ministrisë

Ekspert të Ministrisë së Edukimit dhe të Shkencës marrin pjesë në përgatitjen e materialeve metodologjike dhe informative psh. Manual Studimor dhe Mësimi dhe suplementi video Parandalimi I Trafikut të Qënieve Njerëzore. Qendra Metodike e Botimeve e Organizatës së Publikimit dhe Shpërndarjes së Materialeve Mësimore e shpërndau këtë manual në të gjitha shkollat e Ukrainës (rreth 20 000 kopje, 14 000 kopje në gjuhën ukrainase dhe 6 000 në rusisht). 5 000 kopje janë shpërndarë gjatë tryezave të organizuara me arsimtarët. Qendra Metodologjike për Arsimin e Mesëm në bashkëpunim me La Strada-Ukrainë, përgatiti dhe botoi material informativ dhe metodologjik I cili u shpërndau në institucionet e arsimit të mesëm në të gjithë Ukrainën Ndërmjet detyrave më të rëndësishme të Ministrisë së Punëve të Jashtme është ajo e mbrojtjes së interesave të qytetarëve që qëndrojnë në Ukrainë në periudhe të përhershme ose të përkohshme.

Ajo ofron informacion, këshillim dhe asistencë ligjore për qytetarët e Ukrainës në aspektin e punësimit, kujdesit shëndetësor etj, merr masa për ratifikimin dhe përafrimin e legjislacionit të brendshëm me dokumentat ndërkombëtarë që lidhen me trafikimin; punon në mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave me të gjitha mekanizmat vendase të kufirit si edhe me ato të fqinjëve, avancimin e metodave të hetimit të krimeve që lidhen me trafikimin.

Ndihmë të veçantë jep për shtetasit ukrainas të trafikuar për riatdhësimin, në bazë të kërkesës së tyre.

Gjithashtu ndihmon në përfshirjen e OJF-ve, organizatave ndërkombëtare përtë bashkëpunuar në luftën kundër trafikut të qënieve njerëzore, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rehabilitimi dhe riintegrimin e viktimeve etj.

Sipas statutit konsullor të Ukrainës, Konsulli i Ukrainës në një shtete të huaj, duhet të detyrohet të zbatojë regjistrimin e qytetarëve ukrainas që jetojnë në Disktiktin e Konsullatës përkohësisht apo për një kohë të gjatë; ti informojë qytetarët ukrainas që qëndrojnë përkohësisht në Disktiktin e Konsullatës, rreth legjislacionit të vendit mikpritës dhe traditave locale; bazuar në kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme sipas procedurave të vendosura, ai/ajo duhet të monitorojë kushtet e jetesës dhe edukimin e fëmijëve ukrainas të adoptuar që janë nën

moshën 18 vjec; Konsulli duhet të ketë të drejtën për të lëshojë dhe të rinovojë pasaportat ukrainase etj.

Përfaqësitë diplomatike mund ti ofrojnë shërbimet e mëposhtme viktimave të trafikimit: përgatitja e Certifikatës së Kthimit në Ukrainë për qytetarët ukrainas; financimi I udhëtimit të kthimit për në Ukrainë ( në raste të vecanta); asistencë në kërkimin e ukrainasve që kanë humbur jashtë vendit; lehtësimi I transportit në Ukrainë të trupave të personave që kanë vdekur jashtë vendit.

Policia Kufitare e Shtetit, asiston viktimat ukrainase të trafikimit dhe kontribuon në implementimin e projekteve për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Oficerët e Policisë kufitare mund ta parandalojnë trafikimin e qënieve njerëzore duke shpërndarë materiale informuese tek njerëzit që I përkasin grupeve vulnerabël dhe duke mbledhur informacion nga viktimat e riatdhesuara më qëllim identifikimin/asistimin e viktimave potenciale. Me lejen e viktimave, informacioni I tyre personal mund tu dërgohet OJF-ve ose ata mund ti ofrojnë materiale informuese rreth aktivitetit të OJF-ve në drejtim të asistimit të viktimave të trafikimit.

## B. Analiza, kërkimi shkencor dhe mekanizmat monitoruese.

Analiza, kërkimi shkencor dhe mekanizmat monitoruese janë elementë thelbësorë të një politike efektive anti-trafik. Një numër studimesh sociologjike mbi këtë temë janë realizuar; nje bazë të dhënash për grupin në rrezik është rinovuar mbi një bazë të rregullt dhe diskutime e konsultime individuale janë mbajtur.

Një shembll I mekanizmit monitorues janë raportet mbi implementimin Programit Gjithëpërfshirës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, I përgatitur nga Ministria e Familjes, Rinisë dhe Sporteve. Me qëllim luftën efikase ndaj trafikimit të qënieve njerëzore dhe formimin e një mekanizmi shtetëror të nevojshëm për parandalimin e tij, Këshilli I Koordinimit Ndërsektorial I luftës ndaj trafikimit të qënieve njerëzore, kryesuar nga Ministri I Familjes, Rinisë dhe Sporteve, është formuar nga Kabineti I Ministrave të Ukrainës.

Për një koordinim efikas të masave që kanë për qëllim parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore, Këshilli formoi në Dhjetor të vitit 2004, një Grup Pune me Ekspertë, I cili përbëhej nga profesionistë të

fushave të ndryshme që janë në mënyrë të drejtëpërdrejtë të përfshirë në veprimet e ndërmarra nga Programi Gjithëpërfshirës. Komitetet rajonale për Koordinimin dhe Shkëmbimin e të dhënave në Parandalimin e Trafikimit të qënieve njerëzore, veprojnë në cdo njësi administrative në vend. Nën projektin *Support of Regional Coordination Councils for Combating Trafficking in human beings in Seventeen Oblasts I Ukraines*, financuar nga IOM, Këshillat Konsultative për luftën ndaj trafikimit të qënieve njerëzore u vendosën në 7 njësi vëndore të Ukrainës (Ivano-Frankivsk, Zakarpatska, Khmeltsky, Poltava, Chernigiv, Sumy, dhe Kirovograd). Takimet e mbajtura në këtë strukturë rezultuan në një përpunim të udhëzimeve të bëra ndaj karakteristikave specifike të secilit rajon. Këto udhëzime u qarkulluan në Këshillin e Koordinimit për Luftën ndaj Trafikimit të Qënieve njerëzore.

### C. Bashkëpunimi dhe netëork-u në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Ministria e Punëve të Brendshme, është institucioni I vetëm I përgjegjshëm për implementimin e politikës shtetërore në luftën ndaj trafikimit të qënieve njerëzore. Koordinimi I parandalimit, identifikimit dhe investigimit të krimeve të lidhura me trafikimin e qënieve njerëzore, është marrë përsipër nga njësi speciale. Detyrat e tyre janë parandalimi, identifikimi, investigimi dhe zbardhja e krimeve, themelimi I procedurave kriminale dhe bashkëpunimi me organizata të tjera jo-qeveritare për të ofruar asistencë ndaj viktimave. Kur viktimat identifikohet, njësitë që luftojnë trafikimin e qënieve njerëzore, e referojnë atë tek OJF-të ose tek organizatat ndërkombëtare që mund të sigurojnë asistencë dhe një gamë të gjerë shërbimesh rehabilituese. Duke qenë se krimet e lidhura me trafikimin e qënieve njerëzore shumë shpesh lidhen me krimin e organizuar ndërkombëtar, Ministria e Punëve të Jashtme ka marrë masa për ndërtimin e një bashkëpunimi aktiv me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me struktura të tjera ligjore kombëtare, me autoritetet e duhura të vendeve të tjera dhe organizatat ndërkombëtare, në mënyrë të vecantë me OSCE, Europolin, dhe Këshillin e Evropës. Ministria e Punëve të Jashtme, e cila ka statusin e vëzhguesit në Këshillin e Shteteve të Detit Baltik (CBSS), bashkëpunon ngushtë me sekretariatit e (CBSS) kundrejt zgjidhjeve të Problemit të fëmijëve të

rrugës ka një pjesë active në organizimin e konferencave ndërkombëtare, seminareve dhe aktiviteteve me qëllim luftën ndaj trafikimit të qënieve njerëzore dhe emigracionit ilegal.

Ky plan vendosi një bashkëpunim të ngushtë në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme me focus të vecantë në çështjet e rrejimit dhe emigrimit, të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore , të parandalimit dhe luftës kundër shfrytëzimit seksual të të miturve dhe në çështjet e pornografisë së fëmijëve.

Bashkëpunimi I strukturave shtetërore me organizatat jo-qeveritare dhe ato ndërkombëtare në implementimin e politikave anti-trafik. Një bashkëpunim I tillë fokusohet në pjesëmarrjen në aktivitetet e mëposhtme: Konsultime; shkëmbim informacioni, seminare; tryeza të rrumbullakta; mbështetje organizacionale, administrative dhe financiare; pjesëmarrje në hartimin e planeve të përbashkëta të veprimit dhe elaborimit të një politike kombëtare për luftën ndaj trafikut të grave dhe rritjes së rolit dhe statusit të tyre.

Këto forma bashkëpunimi do të zhvillohen më tepër në të ardhmen.

Një numër I madh organizatash joqeveritare I kanë orientuar aktivitetet e tyre drejt parandalimit të trafikimit të qënieve njerëzore dhe asistimin e viktimave duke vendosur rrjete të organizatave joqeveritare kombëtare dhe rajonale. Në fazat e para të zhvillimit të saj, aktiviteti kryesor I *International Eomen's Rights Centre La Strada-Ukrainë*, ishte netëork-u me strukturat qeveritare, me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Familjes, Rinisë dhe Sporteve dhe Shërbimin Social Shtetëror, duke I bërë ata në partnerët kryesorë.

Si rezultat I këtij bashkëpunimi, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Ukrainë përgatiti në vitin 1998, një letër rekomandimi, duke I adresuar nevojën për punë parandaluese në fushën e trafikimit me përfshirjen e ekspertëve nga organizatat jo-qeveritare.

Letra u firmos nga Ministri dhe ju dërgua departamenteve dhe institucioneve të ndryshëm arsimor. Paskësaj, idea e bashkëpunimit midis institucioneve arsimore dhe organizatave jo-qeveritare u bashkua në Programin e Parandalimit të Trafikut të Grave dhe fëmijëve dhe ne Programin Gjithëpërfshirës Anti-trafik.

## Koment

Suksesi I cdo metode të implementuar nga organizatat jo-qeveritare varet nga përpjekjet për koordinimin dhe bashkëpunimin me strukturat shtetërore

### D. Mobilizimi I burimeve.

Programet qeveritare anti-trafik nuk financohen nga buxheti i shtetit. Kështu që, pjesa më e madhe e programeve në këtë fushë, janë realizuar nga organizatat jo-qeveritare me mbështetjen financiare të organizatave ndërkombëtare dhe qeverive të huaja. Organizatat Ndërkombëtare të mëposhtme, Agjensitë e Huaja për Zhvillim dhe OJF-të janë duke punuar në fushën e luftës kundër trafikut të qënieve njerëzore:

- USAID; -OSCE; -IOM;- ILO;
- International Labour Organization (ILO);
- International Women's Rights Centre 'La Strada' -Ukraine;
- Women's Consortium of the Ukraine;
- Ukrainian Centre for Educational Reforms, etj.

## IV. Implementimi I ligjeve Anti-Trafik

### A.Parandalimi dhe ndërgjegjësismi

Me qëllim luftën efikase ndaj trafikimit të qënieve njerëzore dhe formimin e një mekanizmi shtetëror të nevojshëm për parandalimin e tij, Këshilli Ndërsektorial I Koordinimit në Luftën kundër Trafikimit të qënieve njerëzore , kryesuar nga Ministri I familjes, rinisë dhe sporteve , është formuar nga Kabineti I Ministrave të Ukrainës.

Për një koordinim efikas të masave që kanë për qëllim parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore, Këshilli formoi në Dhjetor të vitit 2004, një Grup Pune me Ekspertë, I cili përbëhej nga profesionistë të fushave të ndryshme që janë në mënyrë të drejtëpërdrejtë të përfshirë në veprimet e ndërmarra nga Programi Gjithëpërfshirës.

Komitetet rajonale për Koordinimin dhe Shkëmbimin e të dhënave në Parandalimin e Trafikimit të qënieve njerëzore, veprojnë në cdo njësi administrative në vend.

Një tjetër element I rëndësishëm I luftës kundër trafikimi të qënieve njerëzore është rritja e ndërgjegjësimit në të gjitha aspektet e

problemit. Aktivitetet kryesore në këtë drejtim realizohen nga Ministria e Familjes, Rinisë dhe Sporteve.

Nën një program kompleks, departamente të ndryshme të ministrisë sigurojnë informacion ndaj më shumë se 26.260 njerëzve mbi çështje të zgjedhjes së karrierës dhe mundësive të punësimit për moshat e reja, prindërve beqare ose familjeve të varfra apo të rinjve që janë liruar nga burgu.

Ministria e Familjes, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale si edhe ministri dhe institucione të tjera, marrin pjesë në implemtimin e Programit Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së të Fëmijëve

(IPEC) në Ukrainë. Në nivel OJF-sh, me rëndësi të madhe janë aktivitetet arsimore dhe parandaluese që targetojnë direct gra dhe vajza nga grupe me rrezik potencial. Me qëllim organizimin e një pune të tillë, ishte shumë e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit midis zyrtarëve dhe strukturave qeveritare, për të siguruar mbështetjen e tyre dhe vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë.

## B.Mbrojtja dhe asistenca.

Një nga çështjet më thelbësore në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, është ofrimi i asistencës ndaj fëmijëve dhe grave viktime të trafikut. Në strukturën e Programit Gjithëpërfshirës Aniti-Trafik në lidhje me Parandalimi e Trafikimi të Qënieve Njerëzore për 2002-2005, Kabineti i Ministrave të Ukrainës në Dekretin nr. 9/89 të dt.27.06.2003, përshtati Masat Tipike për Qendrën Rehabilituese për Viktimat e Trafikut të Qënieve Njerëzore.

Funksioni i qëndës përfshinte: mbështetje ligjore dhe psikologjike të viktimave, ofrimi i ndihmës së parë mjekësore dhe referimin nëse është e nevojshme te specialistë të tjerë të shëndetit, akomodimin, organizimin e programeve individuale dhe në grup të rehabilitimit, ofrimi i një informacioni të përgjithshëm mbi aktivitete të qëndrës, programe të mundshme dhe aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë.

Qendrat riintergruese për viktimat e trafikuar luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e asistencës dhe lehtësimin e riintegrit. Aktivitetet e qëndrave të mëposhtme përfshijnë këshillimin ligjor për viktimat e trafikimit, ekzaminim mjekësor konfidencial dhe asistencë psikologjike dhe sociale.



Programet riintegruese të fokusuara në ofrimin e trajnimeve dhe organizmin e kurseve trajnuese dhe punësimin e viktimave, po ashtu edhe asistencën praktike në akomodimin dhe problemet e pronësisë. Me qëllim sigurimin e asistencës ndaj viktimave të trafikimit Minisria e Familjes, Rinisë dhe Sporteve në Ukrainë, në bashkëpunim me IOM dhe njësitë administrative përkatëse, krijuan në 2005 Qëndrat Rehabilituese Ndër-Rajonale për viktimat në Zhytomyr, Volyn, Chernivtsy, Lviv, dhe Kherson. Nga ana tjetër, OJF-të e fokusuara në aktivitetet me qëllim parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore dhe sigurimin e asistencës ndaj viktimave.

OJF-të aktive në këtë fushë janë:

- International Women's Rights Centre 'La Strada'-Ukraine;
- School of Equal Opportunities;
- Luhansk Regional Council of Women;
- Faith. Hope. Love. (Odessa);
- Youth Centre of Women's Initiatives (Sevastopol);
- Hope and Future (Simpheropol);
- Revival of the Nation (Ternopil);
- Vesta (Uzhgorod);
- Zhinocha Gromada (Women's Community) (Kharkiv);
- Lyubystok (Mykolayiv);
- Progressive Women (Vinnitsa);
- Pan Alliance against Commercial Sexual Exploitation of Children.

OJF-të e mëposhtme filluan organizimin e fushatave kundër trafikimit të qënieve njerëzore në Ukrainë, në fillim të vitit 1997, në kohën kur trafikimi i qënieve njerëzore akoma nuk kishte marrë vëmendjen e duhur nga qeveria.

The *International Women's Rights Centre La Strada*'-Ukrainë, ishte OJF-ja e parë që zhvilloi aktivitete të tilla.

Qëllimi i saj i përgjithëm ishte sensibilizimi i publikut të gjerë dhe i zyrtarëve ndaj problemit të trafikimit të grave si një shkelje e rëndë të të drejtave themelore të njeriut.

Gradualisht, fushatat ndërgjegjësuese kontribuan në një të kuptuar më të mirë të problemit dhe programe të reja u krijuan:

Krijimi i Planeve të Veprimit të përbashkëta me strukturat shtetërore, OJF të tjera dhe organizmata ndërkombëtare (1998-1999), zhvillimi i

aktiviteteve parandaluese (1999-2001), krijimi I një rrjeti të OJF-ve dhe përmirësimi I mekanizmit që ka të bëjë me asistencën ndaj viktimave të trafikut (2000-2002)..

Qendra adreson aspekte të ndryshme të problemit: asistencë ndaj viktimave të trafikut, mbajtja e një linje telefonike për ndihmë, kërkime në fushën e dhunës kundër grave, vlerësimi I akteve legislative në lidhje me aspekte të ndryshme të të drejtave të grave në Ukrainë, programet edukuese për të rinjtë mbi të drejtat e grave për parandalimin e trafikimit dhe formave të tjera të dhunës dhe shrytëzimit të grave. Përvec sa u përmend më sipër, qendra ndërmer gjithashtu aktivitete për rritjen e ndërgjegjësisim, të cilat përfshijnë:

Bashkëpunim I ngushtë me median, shpërndarja e materialeve informuese; publikimi I raporteve dhe memove mbi parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore dhe shpërndarja e tyre te gratë ukrainase, organizimi I ëorkshop-eve, seminareve dhe konferencave, bashkëpunimi me strukturat shtetërore me qëllim krijimin e nje Plani Veprimi Kombëtar që fokusohet në parandalimin e trafikimit, bashkëpunimi me ambasadat e huaja në Ukrainë dhe ambasadat ukrainase jashtë vendit, bashkëpunimi me OJF-të vendase dhe organizatat ndërkombëtare në urainë e jashtë, me qëllim parandalimin e trafikimit te gratë dhe ofrimi i asistencës ndaj viktimave.

### C.Ndjekja penale

Përvec përshtatjes së legjislacionit special që shpesh rinovohet me qëllim futjen e nevojave dhe tendencave të reja, masa praktike dhe organizacionale ishin gjithashtu adaptuar gjatë periudhës së rishikimit, me qëllim gjetjen dhe eliminimin e grupeve të organizuara kriminale të përfshira në trafikimin e qënieve njerëzore.

Një hap I rëndësishëm drejt këtij drejtimi ishte krijimi në Gusht të vitit 2005 të Departamentit për Luftën kundër Krimeve të lidhura më Trafikimin e qënieve njerëzore, brenda ministrisë se Punëve të Brendshme dhe në ndarjet repektive të njësive administrative. Në vtin 2005, u zbuluan më tepër se 3200 raste të transportit ilegal të të miturve që kaluan kufirin e Ukrainës, gjithashtu më tepër se 13 përpjekje të transportit ilegal dhe 40 raste të transportimit të të miturve nga qytetarë të huaj pa dokumenta të rregullta.

## V.PRAKTIKAT MË TË MIRA

Mund të thuhet se në periudhën 2002-2005 Ukraina vazhdoi të përmirësonte strategjitë e saj në luftën kundër trafikut të qënieve njerëzore, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Iniciativat e mëposhtme kishin një impakt pozitiv në këtë drejtim:

Komitetet për Koordinimin e Përpjekjeve dhe Shkëmbimin e të Dhënave për Parandalimin e Trafikimit të qënieve njerëzore operojnë në të gjitha zonat e vendit.

Departamenti për Luftën e Krimeve të lidhura me Trafikimin e qënieve njerëzore punon me efektivitet brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Puna Parandaluese që përfshin trajnimet, diskutimet dhe tavolinat e rumbullakta me target popullatën e gjerë është realizuar në të gjitha rajonet.

Organizatat Joqeveritare bashkëpunojnë me sukses dhe ofrojnë asistencë metodologjike dhe financiare ndaj viktimave.

Është formuar një Rrjet Qendrat Ndër-rajonale Rehabilituese dhe Riintegruese me strehim.

Janë realizuar Kërkime Sociologjike nga shkencëtare lidhur me këto çështje.

Është krijuar një Bazë të dhënash të Grupeve në rrezik.

Është mirëorganizuar puna parandaluese nëpërmjet Linjave Telefonike të ndihmës.

Janë implementuar masa për organizimin e Planeve të Punësimit për të rinjtë dhe gratë e papuna.

Monitorohen rregullisht aktivitetet e agjensive turistike, martesore dhe atyre të punësimit.

Informacion dhe asistencë ligjore u ofrohet shtetasve ukrainas që udhëtojnë jashtë vendit.

Programi Ndërsektorial i Asistencës Sociale për familjet e varfra, është implementuar me qëllim luftën e dhunës në familjes dhe trafikimin e të miturve.

## VI. MANGËSIRA

Megjithatë, dihet vënë re problemet e shumta që mbeten te pazgjidhura dhe fakti se trafikimi i qënieve njerëzore në Ukrainë mbetet aktual.

-Pjesërisht, rritja e trafikimit të qënieve njerëzore në Ukrainë vjen si rezultat i mungesës së informacionit të qytetarëve ukrainas në lidhje me mundësitë e punësimit jashtë vendit, gjithashtu edhe për mungesën e informacionit mbi pasojat e punës ilegale jashtë vendit.

- Mungesa e një sistemi funksional të mbrojtjes së viktimave.

- Dënimi I jo I plotë I kriminelëve, si pasojë e faktit që krimi i trafikimit të qënieve njerëzore është i vështirë për tu vërtetuar para gjykatës dhe shpesh abuzuesit I shpëtojnë ndëshkimit.

## VII. VLERËSIMI I NEVOJAVE

Duke marrë në konsideratë mangësitë dhe komentet e këtij raporti dhe nevojën për përmirësimin e situatës, më poshtë është hartuar një listë me rekomandime.

## REKOMANDIME

Mekanizmat për implementimin e instrumentave ligjorë ndërkombëtarë në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut duhet të zhvillohen. Ndërsa Kodi penal I Ukrainës përmban masa për ndëshkimin e krimeve të trafikimit, veprime të mëtejshme duhet të ndërmerren për të gjetur rrënjët që shkaktojnë problemin.

Është e nevojshme rritja e strukturës ligjore eksistuese me qëllim promovimin e riintegritimit total të personave të trafikuar.

Duke marrë në konsideratë masat e adaptuara dhe aktorët e ndryshëm që marrin pjesë në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, është I nevojshëm një koordinim efektiv, me qëllim arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe efektive.

## SHKURTIME

CBSS Sekretariat -Këshilli I Sekretariatit të Vendve të Detit Baltik

CBSS - Këshilli i Vendve të Detit Baltik

ECPAT International –Stop Prostituimit të Fëmijëve, pornografisë së fëmijëve dhe trafikimit të fëmijëve për qëllime seksuale.

EUROPOL –Zyra e Policisë Evropiane.

ILO- Organizata Ndërkombëtare e Punës.

IOM – Organizata Ndërkombëtare për Emigrimin.

IPEC – Programi Ndërkombëtar për Eleminimin e Punës së të miturve.

OSCE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

UNICEF – Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët.

USSR – Bashkimi I Republikave Sovjetike Socialiste

Aneks

Ratifikimi I Konventave Ndërkombëtare

	UN Protokoli I trafikimit <sup>26</sup>	UN CEDAE <sup>27</sup>	UN CRC <sup>28</sup>	UN CAT <sup>29</sup>	ILO	CoE -
SHQIPËRIA	21.08.2002	11.05.1994	27.02.1992	11.05.1994	02.08.2001	-----
Bosnja & Herzegovina	24.04.2002	01.09.1993	01.09.1993	01.09.1993	05.10.2001	-----
Bullgaria	05.12.2001	08.02.1992	03.06.1991	16.12.1986	28.07.2000	-----
Kroacia	24.01.2003	09.09.1992	12.10.1992	12.10.1992	17.07.2001	-----
Maqedonia	12.01.2005	18.01.1994	02.12.1993	12.12.1994	30.05.2002	-----
Greqia	-----	07.06.1993	11.05.1993	06.10.1988	06.11.2001	-----
Moldavia	16.09.2005	01.07.1999	26.01.1999	28.11.1999	14.06.2002	19.05.2006

<sup>26</sup> Protokoli I Kombeve të bashkuara për parandalimin dhe ndëshkimin e trafikimit të njerëzve, sidomos grave dhe fëmijëve.

<sup>27</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave.1979.

<sup>28</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve., 1989.

<sup>29</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër torturës dhe trajtimeve të tjera cnjerëzore ose ndëshkimit..1984.

Rumania	04.12.2002	4 07.01.198 2	93 28.09.19 90	95 18.12.19 90	13.12.2000	21.08.2006
Serbia	06.09.2001	1 12.03.200	01 12.03.20	01 12.03.20	10.07.2003	-----
Turqia	25.03.2003	5 20.12.198	95 04.04.19	88 02.08.19	02.08.2001	-----
Ukraina	21.05.2004	1 12.03.198	91 28.08.19	87 24.02.19	14.12.2000	-----

Shënime të rëndësishme:

Kohët e fundit Mali I Zi është bërë një shtet i pavaruar. Procesi I ratifikimit të Konventave ndërkombëtare sapo ka filluar, prandaj nuk është përfshirë në tabelën e mësipërme.

Serbia: Shteti I bashkuar I Serbisë dhe Malit të Zi, ishte kufizuar nga të gjitha diskutimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nga SFRY dhe FRY. Jugosllavia ka ratifikuar të gjitha konventat më të mëdha ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në 19 Maj Serbia dhe Mali I Zi firmosën Konventën e Këshillit të Evropës kundër trafikimit të qënieve njerëzore.